43. Një vëmendje tjetër thelbësore në definimin e klasave në NACE është rëndësia relative e veprimtarive, që duhet të përfshihen. Në përgjithësi, janë dhënat klasë të ndara për veprimtaritë që janë dominuese në shumicën e vendeve të BE-së, ose që janë të një rëndësie të veçantë në ekonominë e botës. Për ta fituar krahasueshmërinë ndërkombëtare janë futur disa klasa në strukturat e ISIC-së dhe prandaj janë përfshirë në NACE.

### Kriteret për Grupet dhe Ndarjet

44. Ndryshe nga klasat, procesi dhe teknologjia aktuale e prodhimit, e përdorur në veprimtaritë e prodhimit bëhet më pak e rëndësishme si kriter për grupimin e tyre në nivelet më të larta. Në nivelet më të larta (sektorët), karakteristikat e përgjithshme të mallrave dhe të shërbimeve të prodhuara, si dhe përdorimi potencial i statistikave, për shembull në kornizën e SNA-së dhe ESA-së, bëhen faktorë i rëndësishëm.

45. Kriteret kryesore të zbatuara në përcaktimin e grupeve dhe ndarjeve të NACE-së lidhur me karakteristikat vijuese të veprimtarive të njësive të prodhimit:

    - natyra e mallrave dhe e shërbimeve të prodhuara;
    - shfrytëzimet për të cilat mallrat dhe shëbimet janë vendosur; dhe
    - inputet, procesi dhe teknologjia e prodhimit.

46. Në rastin e natyrës së mallrave dhe shërbimeve të prodhuara duhet të kihet kujdes mbi përbërjen fizike dhe fazën e fabrikimit të artikujve dhe nevojave të shërbyera nga to. Dallimi i kategorive të NACE-së, në kuptim të natyrës së mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, siguron bazën për grupimin e njësive të prodhimit sipas ngjashmërive dhe lidhjet ndërmjet lëndëve të para të konsumuara dhe burimeve të kërkesës, si dhe tregjeve për artikuj.

47. Pesha e caktuar për kriterin e përshkruar më lartë ndryshon nga një kategori në tjetrën. Në një numër të shembujve (p.sh. prodhimtaria e ushqimit, tekstilit, rrobave dhe industrive të lëkurës, prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, si dhe industritë e shërbimit) të tri aspekteve specifike janë ngushtë të lidhura dhe se problemi i përcaktimit të peshave për kriteret nuk paraqitet. Në rastin e produkteve të ndërmjetme, përbërjes fizike dhe fazës së fabrikimit të artikujve shpesh u është kushtuar pjesa më e madhe. Në rastin e mallrave me procese të komplikuara të prodhimit, përdorimi i fundit, teknologjia dhe organizimi i prodhimit të artikujve, shpesh u jepet prioritet karshi përbërjes fizike të mallrave.

## 2.2 Veprimtaritë Kryesore, Sekondare dhe Ndihmëse

48. Një njësi mund të kryejë një ose më shumë veprimtari ekonomike, të përshkruara në një ose më shumë kategori të NACE-së.

49. Veprimtaria kryesore e njësisë statistikore është veprimtaria, e cila kontribuon më së shumti në totalin e vlerës së shtuar të asaj njësie. Veprimtaria kryesore e identifikuar sipas metodës “nga lartë poshtë” (shih sektorin 3.1) nuk llogaritet domosdoshmërisht për 50% ose më tepër e vlerës së shtuar të asaj njësie.

50. Veprimtaria sekondare është çdo veprimtari tjetër e njësisë, prodhimet e së cilës janë mallrat dhe shërbimet, që janë të përshtatshme për dorëzim te palët e treta. Vlera e shtuar e veprimtarisë sekondare duhet të jetë më e vogël sesa ajo e veprimtarisë kryesore.

51. Një dallim duhet të bëhet ndërmjet veprimtarive kryesore dhe sekondare në një anë dhe veprimtarive ndihmëse në anën tjetër. Veprimtaritë krysore dhe ndarëse në përgjithësi kryhen me përkrahjen e një numri të veprimtarive ndihmëse, siç janë: kontabiliteti, transporti, magazinimi, blerja, promovimet e shitjes, riparimi dhe mirëmbajtja, etj. Kështu, veprimtaritë ndihmëse janë ato që ekzistojnë vetëm për t’i mbështetur veprimtaritë ekonomike kryesore ose sekondare të një njësie, duke siguruar mallra ose shërbime për shfrytëzim, vetëm të asaj njësie.

52. Një veprimtari është ndihmëse nëse i përmbush të gjitha kushtet vijuese:

    a. i shërben vetëm njësisë ose njësive që i referohet;
    b. inputet i kontribuojnë shpenzimeve të njësisë;
    c. prodhimet (zakonisht shërbimet, e rrallëherë mallrat) nuk janë pjesë e produktit final të njësisë dhe nuk gjenerojnë formim të kapitalit fiks bruto;
    d. një veprimtari e krahasuesshme në një shkallë të ngjashme kryhet në njësitë e ngjashme të prodhimit.

53. Për shembull, veprimtaritë ndihmëse në vijim nuk duhet të llogariten si të tilla:

    a. prodhimi i mallrave dhe shërbimeve, që janë pjesë e formimit të kapitalit; për shembull, punët ndërtimore për llogari të veten, që mund të klasifikohen ndaras nga ndërtimi, nëse të dhënat janë të mundshme, si dhe prodhimi i softwerëve;

b. prodhimi i artikujve, një pjesë e rëndësishme e të cilëve shiten në treg, madje edhe nëse pjesa e tij konsumohet në lidhje me veprimtaritë kryesore;
c. prodhimi i mallrave ose shërbimeve, të cilat si pasojë bëhen pjesë integrale e prodhimit të veprimtarisë kryesore ose sekondare (p.sh. prodhimi i kutive nga një department i një ndërmarrjeje për paketimin e produkteve të saj);
d. prodhimi i energjisë (trafostacioni i integruar i energjisë ose të termocentrali me koks), madje edhe nëse i tërë prodhimi konsumohet nga njësia amë;
e. blerja e shërbimeve për rishitje, në një gjendje të pandryshuar;
f. hulumtimi dhe zhvillimi, pasi këto veprimtari nuk japin shërbim, që konsumohet gjatë procesit të prodhimit aktual.

54. Në të gjitha rastet, ku të dhënat e ndara janë të mundshme, njësitë e veçanta duhet të dallohen dhe të pranohen si njësi të llojit të veprimtarisë (shih sektorin e ardhshëm) dhe pastaj të klasifikohen sipas veprimtarisë së tyre.

## 2.3 Definicionet e Njësive Statistikore

55. Për ta paraqitur një fotografi të plotë statistikore të ekonomisë kërkohet një fushë e gjerë e informacionit dhe nivel organizativ, në të cilin është i mundshëm të mblidhet informacioni, që ndryshon varësisht nga lloji i të dhënave. Për shembull, të dhënat e profilit për një kompani mund të jenë të arritshme vetëm nga një lokacion qendror, gjeografikisht, duke iu referuar disa lokacioneve të ndryshme. Ndërsa, të dhënat e shitjes së produktit mund të jenë të arritshme për secilin lokacion të ndarë. Për t'i vëzhguar dhe analizuar të dhënat, në mënyrë të kënaqshme është e nevojshme të definohet një sistem i njësive statistikore. Këto formojnë blloqet e referencës së ndërtimit lidhur me atë se cilat të dhëna mund të mblidhen dhe të klasifikohen sipas NACE-së.

56. Llojet e ndryshme të njësive statistikore i plotësojnë nevojat e ndryshme. Por, çdo njësi është entitet specifik, e cila definohet në atë mënyrë që të mund të njihet dhe të identifikohet, si dhe të mos ngatërrohet me ndonjë njësi tjetër. Ai mund të jetë entitet i identifikueshëm legal ose fizik, ose si për shembull, në rastin e njësisë së prodhimit homogjen të një konstrukti statistikor.

57. Në vijim janë njësitë që janë përshkruar në Rregulloren e Këshillit mbi njësitë statistikore[9]:

a. grupi i ndërmarrjes;
b. ndërmarrja;
c. njësia e llojit të veprimtarisë (angl. KAU);
d. njësia lokale;
e. njësia lokale e llojit të veprimtarisë (angl. Local KAU);
f. njësia institucionale;
g. njësia e prodhimit homogjen (angl. UHP);
h. njësia lokale e prodhimit homogjen (angl. Local UHP).

---

[9] Council Regulation (EEC) No 696/93 of 15 March 1993 on the statistical units for the observation and analysis of the production system in the Community (OJ No L 76, 30.3.1993, p. 1).

Marrëdhënia (lidhshmëria) ndërmjet llojeve të ndryshme të njësive statistikore është ilustruar në tabelën vijuese:

| **UHP** | **UHP Lokale** | **UHP** |
|---|---|---|
| Një ose më shumë veprimtari | Ndërmarrje | Njësi lokale |
| | Njësi institucionale | |
| Një veprimtari e vetme | KAU<br>UHP | KAU lokale<br>UHP lokale |

Sistemi i njësive administrative dhe statistikore mund të ilustrohet si në vijim:



# Rregullat e Klasifikimit për Veprimtari dhe Njësi

## Kapitulli 3

## 3.1 Rregullat e Klasifikimit Themelor

58. Një kod i NACE-së caktohet për çdo njësi të regjistruar në regjistrat[10] statistikorë të biznesit, sipas veprimtarisë së tij kryesore. Caktimi i kodit të NACE-së ndihmohet nga: shënimet sqaruese të NACE-së, vendimet e marra nga Komiteti i menaxhimit të NACE-së, tabelat e korrespondencës dhe referenca për sistemet e tjera të klasifikimit, siç janë: ISIC, CPA, HS, CN, etj.

59. Në rastin e thjeshtë kur një njësi kryen vetëm një veprimtari ekonomike, veprimtaria kryesore e asaj njësie përcaktohet nga kategoria e NACE-së, e cila e përshkruan atë aktivitet. Nëse njësia kryen disa veprimtari ekonomike (të ndryshme nga veprimtaritë ndihmëse, sektori 2.2), veprimtaria kryesore përcaktohet në bazë të vlerës së shtuar, e shoqëruar për secilën veprimtari sipas rregullave të paraqitura më poshtë.

60. Vlera e shtuar është koncepti themelor për përcaktimin e klasifikimit të një njësie sipas veprimtarive ekonomike. Vlera e shtuar bruto definohet si diferencë ndërmjet prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm. Vlera e shtuar është një masë shtesë e kontributit të çdo njësie ekonomike për Bruto Produktin Vendor (BPV)

### Zëvendësuesit e Vlerës së Shtuar

61. Për ta përcaktuar veprimtarinë kryesore të një njësie, duhet të dihen veprimtaritë e kryera nga njësia dhe pjesa korresponduese e vlerës së shtuar. Nganjëherë, nuk është e mundur të merren informata mbi vlerën e shtuar, të shoqëruar me veprimtaritë e ndryshme të kryera dhe klasifikimi i veprimtarive duhet të përcakohet, duke përdorur kriterin e zëvendësimit. Kritere të tilla duhet të jenë:

   a. Zëvendësues bazuar në prodhim:

      - bruto produkti i njësisë, që është i atribueshëm për mallra ose shërbime, të shoqëruara në çdo veprimtari,
      - vlera e shitjeve ose e qarkullimit të këtyre grupeve të produkteve, që bien në kuadër të çdo veprimtarie.

   b. Zëvendësuesit e bazuar në input:

      - mëditjet dhe rrogat e atribuara për aktivitete të ndryshme (ose të ardhurat e vetëpunësuarve),
      - numri i stafit të angazhuar në veprimtaritë e ndryshme ekonomike të njësisë,
      - koha e punuar nga stafi, e atribuar për veprimtaritë e ndryshme të njësisë.

62. Kriteri i tillë i zëvendësimit duhet të përdoret si procedurë për të dhënat e vlerës së shtuar të panjohur, për ta fituar përafrinë më të mirë të mundshme të rezultatit, i cili do të ishte mundur të fitohej në bazë të të dhënave të vlerës së shtuar. Përdorimi i kritereve të zëvendësimit nuk i ndryshon metodat e përdorura për ta përcaktuar veprimtarinë kryesore, pasi që ato të jenë vetëm të dhëna vepruese të përafrimit të vlerës së shtuar.

63. Megjithatë, përdorimi i thjeshtë i kritereve të zëvendësimit të cekura më lartë, mund të çojnë në rrugë të gabuar. Gjithnjë do të ketë rast kur struktura e kritereve të zëvendësimit nuk është drejtpërdrejt proporcionale me vlerën e shtuar (të panjohur).

[10] Rregullorja e Këshillit (EEC) No 2186/93

64. Kur përdoret shitja (qarkullimi) si përfaqësim për vlerën e shtuar duhet të merret parasysh se në disa raste qarkullimi dhe vlera e shtuar nuk janë proporcionale, p.sh, qarkullimi në tregti zakonisht ka një pjesë shumë më të ulët të vlerës së shtuar sesa qarkullimi në prodhimtari. Madje, në kuadër të prodhimit, relacioni ndërmjet shitjes dhe vlerës së shtuar rezultuese mund të ndryshojë edhe në kuadër të veprimtarive. Për disa veprimtari, qarkullimi definohet në një mënyrë të veçantë, që bën krahasimin me veprimtaritë e tjera, si jo të dobishme, p.sh, veprimtaritë e ndërmjetësimit financiar ose veprimtaritë e sigurimit. Konsiderata të njëjta duhet të merren parasysh kur përdoren të dhënat e Bruto Produktit si kritere të zëvendësimit.

65. Shumë njësi kryejnë veprimtari tregtare dhe të tjera. Në raste të tilla, shifrat e qarkullimit tregtar janë indikatorët më të papërshtatshëm për pjesën e panjohur të vlerës së shtuar të veprimtarisë tregtare. Një indikator shumë më i mirë është bruto marzha (diferenca ndërmjet qarkullimit tregtar dhe blerjeve të mallrave për rishitje, të përshtatura sipas ndryshimeve në stoqe). Megjithatë, marzha tregtare mund të ndryshojë brenda një tregtie të vetme me shumicë dhe pakicë, si dhe ndërmjet veprimtarive tregtare. Përveç kësaj, duhet t'u kushtohet kujdes rregullave të klasifikimit specifik për tregti, siç përshkruhen në sektorin 3.4.

66. Përkujdesje të ngjashme duhet të merren parasysh edhe kur zbatohen kriteret e zëvendësimit në bazë të inputit. Proporcionaliteti mes meditjeve dhe pagave në një anë dhe vlera e shtuar në anën tjetër nuk është i sigurtë nëse intesiteti i punës i veprimtarive të llojllojshme është i ndryshëm. Intesiteti i punës mund të ndryshojë në mënyrë thelbësore mes veprimtarive të ndryshme ekonomike dhe gjithashtu mes veprimtarive të së njëjtës klasë të NACE-së. Shembull: prodhimi i mallit me dorë përballë prodhimit të mallit duke përdorur proces të mekanizuar.

## 3.2 Veprimtaritë e Shumëfishta dhe të Integruara

67. Raste të tilla mund të paraqiten kur shuma të mëdha të veprimtarive të një njësie janë të përfshira në më tepër se një klasë e NACE-së. Këto raste mund të rezultojnë nga integrimi vertikal i veprimtarive (p.sh, prerja e drunjve e kombinuar me kantierin e sharrës, ose veprimtaritë në një punëtori të argjilit e kombinuar me punët e tullave), ose integrimin horizontal të veprimtarive (p.sh, prodhimi i produkteve të furrës i kombinuar me prodhimin ëmbëlsirave të çokollatës), ose çdo kombinim i veprimtarive në kuadër të një njësie statistikore. Në këto situata, njësia duhet të klasifikohet sipas rregullave të përshkruara në këtë sektor.

68. Nëse një njësi kryen veprimtari që bien vetëm në dy kategori të ndryshme të NACE-së, gjithmonë do të ketë një veprimtari që llogaritet për më tepër se 50% të vlerës së shtuar, përveç në rast që nuk ka gjasa fare, që të dy veprimtaritë në kategori të ndryshme të kenë pjesë të barabarta në 50%. Veprimtaria që përfaqëson më tepër se 50% të vlerës së shtuar është veprimtaria kryesore dhe përcakton klasifikimin e NACE Rev. 2 të njësisë.

69. Në rastin e ndërlikuar, kur njësia kryen më shumë se dy veprimtari, që bien në më tepër se dy kategori të ndryshme të NACE-së, me asnjërën prej tyre më tepër se 50% të vlerës së shtuar, klasifikimi i veprimtarisë së njësisë duhet të përcaktohet duke përdorur metodën "nga lart-poshtë ("top-down"), siç pëshkruhet më poshtë.

## Metoda "Nga Lart-Poshtë"

70. Metoda "nga lart-poshtë" zbaton një parim të hierarkisë: klasifikimi i njësisë në nivelin më të ulët të klasifikimit duhet të bëhet në pajtim me klasifikimin e njësisë së niveleve më të larta të strukturës. Për ta përmbushur këtë kusht, procesi fillon me identifikimin e nivelit më të lartë relevant dhe progreset, duke shkuar teposhtë nëpër nivelet e klasifikimit, në mënyrën vijuese:

a. identifikimi i sektorit që ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar;

b. brenda këtij sektori, të identifikohet ndarja që ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar;

c. brenda kësaj ndarjeje, të identifikohet grupi që ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar;

d. brenda këtij grupi, të identifikohet klasa që ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar.

71. Shembull: një njësi kryen veprimtari (pjesët në kushtet e vlerës së shtuar):

| Sektori | Ndarja | Grupi | Klasa | Përshkrimi i klasës | Përqindja |
|---|---|---|---|---|---|
| C | 25 | 25.9 | 25.91 | Industria e çelikut për rrugë dhe kontejnerë të ngjashëm | 10% |
| | 28 | 28.1 | 28.11 | Prodhimi i motorëve dhe turbinave, me përjashtim të aeroplanëve, të automjeteve dhe ciklit të motorëve. | 6% |
| | | 28.2 | 28.24 | Prodhimi i energjisë drejtuar mjeteve të dorës | 5% |
| | | 28.9 | 28..93 | Prodhimi i makinerive për ushqim, pije dhe përpunimin e duhanit | 23% |
| | | | 28.95 | Prodhimi i makinerive për letër dhe karton | 8% |
| G | 46 | 46.1 | 46.14 | Agjentët e përfshirë në shitjen e makinerive, paisjeve industriale, anijeve dhe aeroplanëve | 7% |
| | | 46.6 | 46.61 | Shitja me shumice e makinerisë bujqësore, paisje dhe furnizime | 28% |
| M | 71 | 71.1 | 71.12 | Veprimtaritë inxhinierike dhe konsulentët tjetër teknik | 13% |

- Identifiko sektorin kryesor ndërmjet
  Sektori C – Prodhimi 52%
  Sektori G –Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletat 35%
  Sektori M – Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike 13%
- Identifiko ndarjen kryesore brenda Sektorit kryesor C:
  Ndarja 25 Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike,

| | | |
|---|---|---|
| | përveç makinerisë dhe pajisjeve | 10% |
| Ndarja28 | Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t. | 42% |

- Identifiko grupin kryesor në kuadër të ndarjes 28:

| | | |
|---|---|---|
| Grupi 28.1 | Prodhimi i makinerisë për qëllime të përgjithshme | 6% |
| Grupi 28.2 | Prodhimi i makinerisë tjetër për qëllime të përgjithshme | 5% |
| Grupi 28.9 | Prodhimi i makinerisë tjetër për qëllime specifike | 31% |

- Identifiko klasën kryesore brenda grupit grupit kryesor 28.9:

| | | |
|---|---|---|
| Klasa 28.93 | Prodhimi i makinerisë për procesimin e ushqimit, pijeve dhe duhanit | 23% |
| Klasa 28.95 | Prodhimi i makinerisë për prodhimin e letrës dhe kartonit | 8% |

Prandaj, klasa e saktë është 28.93: Prodhimi i makinerisë për procesimin e ushqimit, pijeve dhe duhanit, edhe pse klasa me pjesën më të madhe të vlerës së shtuar është: 46.61 Tregtia me shumicë e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe furnizimeve.

Figura vijuese paraqet përshkrimin e mënyrës së zbatuar në shembullin konkret.




72. Për shkak të vështirësive ndërmjet ISIC-së dhe NACE-së në grup dhe nivele të klasave, zbatimi i metodës "nga lartë – poshtë" në NACE mund të japë ndarje ndryshe nga ato që do të ishin fituar duke zbatuar metodën e ISIC. Nëse është e mundur, metoda duhet të zbatohet së pari në kushtet e ISIC, duke e identifikuar klasën e ISIC dhe pastaj sipas NACE-së. Kjo do të mund të siguronte radhitjen me klasifikimet botërore.

73. Kur kjo aplikohet te sektori G "Tregtia me shumicë dhe pakicë", kërkohet një adaptim specifik i metodës "nga lart-poshtë". Për detaje, shih më poshtë paragrafët 93-99.

## Ndryshimet e Veprimtarisë Kryesore të Njësisë

74. Njësitë mund ta ndryshojnë veprimtarinë e tyre kryesore menjëherë ose gradualisht gjatë një periudhe kohore, ose për shkak të faktorëve sezonalë ose për shkak të vendimit të menaxhmentit për ta ndryshuar mostrën e prodhimit. Derisa, të gjitha këto raste kërkojnë që të ndryshohet klasifikimi i njësisë, shumë shpesh ndryshimet mund të rezultojnë në mospërputhje ndërmjet statistikave afatshkurta (mujore dhe tremujore) dhe statistikave afatgjata, duke e bërë interpretimin e tyre tepër të vështirë.

75. Sa herë që një njësi kryen dy veprimtari, që të dyja duke kontribuar në rreth 50% të vlerës së shtuar. Ekziston një rregull e caktuar për t'iu shmangur ndryshimeve të shpeshta, duke mos pasqyruar ndryshimin substancial në realitetin ekonomik. Sipas kësaj rregulle, ndryshimi i veprimtarisë kryesore duhet të bëhet kur veprimtaria aktuale është llogaritur për më pak se 50% të vlerës së shtuar, për së paku dy vjet.

### Trajtimi i Veprimtarive të Integruara Vertikalisht

76. Integrimi vertikal i veprimtarive ndodh kur fazat e ndryshme të prodhimit kryhen në vazhdimësi nga e njëjta njësi dhe kur prodhimi i një procesi shërben si input për tjetrin. Shembuj të integrimit të zakonshëm vertikal përfshijnë: prerja e drunjve dhe kantieri i sharrës; në vijim punëtoria e argjilit e kombinuar me punëtorinë e tullave; ose prodhimi i rrobave në një fabrikë të tekstilit.

77. Kur aplikohet NACE Rev. 2, integrimi vertikal duhet të realizohet si çdo tjetër nga veprimtaritë e shumëfishta, p.sh. veprimtaria kryesore e njësisë është veprimtaria që llogaritet me pjesën më të madhe të vlerës së shtuar, të përcaktuar sipas metodës "nga lart-poshtë". Ky trajtim ka ndryshuar nga versionet e mëparshme të NACE-së. Për integrimin vertikal të situatave specifike në bujqësi, shih paragrafin 92.

78. Nëse vlera e shtuar ose zëvendësuesit nuk mund të përcaktohen për hapat individualë në një proces të integruar vertikalisht, drejtpërsëdrejti nga llogaritë e përpiluara nga vetë njësia, mund të shfrytëzohen karahasimet me njësi të ngjashme. Në mënyrë alternative, vlerësimi i produkteve finale ose të ndërmjetme mund të bazohet në çmimet e tregut.

### Trajtimi i Veprimtarive të Integruara Horizontalisht

79. Integrimi horizontal i veprimtarive ndodh kur veprimtaritë kryhen në të njëjtën kohë, duke përdorur të njëjtit faktorë të prodhimit. Parimi i vlerës së shtuar duhet të zbatohet duke zbatuar metodën "nga lart-poshtë" dhe këtu duhet të zbatohen të njëjtat masa paraprake për shfrytëzimin e zëvendësuesve të radhitur më lartë.

## 3.3 Rregullat për Veprimtaritë Specifike

### Veprimtaritë e ndërmarra në bazë të pagesës dhe të veprimtarive nga agjencionet e tjera private

80. Ky sektor përmban rregullat e agjencioneve të tjera private për fushat e zgjedhura. Për rregullat e plota të agjencioneve private, shih Aneksin II të këtij publikimi.

    a. Kryesore = Njësia që hyn në marrëveshje kontraktuese me një njësi tjetër (>*kontraktuesi*) që njësia tjetër të kryejë detyra specifike, siç janë pjesët e procesit të prodhimit ose madje procesin e plotë të prodhimit, shërbimet e punësimit ose funksionet e mbështetjes.

    b. Kontraktuese = Njësia që kryen detyra specifike, siç janë: pjesët e procesit të prodhimit ose madje procesin e plotë të prodhimit, shërbimet e punësimit ose funksionet e mbështetjes në një marrëveshje kontraktuese me një - k*ryesore*. Termi *nënkontraktues*

gjithashtu përdoret. Në NACE, veprimtaritë e kryera nga *kontraktuesi* janë të emërtuara si: “në bazë të pagesës ose kontratës”.

c. Agjencionet private = marrëveshje kontraktuese sipas së cilës k*ryesorja* kërkon nga *kontraktuesi* t’i kryejë detyrat specifike, siç janë: pjesët e procesit të prodhimit ose madje procesin e plotë të prodhimit, shërbimet e punësimit ose funksionet e përkrahjes.

Kushti i Agjencionit privat është valid, gjithashtu nëse *kontraktuesi* është njësi ndihmëse dhe nëse detyrat kryhen mbi kushtet e tregut ose jo.

Shembuj të pjesëve të prodhimit, që mund të kryhen nga agjencionet private janë: veprimtaritë e prodhimtarisë, shërbimet e punësimit, funksionet e mbështjetjes, etj.

*Kryesorja* dhe *kontraktuesi* mund të vendosen në kuadër të të njëjtit teritor ekonomik ose në teritore të ndryshme ekonomike. Lokacioni aktual nuk ndikon në klasifikim të asnjërit prej këtyre njësive.

81. Kontraktuesit, p.sh. njësitë që kryejnë një veprimtaritë në bazë të pagesës ose kontratës, zakonisht janë të klasifikuara me njësitë që prodhojnë të njëjtat mallra ose shërbime për llogarinë e vet, përveç në tregti (shih paragrafet 93-99, nën shënimet sqaruese të sektorit G) dhe në ndërtimtari (në rast të kompanive të jashtme në veprimtaritë ndërtimore, k*ryesorja* duhe të klasifikohet në 41.10 dhe k*ontraktuesi* në 41.20).

82. Në prodhimtari, k*ryesorja* i jep kontrakuesit specifikat teknike, që veprimtaria prodhuese të kryhet në materialin e inputit. Materiali i inputit (lëndë e parë ose mall i ndërmjetëm) mund të sigurohet (zotërohet) nga k*ryesorja* ose jo. Shembuj të këtyre veprimtarive janë: prodhimtaria e metaleve (farkëtimi, modelimi, prerja, stampimi dhe punët e shkritores); procesimi i metaleve (p.sh. fletëzimi i kromit); prodhimtaria e rrobave, prodhimi final i rrobave ose të pjesëve të ngjashme elementare të procesit të prodhimit.

83. Një k*ryesor*e, e cila plotësisht bën procesin e transformimit me kompani private duhet të klasifikohet sipas prodhimtarisë, vetëm nëse ajo zotëron lëndën e parë të përdorur si input për procesin e prodhimit (dhe prandaj edhe e zotëron prodhimin final). Një k*ryesore,* e cila kryen vetëm një pjesë të procesit të transformimit nga kompanitë private, duhet të klasifikohet sipas prodhimtarisë. Në të gjitha rastet, k*ryesoret* duhet të klasifikohen në pajtim me parimin e vlerës së shtuar: kjo mund të gjendet në sektorin G “Tregtia me shumicë dhe pakicë” (varësisht nga veprimtaria dhe malli specifik i shitur. Shih më poshtë paragrafët 93-99) ose në sektorët e tjerë, p.sh. M “Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike, ose në N “Veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe të përkrahjes”.

84. Në rast të angazhimit të kompanive private në shërbimet e punësimit, duhet të bëhet një dallim ndërmjet kompanisë në bazë të kontratës së përkohshme ose afatgjatë dhe të përhershme:

- Në rastin e kompanisë në bazë të përkohshme, kryesorja klasifikohet në bazë të veprimtarisë që aktualisht e kryen (p.sh. prodhimtari). Kontraktuesi klasifikohet në klasën 78.20 (veprimtaritë e agjencionit të punësimit të përkohshëm).
- Në rastin e kompanisë private në bazë të kontratës afatgjatë ose të përhershme, kryesorja klasifikohet në bazë të veprimtarisë, që aktualisht e kryen (p.sh. prodhimtari). Kontraktuesi klasifikohet në klasën 78.30 (Dispozita e burimeve të tjera njerëzore).

## Trajtimi i prodhimeve nga veprimtaritë e kompanive private në klasifikimin e produkteve sipas aktiviteteve

85. Në sektorin e mëparshëm, u theksua se në përgjithësi klasifikimi i veprimtarive nuk varet nga kriteri i kryerjes së tyre për llogarinë e vet ose në bazë të kontratës a pagesës. Derisa veprimtaritë nuk janë të dallueshme në NACE, outputi perkates është i ndryshëm, varësisht nëse materiali i inputit zotërohet nga njësia e prodhimit ose jo. Në rastin e dytë, outputi i veprimtarisë është shërbimi i kryer dhe i inkorporuar në materialin e inputit, dhe kjo është ajo për çka kontraktuesi paguhet.

86. Prandaj, në përgjithësi CPA dallon ndërmjet mallrave të prodhuara për llogarinë e vet dhe shërbimet e kryera në mallra, në bazë të pagesës ose kontratës. Kategoritë dhe nënkategoritë specifike, zakonisht të koduara si zx.yy. 9 respektivisht zx.yy. 99, e kanë titullin "veprime të nënkontraktuara, si pjesë e prodhimtarisë të…". Këto nënkategori përfshijnë veprime të pjesërishme ose të tërsishme në kuadër të procesit të prodhimit të produkteve të përmendura, të kryera nga kontraktuesi në materialet e zotëruara nga kryesorja. Këta kontraktues paguhen për punën e bërë dhe mund të përfshijnë dhënien e një shume të vogël të materialeve shtesë të nevojshme për këtë punë. Këto nënkategori nuk përfshijnë mallrat e të njëjtës kategori, nëse janë të prodhuara nga kontraktuesi që zotëron materialin kryesor të inputit".

87. Në CPA 2002 dhe CPC ver. 2, këto outpute quhen "shërbime industriale" respektivisht "shërbime prodhimi".

## Instalimi në lokacionin e punës

88. Njësitë kryesisht të angazhuara në instalim ose montim të artikujve ose pajisjeve në ndërtesa për funksionimin e tyre, klasifikohen në sektorin e ndërtimtarisë (ndarja 43).

89. Instalimi i makinerisë dhe pajisjeve të tjera, përveç atyre të lidhura me funksionimin e ndërtesave (punët në ndërtimtarinë civile), klasifikohet në grupin 33.2 "Instalimi i makinerisë dhe pajisjes industriale".

## Riparimi dhe mirëmbajtja

90. Njësitë që i riparojnë ose i mirëmbajnë mallrat klasifikohen në njërin prej kategorive vijuese, varësisht nga lloji i mallrave:

    a. grupi 33.1 "Riparimi i produkteve të fabrikuara metalike, makineri dhe pajisje";

    b. ndarja 43 "Veprimtaritë e specializuara të ndërtimtarisë";

    c. grupi 45.2 "Mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve motorike";

    d. ndarja 95 "Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personalë dhe shtëpiakë".

91. Njësitë që i kontrollojnë fluturaket, lokomotivat dhe anijet klasifikohen në të njëjtën klasë, sikurse njësitë që i prodhojnë ato.

# 3.4. Sektori – Rregullat dhe Definicionet Specifike

Ky sektor paraqet rregullat dhe definicionet, që duhet të konsiderohen kur bëhet klasifikimi i njësive në sektor specifik. Përshkrimet e përgjithshme, definicionet dhe vetitë e sektorëve janë prezantuar në shënimet sqaruese korresponduese.

## Sektori A: Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi

92. Në bujqësi, ne rastet më të shpeshta ku shpërndarja e vlerës së shtuar paraqet vështirësi, është kur njësia: prodhon rrush dhe përpunon verë nga rrushi i vetëprodhuar, ose kur ajo prodhon ullinj dhe përpunon vaj ulliri nga ullinjtë e vetëprodhuar. Në këto raste, indikatori më i përshtatshëm është "numri i orëve të punuara" dhe zbatimi i tyre në këto aktivitete të integruara vertikalisht në përgjithësi, do të çonte në klasifikimin e njësive sipas bujqësisë. Në të njëjtin rast, për produktet e tjera bujqësore, njësitë duhet të klasifikohen në bujqësi sipas konventës, për të garantuar trajtim të harmonizuar.

## Sektori G: Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave

93. Në sektorin G, tregtia dallon ndërmjet shitjes me shumicë dhe pakicë, përveç tregtisë me automjete. Mund të ndodh që njësia kryen veprimtari të integruara tregtare horizontalisht sipas formave të ndryshme të mundshme: të dyja shitja me shumicë dhe pakicë, ose shitja në shitore ose jo në shitore, ose shitja e shumë artikujve. Nëse mallrat e shitura nga njësia nuk i takojne as të vetmes klasë, duke llogaritur së paku 50% të vlerës së shtuar, atëherë aplikimi i metodës "nga lart-poshtë" kërkon kujdes të veçant dhe konsideratë të niveleve shtesë.

94. Brenda ndarjes 46 "Tregtia me shumicë", së pari duhet të konsiderohet niveli shtesë i dallimit: grupi 46.1 "tregtia me shumicë në bazë të pagesës ose kontratës dhe grumbullimi i grupeve 46.2-46.9. Prandaj, vendimi i parë, që duhet të merret është në ndarjen e njësisë në njërin prej këtyre dy mundësive, në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Nëse zgjedhja bie në nivelin e grumbullimit 46.2-46.9, atëherë hapi i dytë përbëhet prej marrjes së vendimit të "jo të specializuar" dhe "të specializuar" (shih më poshtë). Më në fund, zgjedhja qe duhet të bëhet është që gjithnjë të bëhet aplikimi i metodës "nga lart-poshtë" ndërmjet grupeve dhe klasave.

95. Skica më poshtë paraqet trungun e vendimit që duhet të përdoret për ndarjen e një njësie në klasë specifike në ndarjen 46 "Tregtia me shumicë":

    *Produktet korresponduese në ndarje të mëtutjeshme sipas produkteve korresponduese*




96. Në kuadër të ndarjes 47 “Tregtia me pakicë”, së pari duhet të konsiderohet një nivel shtesë i dallimit: grupet e grumbullimit 47.1 deri 47.7 “Tregtia me pakicë në shitore” dhe grumbullimi i grupeve 47.8-47.9 “shtitja me pakicë jo në shitore”. Prandaj, vendimi i parë që duhet të merret është mbi ndarjen e njësisë në njërën prej këtyre dy mundësive, në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Nëse zgjedhja bie në nivelin e grumbullimit “Shitja me pakicë në shitore”, atëherë hapi i dytë përbëhet prej marrjes së vendimit ndërmjet “jo të specializuar” dhe “të specializuar” (shih më poshtë). Më në fund, zgjedhja duhet të bëhet gjithmonë duke aplikuar metodën “nga lart-poshtë” ndërmjet grupeve dhe klasave.

97. Skica më poshtë paraqet trungun e vendimit që duhet të merret për ndarjen e njësisë në një klasë specifike, në ndarjen 47 “Tregtia me pakicë”:

Nëndarjet e mëtutjeshme sipas produkteve korresponduese



98. Në tregtinë me shumicë dhe pakicë, dallimi ndërmjet "të specializuar" dhe "jo të specializuar" bazohet në numrin e klasave të përbëra prej mallrave të shitura, ku klasat duhet të konsiderohen secila e llogaritur për së paku 5% (dhe më pak se 50%) të vlerës së shtuar:

a. Nëse produktet e shitura përbëhen prej së paku deri në katër klasa në cilindo grup, 46.2 deri në 46.7 (për shitje me shumicë) ose 47.2 deri 47.7 (për shitje me pakicë), njësia konsiderohet të jetë në "tregtinë e specializuar". Atëherë, është e nevojshme që të përcaktohet veprimtaria kryesore, duke zbatuar metodën "nga lart-poshtë" në bazë të vlerës së shtuar, duke përzgjedhur së pari grupin kryesor dhe pastaj klasën brenda atij grupi:

| **Klasa** | **Rasti A** | **Rasti B** | **Rasti C** |
|---|---|---|---|
| 47.21 | 30% | 30% | 20% |
| 47.25 | 5% | 15% | 5% |
| 47.62 | 45% | 40% | 35% |
| 47.75 | 20% | 15% | 40% |
| Ndarja e fundit | Klasa 47.62 | Klasa 47.21 | Klasa 47.75 |

b. Nëse produktet e shitura përbëhen prej pesë ose më tepër klasa, në cilindo prej grupeve 46.2 deri 46.7 (për shitje me shumicë) ose 47.2 deri 47.7 (për shitje me pakicë), njësia duhet të klasifikohet si njësi jo e specializuar. Në tregtinë me pakicë, prandaj ndahet në grup 47.1. Nëse ushqimi, pijet dhe duhani llogariten për së paku 35% të vlerës së shtuar, duhet t'i takojë NACE Rev. 2, 47.11. Në të gjitha rastet e tjera duhet t'i takojë klasës 47.19.

| **Klasa** | **Rasti A** | **Rasti B** | **Rasti C** |
|---|---|---|---|
| 47.21 | 5% | 20% | 5% |
| 47.22 | 10% | 15% | 5% |
| 47.42 | 15% | 10% | 45% |
| 47.43 | 25% | 10% | 40% |
| Ndarja e fundit | Klasa 47.62 | Klasa 47.21 | Klasa 47.75 |

99. Rregullat e ndarjes gjithmonë bazohen në veprimtarinë e shitjes me pakicë të njësisë. Nëse, përveç tregtisë me pakicë, njësia ka veprimtarinë e saj të dytë, ndarja e njësisë në klasë të duhura përcaktohet vetëm nga pëbërja e kushtëzuar e veprimtarisë së saj të shitjes me pakicë.

## Sektori K: Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit

## Sektori M: Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike

100. Në sektorin K janë përfshirë dy klasa që shkojnë përtej fushëveprimit tradicional të NACE-së në përfshirjen e prodhimit ekonomik, d.m.th klasa 64.20 "Veprimtaritë e kompanive holding" dhe 64.30 "Trustet, fondet dhe njësitë e ngjashme financiare". Njësitë e

klasifikuara në këto dy klasa nuk kanë kurrfarë të ardhurash nga shitja e produkteve, dhe zakonisht nuk punësojnë ndonjë anëtar të stafit (përveç, një ose disa personave që veprojnë si përfaqësues ligjorë). Nganjëherë këto njësi quhen "pllaka të tungjit", ose "kuti të postës" ose "kuti të zbrazëta", ose "entitete të qëllimeve speciale - SPE", siç e kanë vetëm emrin dhe adresën. Ato janë të shumta në numër në disa vende për shkak të përparësive tatimore.

101. Kur klasifikohet një njësi sipas këtyre dy klasave, duhet t'i kushtohet kujdes gjithashtu klasave të tjera (dy prej tyre në sektorin M, ndarja 70, që do të thotë klasa 70.10 "Veprimtaritë e zyreve kryesore" dhe 70.22 "Biznesi dhe veprimtaritë e tjera konsultative të menaxhimit").

102. Në mënyrë më të veçantë:

a) klasa 64.20 "Veprimtaritë e kompanive 'holding'" i referohet veprimtarive të kompanive 'holding', veprimtaria kryesore e të cilave është posedimi i grupit dhe jo administrimi ose menaxhimi i grupit;

b) klasa 64.30 "Trustet, fondet dhe njësitë e ngjashme financiare" është një klasë shumë e veçantë në NACE, pasi ajo nuk i referohet veprimtarisë ekonomike, por njësive;

c) klasa 66.30 "Veprimtaritë e menaxhimit të fondit" përfshin veprimtaritë e kryera në bazë të pagesës ose kontratës;

d) klasa 70.10 "Veprimtaritë e zyreve kryesore" përfshin mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive të lidhura me ushtrimin e kontrollit veprues dhe menaxhimin e përditshëm;

e) klasa 70.22 "Biznesi dhe veprimtaritë e tjera konsultative të menaxhimit" përfshin aktivitetet konsultative lidhur me çështjet, siç janë: planifikimi strategjik dhe organizativ i koorporatës, objektivat dhe politikat e marketingut, politikat e burimeve njerëzore, etj.

Veprimtaria kryesore e një njësie, duke kryer disa aktivitete të përmendura më lartë, duhet të identifikohet si zakonisht, në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Duhet të merret parasysh se fitimet kapitale nuk themelojnë vlerën e shtuar. Futja e klasave të sipërpërmendura shënon një ndryshim kryesor nga NACE 1.1.

## Sektori O: Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social

103. NACE nuk bën ndonjë dallim për sa i përket sektorit institucional (siç definohet në SNA dhe ESA), në të cilin njësia institucionale klasifikohet. Për më tepër, nuk ka asnjë kategori në NACE që përshkruan të gjitha veprimtaritë e kryera nga Qeveria, si të tilla. Rrjedhimisht, jo të gjitha organet qeveritare janë automatikisht të klasifikuara në sektorin O "Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social". Njësitë që kryejnë veprimtari në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, dhe që janë të atribueshme në veçanti për fushat e tjera të NACE-së, klasifikohen në sektorin e përshtatshëm. P.sh, një shkollë e mesme e administruar nga qeverisja qendrore ose lokale ndahet në grupin 85.3 (Sektori P); ose një spital publik i ndahet klasës 86.10 (Sektori Q). Në anën tjetër, jo vetëm organet qeveritare janë të klasifikuara në sektorin O: gjithashtu këtu klasifikohen njësitë private që kryejnë "Veprimtaritë tipike të administrimit publik".

## Sektori T: Veprimtaritë e ekonomive shtëpiake si punëdhënës; Mallrat dhe shërbimet e paklasifikuara të prodhuara nga ekonomitë shtëpiake për përdorim vetanak

104. Ndarja 97 përfshin vetëm aktivitetet e ekonomive shtëpiake si punëdhënës të personelit vendor. Rezultati i këssaj veprimtarie konsiderohet si output në SNA dhe për këtë qëllim në disa anketa kjo ndarje është përfshirë në NACE Rev. 2. Veprimtaritë e personelit vendor nuk janë klasifikuar këtu: p.sh. veprimtaritë e kujdestareve të bebave duhet të klasifikohen në 88.91, larja e tekstileve në 96.01, veprimtaritë e garderobës 96.09, etj.

105. Nevoja për t'i përshkruar veprimtaritë për përdorim vetanak është shfaqur në grumbullimet e të dhënave, siç janë: fuqia punëtore, anketat e shfrytëzimt të kohës. Derisa veprimtaritë e tregut duhet në përgjithësi të përshkruhen sipas rregullave ekzistuese për identifikimin e kodit të saktë të NACE-së, aplikimi i këtyre rregullave ndaj veprimtarive për shfrytëzimin vetanak është vlerësuar si i vështirë, sepse për dallim nga veprimtaritë e tregut, është vështirë të përcaktohet vlera e shtuar. Këto veprimtari shpesh kombinohet me bujqësinë, ndërtimtarinë, prodhimtarinë e tekstilit, riparimin dhe shërbimet e tjera. Ndarja 98 "Mallrat e paklasifikuara dhe veprimtaritë e ekonomive shtëpiake, që prodhojnë shërbime për shfrytëzimin vetanak" korrespondon me ndarjet 96 dhe 97 të NACE Rev. 1, që i futëm për t'i përfshirë këto veprimtari. Ndarja 98 nuk është relevante në statistikat e biznesit të BE-së në grumbullimin e të dhënave, duke përfshirë veprimtaritë e ekonomive shtëpiake dhe të ekzistencës.

# Raportet ndërmjet NACE Rev. 2 dhe Klasifikimeve të Tjera

## Kapitulli 4

106. Ky kapitull pasqyron marrëdhëniet ndërmjet NACE-së dhe klasifikimeve të tjera të lidhura. Referenca kryesore është në diagramin e këtij dokumenti, në paragrafin 3. Së pari, lidhjet me klasifikimet ndërkombëtare bazuar në Sistemin e Kombeve të Bashkuara, janë të përshkruara në detaje, si në NACE dhe me shumë shembuj të klasifikimeve të BE-së, dhe në mënyra të ndryshme me klasifikime korresponduese botërore. Lidhjet me klasifikimet e tjera të BE-së janë prezantuar. Më në fund, marrëdhëniet me klasifikimet e tjera ndërkombëtare janë përshkruar bashkë me strukturat e grumbulluara të përdorura në kontekst të llogarive kombëtare.

107. RAMON, serveri online i Eurostat-it për metadata jep informata dhe struktura të detajuara mbi klasifikimet statistikore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare, të zhvilluara për shumë fusha statistikore: analizat ekonomike, mjedisi, arsimi, profesionet, llogaritë kombëtare, etj. Informatat përfshijnë aspekte të ndryshme, përfshirë përshkrimet e përgjithshme, strukturat e klasifikimit (p.sh. kodet dhe titujt), shënimet sqaruese, tabelat korresponduese ndërmjet klasifikimeve, dokumenteve metodologjike dhe informata të tjera të përgjitshme lidhur me klasifikimet.

Sa herë që është e mundur, informatat mund të gjenden në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Serveri RAMON mund të ketë qasje publike në ueb-faqen: http://www.europa.eu.int/comm/eurostat/ramon/.

# 4.1 Marrëdhëniet me Klasifikimet Ndërkombëtare

## Familja ndërkombëtare e klasifikimeve ekonomike dhe sociale

108. Familja ndërkombëtare e klasifikimeve ekonomike dhe sociale përbëhet prej klasifikimeve të regjistruara në inventarin e klasifikimeve të Kombeve të Bashkuara, i shqyrtuar dhe i aprovuar si udhëzues nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, ose nga bordet e tjera kompetente ndërqeveritare mbi çështjet e tilla, siç janë: ekonomike, demografike, të punës, të shëndetit, të arsimit, të mirëqenies sociale, të gjeografisë, mjedisit, shfrytëzimit të kohës dhe të turizmit. Ajo, gjithashtu përfshin klasifikimet mbi subjektet e ngjashme që janë të regjistruara në inventar dhe janë të nxjerra ose të lidhura me klasifikimet ndërkombëtare dhe janë kryesisht të përdorura jo vetëm për qëllime rajonale ose kombëtare (siç është NACE dhe CPA).

109. Familja ndërkombëtare e klasifikimeve ekonomike dhe sociale përbëhet nga tri lloje kryesore: referenca, klasifikimet e nxjerra dhe të lidhura.

110. *Klasifikimet e referencës* janë klasifikime ekonomike dhe sociale, që janë produkt i marrëveshjeve ndërkombëtare, të aprovuara nga Komsioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara ose i bordit tjetër kompetent ndërqeveritar, siç është ai i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizatës së Kombeve të Bashkuara të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (UNESCO), Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO), ose i Organizatës Botërore të Doganave (WCO), varësisht nga subjekti. Kështu, klasifikimet e referencës kanë arritur një pranim të gjerë dhe marrëveshje zyrtare, si dhe janë miratuar dhe rekomandohen si udhëzues për përgatitjen e klasifikimeve të nxjerra. Ato mund të përdoren si modele për zhvillimin ose ripunimin e klasifikimeve të tjera, në të dy aspektet e strukturës dhe të aspektit të natyrës, si dhe të definicionit të kategorive. ISIC është klasifikim i references për veprimtaritë ekonomike.

111. *Klasifikimet e* prejardhura bazohen në klasifikimet e referencës. Klasifikimet e prejardhura mund të përgatiten duke përshtatur strukturën dhe kategoritë e klasifikimit të references, dhe pastaj mundësisht të dhënies së detajeve shtesë, përtej asaj që është dhënë me anë të klasifikimit të references, ose mund të përgatiten nga artikujt e rirregulluar dhe të bashkuara nga një ose më shumë klasifikime të referencës. Klasifikimet e prejardhura janë thjesht të përgatitura për t'u përdorur në nivel kombëtar ose shumëkombësh. NACE është një klasifikim i nxjerrë i ISIC-së.

112. *Klasifikimet e lidhura* janë ato klasifikime, që pjesërisht u referohen klasifikimeve të referencës dhe për të cilët tabelat korresponduese (nganjëherë të quajtura si tabela të marrëveshjes ) janë të nevojshme për t'i karahasuar statistikat. NAICS (shih më poshtë) është klasifikimi i lidhur i ISIC-së.

## Sistemi i Integruar i Klasifikimit të Veprimtarive dhe Produkteve i Kombeve të Bashkuara

113. Më 1989 Komisioni Statistikor i KB-së propozoi një grup të klasifikimeve, që së bashku formonin një sistem të integruar për klasifikimin e veprimtarive, mallrave dhe shërbimeve, si dhe që do të mund të përdorej në fusha të ndryshme të statistikave ekonomike, në nivel botëror. ISIC, CPC, SITC dhe BEC janë komponentët kryesorë të këtij sistemi dhe janë të ndërlidhura ngushtë:

- ISIC përfaqëson fushën e veprimtarisë së sistemit,
- CPC është instrumenti qendror për klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve,
- SITC është klasifikim i integruar i mallrave të transportueshme për statistikat ndërkombëtare të tregtisë me qëllim të krahasimit,
- BEC[11] është klasifikim i mallrave sipas kategorive të gjera ekonomike me qëllim të analizave ekonomike.

114. Kur i referohemi mallrave, të dyja CPC dhe SITC, përdorin titujt dhe nëntitujt e përshkrimit për Sistemin e Harmonizuar të kodeve të mallrave (HS), si blloqe ndërtimi për kategoritë e tyre, p.sh. çdo titull në nivelin më të ulët të CPC-së korrespondon saktë me së paku një titull të HS-së ose me një grup të dy ose më tepër titujve ose nëntitujve të HS-së. Ka shumë situata, veçanërisht në bujqësi, ku një titull i HS-së është ndarë nëpër disa artikuj të CPC-së.

115. HS është Klasifikim Ndërkombëtar Doganor i Produktit, i hartuar nga Organizata Botërore e Doganave për Tregti të Jashtme. HS-ja përdoret për të dy tarifat doganore dhe për qëllime të statistikave të Tregtisë së Jashtme. HS-ja është, në mënyrë hierarkike, e strukturuar dhe jep definicione dhe karakteristika të detajuara të rreth 5000 artikujve. Ajo është strukturuar në 96 kapituj, secili i identifikuar nga një kod numerik dyshifror; kapitujt janë të ndarë në tituj, të cilët janë të nënndarë në nëntituj. Titujt identifikohen me anë të kodit numerik katërshifror dhe nëntitujt me një kod numerik gjashtëshiforor. Edhe pse HS-ja kryesisht përfshin artikujt, p.sh. produkte, të cilat kanë dimensione fizike. Ai, gjithashtu përfshin elektricitetin. HS-ja nuk mbulon shërbimet, por përfshin "manifestimet" fizike të shërbimeve (p.sh. planet e arkitektëve, disqet me softuerë, madje edhe origjinalet e artit dhe të antikës së vjetër, më shumë se 100 vjet, etj.). Ai, gjithashtu përfshin artikujt, të cilët nuk prodhohen, siç janë pajisjet e përdorura. Ripunimi më i ri i HS-së u zbatua në vitin 2007.

[11]*Classification by Broad Economic Categories: Defined in Terms of SITC, Rev. 3,* Statistical Papers, No. 53/Rev.3 and corrigendum (United Nations publication, Sales No E.86.XVII.4 and Corr.1).

116. CPC-ja i aranzhon produktet sipas veçorive fizike dhe natyrës së brendshme të artikujve, ose natyrës së shërbimeve të ofruara. Ky kriter përfshin, për shembull, llojin e lëndës së parë të përdorur, procesin e inkuadruar të prodhimit, qëllimin për cilën janë destinuar aritikuj etj. Edhe pse ky kriter është shpesh i njëjtë me atë të përdorur për klasifikimet e veprimtarive ekonomike, CPC-ja nuk është klasifikim i produktit, i varur nga Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike. Për këtë arsye, sistemi CPC i kodimit është sistem i pavarur i ISIC-së.

117. Përkundër kësaj çasjeje specifike, megjithatë, CPC-ja ka marrë parasysh kriterin e origjinës ekonomike. Përveç këtij kriteri (të miratuar në BE për NACE dhe CPA), një klasifikim i produktit kombinohet në një kategori të mallrave ose shërbimeve, që janë prodhim i vetëm i një veprimtaria ekonomike. Kështu, u bënë orvajtje për t'i definuar titujt, në nivelin më të ulët të CPC-së, në atë mënyrë që sa më shumë produkte të këtij niveli të mund të alokohen në një kategori të vetme të ISIC-së: publikimi i CPC  përfshin korrespondencat ndërmjet nënklasave të CPC-së dhe klasave relevante të ISIC-së. Megjithatë, zbatimi i kriterit të origjinës nuk është gjithnjë praktik, madje edhe duke përdorur nivelin më të detajuar të HS-së.

118. Versioni i punuar i CPC, CPC ver. 2, u miratua nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, në mars të vitit 2006.

119. SITC zbaton një rregull tradicionale, në të cilën materialet e përdorura, faza e procesimit dhe shfrytëzimi i fundit janë gjykimet kryesore.

120. BEC është i dizajnuar për të shërbyer si mjet për konvertimin e të dhënave të përpiluara në bazë të SITC në grumbullues domethënës, për qëllime të analizës ekonomike, bazuar në dallimin e SNA ndërmjet artikujve kapitalë, artikujve të ndërmjetëm dhe artkujve të konsumuesit jetëgjatë dhe jo jetëgjatë. Nuk ka ndonjë marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet ISIC dhe BEC, siç i riaranzhon kategoritë e SITC në kategoritë e BEC 19. BEC është ripunuar në vitin 1986, bazuar në ripunimin e tretë të SITC dhe defenicioni i kategorive të BEC-it në kushte të nëntitujve, më pas është ndryshuar, për t'i pasqyruar ndryshimet e bëra në HS në vitet 2002 dhe 2007.

## Lidhja e NACE-së me ISIC-në

121. NACE është një klasifikim i dalë nga ISIC-ja: kategoritë, në të gjitha nivelet e NACE-së definojnë ose për të qenë identike, për të formuar nëngrupe, kategori të vetme të ISIC-së. Niveli i parë dhe i dytë i ISIC Rev. 4 (sektorët dhe ndarjet) janë identikë me sektorët dhe ndarjet e NACE Rev. 2. Nivelet e treta dhe të katërta (grupet dhe klasat) të ISIC Rev. 4 janë nëndarë në NACE Rev. 2 sipas kërkesave evropiane. Megjithatë, grupet dhe klasat e NACE Rev. 2 mund, gjithnjë të grumbullohen, në grupet dhe klasë të ISIC Rev. 4, prej të cilit ato janë nxerrë. Qëllimi i thyerjeve të mëtutjeshme në NACE Rev. 2, krahasuar me ISIC Rev. 4, është, që të fitohet një klasifikim më i përshtatshëm me strukturat e ekonomive evropiane.

122. Edhe pse sistemet e kodimit, të përdorura në ISIC dhe NACE janë, deri më tani, të njëjta: për t'i dalluar lehtë mes të dyve, NACE vendos një pikë mes dy shifrave të para (niveli i ndarjes) dhe dy të fundit për (grupet dhe klasat). Pasi që, disa grupe dhe klasë në ISIC Rev. 4 janë të shpërbëra në grupet dhe klasat e NACE-së, pa futjen e niveleve shtesë, hierarkike, disa kode të ISIC-së ndryshojnë nga kodet korresponduese të NACE-së. Një veprimtari në nivel të grupit ose të klasës mund ta ketë kodin numerik në NACE Rev. 2, i cili ndryshon nga ai në ISIC Rev. 4.

### Lidhjet e NACE-së me klasifikimet e tjera ndërkombëtare

123. Ka klasifikime të tjera të zhvilluara nga Kombet e Bashkuara ose nga organet e tjera ndërqeveritare, që kanë disa marrëdhënie me ISIC-në, ose që shfrytëzojnë pjesë të ISIC-së në definimin e fushëveprimit ose të kategorive të veta. Si pasojë, ata kanë marrëdhënie me NACE-në.

124. Këto klasifikime janë përgatitur për statistikat mbi profesionet, punësimin, shpenzimet, arsimin, turzimin dhe mjedisin. Kryesoret janë radhitur në listën e mëposhtme. Informata më të sakta mund të gjenden në ueb-faqen e divisionit statistikor të KB-së:

(*http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/class_default.asp*)

- Klasifikimet e funksioneve të qeverisjes (COFOG);
- Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED)[12];
- Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve (ISCO)[13];
- Llogaria Përkrahëse e Turizmit (TSA)[14];
- Klasifikimi i Sektorit të Teknologjisë së Informatikës dhe Komunikimit (ICT)[15];
- Përmbajtja dhe definimi i sektorit të industrive të medias.).

## 4.2 Marrëdhëniet me Klasifikimet e BE-së

### Klasifikimi i Produkteve sipas Veprimtarisë - CPA

125. CPA[16]është version evropian i CPC-së dhe qëllimet për të cilat shërben janë në linjë me ato të CPC-së. Në BE, klasifikimet për fushat statistikore specifike janë të lidhura me CPA, përveç nëse CPA-ja përdoret vetë në një klasifikim të anketës. Edhe pse CPA-ja është homolog evropian i CPC-së, ai dallon nga ky i fundit, jo vetëm në atë që zakonisht është më i detajuar, por gjithashtu lidhur me strukturën e tij. BE-ja e miratoi kriterin e origjinës ekonomike për zhvillimin e vet, me NACE-n si kornizë e referencës. Prandaj, deri në nivelin e katërt (klasat) struktura e CPA-së korrespondon me NACE-në. Në përgjithësi, nënklasat e CPC-së riaranzhohen sipas origjinës së tyre ekonomike. Lidhja ndërmjet CPA dhe NACE Rev. 2, është evidente në kodin e CPA-së në të gjitha nivelet e CPA-së, kodimi i katër shifrave të para është identik me atë të përdorur në NACE Rev. 2, me shumë pak përjashtime. Si mjet, në punën praktike statistikore të përditshme, CPA-ja si klasifikim tjetër i produktit, mund të përdoret në përcaktimin e produkteve karakteristike të veprimtarive individuale. Duhet të theksohet, megjithatë, se në disa raste lidhja e veprimtarisë së produktit është një marrëveshje: kjo ndodhë kur të njëjtat produkte janë rezultat i veprimtarive të ndryshme, me procese të ndryshme të prodhimit. Versionet kombëtare të CPA-së ekzistojnë vetëm si versione kombëtare të NACE Rev.2.

---

[12]International Standard Classification of Education (ISCED 1997) (Paris, UNESCO, November 1997).
[13]International Standard Classification of Occupations (ISCO-1988) (Geneva, ILO, 1988).
[14]Commission of the European Communities, Organisation for Economic Cooperation and Development, United Nations and Ëorld Tourism Organization, *Tourism Satellite Account: Recommended Methodological Frameëork*, Statistical Papers, No 80 (United Nations publication, Sales No E.01.XVII.9).
[15]*ëëë.oecd.org*
[16]Council Regulation (EEC) No 3696/93 of 29 October 1993 on the statistical classification of products by activity (CPA) in the European Economic Community, OJ L 342 of 31 December 1993.

## Nomenklatura e Kombinuar - NK

126. CN[17], Nomenklatura e Kombinuar është klasifikim i përdorur brenda BE-së për qëllime të tarifave doganore, për qëllime të statistikave te jashtme dhe siguron një shkallë të detajuar, që shkon përtej asaj që është në HS. NK u fut në përdorim në vitin 1988. Titujt në Nomenklaturën e Kombinuar identifikohen me anë të kodit numerik tetëshifror, duke ia shtuar dy shifra, kodit relevant të HS-së. NK-ja ripunohet çdo vit dhe si rregullore e Këshillit zbatohet nga Shtetet Anëtare.

## PRODCOM

127. "PRODCOM"[18] është shkurtesë për Sistemin e BE-së për Statistikat e Prodhimit për Minierat dhe prodhimtarinë e tyre (p.sh. duke përjashtuar shërbimet e tjera nga "shërbimet industriale"). Klasifikimi i produktit (lista e PRODCOM-it) hartohet çdo vit nga Komiteti i PRODCOM-it, mbi të cilën bazohen statistikat e prodhimit. Titujt e listës së PRODCOM-it nxirren në CN, por kodi i tyre është një thirrje tjetër e kodit të CPA-së. Titujt e PRODCOM-it janë të koduar, duke përdorur kodin numerik tetëshifror, ku gjashtë shifrat e para janë identike me ato të kodit të CPA-së. Prandaj, lista e PRODCOM-it është e lidhur dhe në përputhje me CPA-në. Lidhja me CPA-në thekson lidhjen me NACE-n, duke u mundësuar ndërmarrjeve që prodhojnë produkte që të identifikohen, derisa lidhja me CN-n lejon krahasimet ndërmjet statistikave të prodhimit dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

## Grupet Kryesore Industriale – GKIs (MIGs)

128. MIGs[19]është shkurtesa për Grupimet Kryesore Industriale - një klasifikim evropian, i cili grupon industritë në bazë të kërkesës për produkte: mallrave kapitale, mallrave të ndërmjetme, mallrave afatgjata të komsumit, mallrave joafatgjata të konsumit dhe energjisë. GKI përdoret për disa lloje të indikatorëve, e në ndër to edhe për indeksin e prodhimit industrial (i shprehur në kuptim të vlerës së shtuar dhe principit të bazuar në KAU) dhe indeksin e çmimeve të prodhimit.

## Bilanci i pagesave: klasifikimi për statistikat e investimeve direkte të huaja

129. Bilanci i pagesave[20] shfrytëzon kategoritë e NACE-së në përgjithësi për raportimin e të dhënave mbi investimet e drejtpërdrejta të huaja (FDI): nivelet e ndërprerjes të veprimtarive janë kryesisht të shprehura në kushtet e ndarjeve të NACE-së.

[18]http://europa.eu.int/eur-ex/lex/Result.do?arg0=prodcom&arg1=&arg2=&titre=titre&chlang=en&RechType=RECH_mot&idRoot=2&refinecode=LEG*T1%3DV111%3BT2%3DV1%3BT3%3DV1&Submi t=Search
[19]Commission Regulation (EC) 86/2001 http://eur-lex.europa.eu/pri/en/oj/dat/2001/l_086/l_08620010327en00110014.pdf
[20]http://europa.eu.int/eur-lex/lex/Result.do?arg0=184%2F2005&arg1=&arg2=&titre=titre&chlang=en&RechType=RECH_mot&idRoot=2&refinecode=LEG*T1%3DV111%3BT2%3DV1%3BT3%3DV1&S ubmit=Search

## 4.3 Marrëdhëniet me Klasifikimet e Tjera Shumëkombëshe

### NAICS

130. NAICS është Sistem i Amerikës Veriore për Klasifikimin e Industrisë. NAICS u zhvillua ndërmjet viteve ’90-të, për t’i dhënë definicionet e përbashkëta të industrisë për Kanadën, Meksikën dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe për t’i lehtësuar analizat ekonomike të ekonomive të tri vendeve të Amerikës Veriore. NAICS ndërtohet në bazë të një kornize koceptuale, të orientuar në prodhim dhe klasifikon njësitë dhe jo veprimtaritë. Si rezultat, strukturat e ISIC-së dhe NAICS-së janë thelbësisht të ndryshme. Megjithatë, të dhënat statistikore të grumbulluara sipas NAICS mund të grupohen në ndarje dyshifrore të ISIC Rev. 4/NACE Rev. 2, duke siguruar krahasueshmërinë e të dhënave. Në shumë raste, janë të mundshme lidhje më të detajuara. Një marrëveshje e detajuar ndërmjet NAICS dhe ISIC është botuar në ueb-faqet: (USA: *http://www.census.gov/naics*, Canada: *http://www.statcan.ca/*).

### ANZSIC

131. Klasifikimi Standard Industrial i Australisë dhe Zelandës së Re (ANZSIC) u zhvillua për shfrytëzim nga të dy vendet me qëllim të prodhimit dhe analizave të statistikave industriale. Në zhvillimin e ANZSIC-së, një theks i veçantë i është kushtuar radhitjes së saj me standardet ndërkombëtare. ISIC Rev. 3 është përdorur si standard ndërkombëtar për qëllime të referencës. Marrëveshje të gjera ndërmjet ANZSIC-së dhe ISIC mund të gjenden në ueb-faqen e ABS: *http://www. statistics.gov.au/*. ANZSIC është shumë më afër ISIC/NACE sesa NAICS, pasi që struktura e saj në mënyrë të gjerë e respekton ISIC-n, ku kategoritë në ndarje dhe nivele më të detajuara mund të grupohen në kategori dyshifrore të ISIC-së. Prandaj, kthimi i të dhënave të ANZSIC në ISIC/NACE është i mundshëm në një nivel mjaft të detajuar.

### Klasifikimet e tjera

132. Përveç Shteteve Anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra janë të përkushtuara që ta përdorin një version kombëtar të nxjerrë nga NACE. Për më tepër, rreth dhjetë vende të tjera jashtë BE-së, ose vende kandidate, siç janë: Kroacia dhe Turqia, i referohen NACE-së për klasifikimin e tyre të veprimtarive ekonomike. Më tepër se 150 shtete në botë janë duke përdorur klasifikimet e veprimtarive ekonomike, bazuar ose në NACE ose ISIC.

## 4.4 Strukturat e Grupuara për Llogaritë Kombëtare

133. Llogaritë kombëtare kanë identifikuar nevojën për dy grupime standarde të kategorive ISIC/NACE, që duhet të përdoren për raportimin e të dhënave SNA nga një spektër i gjerë i vendeve. I pari, i njohur si “*grupim i nivelit të lartë*”, grupon sektorët e ISIC/ NACE në 10 ose 11 kategori; i dyti, i quajtur si “*grupim i ndërmjetëm*”, grupon ndarjet dhe përbëhet nga 38 kategori. Dy strukturat e grupuara nuk paraqesin një pjesë integrale të ISIC/NACE, por janë të integruara plotësisht në strukturën e tyre hierarkike (grupim i nivelit të lartë, sektorë, grupim i ndërmjetëm, ndarje, grupe dhe klasë).

134. Tabela vijuese paraqet “grupimin A* 10/11 të nivelit të lartë të SNA/ISIC”:

| | ***ISIC Rev. 4/NACE Rev 2*** | ***Përshkrimi*** |
|---|---|---|
| *1* | A | Bujqësia, pylltaria, peshkataria |
| *2* | B, C, D dhe E | Prodhimtaria, xehetaria dhe gurëthyesit dhe industri tjera |
| *2a* | C | Prodhimtaria |
| *3* | F | Ndërtimi |
| *4* | G, H dhe I | Tregtia me shumicë dhe pakicë, transportimi dhe ruajtja, akomodimi dhe veprimtaritë për ushqim dhe shërbime |
| *5* | J | Informimi dhe komunikimi |
| *6* | K | Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit |
| *7* | L | Veprimtaritë e pasurisë së paluajtshme |
| *8* | M dhe N | Veprimtaritë e shërbimit profesional, shkencor, teknik, administrativ dhe përkrahës |
| *9* | O, P dhe Q | Veprimtaritë e administratës publike, mbrojtjes, arsimit, shëndetit njerëzor dhe punës sociale |
| *10* | R, S, T dhe U | Shërbime tjera |

Tabela më poshtë paraqet "Përmbledhjen e ndërmjetme të SNA/ISIC A*38":

| *A*38* | *ISIC Rev 4/NACE Rev. 2* | *Ndarjet* |
|---|---|---|
| 1. A | Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria | 01 deri 03 |
| 2. B | Xehetaria dh gurëthyesit | 05 deri 09 |
| 3. CA | Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit | 10 deri 12 |
| 4. CB | Prodhimi i tekstilit, lëkurës dhe produkteve të ngjashme | 13 deri 15 |
| 5. CC | Përpunimi i drurit dhe produkteve të letrës dhe printimi | 16 deri 18 |
| 6. CD | Prodhimi i kokut dhe produkteve të rafinuara të naftes | 19 |
| 7. CE | Prodhimi i lëndëve kimike dhe produkteve kimike | 20 |
| 8. CF | Prodhimi i produkteve farmaceutike, kemikaleve mjekësore dhe produkteve botanike | 21 |
| 9. CG | Përpunimi i gomës dhe produkteve plastike, dhe produkteve tjera jo-metalike e minerale | 22 + 23 |
| 10. CH | Prodhimi i metaleve bazë dhe produkteve të fabrikuara metalike përveç makinerisë dhe pajisjeve | 24 + 25 |
| 11. CI | Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike | 26 |
| 12. CJ | Prodhimi i pajisjeve elektrike | 27 |
| 13. CK | Prodhimi i makinave dhe pajisjeve te pa klasifikuara tjeter kund. | 28 |
| 14. CL | Prodhim i pajisjeve të transportit | 29+30 |
| 15. CM | Prodhime tjera dhe riparime, dhe instalim i makinerisë dhe pajisjeve | 31 deri 33 |
| 16. D | Furnizim me energji elektrike, gaz, avull, ajër të kondicionuar | 35 |
| 17. E | Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave, rregullim toke | 36 deri 39 |
| 18. F | Ndërtimtaria | 41 deri 43 |
| 19. G | Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 45 deri 47 |
| 20. H | Transportimi dhe ruajtja në depo | 49 deri 53 |
| 21. I | Akomodimi dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit | 55 + 56 |
| 22. JA | Publikimi, aktivitete audiovizuale dhe emetuese | 58 deri 60 |
| 23. JB | Telekomunikimi | 61 |
| 24. JC | TI dhe shërbime tjera informimi | 62 + 63 |
| 25. K | Aktivitete financiare dhe të sigurimit | 64 deri 66 |
| 26. L | Aktivitete të patundshmërive* | 68 |
| 27. MA | Aktivitete juridike, kontabilitet, menaxhim, arkitekturë, inxhinieri teknikë testuese dhe analiza | 69 deri 71 |
| 28. MB | Hulumtime shkencore dhe zhvillim | 72 |
| 29. MC | Aktivitete tjera profesionale, shkencore dhe teknike | 73 deri 75 |
| 30. N | Aktivitete administrative dhe shërbyese – mbështetëse | 77 deri 82 |
| 31. O | Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim social i detyrueshëm | 84 |
| 32. P | Arsim | |
| 33. QA | Shërbime të shëndetit njerëzor | 86 |
| 34. QB | Përkujdesje për banim dhe aktivitete të punës sociale | 87 + 88 |
| 35. R | Artet, zbavitje dhe rekreacion | 90 deri 93 |
| 36. S | Shërbime tjera | |

| | | |
|---|---|---|
| *37. T*** | Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të ndryshme dhe aktivitete prodhuese shtëpiake për përdorim vetanak | 97+98* |
| *38. U*** | Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale | 99* |

* përfshirë qiratë e vendbanimeve nga pronarët

** Të gjitha U dhe një pjesë e T (ndarja 98) janë jashtë kufirit të prodhimit të SNA-së, dhe do të jenë të zbrazëta për raportimin e të dhënave të SNA-së, mirëpo janë të përfshira plotësisht.

# Ndryshimet nga NACE Rev. 1.1 në NACE Rev. 2

## Kapitulli 5

135. Derisa disa prej rregullave për aplikimin e NACE-së kanë ndryshuar, si: kriteri për ndërtimin e klasifkimit dhe formulimi i shënimeve sqaruese është rishikuar, karakteristikat e përgjithshme të NACE-së kanë mbetur të pandryshuara.

136. Konceptet e reja të nivelit më të lartë të klasifikimit janë prezantuar dhe detajet e reja janë krijuar për t'i pasqyruar format e ndryshme të prodhimit dhe paraqitjen e veprimtarive të reja. Në të njëjtën kohë, janë bërë orvatjet për ta mirëbajtur strukturën e klasifikimit, në të gjitha fushat, që nuk kërkojnë ndryshim në mënyrë eksplicite, bazuar në konceptet e reja.

137. Detajet e klasifikimit janë rritur thelbësisht (nga klasa 514 deri në klasën 615). Për veprimtaritë që prodhojnë shërbime, kjo rritje është e dukshme në të gjitha nivelet, përfshirë atë më të lartin, derisa për veprimtaritë e tjera, siç është bujqësia, rritja në detaje ka prekur më së shumti nivelin më të ulët të klasifikimit.

## 5.1 Ndryshimet në Strukturë

138. NACE Rev. 1.1 kishte 17 sektorë dhe 62 ndarje; NACE Rev. 2 ka 21 sektorë dhe 88 ndarje. Në nivelin më të lartë të NACE-së, disa sektorë mund lehtë të krahasohen me versionin e mëparshëm të klasifikimit. Megjithatë, futja e disa koncepteve të reja në nivelin e sektorit, p.sh. sektorin e informacionit ose grupimin e veprimtarive, lidhur me mjedisin, e bëjnë të lehtë krahasimin e përgjithshëm ndërmjet NACE Rev. 2 dhe versionin e tij të mëparshëm të pamundur.

139. Tabela e vendosur më poshtë paraqet korrespodencën e gjerë ndërmjet sektorëve të NACE Rev. 1.1 dhe NACE Rev.2. Ju lutem, vini re, se kjo tabelë paraqet vetë korrespondencën e përafërt një me një ndërmjet sektorëve: detaje të tjera shtesë janë të nevojshme për të krijuar korrespondencën e plotë.

| NACE Rev 1.1 | | NACE Rev 2 | |
|---|---|---|---|
| **Seksioni** | **Përshkrimi** | **Seksioni** | **Përshkrimi** |
| A | Bujqësi, gjueti dhe pylltari | A | Bujqësi, pylltari dhe peshkatari |
| B | Peshkataria | | |
| C | Xehetari dhe gurëthyes | B | Xehetari dhe gurëthyes |
| D | Prodhim | C | Prodhim |
| E | Furnizim me energji elektrike, gaz dhe ujë | D | Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar |
| | | E | Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës |
| F | Ndërtimtari | F | Ndërtimtari |
| G | Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave dhe mallrave personale dhe shtëpiake | G | Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave |
| H | Hotele dhe restorante | I | Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim |
| I | Transport, ruajtje dhe komunikim | H | Transport dhe ruajtje |
| | | J | Informacion dhe komunikim |

| | | | |
|---|---|---|---|
| J | Ndërmjetësim financiar | K | Aktivitete financiare dhe të sigurimit |
| K | Aktivitete të patundshmërisë, qirasë dhe të biznesit | L<br>M<br>N | Aktivitete të patundshmërisë<br>Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike<br>Aktivitete administrative dhe mbështetëse |
| L | Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm | O | Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm |
| M | Arsim | P | Arsim |
| N | Shëndetësi dhe punë sociale | Q | Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale |
| O | Aktivitete të shërbimeve tjera të komunitetit, sociale dhe personale | R<br>S | Art, zbavitje dhe rekreacion<br>Aktivitete të shërbimeve tjera |
| P | Aktivitete të ekonomive familjare private si punëdhënës dhe aktivitete të pa ndara të ekonomive familjare | T | Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të pa ndara – aktivitete prodhuese shtëpiake për përdorim vetanak |
| Q | Organizata dhe organe jashtë-territoriale | U | Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale |

140. Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet, në aspektin numerik, ndërmjet NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2:

| | NACE Rev 1.1 | NACE Rev 2 | Dallimi |
|---|---|---|---|
| **Seksionet** | 17 | 21 | +4 |
| **NDARJet** | 62 | 88 | +26 |
| **Grupet** | 224 | 272 | +48 |
| **Klasat** | 514 | 615 | +101 |
| | **Seksioni i prodhimit** | | |
| **Seksionet** | 1 | 1 | 0 |
| **NDARJET** | 23 | 24 | +1 |
| **Grupet** | 103 | 95 | -8 |
| **Klasat** | 242 | 230 | -12 |
| | **Seksionet tjera** | | |
| **Seksionet** | 16 | 20 | +4 |
| **NDARJet** | 39 | 64 | +25 |
| **Grupet** | 121 | 177 | +56 |
| **Klasat** | 272 | 385 | +113 |

141. Për të pasur një ide të ndikimit të ndryshimeve në statistikat zyrtare, për shkak të zbatimit të NACE Rev. 2, është e dobishme që t'i dallojmë llojet vijuese të korrespondencës ndërmjet NACE Rev. 1.1 dhe NACE Rev. 2:

- korrespondencat nga "1" në "1": klasa 195 në NACE Rev. 1.1 korrespondon saktësisht me një klasë në NACE Rev. 2 dhe anasjelltas;
- korrespondencat nga "n" deri "1": 86 raste, ku dy ose më shumë klasë në NACE Rev 1.1 korrespondojnë në një klasë në NACE Rev. 2;

- korrespondencat nga “1” deri “m”: 18 raste, ku një klasë e NACE Rev. 1.1 ndahet në dy ose më shumë klasë në NACE Rev. 2;
- korrespondencat nga “n” deri “m”: 215 raste, ku dy ose më shumë klasë në NACE Rev. 1.1 korrespondojnë me dy ose më shumë klasë në NACE Rev. 2.

Njësitë e klasifikuara në klasë, të shoqëruara me korrespondencën nga “1” deri “1” dhe nga “n” deri “1”, automatikisht mund të rikodohen, pasi të zbatohet NACE Rev. 2 në regjistrat e biznesit.
Kjo deklaratë duhet të miratohet në çdo vend, sipas versionit kombëtar të NACE-së.

142. Ndryshimet thelbësore ndërmjet NACE Rev.1.1 dhe NACE Rev.2 janë të shumta për t’i radhitur këtu, në tërësinë e tyre. Megjithatë, ato që janë më të rëndësishme janë radhitur më poshtë.

143. Sektorët e NACE Rev.1.1 për bujqësi dhe peshkim janë kombinuar. Megjithatë, janë dhënë shumë detaje  në këtë sektor A (Bujqësia, pylltari dhe peshkimi). Kjo ka ardhur si reagim i kërkesave të vazhdueshme për më shumë detaje në ISIC, kryesisht për shkak të faktit se bujqësia është një pjesë e rëndësishme e strukturës ekonomike në shumë vende në zhvillim.

144. Janë krijuar ndarjet e reja në prodhimtari, duke përfaqësuar industritë e reja të rëndësishme ose industritë e vjetra, që kanë arritur rëndësinë e tyre ekonomike e sociale, siç është ndarja 21 (Prodhimi i produkteteve themelore farmaceutike dhe të preparateve farmaceutike) dhe ndarja 26 (Prodhimi i kompjuterit, produkteve elektronike dhe optike). Fushëveprimi i të së fundmes ndryshon nga ndarja 30 (Prodhimi i makinerisë dhe kompjuterëve të zyres) në NACE Rev. 1.1, duke e bërë atë një mjet më të mirë për statistikat mbi veprimtaritë e teknikës së lartë. Ndarjet tjera të reja, siç janë ndarja 11 11 (Prodhimi i pijeve) dhe 31 (Prodhimi i mobiljeve) kanë rezultuar nga ndarja ekzistuese, dhe si pasojë, rritjen e komponentëve të tyre nga niveli i grupit qe ishte më parë, në nivel të sektorit.

145. Shumica e ndarjeve të mbetura në sektorin C (Prodhimtaria) janë të pandryshuara, përpos ndarjeve të NACE Rev.1.1, ndarjet 22 (Publikimi, shtypi dhe riprodhimi i mediave të incizuara ) dhe 37 (Riciklimi), pjesët thelbësore të së cilës janë shpërngulur në sektorët e tjerë (shih më poshtë).

146. Riparimi dhe instalimi i makinerisë dhe pajisjeve, e cila dikur klasifikohej sipas prodhimtarisë së llojit korrespondues të pajisjes, tani identifikohet veçmas në ndarjen 33 (Riparimi dhe instalimi i makinerisë dhe pajisjeve). Të gjitha veprimtaritë e specializuara të riparimit, tani janë të klasifikueshme ndaras në NACE, edhe pse nuk është krijuar kurrfarë niveli i lartë i grupimit për “Riparimin”.

147. Një sektor i ri është krijuar, E (Ujësjllësi; ujërat e zeza, veprimtaritë e menaxhimit të mbeturinave dhe të riparimit), i cili përfshinë veprimtaritë e “sanitarisë” në NACE Rev. 1.1 ndarja 90. Grumbullimi i ujit dhe veprimtaritë e shpërndarjes në NACE Rev.1.1 ndarja 41 dhe materialet për veprimtaritë e riparimit, të cilat në masë të madhe korrespondojnë me NACE Rev.1.1, ndarja 37. Ky sektor tani grupon veprimtaritë e interesit të politikës së përbashkët, por është gjithashtu i bazuar në organzimin aktual të këtyre veprimtarive në një numër të madh të vendeve. E dhëna mbi këto veprimtari është rritur thelbësisht.

148. Koncepti i “Veprimtarive të specializuara të ndërtimit” (gjithashtu i njohur si “tregtitë speciale”) është futur në NACE Rev. 2, duke zëvendësuar strukturën e ndarjes së verzionit të mëparshëm, i cili ishte bazuar në masë të madhe në fazën e procesit të ndërtimit.

149. Riparimi i artikujve shtëpiakë është hequr nga sektori G (Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave) i NACE Rev.1.1. Megjithatë, përjashtimi për klasifikimin e tregtisë dhe të riparimit të automjeteve dhe motoçikletave në ndarjen 45 të NACE Rev. 2 (që korrespondon në ndarjen 50 në NACE Rev.1.1) ka mbetur për arsye të krahasueshmërisë dhe vazhdimësisë.

150. Detajet në sektorin I (Akomodimi dhe veprimtaritë e shërbimit të ushqimit) janë rritur për ta pasqyruar natyrën e ndryshme dhe specializimin e veprimtarive të kryera.

151. Një sektor i ri, J (Informatika dhe komunikimi) është krijuar, duke kombinuar veprimtaritë që përfshijnë prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve informative dhe kulturore, sigurimin e mjeteve për t'i transmetuar ose për t'i shpërndarë këto produkte, si dhe të dhënave ose komunikimeve, veprimtarive të teknologjisë informative dhe procesimin e të dhënave dhe të veprimtarive të tjera të shërbimit të informim. Komponentët kryesorë të këtij sektori janë veprimtaritë publikuese, duke përfshirë softuerin e publikimit (ndarja 58); filmi, dhe veprimtaritë e incizimit të zërit (ndarja 59); veprimtaritë e programit dhe emitimit radio televiziv (ndarja 60); veprimtaritë e telekomunikimit (ndarja 61); dhe veprimtaritë e teknologjisë informative (ndarja 62); si dhe veprimtaritë e tjera shërbyese për informim (ndarja 63). Këto veprimtari ishin përfshirë në NACE Rev.1.1 në sektorët D (Prodhimtaria), H (Transporti, deponimi dhe komunikimet), K (Patundshmëritë, veprimtaritë e qirasë dhe të biznesit) dhe O (Komuniteti tjetër, veprimtaritë sociale dhe të shërbimit personal), dhe kanë një ndikim të madh në krahasueshmërinë me versionin e mëparshëm të NACE. Megjithatë, ky trajtim i ri i veprimtarive të informacionit dhe komunikimit siguron një qasje më të qëndrueshme sesa versioni i mëparshëm i NACE-së, bazuar në natyrën e veprimtarive të kryera.

152. Në sektorin K (Financa dhe veprimtaritë e sigurimit), janë futur dy klasë, për të shkuar përtej fushëveprimit tradicional të NACE-së, në mbulimin e prodhimit ekonomik, d.m.th. klasa 64.20 (Veprimtaritë e kompanive holding) dhe 64.30 (Trustet, fondet dhe entitetet e ngjashme financiare).

153. Sektori i NACE Rev 1.1. për "Patundshmëritë, veprimtaritë e qirasë dhe të biznesit" është ndarë në tre sektorë në NACE Rev. 2. Tani, patundshmëria është përfaqësuar si sektor i vetëm (sektori L) për shkak të madhësisë dhe rëndësisë në Sistemin e Llogarive Kombëtare. Veprimtaritë e mbetura janë ndarë në sektorin M (Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike), duke mbuluar veprimtaritë që kërkojnë një shkallë të lartë të trajnimit dhe u mundësojnë shfrytëzuesve njohuri dhe aftësi të specializuara, dhe sektorin N (Veprimtaritë administrative të shërbimit të përkrahjes), duke mbuluar aktivitete që i mbështesin veprimet e përgjithshme të biznesit dhe që nuk përqendrohen në transferin e njohurive të specializuara. Kompjuteri dhe veprimtaritë lidhur me të (NACE Rev.1.1 ndarja 72) nuk janë më pjesë e këtij sektori. Veprimtaritë e riparimit të kompjuterit janë grupuar me riparimin e artikujve shtëpiakë në sektorin S, derisa softveri i publikimit dhe veprimtaritë e TI-së janë grupuar në një sektor të ri, J.

154. Fusha e arsimit (sektori P) është ndryshuar në mënyrë speciale për t'i përfshirë shërbimet e specializuara të sportit, kulturës dhe të shërbimeve të tjera arsimore, si dhe të shërbimeve të specializuara të përkrahjes.

155. Një detaj më tepër i është shtuar sektorit Q (Veprimtaritë e shëndetit njerëzor dhe të punës sociale), duke krijuar tri ndarje në vend të njërës, si në versionin e mëparshëm të NACE. Përveç kësaj, fokusi është ngushtuar dhe pëfshinë vetëm veprimtaritë e shëndetit njerëzor, duke siguruar një mjet më të mirë për matjen e kësaj pjese të rëndësishme të ekonomisë. Si

rezultat, veprimtaritë e veterinarisë janë hequr nga ky sektor dhe janë vendosur në një ndarje të sektorit M (Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike).

156. Komponentët thelbësorë të NACE Rev.1.1 sektori O (Veprimtaritë sociale dhe të shërbimit personal) janë shpërngulur në NACE Rev. 2; sektori E (Ujësjellësi; ujërat e zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe i veprimtarive të riparimit) dhe sektori J (Informatika dhe komunikimi), siç përshkruhen më lartë. Veprimtaritë e mbetura janë rigrupuar në dy sektorë të rinj: për art, argëtim dhe rekreacion (sektori R) dhe akvititetet e tjera të shërbimit (sektori S). Si rezultat, veprimtaritë, siç janë artet kreative, veprimtaritë bibliotekare dhe veprimtaritë e bixhozit janë ngritur në nivelin e ndarjes. Riparimi i kompjuterëve dhe i artikujve personalë dhe shtëpiakë tani përfshihen në këtë sektor të ri, S.

## 5.2 Tabelat Korresponduese: Fushëveprimi dhe Përdorimi

157 Tabelat korresponduese janë mjete të rëndësishme për krahasimin e të dhënave statistikore të mbledhura, të paraqitura gjatë klasifikimeve të ndryshme. Ato bëhen të nevojshme kur ndodhin ndryshimi kohore te klasifikimeve, ose kur kornizat e ndryshme të punës themelore nuk lejojnë që klasifikimet të jenë të lidhura ngushtë. Tabelat korresponduese ndërmjet versioneve të ndryshme të të njëjtit klasifikim përdoren për t'i përshkruar ndryshimet e sakta, që kanë ndodhur në procesin e ripunimit.

158. Pasi që NACE përdoret për mbledhjen dhe prezantimin e statistikave në shumë fusha, është paraqitur një nevojë e madhe për tabelat korresponduese ndërmjet NACE aktuale dhe versionit të saj të mëparshem. Korrespondencat e plota të detajuara ndërmjet NACE Rev. 2 dhe NACE Rev.1.1, dhe anasjelltas, janë të arritshme në formë elektronike, por nuk janë përfshirë në këtë publikim.

159. Kur është përpiluar NACE Rev. 2 dhe në të njëjtën kohë CPA 2008, u krijua një lidhje e fortë ndërmjet dy klasifikimeve. Duke i definuar mallrat në CPA sa herë që është e mundur në terme të CN, u krijua një tabelë e detajuar e korrespondencës ndërmjet CN, CPC, ISIC dhe NACE.

160. Të gjitha tabelat korresponduese janë të mundshme në formën elektronike, vetëm ose në RAMON *(http://ec.europa.eu/eurostat/ra-mon/index.cfm?TargetUrl=DSP_PUB_ËELC)*, ose në ueb-faqen e divisionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara *(http://unstats. un.org/unsd/class )*.

# Fjalorth

# Kapitulli 6

Ky fjalor jep një përshkrim tjetër të disa termave, të përdorura gjatë gjithë Hyrjes dhe Shënimeve Sqaruese të NACE Rev. 2. Është bërë çdo përpjekje per të siguruar se përshkrimet janë në pajtueshmëri me definicionet e termave kur përdoren diku tjetër, por këto përshkrime nuk kanë për qëllim t'i japin të gjitha kuptimet definitive të qëllimit të fjalëve. Qëllimi i këtij fjalori është thjesht që t'u ndihmojë përdoruesve të NACE-së për ta intepretuar atë në mënyrë të drejtë.

**Nën-produkt**: Një nën-produkt i veçantë është një produkt i lidhur teknologjikisht me prodhimin e produkteve të tjera të të njëjtit grup, por i cili nuk është i prodhuar në ndonjë grup tjetër (për shembull, melasat janë të lidhura me prodhimin e sheqerit). Nën-produktet e veçanta përdoren si inpute për prodhimin e produkteve të tjera. Një nën-produkt i rëndomtë (p.sh. një nën-produkt i cili nuk është i veçantë për një grup të vetëm) është një produkt i lidhur teknologjikisht me prodhimin e produkteteve të tjera, por i cili prodhohet në disa grupe (p.sh, hidrogjeni i prodhuar gjatë rafinimit të naftës është i lidhur teknologjikisht me atë produkt të prodhuar në prodhimtarinë petrokimike dhe karbonizimin e thëngjillit, dhe është identik me atë të prodhuar në grupin e përbërë nga produktet e tjera kimike bazë).

**Artikull**: artikulli është një mall i transportueshëm që mund të këmbehet. Ai mund të jetë një nga linjat e prodhimit, një artikull unik (Mona Liza) ose material i mesëm për një shërbim (disketë softveri). Ky është koncepti i përdorur për klasifikimet doganore.

***Mallrat kapitale:*** Mallrat kapitale janë mallra të tjera nga inputet materiale dhe benzina, të përdorura për prodhimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të tjera. Ato përfshijnë ndërtesat e fabrikës, makinerinë, lokomotivat, kamionët dhe traktorët. Toka, zakonisht nuk llogaritet si mall kapital.

***Procesi industrial:*** Një proces i transformimit (qoftë fizik, kimik, manual ose çfarëdo tjetër) i përdorur në prodhimin e produkteve të reja (qofshin mallra të konsumit, të ndërmjetme ose investuese), në procesimin e produkteve të përdorura ose në ofrimin e shërbimeve për industri, siç definohet në sektorin B (Industritë e nxjerrjes së minierave), C (Industria e prodhimit), D (Prodhimi dhe distribuimi i rrymës, gazit dhe avullit), E (Ujësjellësi, ujërat e zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe veprimtaritë e riparimit) dhe F (Industria e ndërtimit).

***Makineria: familjare ose shtëpiake:*** Makineria dhe pajisjet e një lloji të projektuar, kryesisht për përdorim nga ekonomitë shtëpiake private, për shembull makinat larëse të ekonomive shtëpiake.

***Makineri industriale:*** Makineria dhe pajisjet të percaktuara kryesisht për shfrytëzim në lokalet joshtëpiake, p.sh. mjetet e makinës ose makinat e llojit të larjeve të rrobave.

***Industria prodhuese:*** Të gjitha veprimtaritë e përfshira në Sektorin C. Janë përfshirë të dyja: industria, artizanatet dhe veprimtaritë e shkallës së gjerë. Duhet të theksohet se shfrytëzimi i pajisjeve të rënda ose makinerisë nuk është eksluzive për Sektorin C.

***Produkti:*** Një produkt është rezultat i veprimtarisë ekonomike. Është term gjenerik, i zbatuar për mallrat dhe shërbimet.

***Produkt i përfunduar:*** Produkt, për të cilin prodhimi ka përfunduar.

***Produktet gjysmë të përfunduara:*** Produktet, që i janë nënshtruar një procesi të prodhimit, por kërkojnë edhe më tepër procesim të prodhimit, para se të jenë të gatshme për shfrytëzim. Ato mund t'u shiten prodhuesve të tjerë, ose të transferohen në nënkontraktues për procesim të mëtutjeshëm. Shembujt tipikë përfshijnë modelimet e vrazhdëta metalike, të shitura ose të transferuara për përfundim diku tjetër.

***Prodhimi:*** Prodhimi është një aktivitet që rezulton me një produkt. Ai përdoret me referencë për tërë fushen e veprimtarive ekonomike. Termi nuk është rezervuar vetëm për sektorët e bujqësisë,

minierave ose prodhimtarisë. Ai, gjithashtu përdoret në lidhje me sektorin e shërbimeve. Mund të përdoren terma më specifikë për ta treguar prodhimin: dhënien e shërbimeve, procesimin, prodhimtarinë, etj., varësisht nga dega e veprimtarisë. Prodhimi mund të matet në mënyra të ndryshme ose në termat fizikë ose sipas vlerës.

***Transformimi:*** Transformimi është një proces që modifikon natyrën, përbërjen e lëndëve të para, produktet gjysmë të përfunduara ose të përfunduara për qëllimin e fitimit të produkteve të reja.

***Trajtimi:*** Është një proces që kryhet ndër të tjera me qëllim te mbrojtjes së disa produkteve për t'iu dhënë atyre disa rekuizita ose për parandalimin e çdo efekti të dëmshëm, që mund të rezultojë ndryshe nga përdorimi i tyre. Shembuj, janë trajtimi i kulturave bujqësore, i drurit, i metaleve dhe i mbeturinave.

*Vlera e Shtuar:* Vlera e shtuar bruto me çmimin bazë definohet si diferencë ndërmjet outputit me çmime bazë dhe konsumit të ndërmjetëm në çmimin blerës.

# Struktura e gjerë e

# NACE Rev. 2

# Pjesa II

## Struktura e gjerë e NACE Rev. 2

| Seksioni | Titulli | ndarjet |
|---|---|---|
| A | Bujqësi, pylltari dhe peshkatari | 01 - 03 |
| B | Xehetari dhe guroret | 05 – 09 |
| C | Prodhim | 10 – 33 |
| D | Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajr të kondicionuar | 35 |
| E | Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës | 36 – 39 |
| F | Ndërtimtari | 41 – 43 |
| G | Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave | 45 – 47 |
| I | Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim | 55 – 56 |
| H | Transport dhe ruajtje | 49 – 53 |
| J | Informacion dhe komunikim | 58 – 63 |
| K | Aktivitete financiare dhe të sigurimit | 64 – 66 |
| L | Aktivitete të patundshmërisë | 68 |
| M | Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike | 69 – 75 |
| N | Aktivitete administrative dhe mbështetëse | 77 – 82 |
| O | Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm | 84 |
| P | Arsim | 85 |
| Q | Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale | 86 – 88 |
| R | Art, zbavitje dhe rekreacion | 90 – 93 |
| S | Aktivitete të shërbimeve tjera | 94 – 96 |
| T | Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të ndryshme – aktivitete prodhuese shtëpiake për përdorim vetanak | 97 - 98 |
| U | Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë - territor iale | 99 |

# Struktura e Hollësishme e

# NACE Rev. 2

# Pjesa III

# Struktura e hollësishme e NACE Rev. 2

| Ndarja | Grupi | Klasa | | *pjesë ISIC Rev.4 |
|---|---|---|---|---|
| SEKTORI A -BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI | | | | |
| **01** | | | Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to | |
| | 01.1 | | Kultivimi i bimëve njëvjeçare | |
| | | 01.11 | Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore | 0111 |
| | | 01.12 | Kultivimi i orizit | 0112 |
| | | 01.13 | Kultivimi i perimeve, pjepërave dhe shalqirit, bimëve rrënjore dhe tuberose | 0113 |
| | | 01.14 | Kultivimi i kallamsheqerit | 0114 |
| | | 01.15 | Kultivimi i duhanit | 0115 |
| | | 01.16 | Kultivimi i bimëve fibroze | 0116 |
| | | 01.19 | Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare | 0119 |
| | 01.2 | | Kultivimi i kulturave shumëvjeçare | |
| | | 01.21 | Kultivimi i hardhive | 0121 |
| | | 01.22 | Kultivimi i frutave tropikale dhe subtropikale | 0122 |
| | | 01.23 | Kultivimi i agrumeve | 0123 |
| | | 01.24 | Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë | 0124 |
| | | 01.25 | Kultivimi i frutave të tjera pemore, shkurreve dhe arrave | 0125 |
| | | 01.26 | Kultivimi i frutave vajore | 0126 |
| | | 01.27 | Kultivimi i kulturave për prodhimin e pijeve | 0127 |
| | | 01.28 | Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore | 0128 |
| | | 01.29 | Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare | 0129 |
| | 01.3 | | Shumimi i bimëve | |
| | | 01.30 | Shumimi i bimëve | 0130 |
| | 01.4 | | Blegtoria | |
| | | 01.41 | Rritja e gjedheve për qumësht | 0141* |
| | | 01.42 | Rritja e gjedheve të tjera dhe buallicave | 0141* |
| | | 01.43 | Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve | 0142 |
| | | 01.44 | Rritja e gamileve dhe deveve | 0143 |
| | | 01.45 | Rritja e deleve dhe dhive | 0144 |
| | | 01.46 | Rritja e derrave | 0145 |
| | | 01.47 | Rritja e shpezëve | 0146 |
| | | 01.49 | Rritja e kafshëve të tjera | 0149 |
| | 01.5 | | Fermat e përziera | |
| | | 01.50 | Fermat e përziera | 0150 |
| | 01.6 | | Veprimtaritë përkrahëse për bujqësinë dhe veprimtaritë pas korrje-shirjeve | |
| | | 01.61 | Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore | 0161 |
| | | 01.62 | Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet blegtorale | 0162 |
| | | 01.63 | Veprimtaritë e paskorrjes së bimëve | 0163 |
| | | 01.64 | Përpunimi i farërave për shumim | 0164 |
| | 01.7 | | Gjuetia, vënia e pusive dhe veprimtaritë e tjera shërbyese | |
| | | 01.70 | Gjuetia, vënia e pusive dhe veprimtaritë e tjera shërbyese | 0170 |
| **02** | | | Pylltaria dhe prerja e drunjve | |
| | 02.1 | | Kulturat pyjore dhe veprimtaritë e tjera të pylltarisë | |
| | | 02.10 | Kulturat pyjore dhe veprimtaritë e tjera të pylltarisë | 0210 |
| | 02.2 | | Prerja e drunjve | |
| | | 02.20 | Prerja e drunjve | 0220 |
| | 02.3 | | Mbledhja e produkteve pyjore të egra jo drusore rritur në natyrë | |
| | | 02.30 | Mbledhja e produkteve pyjore të egra, jo drusore, rritur në natyrë | 0230 |
| | 02.4 | | Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve | |
| | | 02.40 | Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve | 0240 |
| **03** | | | Peshkimi dhe Akuakultura | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 03.1 | | Peshkimi | |
| | | 03.11 | Peshkimi detar | 0311 |
| | | 03.12 | Peshkimi në ujra të ëmbla | 0312 |
| | 03.2 | | Akuakultura | |
| | | 03.21 | Akuakultura detare | 0321 |
| | | 03.22 | Akuakultura në ujra të ëmbla | 0322 |

| SEKTORI B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE) | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **05** | | | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve | |
| | 05.1 | | Nxjerrja e qymyrit të fortë | |
| | | 05.10 | Nxjerrja e qymyrit të fortë | 0510 |
| | 05.2 | | Nxjerrja e linjiteve | |
| | | 05.20 | Nxjerrja e linjiteve | 0520 |
| **06** | | | Nxjerrja e naftës së papërpunuar dhe gazit natyror | |
| | 06.1 | | Nxerrja e naftës së papërpunuar | |
| | | 06.10 | Nxerrja e naftës së papërpunuar | 0610 |
| | 06.2 | | Nxerrja e gazit natyror | |
| | | 06.20 | Nxerrja e gazit natyror | 0620 |
| **07** | | | Nxjerrja e xehes së metalit | |
| | 07.1 | | Nxjerrja e xehes së hekurit | |
| | | 07.10 | Nxjerrja e xehes së hekurit | 0710 |
| | 07.2 | | Nxjerrja e xeheve jo-metalore | |
| | | 07.21 | Nxjerrja e xeheve të uraniumit dhe toriumit | 0721 |
| | | 07.29 | Nxjerrja e xeheve të tjera jo-metalore | 0729 |
| **08** | | | Xeherorët dhe guroret tjera | |
| | 08.1 | | Nxjerrja e gurit, rërës dhe argjilës | |
| | | 08.11 | Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave | 0810 |
| | | 08.12 | Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjillës dhe kaolinit | 0810 |
| | 08.9 | | Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse) p.k.t. | |
| | | 08.91 | Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehërave kimikë | 0891 |
| | | 08.92 | Nxerrja e torfës | 0892 |
| | | 08.93 | Nxjerrja e kripës | 0893 |
| | | 08.99 | Veprimtaritë e tjera nxjerrëse dhe gurore p.k.t. | 0899 |
| **09** | | | Veprimtaritë e shërbimeve mbështetëse të xeheroreve | |
| | 09.1 | | Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror | |
| | | 09.10 | Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror | 0910 |
| | 09.9 | | Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka | |
| | | 09.90 | Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka | 0990 |

| SEKTORI C - INDUSTRIA PËRPUNUESE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **10** | | | Përpunimi i produkteve ushqimore | |
| | 10.1 | | Përpunimi dhe konservimi (ruajtja) i mishit dhe produkteve me bazë mishi | |
| | | 10.11 | Përpunimi dhe konservimi i mishit | 1010* |
| | | 10.12 | Përpunimi dhe konservimi i mishit të shpezëve | 1010* |
| | | 10.13 | Prodhimi i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve | 1010* |
| | 10.2 | | Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve | |
| | | 10.20 | Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve | 1020 |
| | 10.3 | | Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe perimeve | |
| | | 10.31 | Përpunimi dhe konservimi i patates | 1030* |
| | | 10.32 | Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve | 1030* |
| | | 10.39 | Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve | 1030* |
| | 10.4 | | Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave bimore dhe shtazore | |
| | | 10.41 | Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave | 1040* |
| | | 10.42 | Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngjashme | 1040* |
| | 10.5 | | Prodhimi i produkteve të qumështit | |
| | | 10.51 | Prodhimi i produkteve të qumështit | 1050* |
| | | 10.52 | Prodhimi i akullores | 1050* |
| | 10.6 | | Përpunimi i produkteve të drithërave, niseshtes dhe produkteve të niseshtes | |
| | | 10.61 | Përpunimi i produkteve të drithërave | 1061 |
| | | 10.62 | Përpunimi i niseshtës dhe i produkteve të niseshtes | 1062 |
| | 10.7 | | Prodhimi i produkteve të bukës, ëmbëlsirave, makaronave | |
| | | 10.71 | Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta | 1071* |
| | | 10.72 | Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar | 1071* |
| | | 10.73 | Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli | 1074 |
| | 10.8 | | Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore | |
| | | 10.81 | Prodhimi i sheqerit | 1072 |
| | | 10.82 | Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave | 1073 |
| | | 10.83 | Përpunimi i çajit dhe kafes | 1079* |
| | | 10.84 | Përpunimi i erëzave dhe salcave | 1079* |
| | | 10.85 | Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme | 1075 |
| | | 10.86 | Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike | 1079* |
| | | 10.89 | Përpunimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t | 1079* |
| | 10.9 | | Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshë | |
| | | 10.91 | Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës | 1080* |
| | | 10.92 | Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake | 1080* |
| **11** | | | Prodhimi i pijeve | |
| | 11.0 | | Prodhimi i pijeve | |
| | | 11.01 | Destilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve | 1101 |
| | | 11.02 | Prodhimi i verës nga rrushi | 1102* |
| | | 11.03 | Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash | 1102* |
| | | 11.04 | Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padestiluara | 1102* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 11.05 | Prodhimi i birrës | 1103* |
| | | 11.06 | Prodhimi i majës së birrës | 1103* |
| | | 11.07 | Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe | 1104 |
| **12** | | | Prodhimi i produkteve të duhanit | |
| | 12.0 | | Prodhimi i produkteve të duhanit | |
| | | 12.00 | Prodhimi i produkteve të duhanit | 1200 |
| **13** | | | Prodhimi i tekstilit | |
| | 13.1 | | Përgatitja dhe thurja e fijeve të tesktilit | |
| | | 13.10 | Përgatitja dhe thurja e fijeve të tesktilit | 131 |
| | 13.2 | | Endja e tekstilit | |
| | | 13.20 | Endja e tekstilit | 1312 |
| | 13.3 | | Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit | |
| | | 13.30 | Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit | 1313 |
| | 13.9 | | Prodhimi i tekstileve të tjera | |
| | | 13.91 | Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura | 1391 |
| | | 13.92 | Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve | 1392 |
| | | 13.93 | Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve | 1393 |
| | | 13.94 | Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave | 1394 |
| | | 13.95 | Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve | 1399* |
| | | 13.96 | Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale | 1399* |
| | | 13.99 | Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t | 1399* |
| **14** | | | Prodhimi i veshjeve | |
| | 14.1 | | Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit | |
| | | 14.11 | Prodhimi i veshjeve të lëkurës | 1410* |
| | | 14.12 | Prodhimi i veshjeve të punës | 1410* |
| | | 14.13 | Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme | 1410* |
| | | 14.14 | Prodhimi i veshjeve të brendshme | 1410* |
| | | 14.19 | Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.) | 1410* |
| | 14.2 | | Prodhimi i artikujve nga gëzofi | |
| | | 14.20 | Prodhimi i artikujve nga gëzofi | 1420 |
| | 14.3 | | Prodhimi i rrobave të thurura me grep | |
| | | 14.31 | Prodhimi i çorapeve të thurura | |
| | | 14.39 | Prodhimi i rrobave të tjera të thurura ose të punuara me grep | 1430* |
| **15** | | | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës | |
| | 15.1 | | Tanimi dhe regjja e lëkurës; prodhimi i valixheve, çantave, takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit | |
| | | 15.11 | Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit | 1511 |
| | | 15.12 | Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve | 1512 |
| | 15.2 | | Prodhimi i këpucëve | |
| | | 15.20 | Prodhimi i këpucëve | 1520 |
| **16** | | | Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse | |
| | 16.1 | | Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 16.10 | Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria | 1610 |
| | 16.2 | | Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara-thurëse | |
| | | 16.21 | Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të panelave bazuar në dru (furniri) | 1621 |
| | | 16.22 | Prodhimi i parketit për dysheme | 1622* |
| | | 16.23 | Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese | 1622* |
| | | 16.24 | Prodhimi i kontejnerëve nga druri | 1623 |
| | | 16.29 | Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse | 1629 |
| **17** | | | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës | |
| | 17.1 | | Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit | |
| | | 17.11 | Prodhimi i brumit të letrës | 1701* |
| | | 17.12 | Prodhimi i letrës dhe kartonit | 1701* |
| | 17.2 | | Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit | |
| | | 17.21 | Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit | 1702 |
| | | 17.22 | Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit | 1709* |
| | | 17.23 | Prodhimi i materialit prej letrës për zyre | 1709* |
| | | 17.24 | Prodhimi i tapetave të mureve | 1709* |
| | | 17.29 | Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t. | 1709* |
| **18** | | | Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara | |
| | 18.1 | | Veprimtaritë e shtypjes (printimit) dhe shërbimet e lidhura me shtypjen | |
| | | 18.11 | Shtypja e gazetave | 1811* |
| | | 18.12 | Shtypje të tjera | 1811* |
| | | 18.13 | Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit | 1812* |
| | | 18.14 | Libërlidhja dhe shërbime të ngjashme | 1812* |
| | 18.2 | | Riprodhimi i mediave të incizuara | |
| | | 18.20 | Riprodhimi i mediave të incizuara | 1820 |
| **19** | | | Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës | |
| | 19.1 | | Prodhimi i produkteve të furrës së koksit | |
| | | 19.10 | Prodhimi i produkteve të furrës së koksit | 1910 |
| | 19.2 | | Prodhimi i produkteve të rafinuara të naftës | |
| | | 19.20 | Prodhimi i produkteve të rafinuara të naftës | 1920 |
| **20** | | | Prodhimi i produkteve kimike | |
| | 20.1 | | Prodhimin i produkteve kimike bazë, plehrave kimike dhe komponimeve të azotit, plastikës dhe gomës sintetike në formë primare | |
| | | 20.11 | Prodhimi i gazrave industriale | 2011* |
| | | 20.12 | Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve | 2011* |
| | | 20.13 | Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike | 2011* |
| | | 20.14 | Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike | 2011* |
| | | 20.15 | Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit | 2012 |
| | | 20.16 | Prodhimi i plastikës në formë primare | 2013* |
| | | 20.17 | Prodhimi i gomës sintetike në formë primare | 2013* |
| | 20.2 | | Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike | |
| | | 20.20 | Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike | 2021 |
| | 20.3 | | Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 20.30 | Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës | 2022 |
| | 20.4 | | Prodhimi i sapunit dhe detergjentëve, preparatave të pastrimit dhe lustrimit, parfumeve dhe prepareteve të tualetit | |
| | | 20.41 | Prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim | 2023* |
| | | 20.42 | Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit | 2023* |
| | 20.5 | | Prodhimi i produkteve të tjera kimike | |
| | | 20.51 | Prodhimi i eksplozivëve | 2029* |
| | | 20.52 | Prodhimi i ngjitësve | 2029* |
| | | 20.53 | Prodhimi i vajrave esenciale | 2029* |
| | | 20.59 | Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t. | 2029* |
| | 20.6 | | Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë | |
| | | 20.60 | Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë | 2030 |
| **21** | | | Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike | |
| | 21.1 | | Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike | |
| | | 21.10 | Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike | 2100* |
| | 21.2 | | Prodhimi i preparatave farmaceutike | |
| | | 21.20 | Prodhimi i preparatave farmaceutike | 2100* |
| **22** | | | Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës | |
| | 22.1 | | Prodhimi i produkteve të gomës | |
| | | 22.11 | Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; veshja dhe riparimi i gomave | 2211 |
| | | 22.19 | Prodhimi i produkteve të tjera të gomës | 2219 |
| | 22.2 | | Prodhimi i produkteve të plastikës | |
| | | 22.21 | Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve | 2220* |
| | | 22.22 | Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim | 2220* |
| | | 22.23 | Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari | 2220* |
| | | 22.29 | Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës | 2220* |
| **23** | | | Prodhimi i produkteve minerale jometalike | |
Kjo ndarje përfshin shërbimet e rastësishme të specializuara të përkrahjes për minierën, të dhëna në bazë të pagesës ose kontratës. Kjo përfshin shërbimet e eksplorimit, zbulimit nëpërmjet metodave tradicionale perspektive, siç janë: mostrat e bërthamës dhe studimet gjeologjike, si dhe shpuarjet, shpuarja testuese ose rishpuarja për puset e naftës, mineralet metalike dhe jometalike. Shërbimet e tjera tipike mbulojnë shërbimet e ndërtimit të bazave të naftës, si dhe të gazit, çimentimi i kanaleve të naftës, si dhe të gazit, pastrimin, heqjen e ujit, tamponimin i puseve të naftës dhe gazit, drenazhimin dhe pompimin i minierave, shërbimet rreth largimi të mbingarkesës në minierë, etj.

## 09.1 Veprimtaritë Mbështetëse për Nxjerrjen e Naftës dhe Gazit Natyror

### 09.10 Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet në nxjerrjen e naftës dhe gazit, të dhëna në bazë të pagesës dhe kontratës:
    - shërbimet eksploruese lidhur me nxjerrjen e naftës dhe gazit, p.sh. metodat tradicionale perspektive, siç janë: bërja e studimeve gjeologjike në lokacionet e ardhshme,
    - shpuarjet e drejtuara dhe rishpuarjet - gërmimet në tokë - vendosja e kullës shpuese në vendpunishte, riparimi dhe çmontimi; çimentimi i kanaleve të naftës dhe gazit; pompimi i puseve; lëvrimi dhe braktisja e puseve etj.,
    - lëngëzimi dhe rigasifikimi i gazit natyror për qëllim të transpotit, të bëra në vendin e minierës,
    - shërbimet e drenazhimit, pompimit, me pagesë ose në bazë të kontratës,
    - shpuarjet testuese lidhur me nxjerrjen e naftës dhe gazit.

Koj klasë përfshin:

- shërbimet e mbrojtjes së fushës së naftës dhe gazit nga zjarri.

Kjo klasë përfshin:

- veprimtaritë shërbyese, të kryera nga operatorët e fushave të naftës dhe gazit, shih 06.10, 06.20;
- riparimin e specializuar të makinerisë së minierës, shih 33.12;
- lëngëzimin dhe rigasifikimin e gazit natyror për qëllime transporti, të kryera larg vendpunishtes së minierës, shih 52.21;
- studimet gjeofizike, gjeologjike dhe seizmike, shih 71.12.

## 09.9 Veprimtaritë Mbështetëse për Nxjerrjen e Produkteve të Tjera nga Nëntoka

### 09.90 Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet përkrahëse me pagesë a me kontratë, të duhura për veprimtaritë e minierës së ndarjeve 05, 07 dhe 08:
    - shërbimet eksploruese, p.sh. metodat tradicionale, prespektive, siç janë: marrja e mostrës së bërthamës dhe bërja e studimeve gjeologjike në lokacionet e ardhshme,
    - shërbimet e drenazhimit dhe të pompimit në bazë të pagesës ose kontratës;
    - shpuarjet testuese dhe shpuarjet e vrimave testuese.

Kjo klasë përjashton:

- veprimin e minierave ose guroreve në bazë të kontratës a pagesës, shih ndarjen 05, 07 ose 08;
- riparimin e specilizuar të makinerisë së minierës, shih 33.12;
- shërbimet rreth studimeve gjeofizike, në bazë të kontratës a pagesës, shih 71.12.

# Sektori C – INDUSTRIA PËRPUNUESE

Ky sektor përfshin transformimin fizik ose kimik të materialeve, substancave, ose komponentëve në produkte të reja, edhe pse ky nuk mund të përdoret si kriter i vetëm universal, për definimin e prodhimit (shih vërejtjet në procesimin e mbeturinave më poshtë). Materialet, substancat, ose komponentët e transpformuar janë lëndë e parë, që janë produkte të bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, minierave ose guroreve, si dhe produktetet e veprimtarive të tjera prodhuese.

Ndërrimi substancial, renovimi ose rikonstruimi i artikujve në përgjithësi merret parasysh për të prodhuar. Përfundimi i procesit të prodhimit mund të kryhet në kuptim të asaj, që ai produkt është i gatshëm për përdorim ose konsumim, ose ai mund të gjysmëfinalizohet në kuptim të asaj, që ai të bëhet një input për prodhimin tjetër. Për shembull, prodhimi i aluminit të rafinuar është një input i përdorur në prodhimin primar të aluminit; alumini primar është input i telit të alunimit për nxerrjen e aluminit; dhe teli i aluminit është input për prodhimin e produkteve të fabrikuara të telit.

Prodhimi i komponentëve dhe pjesëve të specializuara, të aksesorëve dhe pjesëve të tjera, të bashkangjitura, makinerisë dhe pajisjes, klasifikohet, si rregull e përgjithshme, në të njëjtën klasë si të mirëmbajtjes së makinerisë dhe pajisjeve, për të cilën pjesët dhe aksesorët janë destinuar. Prodhimi i komponentëve jo të specializiuar të makinerisë dhe pajisjeve, p.sh. makinave, pistonëve, motorëve elektrikë, montimeve elektrike, valvulave, mekanizmave, kushinetave e cilindrave, klasifikohen në klasën e përshtatshme të prodhimit, pa marrë parasysh makinerinë dhe pajisjet, në të cilat këta artikuj mund të përfshihen.

Megjithatë, prodhimi i komponentëve dhe aksesorëve të specializuar, nëse me anë të formimit ose nxerrjes së materialeve plastike, është përfshirë në grupin 22.2. Montimi i pjesëve të komponentëve të produkteve të prodhuara konsiderohet prodhim. Kjo përfshin montimin e produkteve të prodhuara nga komponentët e vetëprodhuar ose të blera. Ripunimi i mbeturinave, p.sh. procesimi i mbeturinave në lëndë të parë sekondare klasifikohet në grupin 38.3 (ripunimi i materialeve). Derisa kjo mund t'i përfshijë transformimet fizike ose kimike, kjo nuk konsiderohet të jetë pjesë e prodhimit. Qëllimi primar i këtyre veprimtarive konsiderohet të jetë trajtimi ose procesimi i mbeturinave, dhe prandaj, ato klasifikohen në sektorin E (ujësjellësi; ujërat e zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe veprimtaritë e riparimit). Megjithatë, prodhimi i produkteve të reja finale si të kundërvëna ndaj lëndëve të para (sekondare) klasifikohet në prodhim. Madje, edhe nëse këto procese i përdorin mbeturinat si një input. Për shembull, prodhimi i argjendit nga mbeturinat e filmit konsiderohen të jenë proces i prodhimit.

Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinerisë dhe i pajisjeve industriale, komerciale dhe të ngjashme, në përgjithësi, klasifikohet në ndarjen 33 (Riparimi, mirëmbajtja dhe instalimi i makinerisë dhe pajisjeve). Megjithatë, riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personalë dhe shtëpiakë klasifikohen në ndarjen 95 (Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personalë dhe shtëpiakë). Derisa, riparimi i automjeteve klasifikohet në ndarjen 45 (Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave). Instalimi i makinerisë dhe pajisjeve kur kryhet si një veprimtari e specializuar, klasifikohet në 33.20.

Vërejtje: Kufijtë e prodhimit dhe sektorët e tjerë të sistemit tjetër të klasifikimit mund të jenë paksa të mjegulluar. Si rregull e përgjithshme, veprimtaritë në sektorin e prodhimit përfshijnë transofimin e materialeve në produkte të reja. Përfundimi i tyre është një produkt i ri. Megjithatë, definicioni se çka e përbën një produkt të ri, mund të jetë paska subjektiv. Si sqarim, veprmtaritë vijuese mund të konsiderohen si prodhuese në NACE:

- procesimi i peshqve të freskët (heqja e lëvozhgave e guacave të detit, filitimi i peshqve), jo të kryera në barkën e peshkimit (shih 10.20);
- pasterizimi i qumështit dhe mbushja e shisheve (shih 10.51);
- konvertimi i lëkurës (shih 15.11);
- konservimi i drurit (shih 16.10);
- veprimtaritë e shtypit lidhur me të (shih18.1);
- mbushja e gomave (shih 22.11);
- prodhimi i gatshëm i çimentos së përzier (shih 23.63);
- galvanizimi elektrik, galvanizimi, dhe trajtimi i nxehtësisë së metaleve (shih 25.61);
- rindërtimi ose riprodhimi i makinerisë (p.sh. makinat automobilistike, shih 29.10).

Anasjelltas, ka veprimtari, edhe pse nganjëherë bëjnë involvimin e proceseve transformuese, klasifikohen në sektorë të NACE-së; me fjalë të tjera, nuk klasifikohen në prodhim. Ata përfshijnë:

- prerjen e drunjve, klasifikuar në sektorin A (Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi);
- përfitimin i produkteve bujqësore, klasifikohet në sektorin A (Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi);
- përgatitjen e ushqimit për konsumim të menjëhershëm nëpër lokale, klasifikohet në ndarjen 56 (Veprimtaritë e shërbimit të ushqimit dhe pijeve);
- përfitimin e xeheve dhe mineraleve të tjera, klasifikuar në sektorin B (Minierat dhe guroret);
- ndërtimin e strukturave dhe veprimtaritë e fabrikimit, të kryera në vendpunishtet e ndërtimit, klasifikuar në sektorin F (ndërtimtaria);
- veprimtaritë e thyerjes së ngarkesës dhe të distribuimit në pjesëza më të vogla, përfshirë paketimin, ripaketimin, ose futjen në shishe të produkteve, siç janë: likerët ose kemikalet; klasifikimi i mbetjeve; përzierja e ngjyrave sipas porosisë së konsumatorit; dhe prerja e metaleve sipas porosisë së konsumatorit; trajtimi që nuk rezulton në artikuj të ndryshëm klasifikohet në sektorin G (Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave).

# 10 Përpunimi i Produkteve Ushqimore

Kjo ndarje përfshin procesimin e produkteve të bujqësisë, pylltarisë, peshkimit në produkteve për ushqimin e njerëzve ose të kafshëve, dhe përfshin prodhimin e produkteve të ndryshme të ndërmjetme, që nuk janë drejtpërsëdrejti produkte ushqimore. Veprimtaria shpesh gjeneron produkte që kanë vlerë më të madhe ose më të vogël (p.sh. lëkurat nga thertoret, ose bërësi për kafshët nga

prodhimi i naftës). Kjo ndarje organizohet sipas veprimtarive, që kanë të bëjnë me lloje të ndryshme të produkteve: mishi, peshku, fruta dhe perime, yndyrnat dhe vajrat, produktet qumështore, produktet e miellit të dridhërave, me ushqimin e kafshëve dhe produktet e tjera ushqimore.

Prodhimi mund të bëhen për llogarinë e vetë, si dhe për palët e treta, si në thertoren e zakonshme. Disa veprimtari konsiderohen prodhuese (p.sh, ato që kryhen në furra të bukës, shitoret e pastiçerisë, dhe shitoret e mishrave të përgatitur etj., të cilët i shesin prodhimet e veta). Madje, edhe pse ka një shitje dhe pakicë të produkteve në shitoret e vetë prodhuesve. Megjithatë, kur procesimi është minimal dhe ai nuk çon në transformim të vertetë, njësia klasifikohet si tregti me shumicë dhe pakicë (sektori G). Përgaditja e ushqimit për konsum të menjëhershëm nëpër objekteve klasifikohet në ndarjen 56 (Veprimtaritë shërbyese të ushqimit dhe pijes).

Prodhimi i ushqimit të kafshëve nga mbeturinat e thertoreve ose nënproduktet klasifikohen në 10.9, derisa procesimi i mbeturinave të ushqimit dhe pijeve në lëndë të parë sekondare 38,3 dhe në hedhjen e ushqimit e mbeturinave të ushqimit dhe pijeve 38.21. Kjo ndarje nuk përfshin përgatitjen e ushqimeve për konsum të menjëhershëm, siç janë nëpër restorante.

## 10.1 Përpunimi dhe Konservimi (Ruajtja) i Mishit dhe Produkteve me Bazë Mishi

### 10.11 Përpunimi dhe konservimi i mishit

Kjo klasë përfshin:

- punën e thertoreve të angazhuara në mbytjen, rregullimin ose paketimin e mishit: të gjedhit, derrit, qengjit, lepurit, deles, devës, etj.;
- prodhimin e mishit të freskët, të ftohur ose të ngrirë, në kërme;
- prodhimin e mishit të freskët, të ftohur apo të ngrirë, në copa.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- therjen dhe prrocesimin e balenave në tokë ose në barka të specializuara;
- prodhimin e gëzofave dhe lëkurave që vijnë nga thertoret, duke përfshirë shitësin e lëkurave;
- riprodhimin e dhjamit dhe yndyrnave të tjera ushqyese nga prejardhja e kafshëve;
- procesimin e hedhurinave të kafshëve;
- prodhimin i leshit të tjerrur.

Kjo klasë përjashton:

- riprodhimin e yndyrnave ushqyese të shpezëve, shih 10.12;
- paketimin e mishit, shih 82.92.

### 10.12 Përpunimi dhe konservimi i mishit të shpezëve

Kjo klasë përfshin:

- punën e thertoreve të angazhuar në mbytjen, rregullimin ose paketimin e shpezëve;
- prodhimin e mishit të freskët, të ftohur ose të ngrirë, porcione individuale;
- riprodhimin e yndyrnave ushqyese të shpezëve.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e puplave dhe krelave.

Kjo klasë përjashton:

- paketimin e mishit, shih 82.92.

### 10.13 Prodhimi i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e mishit të tharrë, të kripëzuar ose tymosur
- prodhimin e produkteve të mishit:
  - suxhukut, sallamit, pashtetës si dhe llojet e tjera të ngjashme

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e mishit të ngrirë, të përgatitur dhe gjellave të shpezëve, shih 10.85;
- prodhimin e supës që përmban mish, shih 10.89;
- tregtinë me shumicë të mishit, shih 46.32;
- paketimin e mishit, shih 82.92.

# 10.2 Përpunimi dhe Konservimi i Peshkut, Krustaceve dhe Molusqeve

## 10.20 Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve

Kjo klasë përfshin:
- përgatitjet dhe konservimin e peshqëe, krustacëve dhe moluskëve: të ngrirë, thell të ngrirë, të tharë, të zier, të tymosur, të kripëzuar, të zhytur në shëllirë, në konserva etj.;
- prodhimin e produkteve të peshqve, krustacëve dhe moluskëve: filetat e peshkut, hajvar, kaviar, dhe zëvendësuesit e kaviarit etj.;
- prodhimin e gjellërave të peshkut për konsum të njeriut ose për ushqim të kafshëve;
- prodhimin e gjellërave dhe tretjeve nga peshqit dhe kafshëve të tjera ujore, jo të përshtatshme për konsum nga njeriu.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- veprimtaritë e barkave, të angazhuara vetëm në procesimin dhe konservimin e peshqve;
- procesimin e algave të detit.

Kjo klasë përjashton:
- procesimin dhe konservimin e peshkut në barkat e angazhuara në peshkim, shih 03.11;
- procesimin e balenave në tokë ose në barkat e specializuara, shih 10.11;
- prodhimin e vajrave dhe yndyrnave nga materiali detar, shih 10.41;
- prodhimin e gjellërave të peshkut të përgatitura, shih 10.85;
- prodhimin e supave të peshkut, shih 10.89.

# 10.3 Përpunimi dhe Konservimi i Frutave dhe Perimeve

## 10.31 Përpunimi dhe konservimi i patates

Kjo klasë përfshin:
- procesimin dhe konservimin e patateve;
- prodhimin e patateve të përgatitura;
- prodhimin e pureve të patateve të dehidruara;
- prodhimin e mezeve të patateve;
- prodhimin e patateve të thyeshme, krispave;
- prodhimin e miellit dhe gjellës së patateve.

Kjo klasë përfshin:

- qërimin industrial të patateve.

### 10.32 Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e lëngjeve të frutave ose të perimeve.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e koncetrateve nga frutat dhe perimet e freskëta.

### 10.39 Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimit, që përmban kryesisht fruta ose perime, përveç gjellërave të gatshme në formë të ngrirë ose të konservuar;
- konservimin e frutave, arrave ose perimeve: të ngrira, të thara, të zhytur në vaj ose në uthull, në konserva etj.;
- prodhimin e ushqimeve të frutave ose perimeve;
- prodhimin e produkteve të ushqimit nga frutat ose perimet;
- prodhimin e reçeleve;
- prodhimin i marmeladave dhe xhelatinës së tavolinës - pjekjet e arrave – prodhimin e ushqimit dhe pastave nga arrat.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshinë:

- prodhimin e ushqimit që prishet të përgatitur nga frutat dhe perimet, siç janë:
  - sallatat, sallatat e përziera, të paketuara,
  - perimet e qëruara, ose të prera
  - tofu (gjizë bathe).

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e lëngjeve nga frutat ose perimet, shih 10.32;
- prodhimin e miellit ose gjellërave nga perimet e thara bishtajore, shih 10.61;
- konservimin e frutave dhe arrave në sheqer, shih 10.82;
- prodhimin e gjellërave të përgatitura nga perimet, shih 10.85;
- prodhimin e koncentrateve artificiale, shih 10.89.

## 10.4 Përpunimi i Vajrave dhe Yndyrnave Bimore dhe Shtazore

Ky grup përfshin prodhimin e vajrave dhe yndyrnave të papërpunuara dhe të rafinuara nga materialet perimore ose kafshore, përveç përpunimit ose rafinimit të dhjamit, yndyrnave të tjera ushqyese të kafshëve.

### 10.41 Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e vajrave të papërpunuara bimore: vajin e ullinjve, vajin e sojës, vajin e palmës, vajin e lulediellit, vajin e farës së pambukut, të rrepës, korzës ose mustardit, të farës së lirit etj.;
- prodhimin e miellit ose ushqimit të papërpunuar nga farat vajore, arrat ose thelbat vajor;
- prodhimin e vajrave të rafinuar nga perimet: vaji i ullinjve, i sojës etj.
- procesimin e vajrave të perimeve: fryerja, zierja, dehidrimi, hidrogjenimi etj.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e vajrave dhe yndyrnave joushqyese nga kafshët;
- nxjerrjen e peshqve dhe gjitarëve të detit për prodhimin e vajrave;
- prodhimin e linterve të pambukut, kekëve të vajit dhe produkteve të tjera, të mbetur nga prodhimi i vajit.

Kjo klasë përjashton:

- riprodhimin dhe rafinimin e dhjamit dhe yndyrnave të tjera ushqyese të kafshëve, shih 10.11;
- prodhimin e margarinës, shih 10.42;
- bluerjen e grurit të lagësht, shih 10.62;
- prodhimin e vajit të grurit, shih 10.62;
- prodhimin e vajrave, shih 20.53;
- trajtimin e vajrave dhe yndyrnave nga proceset kimike, shih 20.59.

### 10.42 Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngjashme

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e margarinës;
- prodhimin e pëzierjeve dhe gostive të ngjashme;
- prodhimin e yndyrnave të përziera të zierjes.

## 10.5 Prodhimi i Produkteve të Qumështit

### 10.51 Prodhimi i produkteve të qumështit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e qumështit të freskët të lëngët, të pasterizuar, të sterizuar, të homogenizuar dhe ose të trajtuar me ultranxehtësi;
- prodhimin e pijeve bazuar në qumësht;
- prodhimin e mazës nga qumështi i lëngët, i freskët, i pasterizuar, i sterilizuar, i homogenizuar;
- prodhimin e qumështit të tharrë ose të koncentuar, i ëmbëlsuar ose jo;
- prodhimin e qumështit ose mazës në formë të ngurtë;
- prodhimin e gjalpës;
- prodhimin e jogurtit;
- prodhimin e djathit dhe gjizës;
- prodhimin e hirrës;
- prodhimin e proteinave të qumështit ose lactose.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e qumështit të papërpunuar (të gjedhit), shih 01.41;
- prodhimin e qumështit të papërpunuar (dhenët, dhitë, kuajt, gomarët, devet, etj.), shih 01.43, 01.44, 01.45;
- prodhimin e zëvendësve të qumështit dhe djathit jo nga qumështi djathor, shih 10.89.

### 10.52 Prodhimi i akullores

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e akullores dhe të akulloreve të tjera ushqyese, siç është akullorja me lëng frutash.

Kjo klasë përjashton:

- veprimtaritë rreth tepricave të akulloreve, shih 56.10.

# 10.6 Përpunimi i Produkteve të Drithërave, Niseshtes dhe Produkteve të Niseshtes

Kjo klasë përfshin prodhimin e miellit ose të gjellërave nga drithërat ose perimet, prodhimin, pastrimin dhe rafinimin e orizit, si dhe prodhimin e përzierjeve të miellit a brumërave nga këto produkte. Në këtë klasë, gjithashtu, përfshihet prodhimi i qullit nga gruri dhe perimet, si dhe prodhimi i nishestes dhe produkteve të saj.

## 10.61 Përpunimi i produkteve të drithërave

Kjo klasë përfshin:
- bluarjen e drithit: prodhimi i miellit, bollgurët, gjellët ose topthat nga gruri, të thekrës, tërshërës, misrit, grurit ose drithërat e tjerë;
- prodhimin e orizit: prodhimi nga orizi i qëruar, bluar, rafinuar, zmaltuar, parazier ose të shndërruar; prodhimi i miellit të orizit;
- bluarjen e perimeve: prodhimi i miellit ose gjellërave nga perimet bishtajore të thara, nga rrënjët e e zhardhokëve ose të arrave ushqyese;
- prodhimin e ushqimit të mëngjesit nga drithërat;
- prodhimin e përzierjeve të miellit dhe të miellit të përgatitur, përzierje nga mielli dhe brumi për bukë, kekë, biskota ose petulla.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e miellit dhe gjellës së patateve, shih 10.31;
- përgatitjen e qullit të drithit, shih 10.62.

## 10.62 Përpunimi i niseshtes dhe i produkteve të niseshtes

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e nishesteve nga orizi, patatet, misri etj.;
- përgatitjen e qullit të drithit;
- prodhimin e glukozës, sirupit të glukozës, maltozës, inulit etj.;
- prodhimin e glutenit;
- prodhimin i tapiokës dhe zëvendësueve të tij të përgatitur nga nishesteja;
- prodhimin e vajit të misrit.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e laktozës (sheqer qumështi), shih 10.51;
- prodhimin e kallamit ose të rrepës së sheqerit, shih 10.81.

# 10.7 Prodhimi i Produkteve të Bukës, Ëmbëlsirave, Makaronave

Kjo grup përfshin prodhimin e produkteve të furrës, të makaronave, petëve dhe produkteve të ngjashme.

## 10.71 Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta

Kjo grup përfshin:
- prodhimin e produkteve të furrës së bukës:
  - buka dhe simitet,
  - pastat, kekët, byrekët, tortet, petullat, kulaçët, simitet etj.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e produkteve të thata të furrës, shih 10.72;
- prodhimin e pastave-makaronave, shih 10.73;
- ngrohjen e artikujve të furrës për konsum të menjëhershëm, shih ndarjen 56.

### 10.72 Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e peksimadhëve, biskotave dhe produkteve të tjera nga furra;
- prodhimin e artikujve dhe kekëve të konservuar nga pasta;
- prodhimin e produkteve të mezës së lehtë (ëmbëlsirat, biskotat e thara, gjevrekët etj.), të ëmbëlsuara ose të kripëzuar.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin i mezës së lehtë nga patatja, shih 10.31.

### 10.73 Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e pastave, siç janë: makaronat dhe shpagetave, qofteve të pjekura ose jo, ose të mbushura;
- prodhimin e koskovave;
- prodhimin e produkteve të konservuara ose të ngrira nga pasta.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e gjellërave të përgatitura nga kockat, shih 10.85;
- prodhimin e supave me përmbajtje të pastës, shih 10.89.

## 10.8 Prodhimi i Produkteve të Tjera Ushqimore

Kjo klasë përfshin prodhimin e ushqimeve dhe gjellërave të përgatitura nga sheqeri dhe ëmbëlsirat, kafeja, çaji dhe erëzat, si dhe produktet dhe specialitetet ushqimore jo të qëndrueshme.

### 10.81 Prodhimi i sheqerit

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin ose rafinimin e sheqerit (sakrozës) dhe të zëvendësueve të sheqerit nga lëngu i kallamit, rrepës, panjës dhe palmës;
- prodhimin e sirupëve nga sheqeri;
- prodhimin e melasës;
- prodhimin e sirupit të panjës dhe sheqerit.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e glukozës, sirupit të glukozës, maltozës, shih 10.62.

### 10.82 Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e kakaos, gjalpës së kakaos, yndyrës së kakaos, vajit të kakaos;
- prodhimin e çokollatës dhe ëmbëlsirave të çokollatës;
- prodhimin e ëmbëlsirave të sheqerit: karameleve, kaçaos, nugat, fondan, çokollatës së bardhë;
- prodhimin e çamçakëzit;
- konservimin në sheqer të frutave, arrave, lëvoreve të fruteve dhe një pjesë të tjera të bimëve;

- prodhimin e tabletave dhe pilulave të ëmbëlsirave.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e sheqerit të sakrozës, shih 10.81.

## 10.83 Përpunimi i çajit dhe kafes

Kjo klasë përfshin:

- dekafeinimin, shkafeinimin dhe pjekjen e kafesë;
- prodhimin i produkteve të kafesë:
  - kafe
  - kafe e tretshme,
  - extraktet dhe koncentratet e kafesë.
- prodhimin i zëvendësuesve të kafesë;
- përzierjen e çajit dhe matés;
- prodhimin i ekstrateve dhe përgatitjet bazuar në çaj ose mate;
- paketimin e çajit përfshirë paketimin në qese të çajit.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e barishteve (mentës, mender, shporriz, kamomil etj.).

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e inulinit, shih 10.62;
- prodhimin e pijeve të forta, birrës, verës dhe pijeve të buta, shih ndarjen 11;
- pregatitjen e produkteve botanike për përdorim farmaceutik, shih 21.20.

## 10.84 Përpunimi i erëzave dhe salcave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mëlmesave-erëzave, soset dhe erëzat:
  - majoneza,
  - mielli i mustardit dhe gjellërave,
  - mustardi i përgatitur etj.,
- prodhimin e uthullës.

Kjo klasë përfshin:

- procesimin e kripës në shkallë të kripës së ushqimit, p.sh.kripa e jodizuar.

Kjo klasë përjashton:

- kultivimin e të korrave të erëzave, shih 01.28.

## 10.85 Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme

Kjo klasë përfshin prodhimin e ushqimeve dhe gjellëve të gatshme (d.m.th. të përgatitura, të lezetuara me erëza dhe të ziera). Këto gjellëra procesohen për t'u konservuar si në formë të ngrirë, ose në konservë, dhe zakonisht janë të paketuara dhe me etiketa për rishitje, d.m.th. kjo klasë nuk përfshin përgatitjen e gjellërave për konsum të menjëhershëm, si në restorante. Për t'u konsideruar si ushqim, këto ushqime duhet të përmbajnë së paku dy përbërës të dallueshëm (përveç erëzave, etj.).

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gjellërave të mishit ose të shpezëve;
- prodhimin e gjellërave të peshkut, përfshirë peshkun dhe patatet e skuqura;
- prodhimin gjellërave të perimeve;
- prodhimin e picës së ngrirë ose picës së konservuar.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e gjellërave lokale dhe kombëtare.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e ushqimit të freskët ose të ushqimeve me më pak se dy përbërës, shih klasën korresponduese në ndarjen 10;
- prodhimin e ushqimeve të përgatitura jo të qëndrueshme, shih 10.89;
- shitjen me pakicë të gjellërave dhe ushqimeve në shitore, shih 47.11, 47.29;
- shitja me shumicë e mishit dhe ushqimit te përpunuar, shih 46.38 ;
- veprimtaritë shërbyese të ushqimit për kontraktuesit, shih 56.29.

### 10.86 Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimeve për përdorime të veçanta ushqyese:
    - recetë foshnjash qumështi,
    - ushqimet tjera qumështore per foshnja,
    - ushqimet e bebes,
    - ushqimet me energji të ulët dhe ato me energji të zvogëluar të destinuar për kontrollin e peshës,
    - ushqimet dietike për qëllime speciale mjekësore,
    - ushqimet me natrium të ulët, përfshirë racionet me pak natrum dhe pa kripëra,
    - ushqimin e destinuar për rritje intensive të muskujve, veçanërisht ushqimin e sportistëve për personat, që vuajnë nga metabolizimi karbohidratik.

### 10.89 Përpunimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e supave dhe lëngjeve të mishit;
- prodhimin e mjaltit artificial dhe karamelave;
- prodhimin e ushqimeve të përgatitura jo të qëndrueshme, siç janë:
    - sandviçët,
    - picat e freskëta (të papjekuar),
- prodhimin e shtesave ushqimore dhe produkteve të tjera të ushqimit p.k.t.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e majës –tharmit;
- prodhimin e ekstrakteve dhe lëngjeve të mishit, peshkut, krustacëve ose moluskëve;
- prodhimin e qumështit jodjathor dhe zëvendësusve të djathit;
- prodhimin e produkteve të vezëve, albuminet e vezëve;
- prodhimin e koncentrateve artificiale.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e ushqimeve të përgatitura jo të qëndrueshme nga frutet dhe perimet, shih 10.39;
- prodhimin e picave të ngrira, shih 10.85;
- prodhimin e pijeve të forta, birrës, verës dhe pijeve të buta, shih ndarjen 11.

# 10.9 Përpunimi i Ushqimeve të Përgatitura për Kafshë

## 10.91 Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës, përfshirë edhe ushqimin e koncentruar të kafshëve dhe shtesat ushqimore;
- përgatitjen e ushqimeve të papërziera (më vete) për kafshët e fermës.

Kjo klasë. Gjithashtu. përfshin:

- trajtimin e mbeturinave të thertores për të prodhuar ushqime të kafshëve të fermës.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e ushqimeve nga peshku për ushqimin e kafshëve, shih 10.20;
- prodhimin e kekut nga fara e vajit, shih 10.41;
- veprimtaritë që rezultojnë nga produktet qe shfrytëzohen per  ushqime te kafsheve pa ndonje trajtim te veçantë (shih 10.41) etj., mbetjet e kokrrave te drithit  te bluar (shih 10.61) etj.

## 10.92 Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin i ushqimeve të përgatitura për kafshët përkëdhelëse, përfshirë qentë, macet, zogjtë, peshqit etj.

Kjo klasë përfshin:

- trajtimin e mbeturinave të thertores për të prodhuar ushqime për kafshë.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e ushqimeve nga peshku, për ushqimin e kafshëve, shih 10.20;
- prodhimin e kekut nga fara e vajit, shih 10.41;
- veprimtaritë që rezultojnë në nënprodukte të përdorshme si ushqim të kafshëve, pa ndonjë trajtim special, p.sh. fara e vajit (shih 10.41), tepricat nga bluarja e drithit (shih10.61) etj.

# 11 Prodhimi i Pijeve

Kjo klasë përfshin prodhimin e pijeve, si dhe pijet joalkoolike, ujin mineral, prodhimin e pijeve alkoolike, kryesisht nëpërmjet fermentimit, birrës dhe verës dhe prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32;
- prodhimin e pijeve bazuar në qumësht, shih 10.51;
- prodhimin e kafesë, çajit dhe produkteve ndihmëse, shih 10.83.
-

# 11.0 Prodhimi i Pijeve

## 11.01 Distilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve të distiluara, të pijshme, alkoolike: uiski, konjaku, xhini, likerëve etj.;

- prodhimin e pijeve të përziera me pije të distiluara alkoolike;
- përzierjen e pijeve të destiluara;
- prodhimin e spiritikëve neutralë.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pijeve alkoolike, jo të distiluara, shih 11.02-11.06;
- prodhimin e alkoolit sintetik të etilit, shih 20.14;
- prodhimin e alkoolit etil nga materialet e fermentuara, shih 20.14;
- vetëm mbushjen dhe vënien e etiketave, shih 46.34 (nëse bëhet si pjesë e shitjse me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet në bazë të pagesës a kontratës).

### 11.02 Prodhimi i verës nga rrushi

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e verës;
- prodhimin e verës shkumëzuese;
- prodhimin e verës nga shira e koncentruar e rrushit.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- përzierjen, pastrimin dhe mbushjen e shisheve;
- prodhimin e verës së butë apo joalkoolike.

Kjo klasë përjashton:

- vetëm mbushjen e shisheve dhe vënien e etiketave, shih 46.34 (nëse kryhet si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet në bazë të pagesës a kontratës).

### 11.03 Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve të fermentuara, por jo të distiluara alkoolike: sake, verë molle, perit - raki dardhe, verërave të tjera të frutave.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e medit dhe pijeve të tjera të përziera, që kanë përbërje të verërave të frutave.

Kjo klasë përjashton:

- vetëm mbushjen e shisheve dhe vënien e etiketave, shih 46.34 (nëse kryhet si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet në bazë të pagesës a kontratës).

### 11.04 Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e vermutit dhe të ngjashme.

Kjo klasë përjashton:

- vetëm mbushjen e shisheve dhe vënien e etiketave, shih 46.34 (nëse kryhet si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet në bazë të pagesës a kontratës).

### 11.05 Prodhimi i birrës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve të maltit, si: birra, birra e lehtë, birra e zezë dhe birra e fortë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e birrës së lehtë dhe joalkoolike.
-

### 11.06 Prodhimi i majës së birrës

### 11.07 Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe
Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e pijeve joalkoolike (përveç birrës dhe verës joalkoolike);
- prodhimin e ujit natyral mineral, ujit tjerë në shishe;
- prodhimin e pijeve të lehta:
- ▪ prodhimin e ujit joalkoolik, të aromatizuar, dhe ose të ëmbëlsuar: limonadës, pijeve freskuese të portokallit, coca colës, pijeve të frutave, ujit tonik etj.

Kjo klasë përjashton :
- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32;
- prodhimin e pijeve bazuar në qumësht, shih 10.51;
- prodhimin e kafesë, çajit, të produkteve të maté-s, shih 10.83;
- prodhimin e pijeve bazuar në alkool, shih 11.01, 11.02, 11.03, 11.04, 11.05;
- prodhimin e verës joalkoolike, shih 11.02;
- prodhimin e birrës joalkoolike, shih 11.05;
- prodhimin e akullores, shih 35.30;
- vetëm mbushjen e shisheve dhe vënien e etiketave, shih 46.34 (nëse kryhet si pjesë e shitjes me shumicë) dhe 82.92 (nëse kryhet në bazë të pagesës a kontratës).

# 12 Prodhimi i Produkteve të Duhanit

Kjo ndarje përfshin procesimin e një produkti bujqësor, duhanit, në një formë të përshtatshme për konsumim final.

## 12.0 Prodhimi i Produkteve të Duhanit

### 12.00 Prodhimi i produkteve të duhanit
Kjo klasë përfshinë:
- prodhimin e produkteve të duhanit dhe produkteve zëvendësuese të duhanit: cigaret, prerjeve te holla te cigareve, duhanit për llullë, duhanit përtypës, tymosje
- prodhimin e duhanit të "homogjenizuar " ose "rizgjedhur –riformuar " .

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:
- këputjen e gjethit dhe ritharjen e duhanit.

Kjo klasë përjashton:
- kultivimin ose procesimin paraprak të duhanit, shih 01.15, 01.63.

# 13 Prodhimi i Tekstilit

Kjo ndarje përfshinë përgatitjen dhe tjerrjen e fijeve të tekstilit, si dhe thurjen-endjen, kryerjen e tekstileve dhe të rrobave të veshjes, prodhimin e artikujve të gatshëm të tekstilit, përveç rrobave (p.sh.

teshave –ndërresave shtëpiake, batanijeve, sexhadeve, litarëve etj.). Kultivimi i fijeve natyrale përshkruhet në ndarjen 01, derisa prodhimi i fijeve sintetike është një proces kimik i klasifikuar në klasën 20.60. Prodhimi i rrobave të veshjes përshkruhet në ndarjen 14.

# 13.1 Përgatitja dhe Thurja e Fijeve të Tesktilit

## 13.10 Përgatitja dhe thurja e fijeve të tesktilit

Kjo ndarje përfshin veprimtaritë përgatitore të fijeve të tekstilit dhe tjerrjen e fijeve të tekstilit. Kjo mund të bëhet nga ndryshimi i lëndës së parë, siç janë: mëndafshi, leshi, fijet e tjera të kafshëve dhe perimeve ose të të prodhuara nga njeriu, letra dhe qelqi etj.
Kjo klasë përfshin:

- veprimtaritë përgatitore rreth fijeve të tekstilit:
  - palosja dhe larja e mëndafshit,
  - heqja e yndyrës dhe karbonizimi i leshit dhe ngjyrosja e leshit të deles,
  - shprishja dhe krehja e fijeve të të gjitha llojeve të kafshëve, perimeve, dhe fijeve të prodhuara nga njeriu.
- tjerrjen dhe prodhimin e fijes dhe perit për të thurur ose qepur, për tregtim ose për procesim të mëtutjeshëm:
  - rrahja e lirit - thurja e pëlhurës,
  - thurja, palosja, lidhja me litar dhe kridhja e penjve dhe penjzave sintetike ose artificiale.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e perit të letrës.

Kjo klasë përjashton:

- veprimtaritë përgatitore, të kryera në kombinim me bujqësinë, shih ndarjen 01;
- njomëzimin e bimëve që bartin fije të tekstilit të perimeve si (juta, liri, koiri etj.), shih 01.16;
- zhveshjen e pambukut, shih 01.63;
- prodhimin e fijeve dhe shtëllungave sistetike ose artificiale, prodhimin e penjve të vetëm (përfshirë perin e cilësisë së ngjitjes dhe të perit për qilima) nga fijet sintetike ose artificiale, shih 20.60;
- prodhimin e fijeve të qelqit, shih 23.14.

# 13.2 Endja e Tekstilit

## 13.20 Endja e tekstilit

Kjo klasë përfshin thurjen e tekstilit. Kjo mund të kryhet nga ndryshimi i lëndës së parë, si: mëndafshit, leshit dhe të fijeve të tjera të kafshëve, të perimeve ose të prodhuara nga njeriu, letra ose qelqi etj.
Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e llojit të gjerë të pambukut të thurur, llojit të leshit, llojit të lëmuar ose pëlhurave të mëndafshit, përfshirë përzierjet ose penjtë artificialë a sistetikë (polipropileni etj.).
- prodhimin e pëlhurave – pëlhurave të tjera të thurura, duke përdorur lirin, ramin, hempin, jutën, fijet e lëvoreve dhe penjve specialë.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e pëlhurave me qime të thurura ose të fijeve, ose të penjëve të kadifessë, peshqirëve të mëndafshit, fashave etj.;
- prodhimin e fabriakteve, pëlhurave të thurura nga fijet e qelqit;
- prodhimin e karbonit të thurur dhe të penjve të aramidit;
- prodhimin e imitimit të gëzofit nga thurja.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pëlhurave të thurura dhe të bigëzuara, shih 13.91;
- prodhimin e mbulesave të tekstilit për dysheme, shih 13.93;
- prodhimin e stofave jo të thurur, shih 13.95;
- prodhimin e pëlhurave të holla-ngushta, shih 13.96;
- prodhimin e shajakut, shih 13.

## 13.3 Proceset Përfundimtare të Përpunimit të Tekstilit

### 13.30 Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit

Kjo klasë përfshin përfundimin e tekstileve dhe të thurjes së rrobave, d.m.th.. zbardhimi, ngjyrosja, qepja e veshjeve dhe të veprimtarive të ngjashme.

Kjo klasë përfshin:

- zbardhjen dhe ngjyrosjen e fijeve të tekstilit, penjve, pëlhurave dhe artikujve të tekstilit, përfshirë thurjen e rrobave;
- veshjet, tharjen, nxjerrjen e avullit, tkurrjen, ndreqjen, rregullimin artikujve të tekstilit, përfshirë thurjen e rrobave.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshinë:

- zbardhjen e farmerkave
- palosjen dhe punët e ngjashme të tekstilit;
- papërshkueshmërinë nga uji, shtresimin me stofa, veshjen me gomë, ose pllenimin e veshjeve të blera;
- shtypjen e ndarëses së mëndafsht në tekstile dhe rroba të thurura.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pëlhurave të tekstilit të pllenuar, të shtresuar, të mbuluar ose të petizuar me gomë-kauçuk, aty ku goma është përbërësi kryesor, shih 22.19.

### 13.9 Prodhimi i tekstileve të tjera

Kjo klasë përfshin prodhimin e produkteve të prodhuara nga tekstilet, përveç rrobave të veshjes, siç janë artikujt e prodhuar nga tekstili, çilimat dhe sexhadet, litarët, pëlhurat e holla të thurura, zbukurimet etj.

### 13.91 Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin dhe procesimin e pëlhurave të thurura ose të thurura me grep, dantellat;
- pëlhurat me qime dhe pëlhurat e mëndafshit;
- llojin e pëlhurave të rrjetit dhe të dritareve të thurura në makina Raschel ose të ngjashme;
- pëlhurat e tjera të thurura ose të punuara me grep.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e gëzofit të imituar me anë të thurjes.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pëlhurave të llojit për rrjetë dhe dritare nga dantellat e thurura në makinat e Raschel-it ose të ngjashme, shih 13.99;
- prodhimin e rrobave të thurura ose të punuara me grep, shih 14.39.

## 13.92 Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e artikujve të gatshëm nga cilido material i tekstilit, përfshirë pëlhurat e thurura a të punuara me grep:
  - batanijet, përfshirë materialet për udhëtim,
- çaraçafët për shtretër, tavolina, toalet ose për kuzhinë, jorganët me pupla, jastëkët, pufet, thastë e fjetjes etj.;
- prodhimin e artikujve të gatshëm të orendive:
  - perdet, valancet, grilat e dritareve, mbulesat e krevatit, të mobiljeve ose të mbulesave të makinave etj.,
  - pëlhurë e gomuar (cerada), tendet, artikuj e kampingut, vela, çadra dielli, mbulesa të gjëra për vetura, makina ose mobile etj.,
  - flamuj, banderola, famuj sinjalizimi etj.,
  - N - lecka pluhuri, shtup enësh dhe artikuj të ngjashëm, jelekë shpëtimi, parashutat etj.

Kjo klasë, po ashtu përfshinë:

- prodhimin e pjesëve të tekstilit të batanijeve elektrike;
- prodhimin e tapicerive të thurura.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e artikujve të tekstilit për përdorim teknik, shih13.96.

## 13.93 Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mbulesave të dyshemeve nga tekstili:
  - qilimat, sexhadet dhe rrogazët.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e mbulesave të endura me plis.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e rrogazave dhe materialeve të tjera të rrogazës të thurura, shih 16.29;
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë nga fletët e tapës, shih 16.29;
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë nga materiali elastik, siç është: vinili, linoleumi, shih 22.23.

## 13.94 Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e spangove, litarëve, dhe kabllove të prodhuara nga fijet e tekstilit, ose rripave ose të ngjashëm, qoftë të impregnuar, të veshur me gomë ose me plastikë;
- prodhimin e rrjetave të thurrura nga spangoja, litarë të anijeve ose litarëve të tjerë;
- prodhimin e produkteve të litarëve ose të rrjetave: rrjetat e pershkatarëve, rrjeteve të anijeve, jastëkve shkarkues, rripave ngarkues, të litarëve, ose kabllove të pajisur me unaza metalike etj.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e rrjetave për flokë, shih 14.19;
- prodhimin e litarëve me fije teli, shih 25.93;
- prodhimin e rrjetave me bisht-karriqeve për peshkim sportiv, shih 32.30.

### 13.95 Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve

Kjo klasë përfshin të gjitha veprimtaritë lidhur me prodhimin e tekstileve ose produkteve të tekstilit jo të saktësuar diku tjetër në ndarjen 13 ose 14, duke përfshirë një numër të madh të proceseve dhe një llojllojshmëri të madhe të artikullit të prodhuar.

### 13.96 Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e pëhurave të holla, përfshirë pëlhurat që pëbëhen nga indet e mbledhura me anë të ngjitësit;
- prodhimin e tiketave, simbolet etj.;
- prodhimin e zbukurimeve ornamentale: shiritet, tufëzat, xhufkat etj.;
- prodhimin e pëlhurave të pllenuara, të mbështjellura, të veshura ose e petëzuar me plastikë;
- prodhimin e perit të metalizuar ose perit të metalizuar me shirit, të perit të gomës dhe spango të veshur me material tekstili, perit të tekstilit ose rripit të veshur të impregnuar, mbështjellur, ose i futur në këllëf në gomë ose plastikë;
- prodhimin e pëlhurës të spangos për gomë të ngjitjes së lartë të perit të prodhuar nga njeriu;
- prodhimin e pëlhurave të tjera të trajtuara ose të veshura: bezet dhe pëlhurat e ngjashme të ngurtësuara të tekstilit, pëlhurat e veshura me gomë ose substanca amilacioze;
- prodhimin e artikujve të ndryshëm të tekstilit: fitilet e tekstilit, mantelat inkandeshente dhe të gazit cilindrik;
- prodhimin e pëlhurave të mantelave me qafëgjatë, të transmisionit ose të rripave transportues ose prodhimin e rripave (qoftë të sforcuar apo jo me metal, ose me materiale të tjera), pëlhurave shtrënguese, pëlhurave kulluese;
- prodhimin e zbukurimeve të automjeteve;
- prodhimin e tabelave për punë artistësh dhe pëlhurat për skicim.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e rripave të transmetimit ose të transportimit nga pëlhurat e tesktilit, perit ose spangos së imprengnuar, të mbështjellur, të veshur ose të petëzuar me gomë, ku goma është përbërësi kryesor, shih 22.19;
- prodhimin e pllakave ose të fletave nga goma celulare ose plastike e kombinuar me tekstile vetëm për qëllime forcuese, shih 22.19, 22.21;
- prodhimin e stofit nga teli metalik i thurur, shih 25.93.

### 13.99 Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin i shajakut;
- prodhimin e tylit dhe pëlhurave të tjera të rrjetës, dhe gajtanit, si dhe qëndisjet në uniforma ose në motive;
- prodhimin e shiritave te tekstilit të ndjeshem në shtypje;
- prodhimin e lidhësave të këpucëve nga tekstili;

- prodhimin e dorashkave dhe pufave.

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e mbulesave të dyshemesë nga shajaku i thurur me grep, shih 13.93;
- prodhimin e vatave të tekstilit dhe artikujve të vatave: peshqirët sanitarë, tamponat etj., shih 17.22.

# 14 Prodhimi i Veshjeve

Kjo ndarje përfshin të gjitha qepjet (të gatshme për veshje ose të prodhuara për t'u matur), në të gjitha materialet (p.sh. lëkurës, pëlhurave të thurura ose të punuara me grep etj.) e të gjithë artikujve të veshjes (p.sh. veshjes e sipërme, veshja e brendshme për burra, gra ose fëmijë; veshjet e punës, veshjet e përditshme ose të rastit etj.) dhe artikujt ndihmës. Nuk ka kurrfarë dallimi ndërmjet veshjes për të rritur dhe veshjes për fëmijë, ose ndërmjet veshjes moderne dhe tradicionale. Ndarja 14 përfshinë industrinë e gëzofit (pëlhurat e gëzofit dhe rrobat e veshjes).

## 14.1 Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit

Kjo klasë përfshin prodhimin e rrobave të veshjes. Materiali i përdorur mund të jetë nga cilido lloj dhe mund të jetë i mbështjellë, i impregnuar ose i gomëzuar.

### 14.11 Prodhimi i veshjeve të lëkurës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e rrobave të veshjes të prodhuara nga lëkura ose të përbërjes prej lëkure, përfshirë aksesorët e punës së industrisë së lëkurës, siç janë: përparset e lëkurës për salduesit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e rrobave bartëse të gëzofit, shih 14.20;
- prodhimin e dorëzave dhe kapelave sportive të lëkurës, shih 32.30;
- prodhimin e veshjeve rezistuese ndaj zjarrit dhe të sigurisë mbrojtëse nga zjarri, shih 32.99.

### 14.12 Prodhimi i veshjeve të punës

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e këpucëve, shih 15.20;
- prodhimin e veshjeve kundër zjarrit dhe sigurisë mbrojtëse nga zjarri, shih 32.99;
- riparimin e rrobave të veshjes, shih 95.29.

### 14.13 Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e veshjeve të tjera të jashtme, të prodhuara nga pëlhurat e thurura, tjerrura ose të punuara me grep, jo të thurura etj, për burra, gra dhe fëmijë:
  - pallto, kostume, komplete rrobash, xhaketa, pantallona, funde etj.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- qepjen e kostumit;
- prodhimin e pjesëve të produkteve të radhitura në listë.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e rrobave të veshjes, lëkurat e gëzofit (përveç kësulave), shih 14.20;
- prodhimin e rrobave të veshjes nga goma ose plastika, jo të montuar me anë të qepjes, por thjesht me anë të ngjitjes 22.19, 22.29;
- prodhimin e veshjeve kundër zjarrit dhe sigurisë mbrojtëse nga zjarri, 32.99;
- riparimin i rrobave të veshjes, shih 95.29.

### 14.14 Prodhimi i veshjeve të brendshme

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e rrobave të brendshme dhe të natës, të prodhuar nga pëlhura e thurur e tjerrur ose e punuar me grep, dantellave etj., për burra, gra dhe fëmijë:
    - këmishave, maicave, brekëve, pantallonat e shkurtra, pizhamat, këmishat e natës, rroba shtëpie, bluzat, këmishat e brendshme, gjimbajtëset, korset etj.

Kjo klasë përjashton:
- riparimin e rrobave të veshjes, shih 95.29.

### 14.19 Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e veshjeve të bebeve, veshjeve sportive, kompleteve të skijimit, të notimit etj.;
- prodhimin e kapelave dhe kaçketave;
- prodhimin e pjesëve të tjera ndihmëse të veshjes: dorëzat, rripat, shallet, lidhëset, kravatat, rrjetet e flokëve etj.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshinë:
- prodhimin e kapelave nga lëkurat e gëzofit;
- prodhimin e veshmbathjes nga materiali i tekstilit, duke mos përfshirë  pjesen e fundit te kepuceve (shollat);
- prodhimin e pjesëve të tjera të produkteve të radhitura në listë.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e kapelave sportive, shih 32.30;
- prodhimin e kapelave të sigurisë (përveç kapelave sportive), shih 32.99;
- prodhimin e veshjeve kundër zjarrit, të sigurisë mbrojtëse ndaj zjarrit, shih 32.99;
- riparimin e rrobave të veshjes, shih 95.29.

## 14.2 Prodhimi i Artikujve nga Gëzofi

### 14.20 Prodhimi i artikujve nga gëzofi

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e artikuvje të bërë nga lëkurat e gëzofit:
    - rrobat e veshjes nga gëzofi dhe pjesët ndihmëse të veshjes,
    - komplete rrobash nga lëkurat e gëzofit, siç janë: “të rëna” pllakat, rrogozat, uniformat etj.,
    - artikuj të ndryshëm nga lëkurat e gëzofit: sexhadet, pufet jo të mbushura, pëlhurat industriale të lustrimit.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e lekures se pa përpunuar , shih 01.4, 01.70;

- prodhimin e lëndëve të para të lëkurave dhe gëzofave, shih 10.11;
- prodhimin e imitimit të gëzofave (pëlhurë me qime të gjata e fituar me anë të thurjes ose punës me grep), shih 13.20, 13.91;
- prodhimin e kapelave te leshta shih 14.19;
- prodhimin e veshjeve te shkurtera  te leshta, shih 14.19;
- të veshurit dhe ngjyrosja e gëzofit, shih 15.11;
- prodhimin e çizmeve ose këpucëve që përmbajnë pjesë të gëzofit, shih 15.20.

## 14.3 Prodhimi i Rrobave të Thurura me Grep

### 14.31 Prodhimi i qorapeve të thurura

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikullit të trokitur, përfshirë çorapet, trikot dhe mbathjet getegrash me këmbëza.

### 14.39 Prodhimi i rrobave të tjera të thurura ose të punuara me grep

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e rrobave të veshjes të thurura ose të punuara me grep dhe rrobave të tjera të punuara me dorë: xhemperët, triko,jelek dhe te ngjashme).

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pëlhurave të thurura dhe të punuara me grep, shih 13.91;
- prodhimin e çorapave të gjata, shih 14.31.

# 15 Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës

Kjo ndarje përfshin prerjen dhe ngjyrosjen e gëzofit dhe transformimin e lëkurave të papërpunuara në lëkurë, me anë të tanimit ose të konservimit dhe fabrikimin e lëkurës në produkte për konsumim final.

Kjo ndarje, gjithashtu, përfshin prodhimin e produkteve të ngjashme nga materialet e tjera (imitimin e lëkurës ose të zëvendësuesve të saj), si veshmbathjen e gomës, valixhet e tekstilit etj. Produktet e prodhuara nga zëvendësuesit e lëkurës përfshihen këtu, pasi që ato prodhohen në të njëjtën mënyrë sikurse prodhohen produktet e lëkurës (p.sh. valixhet) dhe janë shpesh të prodhuara në të njëjtën njësi.

## 15.1 Tanimi dhe Regjja e Lëkurës; Prodhimi i Valixheve, Çantave, Takëmeve të Kuajve dhe Takëmeve të Tjerë; Veshja dhe Ngjyrosja e Gëzofit

Ka grup përfshin prodhimin e produkteve të lëkurës dhe gëzofit.

### 15.11 Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit

Kjo klasë përfshin:

- tanimin, ngjyrosjen dhe rregullimin e lëkurës dhe të llojeve të saj;
- prodhimin e kamoshit të përgatitur, pergamenit të përgatitur, lëkurave origjinale ose të metalizuara;
- prodhimin e lëkurës së krijuar me gërvishje, qethje, shpuplim, regjie, tanim, zbardhje dhe ngjyrosje të lëkurave dhe gëzofave me qime në to.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e gëzofave dhe lëkurave si pjesë të fermës, shih 01.4;
- prodhimin e gëzofave dhe lëkurave si pjesë therjes, shih 10.11;
- prodhimin e rrobave të lëkurës, shih 14.11;
- prodhimin e imitimit të lëkurës, jo të bazuar në lëkurën natyrale, shih 22.19, 22.29.

### 15.12 Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme nga lëkura, nga përbërja e lëkurës, ose ndonjë material tjetër, siç është fletëzimi plastik, materialet e tekstilit, fijet e vulkanizuara ose kartonat, ku përdoret e njëjta teknologji si për lëkurën;
- prodhimin e takëmave dhe parzmoreve të kuajve;
- prodhimin e rriporeve jo metalike (p.sh. pëlhurës, lëkurës, plastikës);
- prodhimin e artikujve të ndryshëm nga lëkura ose përbërja e lëkurës: rripat e sigurisë, vozitjes, paketimit etj.;
- prodhimin e lidhësave të këpucëve nga lëkura;
- prodhimin e kamxhikëve, pajisjeve për ngasjen të kuajve

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e rrobave të veshjes nga lëkura, shih 14.11;
- prodhimin e dorëzave dhe kapelave të lëkurës, shih 14.19;
- prodhimin e veshmbathjes, shih 15.20;
- prodhimin e shalëve për biçikleta, shih 30.92;
- prodhimin e rripave për metale të çmueshme, shih 32.12;
- prodhimin e rripave për metale jo të çmueshme, shih 32.13;
- prodhimin e rripave të sigurisë për rojtarët dhe rripat e tjerë për përdorim profesional, shih 32.99.

## 15.2 Prodhimi i Këpucëve

### 15.20 Prodhimi i këpucëve

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e veshmbathjeve për të gjitha perdorimet nga çfarëdo materiali, me anë të çfaredo procesi, përfshirë shkrirjen ne kallëpe(shih përjashtimet e mëposhtme );
- prodhimin e pjesëve të lëkurës për veshmbathje: prodhimin e pjesëve të sipërme, të shuallëve të jashtëm dhe të brendshëm, të thembrave etj.;
- prodhimin e këpucëve pa lidhese dhe artikujve të ngjashëm.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e veshmbathjeve nga materiali i tekstilit pa përfshirjen e shualleve, shih 14.19;
- prodhimin e pjesëve të drurit për këpucë (p.sh. thembrat dhe këllëfet e këpucëve), shih 16.29;
- prodhimin e çizmeve të gomës dhe të thembrave të këpucëve dhe shualleve të këpucëve dhe të pjesëve të tjera të veshmbathjeve nga goma, shih 22.19;
- prodhimin e pjesëve plastike të veshmbathjeve, shih 22.29;
- prodhimin e çizmeve të skijimit, shih 32.30;
- prodhimin e këpucëve ortopodike, shih 32.50.

# 16 Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara-Thurëse

Kjo ndarje përfshin prodhimin e produkteve të drurit, siç është lënda e drurit, kompensata, rimeso, kontejnerët e drurit, shtrimin e dyshemeve, strugimi i drunjve dhe ndërtesat e parafabrikuara nga druri. Proceset e prodhimit përfshijnë: sharrimin, planifikimin, formën, lustrimin dhe montimin e produkteve të drurit, duke filluar nga trungjet, që janë prerë në grupe, ose lëndët e tjera të drurit dhe që pastaj mund të prehen më tutje ose të marrin formë me anë të tajeve dhe mjeteve të tjera të formës. Lëndet e prera ose format e tjera të transformuara të drurit mund, më pas, të zdrukthtohen ose të lëmohen dhe të montohen në produkte të përfunduara, siç janë kontejnerët e drurit.

Me përjashtim të kantierit të sharrimit, kjo ndarje është nëndarë kryesisht bazuar në produktet specifike të prodhuara.

Kjo ndarje nuk përfshin prodhimin e mobiljeve (31.0), ose instalimin e pajisjeve të drurit dhe të ngjashëm (43.32, 43.33, 43.39).

## 16.1 Sharrimi i Drurit dhe Zdrukthëtaria

### 16.10 Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria

Kjo klasë përfshin:
- sharrimin, lëmimin dhe makinimin në fletëzim, heqjen e lëvores ose ashkëlimin e trungjeve;
- prodhimin e traversave të drunjta të hekurudhës;
- prodhimin e parketit të drunjtë të pamontuar;
- prodhimin e leshit të drurit, miellit të drurit, dhe ashklave.

Kjo klasë përfshin:
- tharjen e drurit;
- pllenimin ose trajtimin kimikal të drurit me prezervativa ose materiale të tjera.

Kjo klasë përjashton:
- prerjen e trupave dhe prodhimin e drurit në dorë të parë, shih 02.20;
- prodhimin e fletëzave mjaft të holla për përdorim në rimeso, dërrasa dhe panele, shih 16.21;
- prodhimin e petavrave dhe shtrëngesave, rruazave dhe kallëpeve, shih 16.23;
- prodhimin e trungjeve të drurit ose drurit të presuar, shih 16.29.

## 16.2 Prodhimi i Produkteve të Drurit, Tapës, Kashtës dhe Materialeve të Gërshetuara-Thurëse

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të drurit, të tapës, të kashtës ose të materialeve thurëse, përfshirë format themelore, si dhe produktet e montuara.

### 16.21 Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të panelave bazuar në dru (furniri)

Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e fletave rimeso, mjaft të holla, për t'i përdorur për rimesim, për prodhimin e kompensatave ose për qëllime të tjera:

    - të lustruara, ngjyrosura, veshura, impregnuara, sforcuara (me letër ose mbështjelljeje përlhure),
    - të prodhuar në formë të motiveve.
- prodhimin e kompensatave, panelave të rimesos dhe të dërrasave dhe fletëzave të ngjashme të drurit të lëmuar;
- prodhimin e dërrasës së hollë te orientuar dhe pjesëve të tjera të dërrasës;
- prodhimin e fijeve të dërrasës së densitetit të mesëm dhe fijet e tjera të dërrasave;
- prodhimin e drurit të dendësuar;
- prodhimin e drurit të lëmuar ngjitës, drurit të lëmuar rimeso.

### 16.22 Prodhimi i parketit për dysheme

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e blloqeve të drunjta të parketit për dysheme, të gjuhëzave etj., të montuar në panele.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e dyshemeve të drunjta të pamontuara, shih 16.10.

### 16.23 Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e artikujve të drunjtë, të paraparë për përdorim kryesisht në industrinë e ndërtimtarisë:
    - traversat, qeper, përforcus të kulmeve,
    - kapriatet e drunjta, të lëmuara ngjitëse, dhe të lidhura me metal,
    - të parafabrikuara,
    - dyert, dritaret,grilat dhe kornizat e tyre me përmbajtje ose jo përmbajtje të pajisjeve metalike, siç janë mbajteset, dryrët etj.
    - prodhimin e shkallëve, parmakëve;
    - rruazave dhe kallapëve e drunjta, petavrave dhe shtrëngesave;
- prodhimin e ndërtesave ose elementeve të parafabrikuara, të dominuara nga druri, p.sh. saunat;
- prodhimin e shtëpive mobile;
- prodhimin e pjesëzave të drunjta (përveç atyre që rrin vetë).

Kjo kalasë përjashton:

- prodhimin e kabineteve të kuzhinës, raftet e librave, garderobat etj., shih 31.01, 31.02, 31.09;
- prodhimin e pjesëzave të drurit, (përveç atyre që rrin vetë) , shih 31.01, 31.02, 31.09.

### 16.24 Prodhimi i kontejnerëve nga druri

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e arkave të paketimit, kutive, arkëzave, daulleve dhe paketimet e ngjashme nga druri;
- prodhimin e paletave, paletave kuti dhe dërrasve të tjera të ngarkesës nga druri;
- prodhimin e barrelave, vaskave, kazanëve dhe produkteve të tjera të vozapunuesve;
- prodhimin e bucelave të drunjta kabllovike.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e valixheve, shih 15.12;
- prodhimin e arkave nga materiali thurës, shih 16.29.

### 16.29 Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të llojllojshme nga druri:
  - dorëzat dhe trupat për mjetet e fshesave, furçave,
  - këpucët e gjatë prej druri ose kallëpet e këpucëve, varëseve të rrobave,
  - enëve të kuzhinës së amvisërisë dhe enëve të gatimit nga druri, statujave të drurit dhe ornamenteve,
  - zbukurimet e drurit, drurit të brendshëm, arkat e drurit për stoli argjendarie,
  - takëmet dhe artikuj e ngjashëm,
  - çikrikët e drurit, kapset, bobinat, qerthujt i perit të qepjes dhe artikuj të ngjashëm,
  - artikuj të tjerë nga druri.
- procesimin naturor të tapës, prodhimin nga tapa e aglomeratuar;
- prodhimin e artikujve nga tapa natyrore ose e aglomeruar, përfshirë mbulesat e dyshemesë;
- prodhimin e thurjeve dhe produktet nga materialet e thurjes: rrogozat, shtrirja e rrogozave, ndarëset - paret, arkat – sanduqet etj.;
- prodhimin e artikujve të shportave dhe artikujve për thurje;
- shportat - prodhimin e kërcullit të zjarrit dhe topthat për energji, të prodhuar nga druri i presuar ose i materialit zëvendësues, siç janë kafeja ose fushat e sojës;
- prodhimin e pjesëve të këpucëve nga druri (p.sh. thembrat dhe kallëpet);
- prodhimin e dorëzave për ambrella, thuprat dhe të ngjashme;
- prodhimin e bloqeve për prodhimin e gypave të tymit të duhanit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e rrogozave dhe shtrirejeve me material të tekstilit, shih 13.92;
- prodhimin e valixheve, shih 15.12;
- prodhimin e mbathjeve të drunjta, shih 15.20;
- prodhimin e shkrepsave, shih 20.51;
- prodhimin e arkave për orët e murit, shih 26.52;
- prodhimin e çikrikëve dhe bobinat, që janë pjesë e makinerisë së tekstilit;
- prodhimin e mobiljeve, shih 31.0;
- prodhimin e lodrave të drurit, shih 32.40;
- prodhimin e brushave dhe fshesave, shih 32.91;
- prodhimin e arkivolëve, shih 32.99;
- prodhimin e tapës si prezervativ të jetës, shih 32.99.

# 17 Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës

Kjo ndarje përfshin prodhimin e pulpit, të letrës dhe të produkteve të konvertuara të letrës. Prodhimi i këtyre produkteve grupohen bashkë, sepse ata formojnë një seri të proceseve të lidhura vertikalisht. Më tepër se një veprimtari shpesh kryhen në një njësi.

Janë tri veprimtari thelbësore: prodhimi i pulpit përfshinë ndarjen e fijeve celuloze nga lënda tjetër e drurit, ose disolvimin dhe heqjen e ngjyrës nga letra e përdorur dhe përzierjen e saj në sasi të vogla të reagentëve për të forcuar lidhjen e fibrave. Prodhimi i letrës përfshinë nxjerrjen e pulpit në një gojëz lëvizëse të telit, ashtu që të formojë një fletë të vazhdueshme. Produktet e konvertuara të letrës prodhohen nga letra dhe materialet e tjera, me anë të teknikave të ndryshme.

Artikujt e letrës mund të shtypen (p.sh. tapetat e murit, mbështjellëset për dhuruta etj.), aq gjatë sa shtypja e informatës nuk është qëllimi kryesor.

Prodhimi i pulpit, letrës dhe kartonit me sasira të mëdha përfshihet në grupin 17.1, ndërsa klasat e mbetura përfshijnë prodhimin e letrës dhe produkteve të letrës në proceset e mëtutjeshme.

## 17.1 Prodhimi i Brumit të Letrës, Letrës dhe Kartonit

### 17.11 Prodhimi i brumit të letrës

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e pulpit të letrës, të zbardhur, gjysmë të zbardhur, ose jo të zbardhur, me procese mekanike, kimike (disolvim apo jo disolvim) ose gjysmë kimike;
- prodhimin e pulpit të pambukut-linterit;
- largimin e ngjyrës dhe prodhimin e pulpit nga letra e hedhur.

### 17.12 Prodhimi i letrës dhe kartonit

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e letrës dhe kartonit për procesim të mëtutjeshëm industrial.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- procesimin e mëtutjeshëm të letrës dhe kartonit;
- veshjen, mbulimin dhe impregnimin e letrës dhe kartonit;
- prodhimin e letrës së petëzuar ose të zhburgosur;
- prodhimin e laminateve dhe folieve, nëse janë ilustruar me letër ose karton, nëse është i lëmuar me letër a karton;
- prodhimin e letrës së prodhuar me dorë;
- prodhimin e letrës për gazeta dhe letrës tjetër për shtypje ose shkrim;
- prodhimin e vatave celuloze dhe të rrjetave nga fibrat celuloze;
- prodhimin e letrës së kopjimit ose letrës së shablonit në rolne ose fleta të mëdha.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e letrës së rrudhur dhe të kartonit, shih 17.21;
- prodhimin e artikujve të letrës me procesim të mëtutjeshëm, kartonit ose pulpit, shih 17.22,17.23, 17.24, 17.29;
- prodhimin e letrës së veshur ose të impregnuar, ku veshja ose imprenguesi është përbërësi kryesor, shih klasën në të cilën prodhimi i veshjes ose impregnuesi është klasifikuar;
- prodhimi i letrës abrasive, shih 23.91.

## 17.2 Prodhimi i Artikujve të Letrës dhe Kartonit

### 17.21 Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e letrës dhe kartonit të rrudhur;
- prodhimin e kutive nga letra dhe kartonit të rrudhur;
- prodhimin e kutive të palosura nga kartonët;
- prodhimin e kutive nga kartoni i fortë;
- prodhimin e kutive të tjera nga letra dhe kartoni;
- prodhimin e thasëve dhe qeseve nga letra;
- prodhimin e kutive të dosjeve për zyrë dhe artikujve të ngjashëm.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e zarfave, shih 17.23;
- prodhimin e artikujve të letrës nga pulpi i letrës së formësuar ose të presuar, (p.sh. kutitë për paketimin e vezëve, pllakëzat e formësuara të pulpi të letrës), shih 17.29.

### 17.22 Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e letrës shtëpiake dhe të higjienës personale dhe produktet e mbushura me celulozë:
  - letra pastruese,
  - faculetat e letrës, peshqirët, letra te kuzhines
  - letra e tualetit;
  - peshqirët dhe tamponat sanitarë,pelenat dhe pelenat e letres(pampersat për bebe),
  - filxhanët, enët dhe tabakët.
- prodhimin e vatave të tekstilit dhe të artikujve të peshqirëve sanitarë, për vata dhe tampona, etj.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e vatave celuloze, shih 17.12.

### 17.23 Prodhimi i materialit prej letrës për zyre

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e letrës së shtypit dhe të shkrimit, e gatshme për përdorim;
- prodhimin e letrës për shtyp të kompjuterëve, e gatshme për përdorim;
- prodhimin e letrës vetëkopjuese, e gatshme për përdorim;
- prodhimin a shablonëve të duplikatorëve dhe letrës së shablonit, e gatshme për përdorim;
- prodhimin e letrës së gomës ose ngjitësve, e gatshme për përdorim;
- prodhimin e zarfave dhe kartolinave, tamponat etj.;
- prodhimin e letrës së shkrimit për arsim dhe tregti (fletore, libralidhëse, regjistra, libra të kontabilitetit, formularë të biznesit etj.), kur informata e shtypur nuk është karakteristika kryesore;

- prodhimin e kutive, çantave prej letre, kuletave dhe konspekte shkrimi, të përbërë nga asurtmeni i letrës së shkrimit.

Kjo klasë përjashton:

- shtypjen mbi produktet e letrës, shih 18.1.

### 17.24 Prodhimi i tapetave të mureve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tapicerisë dhe mbulesave të ngjashme të murit, përfshirë tapicerinë e veshur me vinil dhe tapicerinë e tekstilit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e letrës dhe kartonit në sasira të mëdha, shih 17.12;
- prodhimin e tapicerisë plastike, shih 22.29.

### 17.29 Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e etiketave;
- prodhimin e letrës filtruese dhe të kartonit;
- prodhimin e bobinave, çikrrikëve dhe kapëseve të letrës dhe të kartonit etj.;
- prodhimin e tabakëve të vezëve dhe produktet e tjera të paketimit nga pulpi i formësuar etj.;
- prodhimin e artikujve të letrës;
- prodhimin e kartave nga letra ose kartoni, për përdorim në makinat Jacquard.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e kartave të bixhozit, shih 32.40;
- prodhimin e lojërave dhe lodrave nga letra ose kartoni, shih 32.40.

# 18 Shtypja dhe Riprodhimi i Mediave të Incizuara

Kjo ndarje përfshin shtypjen e produkteve, siç janë: gazetat, librat, periodikët, formularët e biznesit, kartolinat përshëndetëse dhe materiale të tjera, dhe veprimtaritë përcjellëse përkrahëse, siç janë: libërlidhja, shërbimet e prodhimit të pllakave dhe pasqyrimin e të dhënave. Veprimtaritë përkrahëse të përfshira këtu janë një pjesë integrale e industrisë së shtypit, dhe si produkte (pllaka e shtypit, lidhja e librit, ose disku ose dosja i kompjuterit) janë si pjesë integrale e industrisë së shtypit, që gati gjithnjë sigurohet nga këto veprimtari. Proceset përdorura në shtyp përfshijnë një llojllojshmëri të metodave për transferin e një pamje nga një vend, ekran a dosje të kompjuterit, në një medium, siç janë: letra, plastika, metali, artikujt e tekstilit ose të drurit. Metoda më e njohur e këtyre e detyron transferin e pamjes nga një pllakë ose ekran në medium, nëpërmjet litugrafisë, gravurës, ekranit ose shtypjes fleksografike. Shpesh dosja i kompjuterit përdoret që drejtpërsëdrejti ta “shtyjë” mekanizmin e shtypit, për ta krijuar pamjen ose llojet e tjera elektrostatike ose të pajisjes (digjital ose shtypjes pa inpakt). Nëpërmjet shtypit, edhe publikimi mund të kryhet nga njësia e njëjtë (p.sh. një gazetë), është më pak se rasti i këtyre veprimtarive të dallueshme, që kryhen në të njëjtin lokacion fizik. Ndarja, gjithashtu përfshin riprodhimin e mediave të incizuara, siç janë: kompakt disqet, video incizimet, softverët në disqe, në kasetë, etj. Kjo ndarje përjashton veprimtaritë publikuese (shih sektorin J).

## 18.1 Veprimtaritë e Shtypjes (Printimit) dhe Shërbimet e Lidhura me Shtypjen

Ky grup përfshin produktet e shtypit, siç janë: gazetat, librat, periodikët, formularët e biznesit, kartolinat përshëndetëse dhe materialet e tjera, dhe aktivitet përcjellëse të përkrahjes, siç janë: lidhja e librit, shërbimet e prodhimit të pllakave dhe pasqyrimi i të dhënave. Shtypja mund të kryhet duke përdorur teknika të ndryshme dhe në materiale të ndryshme.

### 18.11 Shtypja e gazetave

Kjo klasë, gjithashtu përfshin:

- shtypjen e periodikëve të tjerë, që dalin së paku katër herë në javë.

Kjo klasë përjashton:

- publikimin e lëndës së shtypur, shih 58.1;
- fotokopjimin e dokumenteve, shih 82.19.

### 18.12 Shtypje të tjera

Kjo klasë përfshin:

- shtypjen e revistave dhe periodikëve të tjerë, që botohen së paku katër herë në javë;
- shtypjen e librave dhe broshurave, të muzikës dhe manuskriptet e muzikës, hartat, atlasat, posterët, katalogët e reklamimit, prospektet dhe reklamat e tjera të shtypura, pullat postare, pullat e tatimit, dokumentet e titullit, qeqet dhe letrat e tjera të sigurisë, kartelat smart, albumet, ditarët, kalendarët dhe materialet tjera komerciale të shtypura, materialet e shkrimit personal dhe lëndët e tjera të shtypura me anë të letrave të shtypit, offset, fotogravurës, fleksografikës, shtypit në ekran dhe botimet e tjera të shtypit, makinat e fotokopjimit, printerët e kompjuterit, përfshirë shtypjen e shpejtë;
- të shtypurit drejtpërsëdrejti në tekstil, plastikë, qelq, metal, dru dhe keramikë. Materiali i shtypur është zakonisht me të drejtë të autorit.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- shtypjen e etiketave ose kordeleve (litografik, shtypje në gravur, shtypje fleksografike, etj.).

Kjo klasë përjashton:

- shtypjen serigrafike në tekstil dhe rrobat e veshjes, shih 13.30;
- prodhimin e artikujve të shkrimit (fletoret, libërlidhësit, regjistrat, librat e kontabilitetit, formularët e biznesit etj.), kur informata e shtypur nuk është karakteristika kryesore, shih 17.23;
- publikimin e lëndëve të shtypuara, shih 58.1.

### 18.13 Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit

Kjo klasë përfshin:

- kompozimin, radhitjen e shkronjave, radhitjen e fotografive, inputet e të dhënave para shtypit, përfshirë skanimin dhe njohjen optike të karakterit, përbërjen elektronike;
- përgatitjen e dosjeve, të dhëna për multimedial, aplikimet e shtypjes në letër, CD-ROM, Internet;
- shërbimet e bërjes së pllakës, përfshirë përgatitjen ose vendosjen e pamjes (për proceset e shtypit, të shtypjes së letrës dhe offset)
- përgatitjen e cilindrave: ose gravimin e cilindrave për shtypje të gravurës;
- procesimin e pllakave: “pllaka e kompjuterit” CTP (gjithashtu pllakat e fotopolimerit);
- përgatitjen e pllakave dhe vulave për vulosjen e relievit ose shtypjes;
- përgatitjen e:

- veprave artistike të karakterit teknik, siç janë: përgatitjet e gurëve litografikë dhe blloqeve të drurit,
- prezantimit të medias, p.sh. ekranet per projektor dhe format e tjera të prezantimit,
- skenat, planifikimet, maketat, etj.,
- prodhimin e dëshmive.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e specializuar të dizajnit, shih 74.10.

### 18.14 Libërlidhja dhe shërbime të ngjashme

Kjo klasë përjashton:

- lidhjen e fletëve të shtypura, vendosjen e mostrës dhe shërbimet pas shtypit, të përkrahjes së veprimtarive të shtypit, p.sh.: lidhja dhe përfundimi i librave, broshurave, revistave, katalogëve, etj., duke i palosur, prerë dhe zbukuruar, montuar, qepur, qepur me penj, lidhur me ngjitës; prerjen dhe vënien e mbulesës, ngjitjen, krahasimin, basting, stampimin e artë; lidhjen spirale dhe lidhjen me tela të plastikës;
- lidhjen dhe përfundimin e letrës së shtypur ose të kartonit të shtypur, me anë të palosjes stampimit, shpimit, goditjes, formësimit, shkruarjen reliefore, ngjitjen, lëmimin;
- shërbimet përfundimtare për CD-ROM,
- shërbimet përfundimtare të postës, siç janë: gjërat e zakonshme, përgatitja e zarfave, etj.;
- veprimtaritë e tjera përfundimtare, siç janë: stampimi, vendosja në kallupe dhe kopjimi Braille

## 18.2 Riprodhimi i Mediave të Incizuara

### 18.20 Riprodhimi i mediave të incizuara

Kjo klasë përfshin:

- riprodhimin nga kopjet zotëruese të pllakave të gramafonit, kompakt disqeve dhe kasetave me muzikë ose incizime të tjera të zërit;
- riprodhimin nga kopjet zotëruese të pllakave të gramafonit, kompakt disqeve dhe kasetave me filma dhe me video incizime të tjera;
- riprodhimin nga kopjet zotëruese të softverëve dhe të të dhënave në disqe dhe kaseta.

Kjo klasë përjashton:

- riprodhimin e lëndëve të shtypura, shih 18.11, 18.12;
- publikimin e softverëve, shih 58.2;
- prodhimin dhe distribuimin e filmave, video kasetave dhe filmave në DVD, ose media të ngjashme, shih 59.11, 59.12, 59.13;
- riprodhimin e filmave për distrubuim teatror, shih 59.12;
- prodhimin e kopjeve zotëruese për pllaka ose materiale audio, shih 59.20.

# 19 Prodhimi i Koksit dhe Produkteve të Rafinuara të Naftës

Kjo ndarje përfshin transformimin e naftës dhe të thëngjillit të papërpunuar në produkte të përdorshme. Procesi dominues është rafinimi i naftës, i cili përfshin ndarjen e naftës së papërpunuar në produkte të komponentëve nëpër teknika të tilla, siç janë: plasja dhe distilimi.

Kjo ndarje përfshin përdorimin e gazrave, siç janë: etani, propani dhe butani, si produkte të rafinerive të naftës.

Kjo ndarje, gjithashtu përfshin prodhimin për llogari vetanake të produkteve karakteristike (p.sh. koksit, butanit, propanit, benzinës, kerozinës, karburanteve të naftës etj.), si dhe shërbimet e procesimit (p.sh. rafinimi i zakonshëm).

Këtu nuk është futur prodhimi gazrave të tillë në njësitë e tjera (20.14), prodhimi i gazrave industriale (20.11), nxjerrjen e gazit natyror (metani, etani, ose propani, 06.20), prodhimi i gazit të karburantit ndryshe nga gazrat e naftës (p.sh. gazi i thëngjillit, gazi i ujit, gazi i prodhuesit, gazi i gazpunuesve, 35.21). Prodhimin e petrokimikaleve nga nafta e rafinuar klasifikikohet në ndarjen 20.

## 19.1 Prodhimi i Produkteve të Furrës së Koksit

### 19.10 Prodhimi i produkteve të furrës së koksit

Kjo klasë përfshin:

- veprimtaritë e furrave të koksit;
- prodhimin e koksit dhe të prodhimeve të gjysmëkoksit;
- prodhimin e katranit dhe koksit të katranit;
- prodhimin e gazit të koksit për furra;
- prodhimin e thëngjillit të papërpunuar dhe katranëve të linjitit;
- prodhimin e aglomeracionit të koksit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e briketave të djegies së thëngjillit, shih 19.20.

## 19.2 Prodhimi i Produkteve të Rafinuara të Naftës

### 19.20 Prodhimi i produkteve të rafinuara të naftës

Kjo klasë përfshin prodhimin e karburanteve të lëngta, ose të gazit a të produkteve të tjera nga nafta e papërpunuar, mineralit bituminoz ose të produkteve të tyre të fraksionura. Rafinimi i naftës përfshin një ose më shumë veprimtari vijuese; fraksionimin; distilimin e drejtpërdrejtë të naftës së papërpunuar dhe ndezjen -krakingun.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e karburanteve të automjeteve: benzina, kerozina etj.;
- prodhimin e karburantit: të vajit të nivelit të lehtë, të mesëm dhe të rëndë, gazrat e rafinuara, siç janë: etani, propani, butani etj.;
- prodhimin e vajit, bazuar në vajrat ose yndyrnat lubrifikuese, përfshirë nga vaji i mbeturinave;
- prodhimin e produkteve për industrinë petrokimike dhe për prodhimin e mbulesave të rrugëve;
- prodhimin e produkteve të ndryshme: spiritiku i bardh, vaselina, parafina, xhelatina e naftës etj.;
- prodhimin e briketave të naftës;
- përzierjen e biokarbornateve, d.m.th. përzierjen e alkoolëve me naftë (p.sh. gasohol).

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e briketave të qymyrit;
- prodhimin e briketave djegëse nga thëngjilli i fortë dhe linjiti.

# 20 Prodhimi i Produkteve Kimike

Kjo ndarje përfshin transformimin e lëndëve të para organike dhe inorganike me anë të proceseve kimike dhe të formimit të produkteve. Kjo klasë bën dallimin e prodhimit të kemikaleve themelore, që përbëjnë grupin e parë të industrisë, nga prodhimi i produkteve të ndërmjetme dhe përfundimtare të prodhuara me procesimin e mëtutjeshëm të kemikaleve themelore, që e përbëjnë klasat e mbetura të industrisë.

## 20.1 Prodhimin i Produkteve Kimike Bazë, Plehrave Kimike dhe Komponimeve të Azotit, Plastikës dhe Gomës Sintetike në Formë Primare

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve bazike kimike, fertilizuesve dhe përcjellësit e nitrogjenit, si dhe plastikës dhe gomës sintetike në format primare.

### 20.11 Prodhimi i gazrave industriale

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gazrave të lëngëzuara ose të kompresuara inorganike dhe industriale ose mjekësore:
  - gazrat elementarë,
  - ajrin likuid a të kompresuar,
  - gazrat freskues,
  - gazrat e përzier industrialë,
  - gazrat inerte, siç është dyoksidi i karbonit,
  - gazrat izoluese.

Kjo klasë përjashton:

- nxjerrjen e metanit, etanit, butanit ose propanit, shih 06.20;
- prodhimin e gazrave djegëse, siç janë: etani, butani ose propani në rafineri të naftës, shih 19.20;
- prodhimin e lëndëve të gazta nga thëngjilli dhe mbeturinat, etj., shih 35.21.

### 20.12 Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ngjyrave dhe pigmenteve nga cilido burim, në formën bazë ose koncentrat.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e produkteve të llojit të përdorur si agjendë e ndriçimit floreshent ose si ndriçues.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e ngjyrave dhe pigmenteve të përgatitur, shih 20.30.

### 20.13 Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- pasurimin e xeheve të uranimuit dhe toriumit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e gazrave industrialë, shih 20.11;

- prodhim e fertilizuesve nitrogjenikë dhe pëzierjeve të nitrogjenit, shih 20.15;
- prodhimin e amoniakut, shih 20.15;
- prodhimin e klorit të amoniakut, shih 20.15;
- prodhimin e nitrateve dhe nitrateve të kaliumit, shih 20.15;
- prodhimin e karbonateve të amoniakut, shih 20.15;
- prodhimin e ujit aromatik të distiluar, shih 20.53;
- prodhimin e metaleve bazë, shih ndarjen 24.

### 20.14 Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike

Kjo klasë përfshin prodhimin e kemikaleve, duke përdorur proceset bazë, siç janë krekimi termal dhe distilimi. Rezultati i këtyre proceseve zakonisht janë elemente kemikale të ndara ose lëndë të përbëra, të ndara, kimikisht të definuara.
Kjo klasë përfshin:

- hydrokarbonet aciklike, të njomura dhe të panjomura:
  - hydrokarbonet ciklike të njomura dhe të panjomura,
  - alkoolet aciklike dhe ciklike,
  - acidet mono dhe polikarboksilike, përfshirë acidin acetik,
  - përzierjet e tjera të funksionit të oksigjenit, përfshirë aldehidet, ketonet,
  - kuinonet dhe përzierjet e oksigjenit me funksion të dyfishë ose të shumëfishtë,
  - glicerolin sintetik, përzierjet e nitrogjenit me funksion organik,
  - përfshirë aminet, fermentimin e kallamit të sheqerit, grurit, ose të ngjashëm, për të prodhuar alkool dhe estere,
  - përzierjet e tjera organike, përfshirë produktet nga distilimi i drurit (p.sh. qymyr druri) etj.
- prodhimin e kemikaleve bazë organike, prodhimin e produkteve aromatike sintetike;
- distilimin i katranit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e plastikës në trajta primare, shih 20.16;
- prodhimin e gomës sisntetike në trajtë primare, shih 20.17;
- prodhimin e glicerolit të papërpunuar, shih 20.41;
- prodhimin e vajrave natyrore esenciale, shih 20.53;
- prodhimin e acideve salicilike dhe O-acetilsalicilike, shih 21.10.

### 20.15 Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fertilizuesve:
  - fertilizues- plehnues të rregullt ose kompleks azotik, të fosfatit ose të kaliumit,
  - urenë, kripërat e papërpunuara fosfatike natyrore dhe kripërat e papërpunuara natyrore nga kaliumi.
- prodhimin e produkteve përcjellëse të azotit:
  - acidet nitrike dhe sulfonitrike, amoniake, të klor amoniakut, të karbon amoniakut, nitritatin dhe nitratet e potasiumit.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e dheut të poçerisë me torfë, si përbërës kryesor;
- prodhimin e përzierjeve të dheut të poçerisë nga dheu natyror, rëra, argjila dhe mineralet.

Kjo klasë përjashton:

- nxjerrjen e plehut të zogjve, shih 08.91;
- prodhimin e produkteve agrokimike, si pesticidet, shih 20.20.

### 20.16 Prodhimi i plastikës në formë primare

Kjo klasë përfshin prodhimin e rrëshirave, materialeve plastike, elastomerët jo-vulkanozues termoplastikë, përzierjen e rrëshirave, në bazë të rëndomtë, si dhe prodhimin e rrëshirave jo të rëndomta sistetike.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e plastikës në trajta primare:
  - polimerët, përfshirë ato të etilenit, propilenit, stirenit, klorit vinilit, acetatin e vinilit dhe akrilikut,
  - poliamidet,
  - rrëshirat fenolike dhe epoksidike dhe poliuretinitin,
  - rrëshirat e alkidit dhe të poliesterit,
  - silikonet, jonkëmbyesit, zëvendësuesit bazuar në polimeri.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e celulozës dhe derivateve të saj kimike.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e fijeve artificiale dhe sintetike, fijëzat dhe penjtë, shih 20.60;
- grisjen e produkteve plastike, shih 38.32.

### 20.17 Prodhimi i gomës sintetike në formë primare

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gomës sintetike, trajta primare:
  - gomën sintetike.
  - faktisa
- prodhimin e përzierjeve të gomës sintetike dhe asaj natyrore ose të gomës, si llastiku, (p.sh. balata).

## 20.2 Prodhimi i Pesticideve dhe Produkteve të tjera Agrokimike

### 20.20 Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e insekticideve, rodenticideve, fungicideve, herbicideve, acaricideve, molluskideve, biocideve;
- prodhimin e produkteve kundërmbirjes, rregullatorëve të rritjes së bimës;
- prodhimin e dezinfektuesve (për përdorim bujqësoe dhe përdorime të tjera);
- prodhimin e produkteve të tjera agrokimike p.k.t/

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e plehruesve dhe përzierjet azotike, shih 20.15.

# 20.3 Prodhimi i Ngjyrave, Llaqeve dhe Shtresave të Ngjashme, Ngjyrave të Printimit dhe Mastikës

## 20.30 Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ngjyrave dhe vernikëve, smaltet ose llaqet;
- prodhimin e pigmenteve dhe ngjyrave të përgatitura dhe preparateve opake
- prodhimin e smalteve qelqëzuese dhe glazuese, si dhe lustrues dhe preparate të ngjashme
- prodhimin e mastikës;
- prodhimin e pëzierjeve mbyllëse dhe mbushjeve të mbushjes së ngjashme jo reflektuese dhe preparateve sipërfaqësore;
- prodhimin e tretësve të holluesve me përbërje organike;
- prodhimin e ngjyrës së përgatitur ose larguesit e vernikut;
- prodhimin e ngjyrës së shtypit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e lëndës së ngjyrave dhe pigmentet, shih 20.12;
- prodhimin e ngjyrës së shkrimit dhe të vizatimit, shih 20.59.

# 20.4 Prodhimi i Sapunit dhe Detergjentëve, Preparatave të Pastrimit dhe Lustrimit, Parfumeve dhe Prepareteve të Tualetit

## 20.41 Prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e agjentëve aktivë organikë sipërfaqësor
- prodhimin e letrës, vatave, shajakut etj. e veshur ose e mbuluar me sapun ose detergjent;
- prodhimin e glicerolit;
- prodhimin e sapunit, përveç sapunit kozmetik;
- prodhimin e preparateve aktive për sipërfaqe:
  - pudrat dhe detergjentët larës, në formë të ngurtë ose të lëngët,
  - preparatet e larjes së enëve,
  - zbtutësit e tekstilit.
- prodhimin e produkteve të pastrimit dhe lustrimit:
  - preparatet për parfumosje ose deoderantimi i dhomave,
  - dyllët artificialë dhe të përgatitur,
  - lustruesit dhe kremat për lëkurë,
  - lustruesit dhe kremat për drunj,
  - lustrusit për punimet e mobiljerisë, qelqit dhe metalit,
  - pastat dhe pudrat pastruese, përfshirë letrën, vatat etj., të veshura ose të mbuluara me to.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pëzierjeve të ndara, kimikisht të definuara, shih 20.13, 20.14;
- prodhimin e glicerolit, të produkteve nga nafta e sintentizuar, shih 20.14;
- prodhimin e sapunit kozmetik, shih 20.42.

### 20.42 Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e parfumeve të toaleteve:
    - parfumet dhe ujrat e toaletit, preparatet e bukurisë (shminkë),
    - preparatet mbrojtëse nga djegia e diellit dhe të nxirjes,
    - preparatetet e manikyrit dhe pedikerit,
    - shamponët, llaqet e flokëve, preparatet për valëzimin dhe drejtimin e flokëve,
    - pastat për dhëmbë dhe preparatet për higjienën e gojës, përfshirë preparatet e protezave,
    - preparatet e rrojes, përfshirë preparatetet para rrojes dhe pas rrojes,
    - deodorantet dhe kripërat e larjes,
    - depilatorët.
- prodhimin e sapunit kozmetik.

Kjo klasë përjashton:

- nxjerrjen dhe rafinimin e vajrave esenciale natyrore, shih 20.53.

## 20.5 Prodhimi i Produkteve të Tjera Kimike

Ky grup përfshin prodhimin e eksplozivëve dhe produkteve piroteknike, ngjitësve, vajrat esenciale dhe produktet e p.k.t. p.sh. materialin kimik fotografik (përfshirë filmin dhe letrën e  ndjeshme ne ndriçim), preparatet e e përzierjes diagnostike etj.

### 20.51 Prodhimi i eksplozivëve

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e pudrave shtytëse;
- prodhimin e eksplozivëve dhe produkteve piroteknike, përfshirë kapsullat e perkusionit, detonatorët, raketave sinjalizuese etj.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e shkrepësave.

### 20.52 Prodhimi i ngjitësve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tutkallëve dhe ngjitësve të përgatitur, përfshirë tutkallët dhe ngjitësit e bazuar në gomë.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e xhelatinës dhe derivateve të saj, shih 20.59.
-

### 20.53 Prodhimi i vajrave esenciale

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ekstraktëve të produkteve aromatike natyrore;
- prodhimin e rezonidëve;
- prodhimin e përzierjeve të produkteve aromatizuese për prodhimin e parfumeve ose të ushqimit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e produkteve aromatike sintetike, shih 20.14;
- prodhimin e parfumeve dhe preparateve të toaletit, shih 20.42.

### 20.59 Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pllakave fotografike, filmave, letrës së ndjeshme dhe materialeve të tjera të ndjeshme të paekspozuara;
- prodhimin e preparateve kimike për përdorime fotografike;
- prodhimin e xhelatinës dhe derivateve të saj;
- prodhimin e produkteve të ndryshme kimike:
  - peptonet, derivatet e peptonit, substancat e tjera të proteinit dhe derivatet e tyre,
  - vajrat dhe yndyrnat e modifikuara kimikisht,
  - materialet e përdorura në përfundimin e tekstileve dhe lëkurës,
  - pudrat dhe pastat e përdorura në ngjitje, kallitje ose saldim,
  - substancat e përdorura në metalin e shëllirës,
  - veprimtaritë e përgatitura për çimentot, karbonin e aktivizuar, aditivët vajor lubrifikues,
  - akseleratorët e përgatitur të gomës,
  - katalista dhe produktet e tjera kimike për përdorim industrial,
  - preparatet kundër zhurmës së motorit,
  - preparatet kundër ngrirjes,
  - likuidët për transmisionin hidroalik, përzierja diagnostike ose reagjentëve laboratorikë.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e ngjyrës së shkrimiti dhe të vizatimit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimet e produkteve të definuara kimikisht në sasira, shih 20.13, 20.14;
- prodhimin e ujit të distiluar, 20.13;
- prodhimin e kimikaleve të tjera organike bazë, shih 20.14;
- prodhimin e ngjyrës së shtypit, shih 20.30;
- prodhimin e asfaltit bazuar në ngjitësa, shih 23.99.

## 20.6 Prodhimi i Fibrave Sintetikë dhe Artificialë

### 20.60 Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fijeve sitentike ose artificiale të rimorkimit;
- prodhimin e fijeve kapëse sintentike ose artificiale, jo të pastruara, të krehuara ose ndryshe të procesuara për tjerrje;
- prodhimin e penjve sintetikë ose artificialë, përfshirë penjtë e cilësisë së lartë ngjitëse;
- prodhimin e monofilamentit ose rripit sintentik ose artificial.

Kjo klasë përjashton:

- tjerrjen e fijeve sintetike ose artificiale, shih 13.10;
- prodhimin i penjve të prodhuar nga lënda e parë, e prodhuar nga njeriu, shih 13.10.

# 21 Prodhimi i Produkteve Bazë Farmaceutike dhe Preparateve Farmaceutike

Kjo ndarje përfshin prodhimin e produkteve dhe preparateve bazë farmaceutike. Kjo, gjithashtu përfshin prodhimin e produkteve mediko-kimikale dhe botanike.

## 21.1 Prodhimi i Produkteve Bazë Farmaceutike

### 21.10 Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e substancave aktive medecinale që duhet përdorur në angazhimet e tyre farmakologjike në prodhimin e medikamenteve: antibiotikëve, vitaminave themelore, acidet saliciklike dhe O- acidet acetilsalicilik etj.
- procesimin e gjakut

Kjo klasë gjithashtu përfshinë:

- prodhimin e sheqeve të pastër kimikisht
- procesimin e gjendrave dhe prodhimin e ekstrakteve nga gjendra etj.

## 21.2 Prodhimi i Preparatave Farmaceutike

### 21.20 Prodhimi i preparatave farmaceutike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e medikamenteve:
  - antiserën dhe fraksionet e tjera të gjakut,
  - vaksinat,
  - medikamentët e ndryshëm, përfshirë preparatet homeopatike,
- prodhimin e produkteve kimike kontraceptive për përdorim të jashtëm dhe medikamentet kontraceptive;
- prodhimin e preparateve mjekësore diagnostike, përfshirë testet e shtatëzanisë;
- prodhimin e substancave radioaktive në diagonstifikim në-vivo;
- prodhimin e farmaceutikëve bioteknikë.

Kjo klasë, gjithashtu, përfshin:

- prodhimin e vatave mjekësore të impregnuara: gazave, fashave, veshjeve etj.;
- përgatitjen e produkteve botanike (bluarjen, klasifikimin, prodhimin e miellit) për përdorim farmaceutik.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e infuzioneve herbale (mentë, vervain, kamomilë etj.), shih 10.83;
- prodhimin e mbushjeve dentale dhe të cimentit për dhëmbë, shih 32.50;
- prodhimin e cimentëve të rindërtimin bono, shih 32.50;
- prodhimin e perdeve kirurgjike, shih 32.50;
- shitjen me shumicë të farmaceutikëve, shih 46.46;
- shitjen me pakicë të farmaceutikëve, shih 47.73;
- hulumtimin dhe zhvillimin për farmaceutikët biotenikë , shih 72.1;
- paketimin e farmaceutikëve, shih 82.92.

# 22 Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës

Kjo ndarje përfshin prodhimin e gomës dhe produkteve të plastikës.

Kjo ndarje karakterizohet sipas lëndëve të para, të përdorura në procesin e prodhimit. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se prodhimi i të gjitha produkteve të bëra nga këto materiale është klasifikuar këtu.

## 22.1 Prodhimi i Produkteve të Gomës

Kjo grup përfshin prodhimin e produktit të gomës.

### 22.11 Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; mveshja dhe riparimi i gomave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gomave te jashtme për automjetet, pajisjet, makineritë mobile, aeroplanët, lodrat, mobilet dhe përdorimet e tjera:
    - rrotat pneumatike,
    - gomat solide ose me jastëk,
- prodhimi i gomave të brendshme per automjete;
- prodhimin e pjesëve per riparimin e gomave te jashtme, rikuperimi i gomave, rripat “camelback” për rimbushjen e gomave etj.;
- ripërpunimin dhe rimbushjen e gomave.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e materialeve riparuese për gomat e brendshme, shih 22.19;
- riparimin e gomave dhe gomave të brendshme, montimin ose zëvendësimin e tyre, shih 45.20.

### 22.19 Prodhimi i produkteve të tjera të gomës

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e produkteve të tjera natyrore ose sintentike të gomës, të pavullkanizuar, të vullkanizuar ose të forcuar:
    - pllakat e gomës, fletat, rripat, shkopinjtë, format e profilit,
    - tubacionet, gypat dhe tubat e gomës,
    - bartësit e gomës ose rripat e transmisionit ose lidhjen me rrip,
    - artikujt higjienikë të gomës: këllëfët e kontraceptivëve, thithësit, shishet e ujit të nxehtë etj.,
    - artikujt e gomës së rrobave (nëse është e ngjitur bashkë me të, jo e qepur),
    - shaullët plastikë dhe pjesët e tjera nga goma të veshmbathjeve,
    - penjtë dhe litarët nga goma,
    - fijet dhe pëlhura të gomëzuara,
    - unazat e gomës, pajisjet dhe dyllët,
    - mbulesat e gomës për cilindra,
    - dyshekët e fryeshëm të gomës,
    - ballonët e fryeshëm.
- prodhimin e brushave të gomës;

- prodhimin e kapakëve te gypave te ujit nga goma e fortë;
- prodhimin e krehërve të fortë, të karficave, të brushave dhe të ngjashme.

Kjo klasë, po ashtu, përfshinë:

- prodhimin e materialit riparues të gomës;
- prodhimin e fijeve të tekstilit të impregnuar, veshur, mbuluar ose si përbërës;
- prodhimin e dyshekëve të ujit nga goma;
- prodhimin e kabinave dhe të platformave të larjes;
- prodhimin e kompleteve të gomës për lagështi dhe të zhytjes
- prodhimin e artikujve të seksit nga goma.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pëlhurës së kordonit të gomës së automjetit, shih 13.96;
- prodhimin e rrobave nga pëlhurat elastike, shih 14.14, 14.19;
- prodhimin e veshmbathjeve nga goma, shih 15.20;
- prodhimin e tutkallëve dhe ngjitësve nga goma, shih 20.52;
- prodhimin e rripave "camelback", shih 22.11;
- prodhimin e tragetëve dhe barkave të fryeshme, shih 30.11, 30.12;
- prodhimin e dyshekëve nga goma e pambuluar qelizore, shih 31.03;
- prodhimin e rekuizitave sportive nga goma, përveç rrobave, shih 32.30;
- prodhimin e lodrave dhe kukullave nga goma (përfshirë pishinat e fëmijëve, barkat e fryeshme prej baloni, lodra me figura kafshësh te fryeshme, topat dhe të ngjashëm ), shih 32.40;
- ndreqjen e gomës, shih 38.32.

## 22.2 Prodhimi i Produkteve të Plastikës

Ky grup përbën procesimin e rrëshirave të reja ose të harxhuara (d.m.th. të ricikluara) të plastikës në produkte të ndërmjetme ose finale, duke përdorur procese të tilla, si: modelimin e kompresimit, modelimin e shtrydhjes, të injektimit, të fryerjes dhe të derdhjes. Për shumicën e këtyre proceseve, procesi i prodhimit është i tillë, që një llojllojshmëri e gjerë, e produkteve mund të prodhohen.

### 22.21 Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e semiprodhimeve të produkteve të plastikës:
  - pllakëzat e plastikës, blloqet, filmin, foliet, rripat etj. (qoftë prodhim vetëngjitës ose jo).
- prodhimin e produkteve të mbaruara të plastikës:
  - tubat e plastikës, gypat dhe tubat e gomës, pajisjet e tubave të gomës dhe gypat, filmat e celofanit ose fletëzat.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e plastikës në trajtë primare, shih 20.16;
- prodhimin e artikujve nga goma sintetike ose natyrore, shih 22.1.

### 22.22 Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve të plastikës për paketimin e mallrave:
  - çantat e plastikës, thasët, kontejnerët, kutitë, arkat kashtore, shishet etj.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e valixheve dhe çantave nga plastika, shih 15.12.

### 22.23 Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari
Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e artikujve për ndërtuesit nga plastika:
  - dyert e plastikës, dritaret, skeletet, kanatat, grilat e dritareve,
  - dërrasat e hekurosjes, cisternat, rezervoaret, dyshemet e plastikës,
  - mbulesat e murit ose tavanit në rulone ose në formë të pllakave etj.,
  - artikujt sanitarë nga plastika, si: vaska, dush-kabinat, lavamanët, enëlarëset, cisternat e rrafshta etj.
- prodhimin e mbulesave elastike të dyshemesë, si: vinili, linoleumi etj.;
- prodhimin e gurëve artificialë (p.sh. mermer i kultivuar).

### 22.29 Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës
Kjo klasë përfshin:
- prodhimin e takëmeve të plastikës, të kuzhinës dhe artikujve të tualetit;
- prodhimin e produkteve të ndryshme nga plastika:
  - kapelat e plastikës, pajisjet izoluese, pjesët e pajisjeve të ndriçimit, furnizime për zyra ose shkolla, artikujt e rrobave (nëse janë të ngjitura bashkë, jo të qepura), pajisje për mobilje, statujza, shirita të transportit dhe transmisionit, traka vetëngjitëse nga plastika, kallëpë këpucësh nga plastika, mbajtës të cigareve dhe cigaretava nga plastika, krehër, kaçurela flokësh nga plastika, artikuj, etj.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e valixheve të plastikës, shih 15.12;
- prodhimin e veshmbathjeve nga plastika, shih 15.20;
- prodhimin e mobiljeve të plastikës, shih 31.01, 31.02, 31.09;
- prodhimin e dyshekëve nga plastika e pambuluar qelizore, shih 31.03;
- prodhimin e rekuizitave sportive, shih 32.30;
- prodhimin e lojrave dhe lodrave, shih 32.40;
- prodhimin e protezave mjekësore dhe dentale nga plastika, shih 32.50;
- prodhimin e artikujve të oftamologjisë - syrit , shih 32.50;
- prodhimin e kapelave të forta dhe pajisjeve të tjera të sigurisë personale nga plastika, shih 32.99.

# 23 Prodhimi i Produkteve Minerale Jometalike

Kjo ndarje përfshin veprimtaritë prodhuese lidhur me një substancë të vetme të origjinës së mineralit. Kjo ndarje përfshin prodhimin e qelqit dhe të produkteve të tij (p.sh. qelqi i rrafshtë, qelqit bosh, fijeve të qelqit, artikujve teknikë të qelqit etj.), produkteve të qeramikës, tullave dhe produkteve të pjekura të argjilës, të çimentos dhe të llaçit, nga lëndët e para, në artikuj të përfunduar.

Prodhimi i gurit të formësuar dhe të përfunduar, si dhe të produkteve të tjera minerale janë po ashtu të përfshira në këtë ndarje.

## 23.1 Prodhimi i Qelqit dhe Produkteve prej Qelqit

Kjo grup përfshin qelqin në të gjitha format e tij, i bërë nga çdo proces, dhe aritkujve të qelqit.

### 23.11 Prodhimi i qelqit të rrafshët

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e qelqit të rrafshët, përfshirë qelqin e rrafshët me tela, me ngjyrë ose të lyer.

### 23.12 Formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e qelqit të rrafshët të vrazhdësuar ose të petëzuar;
- prodhimin e pasqyrave të qelqit;
- prodhimin e njësive të shumëfishta të qelqit, ngjitëse në mur.

### 23.13 Prodhimi i qelqit bosh (i zbrazët)

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e shisheve dhe kontejnerëve të tjerë nga qelqi a kristali;
- prodhimin e gotave të pijes dhe të qelqit tjetër shtëpiakë ose artikujve të kristalit.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e lodrave të qelqit, shih 32.40.

### 23.14 Prodhimi i fibrave të qelqit

Kjo klasë përfshinë:

- prodhimin e fijeve të qelqit, përfshirë leshin e qelqit, dhe nga kjo, produktet jo të thurura nga qelqi.

Kjo klasë përjashton :

- prodhimin e pëlhurave të thurura nga penjtë e qelqit, shih 13.20;
- prodhimin e kablos me fije optike për transmisionin e të dhënave ose transmisionin e figurave shih 7.31.

### 23.19 Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi, duke përfshirë edhe mallrat teknike prej qelqi

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve të qelqit për laborator, higjienikë ose farmaceutikë;
- prodhimin e orëve të murit ose qelqeve të orëve, qelqit optik dhe elementeve optike, që nuk janë të punuar në mënyrë optike;
- prodhimin e artikujve të qelqit të përdorur në imitimin e argjendarisë;
- prodhimin e izoluesve të qelqit dhe pajisjet izoluese të qelqit;
- prodhimin e mbështjellësve të qelqit për llampa;
- prodhimin e figurave të qelqit;
- prodhimin e blloqeve të qelqit për shtrim trotuaresh;
- prodhimin e qelqit në shufra dhe gypa.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e elementeve optike, të punuar në mënyrë optike, shih 26.70;
- prodhimin e shiringave dhe pajisjeve të tjera mjekësore laboratorike, shih 32.50.

# 23.2 Prodhimi i Produkteve Rezistuese ndaj Zjarrit

Ky grup përfshin grumbullimin e mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake dhe bizneset, me anë të shportave të mbeturinave, shportave me rrota, kontejnerëve etj. Grupi përfshin grumbullimin e mbeturinave jo të rrezikshme dhe të rrezikshme, p.sh. mbeturinat nga ekonomitë shtëpiake, bateritë e përdorura, vajrat dhe yndyrat e përdorura për zierje, mbeturinat e naftës nga anijet dhe të vajit të përdorur nga garazhet si dhe mbeturinat e ndërtimtarisë dhe prishjes së ndërtesave.

### 38.11 Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme

Kjo klasë përfshin:

- grumbullim e mbeturinave të ngurta jo të rrezikshme (të bërllokut) në kuadër të zonës lokale, siç është grumbullimi i mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake dhe bizneset me anë të shportave të mbeturinave, shportave me rrota, kontejnerëve etj., mund të përfshinë edhe materialet e përziera të restaurueshme,
- grumbullimin e materialeve të riciklueshme,

- grumbullimin e mbeturinave nëpër shporta të bërllokut në vende publike.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- grumbullimin e mbeturinave dhe të prishjeve të ndërtesave,
- grumbullimin dhe largimin e copërave, siç janë shkurret dhe rrënojat,
- grumbullimin e mbetjeve të mbeturinave nga fabrikat e tekstilit,
- operacioni i objekteve të transferit të mbeturinave, për mbeturinat jo të rrezikshme.

Kjo klasë përjashton:

- grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme, shih 38.12,
- operacioni rreth groposjeve për asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme, shih 38.21,
- operacioni rreth objekteve ku materialet e restaurueshme të përziera, siç është letra, plastika, etj., klasifikohen në kategori të dallueshme, shih 38.32.

### 38.12 Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme

Kjo klasë përfshin grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme të ngurta dhe jo të ngurta, d.m.th. të substancave shpërthyese, oksiduese të ndezshme, toksike, ngacmuese, kancerogjene, korrozive, infektuese dhe të tjera, si dhe preparateve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin e njeriut. Ai gjithashtu mund të përfshijë identifikimin, trajtimin, paketimin dhe etiketimin e mbetjeve për qëllime të transportit.

Kjo klasë përfshin:

- grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme siç janë vaji i përdorur:
  - vaji i përdorur nga dërgesat ose garazhet,
  - mbeturinat bio të rrezikshme,
  - mbeturinat nukleare,
  - bateritë e përdorura etj.;
- operacioni i mbeturinave të rrezikshme për transferimin e stacioneve të mbeturinave.

Kjo klasë përjashton:

- restaurimi dhe pastrimi i ndërtesave të kontaminuara, lokacioneve të xeheroreve, të dheut, ujit tokësor, d.m.th. largimin e azbestit, shih 39.00.

## 38.2 Trajtimi i Mbeturinave dhe Asgjësimi i Tyre

Ky grup përfshin asgjësimin dhe trajtimin para asgjësimit të formave të ndryshme të mbeturinave, me anë të mjeteve të ndryshme, siç është trajtimi i mbeturinave organike me qëllim të asgjësimit. Trajtimin dhe asgjësimin e gjallesave toksike, apo kafshëve të ngordhura dhe të mbeturinave tjera të kontaminuara. Trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave radioaktive tranzistore nga spitalet, etj. Grumbullimin e hedhurinave në tok apo në ujë. Varrosjen apo lëvrimin nën mbeturina. Asgjësimin e mallrave të përdorura, siç janë frigoriferët për të eliminuar mbeturinat e dëmshme. Largimin e mbeturinave me anë të shkrumbimit, apo ndezjes. Këtu përfshihet gjithashtu rezultatet e restaurimit të energjisë nga proceset e djegies së mbeturinave.

Ky grup përjashton:

- trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të ujit, shih 37.00,
- restaurimin e materialeve, shih 38.3.

### 38.21 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme

Kjo klasë përfshin asgjësimin dhe trajtimin para asgjësimit të mbeturinave jo të rrezikshme të ngurta dhe jo të ngurta:

- operacionin e gropave të mbeturinave për asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme,
- asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme me anë të ndezjes, shkrumbimit apo metodave tjera me apo parezultim të prodhimit të rrymës apo avullit, djegies, zëvendësimit të karburanteve, biogazit, pluhurit apo nënprodukteve tjera për përdorim të mëtutjeshëm etj.,
- trajtimin e mbeturinave organike për asgjësim.

Kjo klasë përjashton:

- shkëmbimin dhe ndezjen e mbeturinave të rrezikshme, shih 38.22,
- operacioni rreth objekteve ku grumbullohen materialet e përziera të restaurueshme, siç është letra, plastika, kanaçet e përdorura të pijeve dhe metalet, klasifikohen në kategori të dallueshme, shih 38.32,
- dekontaminimin, pastrimin e tokës, ujit, zvogëlimin e materialeve toksike, shih 39.00.

### 38.22 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme

Kjo klasë përfshin grumbullimin e mbeturinave të rrezikshme të ngurta dhe jo të ngurta, d.m.th. të substancave shpërthyese, oksiduese të ndezshme, toksike, ngacmuese, kancerogjene, korrozive, infektuese dhe të tjera, si dhe preparateve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin e njeriut.

Kjo klasë përfshin:

- operacionet e objekteve për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme,
- trajtimin dhe asgjësimin e gjallesave toksike dhe kafshëve të ngordhura edhe mbeturinave tjera të kontaminuara,
- djegien e mbeturinave të rrezikshme,
- asgjësimin e mallrave, siç janë frigoriferët për të eliminuara mbeturinat e dëmshme,
- trajtimin, asgjësimin dhe depozitimin e mbeturinave bërthamore duke përfshirë:
  - trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave radioaktive në tranzicion, d.m.th. të kalbura brenda periodës së transportit nga spitali,
  - mbyllja, përgatitja dhe trajtimi tjetër i mbeturinave tjera nukleare për depozitim.

Kjo klasë përjashton:

- riprocesimin e karburanteve nukleare, shih20.13,
- djegien e mbeturinave jo të rrezikshme, shih 38.21,
- dekontaminimin e tokës, pastrimin e tokës, ujit, zvogëlimin e materialeve toksike, shih 39.00.

## 38.3 Rikuperimi i Materialeve

### 38.31 Çmontimi i mbeturinave metalike

Kjo klasë përfshin çmontimin e makinave të çfarëdo lloji (automobila, anije, kompjuterë, televizorë dhe pajisje të tjera) për riaftësim në materiale të përdorshme.

Kjo klasë përjashton:

- asgjësimin e mallrave të përdorura, siç janë frigoriferët për të eliminuar mbeturinat e dëmshme, shih 38.22,
- çmontimin e automobilave, anijeve, kompjuterëve, televizorëve dhe pajisjeve të tjera për të marrë/rishitur pjesët e përdorshëm, shih sektorin G.

### 38.32 Rikuperimi i materialeve të klasifikuara

Kjo klasë përfshin procesimin e mbeturinave të metalit dhe jo të metalta, artikujve tjerë në materiale të lëndës së dytë, zakonisht duke përfshirë procesin mekanik apo transformimin kimik.

Gjithashtu është përfshirë restaurimin e materialeve nga grumbujt e mbeturinave në formën 1, duke ndarë dhe klasifikuar materialet e rikthyeshme nga grumbujt e mbeturinave jo të rrezikshme (p.sh. plehrat) ose 2, ndarjen dhe klasifikimin e materialeve të përziera të riktheyshme, siç është letra, plastika, kanaçet e pijeve të përdorura dhe metalet, në kategori të dallueshme.
Shembujt të proceseve mekanike apo transformime kimike, që janë ndërmarrë, janë:

- dërrmim mekanik të mbeturinave nga veturat e përdorura, makinat larëse, biçikletat etj.,
- prerjen e mbeturinave të metalta, automjeteve që i ka mbarua jetë-zgjatja etj.,
- metodat e tjera të trajtimit mekanike, siç është prerja, presimi për të zvogëluar vëllimin,
- rikthimi i metaleve nga mbeturinat fotografike, p.sh. solucionin fiksues të filmave dhe letrave fotografike,
- rikthimin e gomës, siç janë gomat e përdorura për të prodhuar lëndën e parë sekondare,
- klasifikim dhe topthimi i plastikës, për të prodhuar lëndën e parë sekondare për tubacione, saksi të luleve, paleta dhe të ngjashëm,
- procesimi (pastrimi, shkrirja, bluarja) e mbeturinave të plastikës, apo gomës në granule,
- dromca, pastrimi dhe klasifikimi i qelqit - dërrmimin, pastrimin dhe klasifikimin e mbeturinave tjera, siç janë mbeturinat e demulimit për të fituar lëndën e parë sekondare,
- procesimin e vajrave dhe yndyrave të përdorura të zierjes në lëndë të para sekondare,
- procesimin e mbeturinave të tjera të ushqimit, pijeve dhe duhanit, si dhe substancave të banimit në material të parë sekondar.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e produkteve të reja finale nga (të vetë-prodhuara, apo jo të vetë-prodhuara), në lëndë të parë sekondare, siç është filli i tjerrjes nga rezervat e pëlhurës, duke prodhuar brum nga mbeturina e letrës, nga zbrazja e gomave apo prodhimin e metalit nga copëzat metalike, shih klasat korresponduese në seksionin C (Prodhimi),
- riprocesimin e lëndëve nukleare, shih 20.13,
- rishkrirjen e mbeturinave dhe copëzave të hekurit, shih 24.10,
- rikthimin e materialeve gjatë procesit të djegies, apo shkrumbimit të mbeturinave, shih 38.2,
- trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme, shih 38.21,
- trajtimi i mbeturinave organike për asgjësim, përfshirë prodhimin e djegies, shih 38.21,
- rikthimi i energjisë gjatë procesit të djegies, shih 38.21,
- trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave radioaktive të tranzicionit nga spitale etj., shih 38.22,
- trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave toksike dhe të kontaminuara, shih 38.22,
- shitjen me shumicë të materialeve të rikthyeshme, shih 46.77.

# 39 Aktivitetet e Riparimit dhe Shërbimet e Tjera të Menaxhimit të Mbeturinave

Kjo ndarje përfshin, dhënien e shërbimeve të riparimit, d.m.th. pastrimin e ndërtesave dhe lokacioneve të kontaminuara, të dheut, ujit sipërfaqësor apo tokësor.

## 39.0 Aktivitetet e Riparimit dhe Shërbimet e Tjera të Menaxhimit të Mbeturinave

### 39.00 Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave

Kjo klasë përfshin:

- dekontaminimin e dheut dhe ujit tokësor në vendin e ndotjes, ose në vendin origjinal të mëparshëm, duke përdor p.sh. metoda mekanike, kimike apo biologjike,
- dekontaminimin e uzinave apo lokacioneve industriale, përfshirë uzinat dhe lokacionet nukleare,
- dekontaminimin dhe pastrimin e ujit sipërfaqësor, duke pasuar ndotjen aksidentale, p.sh. gjatë grumbullimit të ndotësve ose nëpërmes zbatimit të kimikaleve,
- pastrimin e derdhjeve të naftës dhe ndotjeve të tjera në tokë, në ujin sipërfaqësor, në oqean dhe dete, përfshirë zonat bregdetare,
- zvogëlimin e materieve toksike, azbestit, ngjyrës së plumbit dhe materialeve tjera toksike,
- aktivitetet tjera kontrolluese të specializuara të ndotjes.

Kjo klasë përjashton:

- kontrollin e pesticideve në bujqësi, shih 01.61,
- pastrimin e ujit, për qëllime të furnizimit të ujit, shih 36.00,
- trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme, shih 38.21,
- trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme, shih 38.22,
- fshirja e plehrave të jashtëm dhe pastrimi me ujë i rrugëve etj., shih 81.29.

# Sektori F – NDËRTIMTARIA

Ky sektor përfshin ndërtimin e përgjithshëm dhe aktivitetet e specializuara të ndërtimit për punët e ndërtesave dhe ndërtimeve civile. Ai përfshin punën e re, riparimin, shtesat dhe modifikimet, ngritjen e ndërtesave apo strukturave të parafabrikuara në lokacion, si dhe ndërtimtarinë e natyrës së përkohshme.

Ndërtimtaria e përgjithshme, është ndërtimi i banesave komplete, ndërtesave të zyrave, të shitoreve, të ndërtesave publike dhe shërbimit, ndërtesave të fermave etj., apo ndërtimin e veprave të ndërtimeve civile, siç janë autostradat, rrugët, urat, tunelet, hekurudhat, aeroportet, limanet dhe projektet tjera ujore, siç janë sistemet e ujitjes, sistemet e kanalizimit, objektet industriale, naftësjellësit dhe linjat elektrike, objektet sportive etj.

Kjo punë mund të kryhet për llogari të vetën, me pagesë apo në bazë të kontratës. Pjesët e punës dhe nganjëherë, madje edhe e tërë puna praktike, mund t'i jepet një nën-kontraktuesi. Njësiti i cili bart përgjegjësinë e përgjithshme për projektin e ndërtimit, është klasifikuar këtu.

Këtu është përfshirë gjithashtu, ndërtimi i banesave dhe punimeve të ndërtimeve civile.

Ky seksion, përfshin ndërtimin komplet të ndërtesave (ndarja 41), ndërtimin komplet të veprave të inxhinierisë civile (ndarja 42), si dhe aktivitetet e ndërtimtarisë së specializuar, nëse kryhen vetëm si pjesë e procesit të ndërtimit (ndarja 43).

Dhënia me qira e pajisjes së ndërtimit të një operatori, klasifikohet si një aktivitetet specifik i ndërtimit, i kryer me këtë pajisje.

Ky seksion gjithashtu përfshin zhvillimin projekteve ndërtuese, për ndërtesat apo veprat e ndërtimtarisë civile, duke i bashkuar mjetet financiare, teknike dhe fizike, për të realizuar projektet e ndërtimit për shitje të mëvonshme. Nëse këto aktivitetet kryhen, jo për shitje të mëvonshme të projekteve ndërtimore, por për punën e tyre (p.sh. dhënien me qira të hapësirës në këto ndërtesa, aktivitetet prodhuese në këto uzina), njësiti do të duhej të klasifikohej këtu, por sipas aktivitetit të tij operacional, d.m.th. pronës së patundshme, prodhimit etj.

## 41 Ndërtimi i Ndërtesave

Kjo ndarje përfshin, konstruktim e përgjithshëm të ndërtesave të të gjitha llojeve. Ai përfshin punimet e reja, riparimin, shtesat dhe modifikimet, ngritjen e ndërtesave apo strukturave të parafabrikuara në lokacion si dhe ndërtimtarinë e natyrës së përkohshme.

Këtu përfshihet edhe ndërtimin e banesave komplete, ndërtesave të zyrave, të shitoreve, ndërtesave tjera publike dhe të shërbimit, ndërtesave të fermave etj.

## 41.1 Zhvillimi i Projekteve të Ndërtimit

### 41.10 Zhvillimi i projekteve të ndërtimit

Kjo klasë përfshin:

- zhvillimin e projekteve të ndërtimit të ndërtesave për banim dhe jo banim, duke i bashkuar mjetet financiare teknike dhe bazike, për të realizuar projektet e ndërtimit për shitje të mëvonshme.

Kjo klasë përjashton:

- konstruktimin e banesave, shih 41.20,
- aktivitetet arkitekturale dhe inxhinierike, shih 71.1,
- shërbimet menaxhuese të projektit, lidhur me projektet e ndërtimit, shih 71.1.

## 41.2 Ndërtimi i Objekteve Banesore dhe Jobanesore

Ky grup përfshin konstruktimin e ndërtesave komplete banesore dhe jo banesore, në bazë të llogarisë së vetë për shitje me pagesë ose me kontratë. Në këtë proces të ndërtimit, është e mundur pjesëmarrja e kompanive për disa pjesë të ndërtimit, ose madje për tërë procesin e ndërtimit. Nëse vetëm disa pjesë të specializuara të procesit të ndërtimit kryhen, ky aktivitetet klasifikohet në ndarjen.

### 41.20 Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

Kjo klasë përfshin:

- konstruktimin e të gjitha llojeve të ndërtesave banesore:
  - shtëpitë për familje të vetme,
  - ndërtesat për shumë familje, përfshirë ndërtesat e larta;
- konstruktimin e të gjitha llojeve të ndërtesave jo banesore:
  - ndërtesat për prodhimet industriale, p.sh. fabrikat, punëtoritë, uzinat e montimit etj.,
  - spitalet, shkollat, ndërtesat për zyre, hotelet, shitoret, qendër tregtare, restorantet,
  - ndërtesat e aeroportit,
  - objektet për sporte të brendshme,
  - garazhet e parkimit, përfshirë garazhet e parkimit të nëndheshëm,
  - depot,
  - ndërtesat fetare;
- montimi dhe ngritja e konstruksioneve të parafabrikuara në lokacionin e ndërtimit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- rimodelimin dhe renovimin e strukturave ekzistuese banesore.

Kjo klasë përjashton:

- konstruktimin e objekteve industriale, përveç ndërtesave, shih 42.99,
- aktivitetet arkitekturale dhe inxhinirike, shih 71.1,
- menaxhimin e projektit për konstruktim, shih 71.1.

# 42 Punimet Inxhinierike

Kjo ndarje përfshin, konstruksionet e përgjithshme të objekteve të ndërtimeve civile. Po ashtu, kjo ndarje përfshin, punimet e reja, riparimin, shtesat dhe alternimet, ngritjen e strukturave të parafabrikuara në vendin e ndërtimit si dhe konstruktimet e natyrës së përkohshme.

Këtu përfshihen edhe konstruktimi i ndërtimeve të rënda, siç janë autostradat, magjistralet, urat, tunelet, hekurudhat, aeroportet, limanet, si dhe projektet tjera ujore, siç janë sistemet e ujitjes, sistemet e kanalizimit, objektet industriale, naftësjellësit dhe linjat elektrike, objektet e sporteve të jashtme, etj. Kjo punë mund të kryhet për llogari të vet, me pagesë ose në bazë të kontratës. Pjesë të punimeve dhe nganjëherë, madje e tëra puna praktike mund të nënkontraktohet.

## 42.1 Ndërtimi i Rrugëve dhe Hekurudhave

### 42.11 Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e autostradave, magjistraleve, rrugëve, rrugëve të tjera të automjeteve dhe këmbësorëve,
- punimet sipërfaqësore nëpër magjistrale, rrugë, autostrada, ura apo tunele:
  - shtrimin e asfaltit nëpër rrugë,
  - vënia e ngjyrave dhe shenjave të tjera nëpër rrugë,
  - instalimin e pengesave, shenjave të trafikut dhe ngjashëm;
- konstruktimin e pistave të aeroporteve.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e ndriçimit të rrugëve dhe sinjaleve elektrike, shih 43.21,
- aktivitetet arkitekturale dhe inxhinirike, shih 71.1,
- menaxhimin e projektit për ndërtim, shih 71.1.

### 42.12 Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nëntokësore

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e hekurudhave dhe metrove.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e ndriçimit të rrugëve dhe sinjaleve elektrike, shih 43.21,
- aktivitetet arkitekturale dhe inxhinirike, shih 71.1,
- menaxhimin e projektit për ndërtim, shih 71.1.

### 42.13 Ndërtimi i urave dhe tuneleve

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e urave, përfshirë të atyre për autostradat e mbingritura,
- ndërtimin e tuneleve.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e ndriçimit të rrugëve dhe sinjaleve elektrike, shih 43.21,
- aktivitetet arkitekturale dhe inxhinierike, shih 71.1,
- menaxhimin e projektit për ndërtim, shih 71.1.

## 42.2 Ndërtimi i Projekteve të Shërbimeve Publike

### 42.21 Ndërtimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve

Kjo klasë përfshin ndërtimin e linjave të distribuimit për transportimin e fluideve, të ndërtesave dhe strukturave të tjera që janë pjesë integrale e këtyre sistemeve.

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e konstruksioneve të ndërtimit civil për:
    - të naftësjellësve të distancave të gjata dhe urbane,
    - konstruktimin e ujësjellësit kryesor dhe të linjave,
    - sistemet e ujitjes (kanalet),
    - rezervuarët;
- ndërtimin e:
    - sistemeve të ujërave të zeza, përfshirë riparimin,
    - uzinat e asgjësimin të ujërave të zeza;
- stacionet e pompimit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shpimit e puseve të ujit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e menaxhimit të projektit, lidhur me punimet e ndërtimeve civile, shih 71.12.

### 42.22 Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikime

Kjo klasë përfshin ndërtimin e linjave të shpërndarjes për rrymë, telekomunikacion, ndërtesat dhe strukturat tjera që janë pjesë integrale e këtyre sistemeve.

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e konstruksioneve të ndërtimit civil për,
- linjat e energjisë së rrymës në distanca të gjata dhe komunikimin urban,
- termocentralet.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e menaxhimit të projektit lidhur me punimet e ndërtimeve civile, shih 71.12.

## 42.9 Ndërtimi i Projekteve të Tjera të Ndërtimit Civil

### 42.91 Ndërtimi i projekteve të ujit

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e:
    - kanaleve të ujit, limaneve dhe punimeve rreth lumit, portet e vogla (të marinës), bllokuesve, etj.,
    - të pendave dhe digave;
- gërryerjen e kanaleve të ujit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e menaxhimit të projektit lidhur me punimet e ndërtimeve civile, shih 71.12.

### 42.99 Ndërtimi i projekteve të tjera të ndërtimit civil p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e objekteve industriale, përveç ndërtesave siç janë:
    - rafineritë,
    - uzinat kimike;
- punët ndërtimore, ndryshe nga ndërtesat siç janë:
    - objektet e sporteve të jashtme.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- nënndarjen e tokës bashkë me përmirësimin e tokës, (p.sh. shtimi i rrugëve, infrastrukturës së shërbimeve publike etj.).

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e pajisjeve dhe makinerisë industriale, shih 33.20,
- nënndarjen e tokës pa përmirësimin e saj, shih 68.10,
- aktivitetet e menaxhimit të projektit lidhur me punimet e ndërtimeve civile, shih 71.12.

# 43 Aktivitetet e Ndërtimit të Specializuar

Kjo ndarje përfshin, aktivitetet e ndërtimit të specializuar (zanate speciale), d.m.th ndërtimin e pjesëve të ndërtesave dhe punimeve të ndërtimit civil, apo të përgatitjeve tjera. Këto aktivitete zakonisht janë të specializuara në një aspekt të përgjithshëm, kundër strukturave të ndryshme, duke kërkuar aftësi apo pajisje të specializuara, siç janë shtyllë-ngulja, punët e themelit, të punimeve të armaturës, punimeve të betonit, shtrimin e tullave, vënien e gurëve, vënia e skelave, mbulimi i çatisë, etj. Këtu përfshihet edhe ngritja e strukturave të çelikta, me kusht që pjesët të mos jenë të prodhuara nga e njëjta njësi. Aktivitetet e specializuara të ndërtimit, kryesisht kryhen në bazë të nënkontratës, por veçanërisht në ndërtimet e riparimit, kjo gjë bëhet drejtpërsëdrejti për pronarin e pronës.

Këtu gjithashtu, përfshihen edhe aktivitetet e kryerjes dhe përfundimit të ndërtesës.

Këtu përfshihen, instalimi i të gjitha llojeve të instalimeve, që e bëjnë ndërtesën të funksionojë si e tillë. Këto aktivitete, kryhen zakonisht në lokacionin e ndërtimit, edhe pse pjesët të punimeve mund të kryhen në një punëtori speciale. Këtu përfshihen aktivitetet, siç janë punët e ujësjellësit, instalimi i sistemeve të ngrohjes qendrore dhe klimatizimit, antenave, sistemeve të alarmit dhe punëve tjera elektrike, sistemet e spërkatjes, të ashensorëve dhe shkallëve lëvizëse, etj. Gjithashtu përfshihen, punët e izolimit (të ujit, ngrohjes, zërit), punimet me kallaj, punët për ftohje komerciale, instalimin e sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit për rrugët, hekurudhat, aeroportet, limanet, etj. Gjithashtu përfshihen aktivitetet e riparimit të llojit të njëjtë të sipërpërmendur.

Aktivitetet e përfundimit të ndërtesës, përfshin aktivitetet që kontribuojnë në kompletimin ose përfundimin e konstruksionit, siç është glazura, suvatimi, ngjyrosja, vënia e pllakave në dysheme dhe mur, apo mbulimi me materiale të tjera, siç është parketi, qilimat, tapetat e murit, etj.

Mbushja e dyshemesë me rërë, përfundimi i zdrukthëtarisë, punimet akustike, pastrimi i eksterierit, etj. Gjithashtu riparimi i të njëjtit tip, si të aktiviteteve të lartpërmendura, përfshihet gjithashtu, dhënia e pajisjes me operator, klasifikohet në aktivitetin e ndërtimit të shoqëruar.

## 43.1 Demolimi dhe Përgatitja e Vendpunishtes

Ky grup përfshin, aktivitetet e përgatitjes së lokacionit për aktivitetet vijuese të ndërtimit, përfshirë largimin e strukturave ekzistuese të mëparshme.

### 43.11 Demolimi i objekteve

Kjo klasë përfshin:

- shembjen apo rrënimin e ndërtesave apo strukturave tjera.

### 43.12 Përgatitja e vendpunishtes

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e lokacioneve të ndërtimit,
- largimin e dheut: gërmimi, groposjet, nivelimin dhe gradimin e lokacioneve të ndërtimit, prashitjen e kanaleve, largimin e shkëmbinjve, thyerja etj.
- përgatitjen e lokacionit për minierat:
  - largimin e mbingarkesave dhe zhvillimeve tjera si dhe përgatitjen e pronave dhe lokacioneve të mineraleve dhe vend-punishteve të mineraleve, përveç vend-punishteve të naftës dhe gazit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ndërtimin e drenazhës së lokacionit,
- drenazhimin e tokës bujqësore, apo të pylltarisë.

Kjo klasë përjashton:

- shpimin e puseve për prodhimin e naftës, apo të gazit, shih 06.10, 06.20,
- dekontaminimin e dheut, shih 39.00,
- shpimin e puseve të ujit, shih 42.21,
- çelja e puseve, shih 43.99.

### 43.13 Shpimet testuese dhe shpuarja

Kjo klasë përfshin:

- shpimet testuese, dhe marrjen e mostrës së brendisë së tokës për ndërtim për qëllime gjeofizike, gjeologjike dhe të ngjashëm.

Kjo klasë përjashton:

- shpimin e puseve për prodhimin e naftës dhe gazit, shih 06.10, 06.20,
- shpimet testuese dhe shërbimet mbështetëse të shpimit gjatë aktiviteteve të minierave, shih 09.90,
- shpimin e puseve të ujit, shih 42.21,
- hapjen e puseve, shih 43.99,
- eksploatimin e fushave të naftës dhe gazit, matjet gjeofizike, gjeologjike dhe sizmike, shih 71.12.

## 43.2 Aktivitetet Elektrike, Hidraulike dhe Instalime të Tjera të Ndërtimit

Ky grup përfshin aktivitetet instaluese, që mbështesin funksionimin e ndërtesës si të tillë, përfshirë instalimin e sistemit elektrik, hidraulik (të sistemeve të ujit, gazit dhe kanalizimit), të sistemeve të ngrohjes dhe të klimatizimit, ashensorëve etj.

### 43.21 Instalimet elektrike

Kjo klasë përfshin instalimin e sistemeve elektrike të të gjitha llojeve të ndërtesave dhe strukturave të ndërtimit civil të sistemeve elektrike.

Kjo klasë përfshin:

- instalimin e:
  - e pajisjeve dhe instalimeve elektrike,
  - instalimit të telekomunikacionit,

  - rrjetit kompjuterik dhe të instalimit të televizionit kabllovik, përfshirë atë të fijeve optike,
  - antenat satelitore,
  - sistemet e ndriçimit,
  - alarmet kundër zjarrit,
  - sistemet e alarmit kundër vjedhjes,
  - ndriçimin e rrugëve dhe të sinjaleve elektrike,
  - ndriçimin e pistave të aeroportit,
  - kolektorët e energjisë solare.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- lidhjen e pajisjeve elektrike dhe pajimeve shtëpiake, përfshirë ngrohjen qendrore.

Kjo klasë përjashton:

- konstruktimin e linjave të komunikimit dhe të transmetimit të energjisë, shih 42.22,
- monitorimin dhe monitorimin me telekomandë të sistemeve të sigurisë elektrike, siç janë alarmet kundër vjedhjes dhe kundër zjarrit, përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre, shih 80.20.

### 43.22 Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit

Kjo klasë përfshin instalimin e sistemit të ujësjellësit, ngrohjes qendrore dhe të kilmatizimit, përfshirë shtesat, alternimet, mirëmbajtjen dhe riparimin.

Kjo klasë përfshin:

- instalimin në ndërtesa apo projekte tjera të ndërtimit:
  - të sistemit të ngrohjes (elektrike me gaze apo me naftë),
  - të furrave, të kullave të ftohjes,
  - të kolektorëve të energjisë solare jo elektrike,
  - të pajisjeve të hidraulikës dhe të sanitarisë,
  - të gypave dhe pajisjeve ventilimit dhe të klimatizimit,
  - të instalimeve të gazit,
  - të gypave të avullit,
  - të sistemeve për fikjen e zjarrit,
  - të sistemeve spërkatëse të barit;
- instalimin e gypave.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e bazës të ngrohjes elektrike, shih 43.21.

### 43.29 Instalime të tjera ndërtimore

Kjo klasë përfshin, instalimin e pajisjeve tjera nga sistemet elektrike të hidroaulikës, të ngrohjes qendrore dhe klimatizimit, apo të makinerisë industriale në ndërtesa dhe strukturat e ndërtimit civil.

Kjo klasë përfshin:

- instalimin nëpër ndërtesa apo projekte tjera të ndërtimit:
  - të ashensorëve, shkallëve lëvizëse, përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen,
  - dyert automatike dhe rrotulluese,
  - përçuesit e ndriçimit,
  - sistemet e pastrimit me vakum,
  - izolimin termal të zërit apo dridhjes.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e makinerisë industriale, shih 33.20.

# 43.3 Përfundimi dhe Finalizimi i Punëve të Ndërtesave

## 43.31 Punime suvatimi

Kjo klasë përfshin:

- aplikimin nëpër ndërtesa dhe projektet tjera të ndërtimit të suvatimin interior dhe eksterier, apo të llaçit, përfshirë materialet tjera apo veshje me listela.

## 43.32 Punime montimi nga druri dhe materiale të tjera

Kjo klasë përfshin:

- instalimin e dyerve (përveç atyre automatike dhe rrotulluese), të kornizave të dyerve dhe dritareve të drurit apo materialet tjera;
- instalimin e kuzhinave të ndërtuara me dollapë, të shkallëve të drunjta, të montimin të shitoreve dhe ngjashëm;
- kompletimin e interierit, siç janë tavanet dhe ndarjet e lëvizshme, etj.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e dyerve automatike dhe rrotulluese, shih 43.29.

## 43.33 Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve

Kjo klasë përfshin:

- shtrirjen, vënien e pllakave, varjen ose montimin në ndërtesa dhe projekte tjera të ndërtimit të:
  - qeramikës, ose gurëve të prerë për mure ose pllakave të dyshemesë, montimin e suvës së qeramikës,
  - shtrimin e parketit dhe mbulesave tjera të drunjta për dysheme, mbështjelljen e mureve me pjesë të drunjta
  - mbulimin e dyshemeve me qilima dhe linelium, përfshirë nga goma dhe plastika,
  - shtrimi i dyshemeve apo veshja e mureve me terako, mermer, granit apo rrasat e gurit dhe tapeta të murit.

## 43.34 Lyerja dhe vendosja e xhamave

Kjo klase përfshin:

- ngjyrosjen e brendshme dhe të jashtme të ndërtesave,
- ngjyrosjen e strukturave civile instalimin e xhameve, pasqyrave, etj.

Kjo klase përjashton: instalimin e dritareve 43.32.

## 43.39 Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave

Kjo klase përfshin:

- pastrimin e ndërtesave të reja pas ndërtimit të tyre, punët tjera të kompletimit dhe përfundimit

Kjo klase përjashton:

- aktivitetet e dizajnerëve të dekorimit të brendshëm, shih 74.10,
- pastrimin gjeneral të banesave dhe të strukturave tjera, shih 81.21,
- pastrimin e specializuar të brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave, shih 81.22.

## 43.9 Aktivitete të Tjera të Specilizuara për Ndërtim

### 43.91 Punimet e kulmit (çatisë)

Kjo klasë përfshin:

- ndërtimin e çative,
- mbulimin e çative.

Kjo klase përjashton:

- dhënien me qira të makinerisë dhe pajisjes së ndërtimit pa operator, shih 77.32.

### 43.99 Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

Aktivitetet e ndërtimit të specializuara në një aspekt i përbashkët për llojin e ndryshëm të strukturave, duke kërkuar mjeshtëri apo pajisje të specializuara: konstruktimin e bazamenteve, përfshirë nguljen e shtyllave, punimet rreth mbrojtjes nga lagështia dhe uji, heqja e lagështisë së ndërtesave, hapja e puseve, ngritja e elementeve të çelikta, lakimi i çelikut, vënia e tullave dhe të gurëve, skelet dhe platforma punuese për ngritje dhe çmontim, përjashtuar dhënien me qira të skelave dhe platformave të punës, ngritjen e oxhaqeve dhe furrave industriale, puna me specialistin që kërkon kushte për nevojën e aftësive nxitëse dhe përdorimin e pajisjeve tjera, siç janë në lartësi dhe struktura të larta.

- Punën nën sipërfaqësore,
- ndërtimin e pishinave të jashtme,
- pastrimin e avullit, hedhjen e rërës dhe aktivitetet e ngjashme të pjesës së ngjashme të ndërtesës,
- dhënia me qira e kranave dhe pajisjeve tjera të ndërtimit, e cila nuk mundë t’i jepet një lloji specifik të ndërtimit, me operator.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të makinerisë dhe pajisjes së ndërtimit me operator, shih 77.32.

# Sektori G – TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE

Ky sektor përfshin shitjen me shumicë dhe pakicë (d.m.th. shitje pa transformim) të çdo lloji të mallit, dhe dhënien e shërbimeve të rastësishme, për shitjen e mallit. Shitjet me shumicë dhe pakicë, janë hapat final në distribuimin e mallit. Në këtë sektor, gjithashtu përfshihet riparimi i automjeteve dhe motoçikletave. Shitja pa transformim, përfshin operacionet e zakonshme (ose manipulimet), lidhur me tregtinë, p.sh. sortimin, gradimin dhe montimin e mallrave, përzierjen e mallrave (p.sh të rërës), mbushjen e shisheve (me ose pa procedimin e pastrimit të shishes), paketimin, ndarjen e sasive të mëdha dhe ripaketimin për distribiumin në pjesë më të vogla, magazinimi (qoftë të ngrirë apo të freskët). Ndarja 45 përfshin të gjitha aktivitetet, lidhur me shitjen dhe riparimin e mjeteve motorike dhe të motoçikletave, ndërsa ndarja 46 dhe 47 përfshin të gjitha aktivitetet tjera të shitjes. Dallimi mes ndarjes 46 (shitjen me shumicë) dhe ndarja 47 (shitjen me pakicë), bazohet në llojin predominues të myshteriut.

Shitja me shumicë, është rishtije (shitje pa transformim) të mallrave të reja dhe të përdorura, blerësve me pakicë, tregtia mes bizneseve, siç janë përdoruesit industrial, komercial, institucional, apo rishitje për tregtarët tjerë me shumicë, përfshin veprimin si një agjentë apo broker në blerjen e mallit, apo shitjen e mallit personave dhe kompanive të tilla. Llojet kryesore të bizneseve janë futur në shitjen me shumicë të tregtarëve, d.m.th. shitësit me shumicë, të cilët kanë të drejtë për mallrat që ata i shesin, siç janë tregtarët me shumicë, ndërmjetës, distributor industrial, importues dhe shoqatat e kooperativave blerëse, degat e shitjeve dhe zyrat e shitjeve (por jo shitore me pakicë), që mirëmbahen nga njësitë e prodhimit apo të minierave, përveç uzinave apo xeheroreve për qëllime marketingu, të produkteve të tyre dhe që thjesht nuk marrin urdhra për të plotësuar nga dërgesat direkt nga uzinat apo xeheroret. Këtu, gjithashtu janë përfshirë brokerët e mallrave dhe artikujve, tregtarët dhe komisionarët dhe grumbulluesit /montuesit, blerësit dhe shoqatat e kooperativave të angazhuara në marketingun e produkteve të fermës.

Shitësit me shumicë shpesh i grumbullojnë, i sortojnë dhe i klasifikojnë mallrat e tyre në grupe të mëdha, bëjnë thyerjen e grupeve më të mëdha, ripaketojnë dhe rishpërndajnë ato në grupe më të vogla. Për shembull farmaceutikët, i magazinojnë, i fusin në frigorifer, i shpërndajnë dhe i instalojnë mallrat, angazhohen në promovimin e shitjes për blerësit e tyre dhe në dizajnimin e etiketave. Shitja me pakicë, është rishitje (shitje pa transformim) e mallrave të rinj dhe të përdorur, kryesisht publikut të përgjithshëm për konsumim personal, shtëpiak apo shfrytëzim, nëpër shitore, shtëpi të mallrave, tezga, shtëpive që bëjnë porositë me postë, personave që bëjnë shitjen nëpër shtëpi, tregtarëve shëtitës, kooperativave të konsumatorëve, shtëpive të ankandeve etj. Shumica e tregtarëve me pakicë e marrin të drejtën për mallrat që i shesin, por disa prej tyre veprojnë si agjentë për kryesorin dhe shesin, ose në bazë të konsinacionit apo të komisionit.

# 45 Tregtia me Shumicë dhe Pakicë, si dhe Riparimi i Automjeteve dhe Motoçikletave

Kjo ndarje përfshin të gjitha aktivitetet (përveç prodhimit dhe dhënies me qira), lidhur me mjetet motorike dhe motoçikleta, duke përfshirë maunat dhe kamionët, siç janë shitja me shumicë dhe pakicë e mjeteve të reja dhe të përdorura, riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve si dhe shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesorëve për mjetet motorike dhe motoçikleta. Këtu gjithashtu, janë përfshirë aktivitetet e agjentëve tregtare të përfshirë në shitje me shumicë apo pakicë të automjeteve.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin aktivitetet e larjes, lustrimin e automjeteve, etj.

Kjo ndarje nuk përfshin shitjen me pakicë të karburanteve automobilistike dhe të produkteve lubrifikuese, flladitëse apo dhënien me qira të mjeteve motorike dhe motoçikletave.

## 45.1 Tregtia e Automjeteve

### 45.11 Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël

Kjo klasë përfshin:

- shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të reja dhe të përdorura:
  - mjetet motorike për pasagjer, përfshirë mjetet motorike të specializuara për të udhëtar, siç janë autoambulancat dhe minibusët etj., (me peshë qe nuk e tejkalojnë 3,5 tonë).

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të mjeteve motorike për përdorim jashtë rrugëve (me peshë që nuk tejkalojnë 3,5 tonë).

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesorëve për mjetet motorike, shih 45.3,
- dhënien me qira të mjeteve motorike me shoferë, shih 49.3,
- dhënien me qira të mjeteve motorike pa shofer, shih 77.1.

### 45.19 Tregtia e automjeteve të tjera

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të automjeteve të reja dhe të përdorura:
  - të kamionëve, maunave me rimorkio dhe gjysmë rimorkio,
  - automjetet e kampingut siç janë karvanët dhe shtëpitë motorike.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të mjeteve motorike me përdorim jashtë rruge (me peshë që kalon 3,5 tonë).

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesorëve për mjetet motorike, shih 45.3,
- huazimin e kamionëve me shoferë, shih 49.41,
- huazimin e kamionëve pa shoferë, shih 77.12.

## 45.2 Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjeteve

### 45.20 Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve

Kjo klasë përfshin:

- Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike:
  - riparimet mekanike,
  - riparimet elektrike,
  - riparimin e sistemeve të injektimit elektrik,
  - servisimet e rëndomta,
  - riparimin e karrocerisë,
  - riparimin e pjesëve të mjeteve motorike,
  - pastrimin, lustrimin etj.,
  - spërkatjen dhe ngjyrosjen,
  - riparimin e xhamave dhe dritareve,
  - riparimin e ulëseve të mjeteve motorike;
- riparimin e rrotave dhe të gomave, montimin apo zëvendësimin,
- trajtimin kundër ndryshkut,
- instalimin e pjesëve dhe aksesorëve, jo si pjesë e procesit të prodhimit.

Kjo klasë përjashton:

- rivullkanizimin dhe rindërtimin e gomave, shih 22.11.

## 45.3 Tregtia e Pjesëve dhe Aksesorëve të Automjeteve

- Ky grup përfshin tregtimin me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve të pjesëve, komponentëve, furnizimeve, veglave dhe aksesorëve për mjetet motorike, siç janë:
  - gomat e rrotave dhe gomat e brendshme të rrotave
    kandelat, bateritë, pajisjet e ndriçimit dhe pjesët elektrike.

### 45.31 Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

### 45.32 Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të karburanteve të automjeteve, shih 47.30.

## 45.4 Tregtia, Mirëmbajtja dhe Riparimi i Motoçikletave dhe Pjesëve e Aksesorëve të Tyre

### 45.40 Tregtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitje me shumicë dhe pakicë të motoçikletave përfshirë mopedët,
- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesorëve për motoçikleta (përfshirë nga agjentët tregtare dhe shtëpitë porositëse me postë),
- mirëmbajtjen dhe riparimin e motoçikletave.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të biçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre, shih 46.49,
- shitjen me pakicë të biçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre, shih 47.64,
- dhënien me qira të motoçikletave, shih 77.39,
- riparimin dhe mirëmbajtjen e biçikletave, shih 95.29.

# 46 Tregtia me Shumicë, përveç Automjeteve dhe Motoçikletave

Kjo ndarje përfshin shitjen me shumicë për llogari të vete ose në bazë të pagesës ose kontratës (të tregtisë së komisionit), lidhur me tregtinë, ose shitjen me shumicë vendore dhe tregtinë ndërkombëtare me shumicë (import/eksport).
Kjo ndarje përjashton:

- shitjen me shumicë të mjeteve motorike, karvanëve dhe motoçikletave, shih 45.1, 45.4,
- shitjen me shumicë e aksesorëve të mjeteve motorike, shih 45.31, 45.40,
- dhënia me qira dhe lizingu i artikujve, shih ndarjen 77,
- paketimi i mallrave të ngurta dhe mbushja e shisheve me mallra të lëngët, apo të gazta, përfshirë përzierjen dhe filtrimin për palët e treta, shih 82.92.

## 46.1 Aktivitetet e Ndërmjetësimit në Shitjen me Shumicë

Ky grup përfshin:

- aktivitetet e agjendave tregtare, të brokerëve të mallrave dhe të gjithë shitësit të tjerë me shumicë, që tregtojnë në emër dhe llogari të të tjerëve,
- aktivitetet e atyre, të përfshirë në prurjen bashkë të blerësve dhe shitësve, apo në ndërmarrjen e transaksioneve komerciale, në emër të shefit përfshirë në internet.

Ky grup gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e shtëpive të ankandeve, për shitje me shumicë, përfshirë ankandet me shumicë mes internetit.

### 46.11 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, lëndëve të para tekstile dhe mallrave gjysmë të gatshme

Kjo klasë përjashton:

- shitje me shumicë në emër të vetë, shih 46.2 deri 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtare pa shitore, shih 47.99.

### 46.12 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale

Kjo klasë përfshin:

- agjentët e involvuar në shitjen e:
  - karburanteve, mineraleve, metaleve dhe kimikaleve industriale, përfshirë fertilizuesit.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë me emër të vet, shih 46.2 deri 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë, që nuk kanë shitore, shih 47.99.

### 46.13 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të ndërtimit

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë me emër të vetë, shih 46.2 deri 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që s'kanë shitore, shih 47.99.

### 46.14 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe aeroplanëve

Kjo klasë përfshin agjentët e involvuar në shitjen e:
- makinerisë, përfshirë makinerinë e zyrave dhe kompjuterët, pajisjet industriale, anijeve dhe avionëve.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet e agjentëve tregtarë për mjetet motorike, shih 45.1,
- ankandet e mjeteve motorike, shih 45.1,
- shitje me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që nuk kanë shitore, shih 47.99.

### 46.15 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e mobilieve, mallrave shtëpiake, pjesëve elektronike dhe hekurishteve

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë në emër të vetë, shih 46.2 to 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që nuk kanë shitore, shih 47.99.

### 46.16 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, gëzofit, këpucëve dhe artikujve prej lëkure

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë në emër të vetë, shih 46.2 to 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtar që nuk kanë shitore, shih 47.99.

### 46.17 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë në emër të vetë, shih 46.2 to 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që nuk kanë shitore, shih 47.99.

### 46.18 Aktivitetet e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 to 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që nuk kanë shitore, shih 47.99,
- aktivitetet e agjentëve të sigurimit, shih 66.22,
- aktivitetet e agjentëve të patundshmërisë, shih 68.31.

### 46.19 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 to 46.9,
- shitjen me pakicë nga agjentët tregtarë që nuk kanë shitore, shih 47.99.

## 46.2 Tregtia me Shumicë e Lëndëve të Para Bujqësore dhe Kafshëve të Gjalla

### 46.21 Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të grurit dhe farërave,
- shitjen me shumicë të frutave vajore,
- shitjen me shumicë të duhanit të papërpunuar,
- shitjen me shumicë të ushqimit të kafshëve dhe të lëndëve të para bujqësore p.k.t

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë të fijeve të tekstilit, shih 46.76.

### 46.22 Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të luleve, bimëve dhe të kokrrave,

### 46.23 Tregtia me shumicë e kafshëve të gjalla

### 46.24 Tregtia me shumicë e lëkurave të papërpunuara, lëkurave dhe artikujve prej lëkure

## 46.3 Tregtia me Shumicë e Produkteve Ushqimore, Pijeve dhe Duhanit

### 46.31 Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të freskëta,
- shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të konservuara.

### 46.32 Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të tij

### 46.33 Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrnave të gatimit

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të produkteve qumështore,
- shitjen me shumicë të veve dhe të produkteve nga vezët,
- shitjen me shumicë vajrave dhe yndyrave ushqyese, nga kafshët apo me prejardhje perimore.

### 46.34 Tregtia me shumicë e pijeve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të pijeve alkoolike,
- shitjen me shumicë të pijeve jo alkoolike.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- blerjen e verës në vendin e prodhimit me shumicë dhe futjen e saj në shishe pa transformim.

Kjo klasë përjashton:
- përzierjen e verës apo të pijeve të forta të distiluara, shih 11.01, 11.02.

### 46.35 Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit

### 46.36 Tregtia me shumicë e sheqerit, e çokollatës dhe e ëmbëlsirave

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të sheqerit, të çokollatës dhe ëmbëlsirave të sheqerit,
- shitjen me shumicë të produkteve të furrave.

### 46.37 Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave

### 46.38 Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe molusqet (frutat e detit)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët përkëdhelëse.

### 46.39 Tregtia me shumicë, jo e specializuar, e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit

## 46.4 Tregtia me Shumicë e Artikujve Shtëpiakë

Ky grup përfshin shitjen me shumicë të artikujve shtëpiak, përfshirë tekstilet.

### 46.41 Tregtia me shumicë e tekstileve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të perit,
- shitjen me shumicë të pëlhurës,
- shitjen me shumicë të rrobave shtëpiake etj.,
- shitjen me shumicë të artikujve për rrobaqepësi: gjilpërave, penjtë e qepjes ejt.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë të fijeve të tekstilit, shih 46.76.

### 46.42 Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të rrobave, përfshirë veshjet sportive,

- shitjen me shumicë të pjesëve përcjellëse të rrobave, siç janë dorëzat, kravatat dhe mbërtheckat,
- shitjen me shumicë të veshmbathjeve,
- shitjen me shumicë të artikujve të gëzofit,
- shitjen me shumicë të ombrellave.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të argjendarisë, shih 46.48,
- shitjen me shumicë të artikujve të lëkurës, shih 46.49,
- shitjen me shumicë të veshmbathjeve dhe pajisjeve speciale sportive, siç janë çizmet e sikjave, shih 46.49.

### 46.43 Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pajisjeve shtëpiake elektrike,
- shitjen me shumicë të radio dhe televizorëve,
- shitjen me shumicë të aparateve fotografik dhe optik,
- shitjen me shumicë të aparateve elektrik të ngrohjes,
- shitjen me shumicë të trakave audio dhe video, CD, DVD.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të trakave të zbrazëta, audio, video, CD, DVD, shih 46.52,
- shitjen me shumicë të makinave qepëse, shih 46.64.
-

### 46.44 Tregtia me shumicë e porcelanit dhe artikujve të xhamit, si dhe e materialeve pastruese

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të artikujve të porcelanit dhe të xhamit,
- shitjen me shumicë të materialeve pastruese.

### 46.45 Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe kozmetikës

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të parfumerisë, kozmetikës dhe sapunëve.

### 46.46 Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të artikujve farmaceutik dhe medicinal.

### 46.47 Tregtia me shumicë e mobilieve, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mobileve shtëpiake,
- shitjen me shumicë të qilimave,
- shitjen me shumicë të pajisjeve të ndriçimit.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të mobileve të zyrave, shih 46.65.

### 46.48 Tregtia me shumicë e orëve dhe e artikujve të argjentarisë

### 46.49 Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiakë

Kjo klasë përfshin:

- Shitjen me shumicë të artikujve të drurit, të punimeve të shportarisë dhe të artikujve nga tapa etj.,
- shitjen me shumicë të biçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre,
- shitjen me shumicë në artikujt e shkrimit, të librave, revistave dhe gazetave,
- shitjen me shumicë e artikujve të lëkurës dhe të aksesorëve të udhëtimit,
- shitjen me shumicë të instrumenteve muzikor,
- shitjen me shumicë të lojërave dhe lodrave,
- shitjen me shumicë e artikujve sportive, përfshirë veshmbathjen sportive speciale, siç janë çizmet e skajimit.

## 46.5 Tregtia me Shumicë e Pajisjeve të Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikimit

Ky grup përfshin shitjen me shumicë të pajisjes së teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT), d.m.th. kompjuterët, pjesët dhe pajisjet e telekomunikacionit.

### 46.51 Tregtia me shumicë e kompjuterëve, e pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe softuerëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kompjuterëve dhe pajisjeve periferike të kompjuterëve,
- shitjen me shumicë të softuerëve.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë pjesëve mekanike, shih 46.52,
- shitjen me shumicë të makinerisë dhe pajisjeve të zyrave, (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), shih 46.66.

### 46.52 Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikimit, si dhe pjesëve të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të valvulave dhe tubacioneve elektronike,
- shitjen me shumicë të aparateve gjysmë-përçuese,
- shitjen me shumicë të mikroçipave dhe qarqeve të integruar,
- shitjen me shumicë të qarqeve të printuar,
- shitjen me shumicë të audio dhe videokasetave të zbrazëta dhe të disketave, të disqeve magnetik dhe optik (CD, DVD),
- shitjen me shumicë të pajisjeve të telefonit dhe komunikimit.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të audio dhe videokasetave të incizuara, CD, DVD, shih 46.43,

- shitjen me shumicë të kompjuterëve dhe pajisjeve periferike të kompjuterëve, shih 46.51.

## 46.6 Tregtia me Shumicë e Makinerisë Tjetër, Pajisjeve dhe Pjesëve të Tjera

Ky grup përfshin shitjen me shumicë të makinerisë së specializuar, pajisjeve dhe furnizimeve, për makinerinë e të gjitha qëllimeve.

### 46.61 Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve furnizuese

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerisë dhe pajisjes bujqësore:
  - plugjeve, shpërndarësit e plehrave natyral, farë-mbjellësit,
  - makinat korrëse,
  - makinat shirëse,
  - makinat e mjeljes,
  - makinat për ruajtjen e shportarisë, makinat për ruajtjen e bletëve,
  - traktorët e përdorur në bujqësi dhe pylltari.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- kositëset e barit.

### 46.62 Tregtia me shumicë e veglave të makinerive

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mjeteve të makinerisë për

secilin lloj dhe secilin material.

Kjo gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të mjeteve të makinerisë të kontrolluara me kompjuter.

### 46.63 Tregtia me shumicë e makinerive të minierave, të ndërtimit, si dhe për punime inxhinierike

### 46.64 Tregtia me shumicë e makinerive të industrisë tekstile dhe të makinave të qepjes dhe thurjes

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të makinave të kontrolluara me kompjuter për industrinë e tekstilit dhe të makinave qepëse dhe për thurje të kontrolluara me kompjuter.

### 46.65 Tregtia me shumicë e mobilieve të zyrave

Kjo klasë përfshin:

- Shërbimet e tregtisë me shumicë për:
  - mallrat e klasifikuar në 31.01 (Prodhimi i mobileve të zyrave dhe shitoreve).

### 46.66 Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrave

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të pajisjeve dhe makinerisë për zyre, pos kompjuterëve dhe pajisjeve periferike të kompjuterëve.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë të kompjuterëve dhe pajisjeve periferike të tyre, shih 46.51,
- shitjen me shumicë të pjesëve elektronike dhe pajisjeve telefonike dhe të komunikimit, shih 46.52.

### 46.69 Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të transportit, përveç mjeteve motorike, motoçikletave dhe biçikletave,
- shitjen me shumicë të robotëve të linjave të prodhimit,
- shitjen me shumicë të pajisjeve çelësave dhe pajisjeve tjera instaluese për përdorim industrial,
- shitjen me shumicë të materialit tjetër elektrik, siç janë elektromotorët, transformatorët,
- shitjen me shumicë e makinerisë tjetër n.e.c. për përdorim në industri (përveç industrisë së minierave, ndërtimit, ndërtimit civil dhe të tekstilit), tregti dhe navigacion si dhe shërbime tjera.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- shitjen me shumicë të instrumenteve dhe mjeteve matëse.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë të mjeteve motorike, rimorkiove dhe karvanëve, shih 45.1,
- shitjen me shumicë të pjesëve për mjetet motorike, shih 45.31,
- shitjen me shumicë të motoçikletave, shih 45.40,
- shitjen me shumicë të biçikletave, shih 46.49.

## 46.7 Tregtia Tjetër me Shumicë e Specializuar

Ky grup përfshin aktivitetet tjera të specializuara të shitjes me shumicë, jo të klasifikuara në grupe tjera të kësaj ndarje. Ky grup përfshin shitjen me shumicë të produkteve të ndërmjetëm, përveç atyre bujqësore, që në mënyrë tipike nuk janë për përdorim shtëpiak.

### 46.71 Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me shumicë të karburanteve, të yndyrave, lubrifikantëve, vajrave, siç janë:
    - qymyr druri, thëngjilli, koksi, druri i djegies, nafta,
    - naftë e papërpunuar, vaji i papërpunuar, karburantin diesel, gazolina, nafta si lëndë djegëse, nafta për ngrohje, kerozina,
    - gazrat e lëngëta të naftës, butanin dhe gaz propanin,
    - vajrat dhe yndyrat lubrifikuese, produktet e rafinuara të naftës.

## 46.72 Tregtia me shumicë e metaleve dhe mineraleve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të xeheve të metalit me ngjyrë dhe pangjyrë,
- shitjen me shumicë të metaleve me ngjyrë dhe pangjyrë, në forma primare,
- shitjen me shumicë të gjysmëprodukteve të metalta dhe jo të metalta n.e.c.,
- shitjen me shumicë të arit dhe metaleve tjera të çmuara.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me shumicë të mbeturinave të metalit, shih 46.77.

## 46.73 Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të drurit të papërpunuar,
- shitjen me shumicë të produkteve të procesimit primar nga druri,
- shitjen me shumicë të ngjyrave dhe zmaltit,
- shitjen me shumicë të materialeve ndërtimore:
  - të rërës, zhavorrit;
- shitjen me shumicë të tapetave të murit dhe materialit për dysheme,
- shitjen me shumicë e xhamit të rrafshët,
- shitjen me shumicë e pajisjeve sanitare:
  - vaskave, lavamanit, porcelanit dhe të sanitarisë tjetër,
  - shitjen me shumicë të ndërtimeve të parafabrikuara.

## 46.74 Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të harduerëve dhe bravave,
- shitjen me shumicë e pajisjeve dhe instalimeve,
- shitjen me shumicë e ngrohësve të ujit të ngrohtë,
- shitjen me shumicë të pajisjeve instaluese sanitare:
  - tubacioneve, gypave, pajisjeve, rubineteve, pjesëve T, konektorëve, gypat e gomës etj.;
- shitjen me shumicë të veglave siç janë çekanët, sharrat, kaçavidat dhe veglat tjera të dorës.

## 46.75 Tregtia me shumicë e produkteve kimike

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kimikaleve industrial:
  - anilina, ngjyra për shtypje, vajra esencial, gazrat industriale, ngjitësit kimik, material ngjyroses, rrëshira sintetike, metanoli, parafina, parfumet dhe aromatizuesit, sodën, kripën industrial, acidet dhe sulfuret, derivatet e niseshtes etj.
- shitjen me shumicë të plehrave artificial dhe produkteve agrokimike.

## 46.76 Tregtia me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të materialit plastik në formën primare,
- shitjen me shumicë të gomës,
- shitjen me shumicë të fijeve të tekstilit etj.,
- shitjen me shumicë të letrës në sasi të mëdha,

- shitjen me shumicë të gurëve të çmueshëm.

### 46.77 Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të hedhurinave dhe mbeturinave të metalta dhe jo të metalta dhe materialeve për riciklim, përfshirë grumbullimin sortimin, ndarjen, çmontimin e mallrave të përdorura, siç janë veturat në mënyrë që të fitohen pjesë të ripërdorshme, paketimin dhe ripaketimin, deponimin dhe dorëzimin pa një proces të transformimit të vërtetë. Përveç kësaj, mbeturinat e blera dhe të shitura kanë një vlerë të qëndrueshme.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- çmontimin e automobilave, kompjuterëve, televizorëve dhe pajisjeve tjera për të fituar dhe rishitur pjesë të përdorshme.

Kjo klasë përjashton:

- grumbullimin e mbeturinave shtëpiake dhe industriale, shih 38.1,
- trajtimin e mbeturinave, jo për një përdorim të më tejmë, në një proces të prodhimit industrial, por me qëllim të asgjësimit, shih 38.2,
- procesimi i mbeturinave dhe hedhurinave të metalta dhe artikujve tjerë në lëndë të parë të sekondare, kur kërkohet një proces i vërtetë i transformimit (rezultimi i lëndës së parë sekondare është i përshtatshëm për përdorim të drejtë për drejtë në një proces të prodhimit industrial, por ai nuk është një produkt final), shih 38.3,
- çmontimi i automobilave, kompjuterëve, televizorëve dhe pajisjeve tjera për riparimin e materialeve, shih 38.31,
- thyerjen e anijeve, shih 38.31,
- grimcimin e veturave me anë të procesit mekanik, shih 38.32,
- shitjen me pakicë e mallrave të përdorur, shih 47.79.

## 46.9 Tregtia me Shumicë Jo e Specializuar

### 46.90 Tregtia me shumicë jo e specializuar

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mallrave të ndryshëm, pa ndonjë specializim të posaçëm.

# 47 Tregtia me Pakicë, përveç Tregtisë së Automjeteve dhe Motoçikletave

Kjo ndarje përfshin  tregtinë me pakicë (shitjen pa përpunim) të mallrave të reja dhe të përdorura, kryesisht për popullatën për konsum personal apo për nevoja të ekonomive familjare,  e cila ushtrohet në shitore, shtëpi të  mallrave, në tezga, me porosi postare dhe internet, shitësve në rrugë, të personave shitës derë - më – derë, kooperativave të konsumatorëve etj.

Tregtia me pakicë klasifikohet së pari sipas llojit të vendit të shitjes ku ajo ushtrohet (tregtia me pakicë në shitore: grupet 47.1 deri 47.7; shitjen me pakicë jashtë shitoreve: grupet 47.8 dhe 47.9). Tregtia me pakicë në shitore, përfshin edhe shitjen me pakicë të mallrave të përdorura (klasa 47.79). Për tregtinë  me pakicë në shitore ekziston një dallim tjetër mes shitjes me pakicë të specializuar

(grupet 47.2 deri 47.7) dhe shitjes me pakicë jo të specializuar (grupi 47.1). Grupet e cekura ndahen në nën grupe tjera, duke u bazuar nga sasia e produkteve të shitura. Shitja jashtë shitoreve ndahet sipas mënyrës se si ushtrohet , siç janë shitjet me pakicë nëpërmes tezgave dhe tregjeve (grupi 47.8) dhe shitja tjetër me pakicë jashtë shitoreve, p.sh. porosia me postë, shitjen derë - më – derë, me anë të aparateve vetëshërbyese etj. (grupi 47.9).

Mallrat e shitura në këtë ndarje kufizohen në mallrat që zakonisht referohen si mallra të konsumit të gjerë apo mallra të shitjes me pakicë. Prandaj mallrat që nuk shiten përmes tregtisë me pakicë janë të përjashtuara nga kjo ndarje (p.sh. drithërat, xehet, makineritë industriale etj). Kjo ndarje gjithashtu përfshin njësitë të cilat kryesisht merren me shitjen e produkteve për popullatën , siç janë kompjuterët personal, produkte nga letra dhe materiale për shkrim, ngjyra apo materiale druri, edhe pse këto produkte mund të mos jenë për përdorim personal apo ekonomi familjare. Trajtimi që është i zakonshëm në tregti, nuk ndikon në karakterin bazik të mallit dhe mund të përfshijë: sortimin, ndarjen, përzierjen dhe paketimin.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin, shitjen me pakicë nga agjentët tregtar dhe aktivitetet e shtëpive të ankandit të shitjes me pakicë.

Kjo ndarje përjashton:

- shitjen e produkteve të fermerëve nga fermerët, shih ndarjen 01,
- prodhimin dhe shitjen e mallrave, që në përgjithësi klasifikohet si prodhim në ndarjet 10-32,
- shitjen e mjeteve motorike dhe pjesëve të tyre, shih ndarjen 45,
- tregtinë në prodhimet e grurit, xeheve, naftës së papërpunuar, kimikaleve industriale, hekurit, çelikut, makinerisë dhe pajisjeve industriale, shih ndarjen 46,
- shitjen e ushqimit dhe të pijeve për konsumim nëpër lokale dhe shitjen që merren me veti, shih ndarjen 56,
- dhënien me qira të mallrave personale dhe shtëpiake të publikut të gjerë, shih grupin 77.2.

## 47.1 Tregtia me Pakicë në Dyqane Jo të Specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të llojllojshme të linjave të produktit në të njëjtën njësi (shitore jo të specializuara), siç janë supermarketët apo shtëpitë e mallrave.

### 47.11 Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të mallrave të ndryshme nga të cilët mbizotrojnë produktet e ushqimit, pijet dhe duhani:
    - aktivitetet e shitoreve me mallra të përziera në të cilat , përveç produkteve të ushqimit, pijeve dhe duhanit, bëhet edhe shitja e mallrave tjera të ndryshme, siç janë rrobat, mobilet, pajisjet, mallra metalike, kozmetik etj.

### 47.19 Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të të mallrave të ndryshme, nga të cilët produktet e ushqimit, pijeve dhe duhanit, nuk janë mbizotëruese.

- aktivitetet e shtëpive të mallrave të cilat merren me shitjen e mallrave të ndryshme, përfshirë: rrobat, mobilet, pajisjet, mallra metalike, kozmetikën, stolitë, lodrat, artikujt sportiv, etj.

## 47.2 Tregtia me Pakicë e Produkteve Ushqimore, Pijeve dhe Duhanit, në Dyqane të Specializuara

### 47.21 Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të frutave dhe perimeve të freskëta,
- shitjen me pakicë të frutave dhe perimeve të përgatitura dhe të konservuara.

### 47.22 Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit (përfshirë të shpezëve).

### 47.23 Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe molusqeve (frutave te detit) në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të peshqve, ushqimit tjetër të detit dhe produkteve nga to.

### 47.24 Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara

### 47.25 Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë e pijeve (jo për konsumim nëpër lokale):
  - pijet alkoolike,
  - pijet jo alkoolike.

### 47.26 Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të duhanit,
- shitjen me pakicë të produkteve të duhanit.

### 47.29 Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të produkteve qumështore dhe të vezëve,
- shitjen me pakicë e produkteve tjera të ushqimit p.k.t.

## 47.3 Tregtia me Pakicë e Karburantit për Automjete, në Dyqane të Specializuar

### 47.30 Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të karburantit për mjetet motorike dhe motoçikletat.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- shitjen me pakicë të produkteve lubrifikuese dhe të produkteve të ftohjes për mjetet motorike.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me shumicë të karburanteve, shih 46.71,
- shitjen me pakicë të gazit të lëngët, të naftës, përzierje apo ngrohje, shih 47.78.

## 47.4 Tregtia me Pakicë e Pajisjeve Informatike dhe të Komunikimit, në Dyqane të Specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të pajisjeve teknologjike të informatikës dhe komunikimit (ICT), siç janë kompjuterët dhe pajisjet periferike, pajisjet e telekomunikimit dhe të elektronikës së konsumatorit nga shitoret e specializuara.

### 47.41 Tregtia me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të kompjuterëve,
- shitjen me pakicë të pajisjeve periferike të kompjuterëve,
- shitjen me pakicë të konzolave për video lojëra,
- shitjen me pakicë të softuerëve jo të ndryshuar, përfshirë video lojërat.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me pakicë të kasetave dhe disqeve të zbrazëta, shih 47.63.

### 47.42 Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në dyqane të specializuara

### 47.43 Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të pajisjeve të radio dhe televizorit,
- shitjen me pakicë të audio dhe video pajisjeve,
- shitjen me pakicë CD, DVD etj., radiorekorderëve dhe kasetofonave.

## 47.5 Tregtia me Pakicë e Pajisjeve të Tjera Shtëpiake në Dyqane të Specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të pajisjeve shtëpiake, siç janë tekstilet, harduerët, qilimat, instalimet elektrike apo mobilet, në shitoret e specializuara.

### 47.51 Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të pëlhurave,
- shitjen me pakicë të fillit për thurje,

- shitjen me pakicë të materialeve bazike për staza, tapiceri apo prodhimin e qëndisjeve,
- shitjen me pakicë të tekstileve,
- shitjen me pakicë të materialit për qepje: gjilpërave, perit të qepjes etj.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të veshjes, shih 47.71.

### 47.52 Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të harduerëve,
- shitjen me pakicë të ngjyrave, varnishave dhe llacëve,
- shitjen me pakicë të xhamit të rrafshët,
- shitjen me pakicë materialit tjetër ndërtimore, siç janë tullat, druri, pajisjet sanitare,
- shitjen me pakicë e materialit dhe pajisjeve për punë personale.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me pakicë të makinave kositëse, sido që të jenë të operuara,
- shitjen me pakicë të saunave.

### 47.53 Shitja Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë e qilimave dhe stazave,
- shitjen me pakicë të perdeve dhe perdeve rrjetë,
- shitjen me pakicë e tapetave të murit dhe materialit për dysheme.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të pllakave të tapës për dysheme, shih 47.52.

### 47.54 Tregtia me pakicë e pajisjeve elekroshtëpiake në dyqane të specializuara

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të audio dhe video pajisjeve, shih 47.43.

### 47.59 Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiakë, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë e mobileve shtëpiake,
- shitjen me pakicë të artikujve për ndriçim,
- shitjen me pakicë të enëve të kuzhinës për shtëpi dhe të takëmeve, të fajancave, artikujve të qelqit, porcelanit dhe të poçerisë,
- shitjen me pakicë të mallrave të drurit të tapes dhe artikujt e shportarisë,
- shitjen me pakicë e instalimeve jo elektrike shtëpiake,
- shitjen me pakicë e instrumenteve dhe partiturave,
- shitjen me pakicë të sistemeve elektrike të alarmeve të sigurisë, siç janë mjetet e kyçjes, kasafortat, dhe qemerëve, pa shërbimet e instalimit apo të mirëmbajtjes,
- shitjen me pakicë të artikujve dhe pajisjeve shtëpiake p.k.t

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të artikujve të antikës, shih 47.79

## 47.6 Tregtia me Pakicë e Mallrave Kulturore dhe të Argëtimit, në Dyqane të Specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë në shitoret e specializuara të artikujve kulturor dhe rekreativ, siç janë, librat, gazetat, incizimet muzikore dhe video, pajisjet sportive, lojërat dhe lodrat.

### 47.61 Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të librave të të gjitha llojeve.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të librave të përdorura apo të antikës, shih 47.79.

### 47.62 Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të furnizimeve të zyrës, siç janë lapsat kimik, lapsat e thjeshtë, letra etj.

### 47.63 Tregtia me pakicë e incizimeve muzikore dhe videove, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të pllakave muzikore audio kasetave, komapkt disqet dhe kasetat,
- shitjen me pakicë të video kasetave dhe DVD.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

shitjen me pakicë të kasetave dhe disqeve të zbrazëta.

### 47.64 Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të artikujve sportive, pajimet e peshkimit (takëme), artikujt e kampingut, barkat dhe biçikletat.

### 47.65 Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të lojërave dhe lodrave, të prodhuar nga të gjitha materialet.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të konzolave për video lojëra, shih 47.41,
- shitjen me pakicë të softuerëve jo të ndryshuar, përfshirë video lojërat, shih 47.41.

## 47.7 Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen nëpër shitore të specializuara që mbajnë linjën e veçantë të produkteve, jo të futur në pjesë tjera të klasifikimit, siç janë veshjet, veshmbathjet dhe artikujt e lëkurës, mallrat farmaceutik dhe medicinal, orët, suverinët, materialet e pastrimit, armët e zjarrit, lulet dhe kafshët

përkëdhelëse si dhe të tjerat. Këtu futet gjithashtu shitja me pakicë e mallrave të përdorur në shitoret e specializuara.

### 47.71 Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të artikujve të veshjeve,
- shitjen me pakicë të artikullit nga gëzofi,
- shitjen me pakicë të pjesëve ndihmëse të veshjes, siç janë dorëzat, kravatat, mbërtheckat, etj.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me pakicë të tekstileve, shih 47.51.

### 47.72 Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të veshmbathjes,
- shitjen me pakicë të artikujve të lëkurës,
- shitjen me pakicë të aksesorëve të udhëtimit nga lëkura dhe zëvendësuesve të lëkurës.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me pakicë të pajisjeve speciale të veshmbathjes sportive, siç janë çizmet e skijimit, shih 47.64.

### 47.73 Tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të farmaceutikëve.

### 47.74 Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara

### 47.75 Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të artikujve të parfumerisë, kozmetikës dhe tualetit.

### 47.76 Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara

### 47.77 Tregtia me pakicë e orëve dhe argjentarisë në dyqane të specializuara

### 47.78 Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të pajisjeve fotografike, optike dhe precize,
- aktivitetet e shitoreve të optikës (syzave),
- shitjen me pakicë të suvenirëve, punimet e xeheve dhe artikujve fetar,
- aktivitetet rreth galerive komerciale të artit ,
- shitjen me pakicë të lëndës djegëse për amvisëri (naftës si lëndë djegëse), gazit në shishe, thëngjillit dhe drurit për djegie,
- shitjen me pakicë të armëve të zjarrit dhe municionit,
- shitjen me pakicë e pullave postare dhe parave të metalta,

- shërbimet rreth tregtisë me pakicë për galeritë komerciale të artit,
- shitjen me pakicë të produkteve jo ushqimore n.e.c.

### 47.79 Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të librave të përdorura,
- shitjen me pakicë të mallrave tjerë të përdorur,
- shitjen me pakicë të gjësendeve antike,
- aktivitetet e shtëpive të ankandeve (shitje me pakicë).

Kjo klasë përjashton:
- shitjen me pakicë të mjeteve motorike të përdorura, shih 45.1,
- aktivitetet e ankandeve në internet dhe ankandeve tjerë jashtë shitoreve (shitje me pakicë), shih 47.91, 47.99,
- aktivitetet e shitoreve me garanci, shih 64.92.

## 47.8 Tregtia me Pakicë përmes Tezgave dhe Tregjeve

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të çdo lloji të produktit të ri apo të përdorur në një tezgë, zakonisht lëvizëse ose përgjatë një rruge publike, apo e vendosur në vendin e tregut.

### 47.81 Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të ushqimit të përgatitur për konsumim të menjëhershëm (shitësit mobil të ushqimit), shih 56.10.

### 47.82 Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve

### 47.89 Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të mallrave të tjera

Kjo klasë përfshin:
- shitjen me pakicë të artikujve tjerë nëpërmjet tezgave apo tregjeve siç janë:
  - qilimat dhe të gjitha llojet e tjera të tepihëve,
  - librat,
  - lojërat dhe lodrat,
  - pajisjet shtëpiake dhe pajisje elektronike për përdorim të gjerë
  - incizimet muzikore dhe videot.

## 47.9 Tregtia me Pakicë Jo në Dyqane, Tezga ose Tregje

Ky grup përfshin aktivitetet e shitjes me pakicë me anë të porosive postare, nëpërmjet internetit, nëpërmjet shitjeve derë më derë , makinave shitëse etj.

### 47.91 Tregtia me pakicë me porosi nëpërmjet postës ose internetit

Kjo klasë përfshin aktivitetet e shitjes me pakicë nëpërmjet porosive postare, apo nëpërmjet internetit, d.m.th aktivitetet e shitjes me pakicë ku blerësi e bën zgjedhjen e tij në bazë të reklamimeve,

katalogëve, informatave të siguruara në ueb-faqe, apo ndonjë formë tjetër të reklamimit. Blerësi e bënë porosinë e tij nëpërmjet postës, telefonit apo nëpërmjet internetit (zakonisht nëpërmjet formave të veçanta të porositjes të siguruara nga ueb-faqja). Produktet e blera direkt mund të shkarkohen nga interneti, apo fizikisht t'i dorëzohen konsumatorit (porositësit).
Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të çdo lloj produkti me anë të porosisë postare,
- shitjen me pakicë të çdo lloj produkti nëpërmjet internetit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen direkt nëpërmjet televizionit, radios dhe telefonit,
- ankandet e shitjes nëpërmjet internetit.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të mjeteve motorike dhe të pjesëve dhe aksesorëve të tyre nëpërmjet internetit, shih grupet 45.1, 45.3,
- shitjen me pakicë të motoçikletave, pjesëve dhe aksesorëve të tyre nëpërmjet internetit, shih 45.40.

### 47.99 Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të mallrave të ndryshme të pa përfshira në klasat e mëparshme:
  - me anë të shitjeve direkt apo të personave shitës derë më derë,
  - nëpërmjet aparateve vetëshërbyese të shitjes etj.
- shitjen direkt të lëndëve djegëse (naftës për ngrohje, të drurit të zjarrit, etj.), dërguar konsumatorëve,
- aktivitetet e ankandeve jasht shitoreve (lidhur me tregtinë me pakicë ),
- shitjen me pakicë me anë të agjentëve tregtare (jo në shitore).

# Sektori H – TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI

Ky sektor përfshin sigurimin e transportit të pasagjerëve dhe të mallit, të planifikuar apo jo, me anë të hekurudhës, tubacioneve, transportit rrugor, ujor apo ajror si dhe aktivitetet përcjellëse, siç janë objektet e terminalit dhe të parkingut, trajtimi i dërgesave kargo, magazinimi etj. Në këtë sektor përfshihet edhe dhënia me qira e mjeteve të transportit me shofer apo operator. Këtu, gjithashtu përfshihen aktivitetet postare dhe të korrierit.

Ky sektor përjashton:

- riparimin apo alternimin esencial të mjetit trasportues, përveç mjeteve motorike, shih grupin 33.1,
- ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve, hekurudhave,limaneve, aeroporteve, shih ndarjen 42,
- mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike, shih 45.20,
- dhënien me qira të mjeteve të transportuese pa shofer apo operator, shih 77.1, 77.3.

## 49 Transporti Tokësor dhe Transporti përmes Tubacioneve

Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve dhe të mallrave, nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor si dhe transportit të mallrave nëpërmjet gypave / tubacioneve.

## 49.1 Transporti Hekurudhor Ndërurban i Pasagjerëve

### 49.10 Transporti hekurudhor ndërurban i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportimin e pasagjerëve në hekurudhë duke përdorur vagonët hekurudhor në rrjetat e linjave kryesore, të shpërndarë në zonat e mëdha gjeografike,
- transportimi i pasagjerëve me anë të linjave hekurudhore interurbane,
- operacioni i vagonëve të fjetjes apo të hajes,
- restoranteve, si operacion i integruar i kompanive hekurudhore.

Kjo klasë përjashton:

- transportin e pasagjerëve me anë të sistemeve urbane dhe sistemeve tranzitore nën urbane, shih 49.31,
- aktivitetet e terminalit të pasagjerëve, shih 52.21,
- operacionet e infrastrukturës hekurudhore, aktivitetet lidhur me manovrimin dhe spostimin, shih 52.21,
- operacioni rreth vagonëve të fjetjes dhe vagonëve të restorantit, kur operohen nga njësitë e ndara, shih 55.90, 56.10.

## 49.2 Transporti Hekurudhor i Mallrave

### 49.20 Transporti hekurudhor i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportimi i mallrave nëpërmjet rrjetave të linjave kryesore të hekurudhave si dhe transportin e mallrave nëpërmjet linjave të shkurtra hekurudhore.

Kjo klasë përfshin:

- deponimin dhe magazinimin, shih 52.10,
- aktivitetet rreth terminalit të mallrave, shih 52.21,
- operacionet e infrastrukturës hekurudhore, aktivitetet lidhur me manovrimin dhe spostimin, shih 52.21,
- trajtimi i ngarkesës së transportit kargo, shih 52.24.

## 49.3 Transporti Tjetër Rrugor i Pasagjerëve

Ky grup përfshin të gjitha aktivitetet e transportit tokësor të pasagjerëve, ndryshe nga transporti hekurudhor. Megjithatë, transporti hekurudhor si pjesë e sistemeve të transportit urban apo nën-urban, është përfshirë në këtë grup.

### 49.31 Transporti rrugor urban dhe ndërurban i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin tokësor të pasagjerëve, me anë të sistemeve të transportit urban apo nën-urban. Kjo klasë mund të përfshijë mënyra të ndryshme të transportit tokësor, siç janë transporti me autobus, tramvaj, trolejbus, me metro dhe hekurudhë të mbingritur etj. Transporti bëhet në bazë të rrugëve të projektuara, duke ndjekur një orar të kohës së saktë, duke u kujdesur në marrjen dhe lëshimin e pasagjerëve nëpër stacionet e fiksuara.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- linjat nga qyteti në aeroport, apo nga qyteti në stacion,
- operacioni i hekurudhave me kabllo, teleferiku ajror etj., nëse janë pjesë e sistemit të transitit urban, apo nën-urban.

Kjo klasë përjashton:

- transportin e pasagjerëve me anë të hekurudhave interurbane, shih 49.10.

### 49.32 Aktiviteti i taksive

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- qiradhënien tjetër të veturave private me shofer.

### 49.39 Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- transportin tjetër rrugor të pasagjerëve:
  - shërbimet e autobusëve në orar të distancave të gjata,
  - charter,
  - ekskursionet dhe shërbime tjera të rastësishme me autobus në distance të gjata, autobusët e aeroportit;

- operacioni i teleferikut kabllovik, ski-lifteve dhe me kabllo, nëse nuk janë pjesë e sistemit të transitit urban apo nën-urban.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- operacionin e autobusëve shkollor dhe autobusëve për transportin e punonjësve,
- transportin e pasagjerit nga njeriu ose mjetet e tërhequra nga kafshët.

Kjo klasë përjashton:

- transportim e ambulancave, shih 86.90.

## 49.4 Transporti Rrugor i Mallrave dhe Shërbimet e Zhvendosjes

Ky grup përfshin të gjitha aktivitetet e transportin tokësor të ngarkesave ndryshe, nga transporti hekurudhor.

### 49.41 Transporti rrugor i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- të gjitha operacionet e transportit rrugor të ngarkesave:
  - shpenzimin e regjistrimit,
  - shpenzimi i magazinimit,
    shpenzimi i frigoriferit,
  - shpenzimin e peshës së rëndë,
  - shpenzimin e ngarkesës së mallit, përfshirë shpenzimin në kamionët cisterna, përfshirë grumbullimin e qumështit nëpër ferma,
  - shpenzimin e automobilave, transportin e mbeturinave dhe materialeve të tyre, pa grumbullimin apo asgjësimin.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të kamionëve me shoferë,
- transportimin e mallit nga njeriu apo mjetet e tërhequra nga kafshët.

Kjo klasë përjashton:

- shpenzimin e regjistrimit në kuadër të pyllit, si pjesë e operacioneve të regjistrimit, shih 02.40.
- shpërndarjen e ujit me mauna, shih 36.00,
- operacionin i objekteve të terminalit për trajtimin e ngarkesës, shih 52.21,
- aktivitetet e ambalazhimit dhe të paketimit për transport, shih 52.29,
- aktivitetet postare dhe të korrierit, shih 53.10, 53.20,
- transportimi i mbeturinave si pjesë e integruar e aktiviteteve për grumbullimin e mbeturinave, shih 38.11, 38.12.

### 49.42 Shërbimet e zhvendosjes

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e zhvendosjes së bizneseve dhe ekonomive shtëpiake me anë të transportit rrugor.

## 49.5 Transporti përmes Tubacioneve

### 49.50 Transporti përmes tubacioneve

Kjo klasë përfshin:

- transportin e gazrave, lëngjeve, të ujit, llaçeve të ujshëm dhe të artikujve tjerë, nëpërmes gypave.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- funksionimin e stacioneve të pompave.

Kjo klasë përjashton:

- distribuimin e gazit, avullit, ujit natyral apo të prodhuar, shih 35.22, 35.30, 36.00.
- transportimin e likuideve me anë të kamionëve, shih 49.41.

# 50 Transporti Ujor

Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve, apo të mallrave nëpër ujë, qoftë të planifikuar apo jo. Në këtë ndarje janë të përfshira gjithashtu operacioni i barkave për tërheqje apo shtytjen të rimorkiove, të barkave për ekskursion, barkave për lundrim, apo të vizituarit e monumenteve historike, ferribotat, taksitë e ujit etj. Edhe pse lokacioni është një indikator për ndarjen mes transportit ujor në det dhe në brendi të tokës, faktori i vendosjes, është lloji i anijes së përdorur. Transporti me lundra në ujë është i klasifikuar në grupet 50.1 dhe 50.2, ndërsa transporti që përdor lundra tjera është klasifikuar në 50.3 dhe 50.4.

Kjo ndarje përjashton aktivitetet e restoranteve dhe barkave në anijet (shih 56.10, 56.30), nëse këto aktivitete kryhen nga njësitë e ndara.

## 50.1 Transporti Detar dhe Bregdetar i Pasagjerëve

Ky grup përfshin transportin e pasagjerëve në lundra të projektuara për operim në ujërat e detit, apo bregdetare. Këtu gjithashtu përfshihet edhe transporti i pasagjerëve nëpër liqet e mëdhenj etj., ku përdoren të njëjtat lloje të lundrave.

### 50.10 Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin e pasagjerëve nëpër ujëra e detit dhe bregdetare, të planifikuara apo jo:
  - funksionimin e barkave për ekskursione,
  - lundrimeve apo të vizitave të monumenteve historike, funksionimin e ferribotave,
  - taksive të ujit etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të barkave për kënaqësi, me ekip për transport ujor nëpër det dhe përgjatë bregdetit (p.sh. të lundrimeve për peshkim).

Kjo klasë përjashton:

- aktivitet e restoranteve dhe bareve nëpër anije, kur këto aktivitet sigurohen nga njësitë e veçanta, shih 56.10, 56.30,
- dhënien e barkave dhe jahteve për argëtim pa ekip, shih 77.21,
- dhënin me qira të anijeve apo barkave komerciale pa ekip, shih 77.34,
- operacioni i “kazinove lundruese”, shih 92.00.

## 50.2 Transporti Detar dhe Bregdetar i Mallrave

Ky grup përfshin transportin e mallrave nëpër lundra, të projektuara për funksionim në ujërat e detit apo bregdetare. Gjithashtu përfshihet edhe transporti i mallrave nëpër liqet e mëdhenj etj., kur përdoren lundrat e llojeve të ngjashme.

### 50.20 Transporti detar dhe bregdetar i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallit nëpër ujërat e deteve dhe bregdetare, qoftë të planifikuar apo jo,

- transportin me anë të tërheqjes apo shtytjes të maunave, karteleve të naftës etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të lundrave me ekip për transport të mallrave nëpër ujëra të detit apo bregdetare.

Kjo klasë përjashton:

- deponimin e mallrave, shih 52.10,
- funksionimin e limanit dhe aktivitet tjera ndihmëse, siç janë futja në dok (skele), pilotimi, bartjen me maunë, ngarkimi i lundrës, shih 52.22,
- trajtimi i ngarkesës, shih 52.24,
- dhënia me qira e anijeve apo barkave komerciale pa ekip, shih 77.34.

## 50.3 Transporti i Brendshëm Ujor i Pasagjerëve

Ky grup përfshin transportin e pasagjerëve nëpër ujërat e brendshëm të vendit, përfshirë lundrat që nuk janë të përshtatshme për transport detar.

### 50.30 Transporti i brendshëm ujor i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin e pasagjerëve nëpër lumenj, kanale, liqe dhe ujëra tjerë të lundrueshëm në brendësi të vendit, përfshirë limanet dhe portet e brendshëm.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të barkave të argëtimit me ekip, për transport ujor në brendësi të vendit.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të barkave dhe jahteve të argëtimit pa ekip, shih 77.21.

## 50.4 Transporti i Brendshëm Ujor i Mallrave

Ky grup përfshin transportin e mallrave nëpër ujërat e brendësisë, përfshirë lundrat që nuk janë të përshtatshme për transport detar.

### 50.40 Transporti i brendshëm ujor i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallrave nëpër lumenj, kanale, liqe dhe rrugë tjera lundruese.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të lundrave me ekip për transport ujor të mallrave në brendësi të vendit.

Kjo klasë përjashton:

- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24,
- dhënien me qira të anijeve apo barkave komerciale pa ekip, shih 77.34.

# 51 Transporti Ajror

Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve apo të mallrave, nëpërmjet ajrit apo hapësirës.

Kjo ndarje përjashton:

- spërkatjen e të korrave, shih 01.61,
- kontrollimi i përgjithshëm i aeroplanëve apo motorëve të aeroplanëve, shih 33.16,
- operacioni i aeroporteve, shih 52.23,
- reklamimi ajror (të shkruarit në qiell), shih 73.11,
- fotografimi në ajër, shih 74.20.

## 51.1 Transporti Ajror i Pasagjerëve

### 51.10 Transporti ajror i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin ajror të pasagjerëve nëpërmes rrugëve të rregullta në orare të rregullta,
- fluturime të çarter të pasagjerëve,
- fluturimet skenike dhe turistike.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të mjeteve të transportit ajror me operato, për qëllime të transportimit të udhëtarëve,
- aktivitete e përgjithshme të aviacionit, siç janë: transporti i pasagjerëve me aeroklube për instruksione apo argëtim.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të mjeteve të transportit ajror pa operator, shih 77.35.

## 51.2 Transporti Ajror i Mallrave dhe Transporti Hapësinor

### 51.21 Transporti ajror i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallrave nëpërmes vijave të rregullta ajrore në orare të rregullta, transporti ajror i mallrave pa orar.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të mjeteve të transportit ajror me operator, për qëllim të transportimit të mallrave.

### 51.22 Transporti hapësinor

Kjo klasë përfshin:

- lansimin e sateliteve dhe fluturakeve hapësinore,
- transportin hapësinor të mallrave dhe pasagjerëve

# 52 Magazinimi dhe Aktivitetet Mbështetëse për Transport

Kjo ndarje përfshin aktivitet e magazinimit të përkrahjes për transport, siç është operimi i infrastrukturës transportuese (p.sh. aeroporteve, limaneve, tuneleve, urave, etj.), aktivitetet e agjencive të transportit dhe të trajtimit të ngarkesave.

## 52.1 Magazinimi dhe Ruajtja

### 52.10 Magazinimi dhe ruajtja

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e objekteve të ruajtjes dhe magazinimin për të gjitha llojet e mallrave:
    - operacioni e silosve të drithërave,
    - depot e mallrave të përgjithshme,
    - depot me frigoriferë,
    - cisternat e ruajtjes etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ruajtjen e mallrave në zonat e jashtme tregtare,
- ngrirje me rrymim ajri.

Kjo klasë përjashton:

- objektet e parkimit për mjetet motorike, shih 52.21,
- funksionimin e objekteve të vetë-ruajtjes, shih 68.20,
- dhënia me qira e hapësirës së zbrazët, shih 68.20.

## 52.2 Aktivitete Mbështetëse për Transport

Ky grup përfshin aktivitetet përkrahëse për transportimin e pasagjerëve apo mallrave, siç janë operacioni i pjesëve të infrastrukturës transportuese, apo aktiviteteve lidhur me trajtimin e mallrave menjëherë, para transportit, apo në mes të segmenteve transportuese. Këtu përfshihet operacioni dhe mirëmbajta e të gjitha objekteve të transportit.

### 52.21 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor

Kjo klasë përfshin:

- aktivitete lidhur me transportin tokësor të pasagjerëve, të kafshëve apo të mallrave:
    - funksionimin e objekteve të terminalit siç janë, stacionet e hekurudhore, stacionet e autobusit, stacionet për trajtimin e mallrave,
    - operacionet e infrastrukturës hekurudhore,
    - operacionet e rrugëve, urave, tuneleve, auto-parkingjeve apo garazheve, parkingjet e biçikletave, ruajtjen dimërore të karvanëve;
- ndërruesi dhe manovruesi i shinave të trenit,
- asistenca përskaj rrugës dhe tërheqjes së mjeteve.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- lëngëzimin e gazit për qëllime transportuese.

Kjo klasë përjashton:
- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24.

### 52.22 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin ujor

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet lidhur me transportin ujor të pasagjerëve, kafshëve apo mallrave:
  - funksionimin e objekteve terminale, siç janë limanet dhe skelet,
  - funksionimi i bllokuesve të rrjedhave të ujit etj.,
  - navigacionin, pilotimin dhe aktivitetet e vend-ankorimit,
  - bartja e mallit, aktivitetet e ngarkimit,
  - aktivitetet e fanarit.

Kjo klasë përjashton:
- trajtimin e ngarkesave, shih 52.24,
- funksionimin e marinave, shih 93.29.

### 52.23 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin ajror

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet lidhur me transportin ajror të pasagjerëve, kafshëve, apo mallrave:
  - funksionimin e objekteve të terminalit, siç janë terminalët e aeroporteve etj.,
  - aktivitetet e kontrollit të aeroporteve dhe të trafikut ajrorë,
  - aktivitetet e shërbimit në tokë nëpër aeroporte.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- shërbimet në mbrojtjen nga zjarri dhe fikjen e zjarrit në aeroporte.

Kjo klasë përjashton:
- trajtimi i ngarkesave, shih 52.24,
- operacioni i shkollave të fluturimit shih 25.23.

### 52.24 Trajtimi i transportit "cargo"

Kjo klasë përfshin:
- ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të valixheve të pasagjerëve, pavarësisht mënyrës së transportit të përdorur,
- punëtorët e shkarkimit, ngarkimin dhe shkarkimin e vagonëve hekurudhorë të mallrave.

Kjo klasë përjashton:
- funksionimin e objekteve të terminalit, shih 52.21, 52.22 dhe 52.23.

### 52.29 Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit

Kjo klasë përfshin :
- dërgimin e mallrave,
- aranzhimin apo organizimin e operacioneve të transportit ajror, rrugor, detar,
- organizimin e kontingjenteve grupore apo individuale (përfshirë marrjen dhe dorëzimin e mallrave dhe grupimin e dërgesave / kontingjenteve),
- lëshimi dhe prokurimi i dokumenteve dhe pagesave të transportit dhe faturave të mallrave,
- aktivitetet e agjenteve të doganave,
- aktivitetet e dërguesve detar të mallrave dhe agjenteve të ngarkesave ajrore,

- ndërmjetësimi për hapësirën e anijeve dhe aeroplanëve,
- operacioni e trajtimit të mallrave, p.sh. ambalazhimin e përkohshëm për të vetmin qëllim të mbrojtjes të mallrave gjatë transitit, hapja e ambalazhit, mostrimi dhe matja e mallrave.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e korrierit, shih 53.20,
- dhënia e sigurimeve për transportin motorik, detar dhe të aviacionit, shih 65.12,
- aktivitetet e agjencive të udhëtimeve, shih 79.11,
- aktivitetet e operatorëve të turneve, shih79.12,
- aktivitetet e asistentëve turistik, shih 79.90.

# 53 Aktivitetet Postare dhe të Ndërlidhjes Postare

Kjo ndarje përfshin aktivitetet postare dhe të korrierit, siç është marrja, transporti dhe dërgimi i letrave dhe paketave sipas marrëveshjeve të ndryshme. Në këtë ndarje janë të përfshira edhe shërbimet e dërgimit lokal dhe të porosive tjera.

## 53.1 Aktivitetet e Postave në Ofrimin e Shërbimeve të Përgjithshme

### 53.10 Aktivitetet e postave me në ofrimin e shërbimeve të përgjithshme

Kjo klasë përfshin aktivitetet e ofrimit të shërbimeve të përgjithshme postare të ushtruara nga një apo më tepër ofrues. Shërbimet përfshijnë shfytzimin rrjetit unik postar, , përfshirë lokacionet e shitjes me pakicë, objektet e sortimit dhe të procesimit dhe rrugët e bartjes për të marrë dhe shpërndarë postën. Shpërndarja mundë të përfshijë postimin e letrave, d.m.th. të letrave, kartolinave, letrat të shtypura (gazetat, periodikët, artikujt reklamues etj.). Pako të vogla të mallrave apo dokumente. Këtu përfshihen gjithashtu, shërbimet tjera të nevojshme për të mbështetur obligimin e shërbimit universal.

Kjo klasë përfshin:

- marrjen, sortimin, transportin dhe shpërndarjen e letrave postare (vendore apo ndërkombëtare), llojin e postës, pakot dhe paketimin me anë të shërbimeve postare, që funksionojnë në bazë të shërbimit dhe obligimit. Këtu mund të përfshihen një apo më tepër mënyra të transportit dhe aktiviteti mund të kryhet me transportin e vet personal (privat), apo nëpërmes të transportit publik
- grumbullimin e letrave postare dhe të pakove nga kutitë publike të letrave, apo zyrat e postave.

Kjo klasë përjashton:

- xhirollogaritë postare dhe aktivitetet e kursimit postar dhe aktivitetet e dërgimit të parave, shih 64.19.

# 53.2 Aktivitetet e Tjera Postare dhe të Ndërlidhjes

## 53.20 Aktivitetet e tjera postare dhe të ndërlidhjes

Kjo klasë përfshin:

- marrjen, sortimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare (vendore apo ndërkombëtare ) dhe llojin e dërgesës të pakove dhe të paketimeve nga ana e firmave që operojnë jashtë fushëveprimit të obligimit të shërbimit universal, mund të përfshihen një apo më tepër mënyra të transportit dhe aktiviteti mund të kryhet me transportin e vet personal (private) apo nëpërmes transportit publik.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shërbimet e dërgimeve nëpër shtëpi.

Kjo klasë përjashton:

- transportin e mallrave sipas mënyrës së transportit 49.20, 49.41, 50.20, 50.40, 51.21, 51.22.

# Sektori I – AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR

Ky sektor përfshin sigurimin e akomodimit të qëndrimit të shkurtër për vizitorët dhe udhëtarët të tjerë si dhe sigurimin e ushqimeve dhe pijeve komplete të përshtatshme për konsum të menjëhershëm. Sasia dhe lloji i shërbimeve plotësuese të siguruara brenda këtij sektori, mund të ndryshojnë gjerësisht.

Ky sektor përjashton sigurimin e akomodimit afatgjatë si vendbanim primar, i cili është i klasifikuar në aktivitetet e patundshmërisë, (Sektori L). Këtu gjithashtu përjashtohet përgatitja e ushqimit apo pijeve, të cilat nuk janë të përshtatshme për konsumim të menjëhershëm, apo që janë shitur nëpërmjet kanaleve të distribuimit të pavarur, d.m.th. nëpërmes aktivitetet të shitjes me shumicë apo me pakicë. Përgatitja e këtyre ushqimeve, është klasifikuar në prodhim (Sektori C).

## 55 Akomodimi

Kjo ndarje përfshin sigurimin dhe akomodimin e qëndrimit të shkurtër për vizitorë dhe udhëtarët tjerë. Këtu përfshihen gjithashtu, sigurimi i akomodimit të afateve më të gjata për studentet punëtorë dhe individët e ngjashëm. Disa njësi mund të sigurojnë vetëm akomodim, ndërsa të tjerët sigurojnë kombinimin e akomodimit, ushqimeve ose objekteve rekreative.

Kjo ndarje përjashton, aktivitetet lidhur me sigurimin e vendbanimeve primare afatgjate në objektet, siç janë apartamentet që në mënyrë tipike jepen me qira në bazë mujore apo vjetore të klasifikuara në (Sektorin L) të patundshmërisë (Sektorin L).

## 55.1 Hotelet dhe Akomodimi i Ngjashëm

### 55.10 Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm

Kjo klasë përfshin sigurimin e akomodimit, në bazë ditore apo javore, kryesisht për qëndrimet e shkurtra nga vizitorët. Kjo përfshin sigurimin e akomodimit të mobiluar nëpër dhomat e mysafirëve dhe suitave - apartamenteve. Shërbimet përfshijnë, pastrimin ditor dhe rregullimin e shtretërve. Mund të sigurohet një numër e shërbimeve shtesë, siç janë: shërbimet e ushqimeve dhe të pijeve, parkimit, dhe shërbimet e larjes së rrobave, pishinat dhe sallat e ushtrimeve, objektet rekreative si dhe objektet e konferencave dhe konventave.

Kjo klasë përfshin akomodimin e siguruar:

- hotelet,
- hotelet e vendeve turistike,
- hotelet me apartamente/suita,
- motelet.

Kjo klasë përjashton:

- Sigurimin e shtëpive dhe të banesave të mobiluara ose jo të mobiluara,

- apo të apartamenteve për shfrytëzimi më permanent, në mënyrë tipike në bazë mujore apo vjetore, shih ndarjen 68.

## 55.2 Pushimet dhe Akomodimet e Tjera me Qëndrim të Shkurtër

### 55.20 Pushimet dhe akomodimet e tjera me qëndrim të shkurtër

Kjo klasë përfshin, sigurimin e akomodimit në mënyrë tipike në bazë ditore apo javore, kryesisht për qëndrime të shkurta nga vizitorët, në hapësirën e vet personale, që përbëhet nga dhomat e mobiluara komplete, plotësisht apo zonat për banim, ngrënie dhe fjetje, me objektet e zierjes apo kuzhinat të pajisura plotësisht. Këto mund të jenë në formë të apartamenteve nëpër ndërtesa shumëkatëshe për qëndrim të lirë, të blloqeve të ndërtesave, apo të bungallove njëkatëshe, të shtëpive malore, të vilave dhe kabinave. Këtu mund të sigurohen shumë pak shërbime plotësuese.

Kjo klasë përfshin akomodimin e siguruar nga:

- shtëpitë për fëmijët dhe shtëpitë e festave tjera,
- banesat dhe bungallët e vizitorëve, vilat dhe kabinat pa shërbime të mirëmbajtjes shtëpiake,
- dhomat e rinisë dhe strehimet malore.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e akomodimit të mobiluar për qëndrim të shkurtër bashkë me pastrimin ditor, rregullimin e shtretërve, shërbimet e ushqimit dhe të pijeve, shih 55.10,
- sigurimin e shtëpive dhe banesave të mobiluara apo jo të mobiluara, të apartamenteve për qëndrim më të gjatë, në mënyrë tipike në bazë mujore apo vjetore, shih ndarjen 68.

## 55.3 Kampingjet, Parqet me Mjete Rekreative dhe me Rimorkio

### 55.30 Kampingjet, parqet me mjete rekreative dhe me rimorkio

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e akomodimit në terrenet e kampit, parqeve të rimorkiove, kampet rekreative si dhe kampet e peshkimit dhe të gjuetisë, për vizitorëve me qëndrim të shkurtër,
- sigurimin e hapësirës dhe të objekteve, ndërtesave për mjetet rekreative.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- akomodimin e siguruar nga strehimoret mbrojtëse, apo të pajisjeve për vendosjen e tendave ose të thasëve të fjetjes.

Kjo klasë përjashton:

- strehimoret malore, kabinat dhe dhomat e të rinjve, shih 55.20.

## 55.9 Akomodime të Tjera

### 55.90 Akomodime të tjera

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e akomodimit të përkohshëm apo afatgjatë në dhoma të vetme, apo për më tepër persona, apo të dhomave të studentëve për punëtorët migrues (sezonal) dhe individët tjerë.

Kjo klasë përfshin:

- vendbanimet e studentëve,
- konviktet shkollore,
- dhomat e punëtorëve,
- shtëpitë me dhoma dhe sigurim të ushqimit,
- vagonët e fjetjes të hekurudhave.

-

# 56 Aktivitetet Shërbyese të Ushqimit dhe Pijeve

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e shërbimeve të gjellëve dhe pijeve, duke siguruar ushqimet dhe pijet komplete të përshtatshme për konsum të menjëhershëm nëpër restorante tradicional, restorante vetshërbyes, apo marrjes me vete, në stenda të përhershme apo të përkohshme, me ulëse apo pa ulëse. Me rëndësi është fakti, se ushqimet e përshtatshme me konsumim të menjëhershëm ofrohen dhe jo lloji i objektit që i siguron ato.

Këtu përjashtohet prodhimi i gjellëve jo të përshtatshme për konsumim të menjëhershëm, jo të planifikuara, për të konsumuar menjëherë, apo të gjellës së përgatitur, i cili nuk konsiderohet të jetë gjellë, (shih ndarjet 10: prodhimi i produkteve të ushqimit dhe 11: prodhimi i pijeve). Gjithashtu, përjashtohet shitja e ushqimit jo e vetprodhuar që nuk konsiderohet të jetë gjellë apo të gjellëve që nuk janë të përshtatshme për konsumim të menjëhershëm (Sektori G: tregtia me shumicë dhe pakicë).

## 56.1 Restorantet dhe Aktivitetet Shërbyese Lëvizëse të Ushqimit

### 56.10 Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit

Kjo klasë përshinë sigurimin e shërbimeve të ushqimit për myshterinjtë, qoftë ata që janë shërbyer deri sa janë të ulur apo shërbehen vetë nga vitrina e artikujve, pa dallim nëse ata hanë gjella të përgatitura në lokal, i marrin ato me vete, apo i dorëzohen atyre. Kjo përfshin përgatitjen dhe shërbimin e gjellëve për konsumim të menjëhershëm nga mjete e motorizuara, apo karrocat jo të motorizuara.

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- restoranteve,
- kafeneve,
- restoranteve “fastfood”,
- të marrjes së ushqimit me veti,
- të akullorë shitëse ,
- të karrocave mobile të ushqimit,
- përgatitjen e ushqimit në tezgat e tregut.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e restorantit dhe të barit lidhur me transportimin, kur ato kryhen nga njësit e veçanta.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen me pakicë të ushqimit nëpërmjet makinave shitëse, shih 47.99,
- funksionimin e koncesionit të objekteve të ushqimit, shih 56.29.

## 56.2 Furnizimi me Ushqim me Porosi për Raste dhe Shërbime të Tjera Ushqimore

Ky grup përfshin aktivitetet e furnizimit të ushqimit për raste individuale, apo për një periudhë kohe të saktësuar dhe funksionimin e koncesioneve të ushqimit, siç janë objektet sportive apo të ngjashme.

### 56.21 Furnizimi me ushqim me porosi për raste

Kjo klasë përfshin, sigurimin e shërbimeve të ushqimeve bazuar në aranzhimet kontraktuese me myshteriun, në lokacionin e saktësuar nga myshteriu, për një rast specifik.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e artikujve ushqimor të prishshëm për rishitje, shih 10.89,
- shitje me pakicë të artikujve ushqimor të prishshëm, shih ndarjen 47

### 56.29 Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit

Kjo klasë përfshin, furnizimin industrial të ushqimit, d.m.th. sigurimin e shërbimit të ushqimit bazuar në aranzhimet kontraktuese me myshteriun për një periudhë kohe të caktuar. Gjithashtu, përfshihet funksionimi i koncesioneve të ushqimeve nëpër objekte sportive dhe të ngjashme. Ushqimi zakonisht përgatitet në njësinë qendrore.

Aktivitetet e kontraktorëve të shërbimit të ushqimit:
- aktivitetet e kotraktroëve të shërbimit të ushqimit (d.m.th. për kompanitë kontraktuese),
- funksionimin e koncesioneve të ushqimit nëpër objekte sportive apo të ngjashme,
- operacioni i kantinave apo kafeneve (d.m.th. për fabrikat, zyrat, spitalet apo shkollat), në bazë të koncesionit.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e artikujve të prishshëm për rishtije, shih 10.89
- shitjen me pakicë të artikujve ushqimor të prishshëm.

## 56.3 Aktivitetet Shërbyese të Pijeve

### 56.30 Aktivitetet shërbyese të pijeve

Kjo klasë përfshin:
- përgatitjen e shërbimit të pijeve për konsumim të menjëhershëm nëpër lokale.

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:
- bareve,
- tavernave,
- salloneve të koktejit,
- diskotekave (duke mbisunduar shërbimi i pijeve),
- lokalet e birrave,
- shitoret e kafeve,
- baret e lëngjeve të frutave,
- shitësit mobil të pijeve.

Kjo klasë përfshin:

- rishitjen e pijeve të paketuara/përgatitura, shih 47,
- shitjen me pakicë të pijeve nëpërmes makinave shitëse, shih 47.99,
- operacioni i diskotekave dhe të podiumeve të vallëzimit pa shërbim të pijeve, shih 93.29.

# Sektori J – INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Ky sektor përfshin prodhimin dhe distribuimin e informatave dhe produkteve kulturore, sigurimin e mjeteve për transmetimin dhe distribuimin e këtyre produkteve si dhe aktivitetet e të dhënave, apo të komunikimit, të teknologjisë së informatikës dhe procesimin e të dhënave dhe aktivitetet tjera shërbyese të informatikës.

Komponentët kryesore të këtij sektori, janë aktivitetet e publikimit (ndarja 58), përfshirë publikimin e softuerëve, filmave dhe aktivitetet e incizimit të zërit (ndarja 59), aktivitetet e emetimit dhe programimit radio-televiziv (ndarja 60), aktivitetet telekomunikuese (ndarja 61), aktivitetet e teknologjisë informative (ndarja 62) si dhe aktivitetet tjera shërbyese të informatikës (ndarja 63).

Publikimi përfshin, njohjen e të drejtave të autorit për përmbajtjen (produktet e informatës) dhe bërjen e kësaj përmbajtje të arritshme për publikun e gjerë, duke u angazhuar për riprodhimin dhe distribuimin e kësaj përmbajtje në forma të ndryshme. Në këtë sektor janë të përfshirë të gjitha format e realizueshme të publikimit (në formën e shtypit, elektronike apo audio, në internet, si produkte multimediale, siç janë librat e referencës, CD-ROM etj.).

Aktivitet lidhur me prodhimin dhe distribuimin e programit televiziv i stërhollojnë ndarjet 59, 60 dhe 61, duke pasqyruar faza të ndryshme në ketë proces. Komponentët individuale, siç janë filmat, seritë televizive etj., prodhohen me anë të aktiviteteve në ndarjen 59, ndërsa krijimi i programit komplet të një kanali televiziv nga komponentët e prodhuar në ndarjen 59, apo komponentëve tjerë, siç është programi i lajmeve direkt (live), është futur në ndarjen 60. Ndarja 60, gjithashtu përfshin emetimin e këtij programi nga producenti. Distribuimi i programit komplet televiziv nga palët e treta, d.m.th. pa kurrfarë ndryshimi të përmbajtjes, është përfshirë në ndarjen 61. Ky distribuim në ndarjen 61 mund të kryhet nëpërmjet emetimit satelitor apo sistemeve kabllovike.

## 58 Aktivitetet Botuese

Kjo ndarje përfshin publikim e librave, broshurave, trakteve, fjalorëve, enciklopedive, atllaseve, të hartave dhe tabelave, botimin e gazetave, revistave dhe periodikëve, listën e doracakëve të telefonave dhe të postës si dhe botimet tjera, siç janë botimi i softuerëve. Publikimi përfshin njohjen e të drejtave të autorit për përmbajtjen (produktet e informatës) dhe bërjen e kësaj përmbajtje të arritshme për publikun e gjerë, duke angazhuar, apo aranzhimin për riprodhimin dhe distribuimin e kësaj përmbajtje në forma të ndryshme. Në këtë ndarje janë të përfshirë të gjitha format e realizueshme të publikimit (në formën e shtypit, elektronike apo audio, në internet, si produkte multimediale, siç janë librat e referencës CD-ROM etj.), përpos publikimit të filmave. Kjo ndarje përfshin botimin e filmave, videokasetave dhe filmave në DVD, apo media të ngjashme, (ndarja 59) dhe prodhimin e kopjeve origjinale për pllaka, apo material audio, (ndarja 59). Këtu përjashtohet gjithashtu shtypja, (shih 18.11, 18.12) dhe riprodhimi masiv i mediave të incizuara, (shih 18.20).

## 58.1 Publikimi i Librave, Periodikëve dhe Aktivitetet e Tjera të Publikimit

Ky grup përfshin aktivitetet e botimit të librave, gazetave, revistave dhe periodikëve të tjerë, fjalorëve dhe listave të postës dhe punët tjera siç janë fotot, gravimet, kartolinat, oraret e punës, formularët, posterët si dhe reproduksionet e veprave të artit. Këto vepra karakterizohen nga kreativiteti intelektual i kërkuar në zhvillimet e tyre dhe zakonisht janë të mbrojtura nga e drejta e autorit.

### 58.11 Publikimi i librave

Kjo klasë përfshin aktivitet e botimit të librave në shtypshkronjë, elektronik (CD, në monitorë elektronik etj.), në formën audio, apo në internet.

Të përfshira janë edhe:

- botimi i librave, broshurave, trakteve dhe publikimeve të ngjashme, përfshirë botimin e fjalorëve,
- enciklopedive,
- botimin e atllaseve, hartave dhe tabelave,
- botimin e audio librave,
- botimin e enciklopedive etj., në CD-ROM.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e globeve, shih 32.99,
- botimin e materialeve reklamuese, shih 58.19,
- botimin e librave të muzikës dhe fletushkave, shih 59.20,
- aktivitetet e autorëve të pavarur, shih 90.03.

### 58.12 Publikimi i adresarëve dhe numrave telefonikë

Kjo klasë përfshin, botimin e listave të fakteve/informative (bazës së të dhënave), që janë të mbrojtura në formën e tyre, por jo në përmbajtjen e tyre. Këto lista mund të betohen në formë të shtypur apo elektronike.

Kjo klasë përfshin:

- botimin e listave postare,
- botimin e librave telefonik,
- botimin e fjalorëve dhe përpilimeve tjera, siç janë e drejta precedentale, përmbajtja farmaceutike, etj.

### 58.13 Publikimi i gazetave

Kjo klasë përfshin botimin e gazetave, përfshirë gazetat reklamuese, që dalin së paku katër herë në javë. Botimi mund të kryhet në formë të shtypit apo elektronike, përfshirë internetin.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e agjencive të lajmeve, shih 63.91.

### 58.14 Publikimi i revistave dhe periodikëve

Kjo klasë përfshin botimin e periodikëve dhe revistave tjera që dalin më pak se katër herë në javë. Botimi mund të bëhen në formë të shtypit apo elektronike, përfshirë internetin. Këtu përfshihet edhe botimi i programeve radio-televizive.

### 58.19 Aktivitetet e tjera botuese

Kjo klasë përfshin:

- botimin e (përfshirë në internet) :
  - katalogëve,
  - fotove, gravurave dhe kartolinave,
  - kartave përshëndetëse,
  - formularëve,
  - postereve, riprodhimin e veprave të artit,
  - materialin reklamues,
  - materialin tjetër të shtypur;
- botimin online të statistikave dhe informatave tjera.

Kjo klasë përjashton:

- botimin e gazetave të reklamimit, shih 58.13,
- sigurimin online të softuerëve (aplikacioni i hostingut dhe aplikimi i dhënies të shërbimeve), shih 63.11.

## 58.2 Publikimi i Softuerëve

### 58.21 Publikimi i lojërave kompjuterike

Kjo klasë përfshin:

- botimin e lojërave kompjuterike për të gjitha platformat.

### 58.29 Publikimi i softuerëve të tjerë

Kjo klasë përfshin:

- botimin e softuerëve të gatshëm (jo të ndryshuar), përfshirë përkthimin apo adaptimin e softuerëve jo të ndryshuar, për një treg të veçantë në llogari të vet:
  - sistemet e operimit,
  - aplikimet biznesore dhe aplikimet tjera.

Kjo klasë përjashton:

- riprodhimin e softuerëve, shih 18.20,
- shitjen me pakicë të softuerëve jo të ndryshuar, shih 47.41,
- prodhimin e softuerëve jo të përcjellur me botim, përfshirë përkthimin dhe adaptimin e softuerëve jo të ndryshuar për një treg të posaçëm, në bazë të pagesës apo kontratës, shih 62.01.
- sigurimin e softuerëve onllajn (aplikimin e hostingut dhe aplikimin e dhënies së shërbimeve), shih 63.11.

# 59 Prodhimi i Filmave, Videove dhe Programeve Televizive, Incizim i Zërit dhe Aktivitetet e Publikimit të Muzikës

Kjo ndarje përfshin prodhimin e filmave teatror dhe jo teatror, qoftë në film, videokaseta, apo disk për projektim direkt në teatro apo për emetimin në televizion, aktivitetet përkrahëse, siç janë montimi i filmit, prerja, dublimi etj., shpërndarja e filmave dhe produksionet tjera filmike për industri tjera, si dhe produksionin e filmave si dhe projektimin e produksioneve tjera filmike. Blerjen dhe shitjen e filmave apo të drejtat tjera të shpërndarjes së produksioneve filmike, janë futur gjithashtu në këtë ndarje.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin aktivitetet e incizimit të zërit, p.sh. produksionin e incizimeve origjinale të zërit, botimin, promovimin si dhe distribuimin e tyre, publikimin e muzikës si dhe të aktiviteteve shërbyese të incizimit të zërit në studio apo tjetërkund.

## 59.1 Aktivitetet e Filmave, Videove dhe Programeve Televizive

Ky grup përfshin prodhimin e filmave teatror dhe jo teatror, qoftë në film, videokasetë, DVD, apo të mediave tjera, përfshirë distribuimin digjital për projektim direkt në teatro, apo për emetim në televizion. Aktivitet përkrahëse, siç janë montimi i filmit, prerja, dublimi, etj., distribuimi e filmave apo të produksioneve tjera filmike (videokasetave, DVD, etj.) për industritë tjera si dhe projeksionin e tyre.

Këtu është futur gjithashtu blerja dhe shitja e filmit, apo çdo e drejtë tjetër e distribuimit të produksioneve filmike.

### 59.11 Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e filmave video, programeve televizive, (serive televizive, dokumentarëve etj.), apo reklamimet televizive.

Kjo klasë përjashton:

- duplikimin e filmit (përveç riprodhimit të filmit për distribuim teatror), audio dhe videokasetave, riprodhimin e CD-ve apo DVD-ve, nga kopjet origjinale, shih 18.20.
- shitja me shumicë e videokasetave të incizuara, CD, DVD, shih 46.43,
- shitja me shumicë e videokasetave të zbrazëta, CD, shih 46.52,
- shitja me pakicë e videokasetave, CD, DVD, shih 47.63,
- aktivitetet e post-produksionit, shih 59.12,
- incizimin e zërit dhe incizimin e librave në kaseta, shih 59.20,
- emetimin televiziv, shih 60.2,
- krijimin e një programi komplet të kanalit televiziv, shih 60.2,
- procesimin e filmit ndryshe nga industria e filmit, shih 74.20,
- aktivitetet agjentëve ose agjencive artistike personale teatrore, shih 74.90,
- dhënia me qira e videokasetave, DVD-ve, publikut të gjerë, shih 77.22,
- titrimi i mbyllur (d.m.th. të njëkohshëm) kohës së vërtetë të paraqitjeve direkt televizive, takimeve, konferencave, etj., shih 82.99,

- aktivitetet e aktorëve për llogari të veten, karikaturistët, regjisorët, dizjanerët e binave, skenografët dhe specialistët teknik, shih 90.0.

## 59.12 Aktivitetet e post-produksionit të filmave, videove dhe programeve televizive

Kjo klasë përfshin aktivitetet e post-produksionit, siç janë montimi, transferat e filmit/ kasetës, titujt, nën titujt, reklamat, titrimet e mbyllura, grafika e prodhuar me kompjuter, animacioni i efekteve speciale, zhvillimin dhe procesimin e filmit si dhe aktivitetet e laboratorëve filmik dhe aktivitetet e laboratorëve special për filmat e animuar.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- aktivitetet e repertorit të bibliotekave filmike etj.

Kjo klasë përjashton:
- duplikimin e filmit (përveç reproduksionit të filmit për distribuim teatror) si dhe të audio dhe videokasetave, reproduksionin e CD-ve, apo DVD-ve, nga kopjet origjinale, shih 18.20,
- shitja me shumicë e videokasetave të incizuara, CD-ve, DVD-ve, shih 46.43,
- shitjen me shumicë të videokasetave të zbrazëta, CD-ve, shih 46.52,
- shitja me pakicë e videokasetave, CD-ve, DVD-ve, shih 47.63,
- procesimin e filmit, ndryshe nga industria filmike, shih 74.20,
- dhënien me qira të videokasetave, DVD-ve, ose publikut të gjerë, shih 77.22,
- aktivitetet e aktorëve për llogari të vetë, karikaturistëve, regjisorëve, skenografëve dhe specialistëve teknik, shih 90.0.

## 59.13 Aktivitetet e shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive

Kjo klasë përfshin:
- distribuimin e filmit, videokasetave, DVD-ve dhe produksionet e ngjashme nëpër teatro filmike, rrjetet dhe stacionet televizive dhe ekspozuesit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- njohjen e të drejtave për distribuimin e filmit, videokasetave dhe DVD-ve.

Kjo klasë përjashton:
- shumëzimin e filmit si dhe reproduksionin e audio dhe videokasetave, CD-ve apo DVD-ve, nga kopjet origjinale, shih 18.20,
- shitja me shumicë e videokasetave të incizuara dhe DVD-ve, shih 46.43,
- shitja me pakicë e videokasetave dhe DVD-ve të incizuara, shih 47.63.

## 59.14 Aktivitetet e projektimit të filmit

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet e projeksionit të filmit apo të videokasetave nëpër kinema, në terren të hapur apo në objektet tjera të projeksionit,
- aktivitetet e kino-klubeve.

### 59.2 Incizimi i Zërit dhe Aktivitetet e Publikimit të Muzikës

#### 59.20 Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës

Kjo klasë përfshin, aktivitetet e produksionit të incizimeve origjinale të zërit, siç janë kasetat, CD-të, nxjerrjen, promovimin dhe distribuimin e incizimeve të zërit për shitësit me shumicë, të atyre me pakicë, apo drejtpërsëdrejti publikut. Këto aktivitete mund të jenë të integruara, apo të mos jenë në produksionin e incizimeve të kopjeve origjinale në të njëjtën njësi. Nëse jo, njësiti që ushtron këto aktivitete duhet të fitojë të drejtën e reproduksionit dhe distribuimit për incizimet origjinale.

Kjo klasë gjithashtu përfshin aktivitetet shërbyese rreth incizimit të zërit në studio, apo tjetërkund, përfshirë prodhimin e radio-programeve në kaseta.

Kjo klasë gjithashtu përfshin, aktivitet e botimit muzikor, d.m.th. aktivitetet e njohjes dhe të regjistrimit të së drejtës së autorit për kompozimet muzikore, autorizimin dhe përdorimin e këtyre kompozimeve në incizime, radio, televizion, filma, paraqitje direkt, në media të shtypit dhe të tjera. Njësitë e angazhuara në këto aktivitete mund të posedojnë të drejtën e autorit, apo të veprojnë si administratorë të drejtës autoriale për muzikë, në emër të pronarëve të drejtës autoriale. Këtu përfshihet edhe publikimi i muzikave dhe librave të raportorit.

## 60 Aktivitetet Programore dhe të Transmetimit

Kjo ndarje përfshin, aktivitetet e krijimit të përmbajtjes apo njohjes së të drejtës për të distribuuar përmbajtjen dhe më pas transmetimin e asaj përmbajtje, siç janë programet radiotelevizive dhe të të dhënave, të argëtimit, lajmeve, bisedave dhe të ngjashme. Gjithashtu, përfshihet transmetimi i të dhënave në mënyrë tipike të integruar në transmetimin radio apo televiziv. Transmetimi mund të kryhet duke përdorur teknologji të ndryshme, nëpër ajër, nëpërmjet satelitit, rrjetit kabllovik apo internetit.

Kjo ndajre gjithashtu përfshin produksionin e programeve që janë në mënyrë tipike, të ngushtë në karakter (format të kufizuara, siç janë lajmet, sportet, programet edukative dhe për rini), në bazë abonimit apo të pagesës, për palën e tretë, për transmetim të mëvonshëm për publikun.

Kjo ndarje përjashton distribuimin e programeve kabllovike, apo të abonimit tjetër (shih ndarjen 61).

### 60.1 Transmetimi i Programeve Radiofonike

#### 60.10 Transmetimi i programeve radiofonike

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e transmetimit të audio sinjaleve, nëpërmes objekteve dhe studiove të radiotransmetimit për transmision të programit dëgjimor për publikun, dashamirët apo abonuesit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e rrjetave radiofonike, d.m.th. montimin dhe transmetimin e programit dëgjimor për simpatizantët, apo abonuesit nëpërmes transmetimit ajror, kabllovik apo satelitor,
- aktivitetet e transmetimit radiofonik, nëpërmes internetit (radio stacionet e internetit),
- transmetimin e të dhënave të integruara me transmetim radiofonik.

Kjo klasë përjashton:

- produksionin e radio programeve të incizuara në kaseta, shih 59.20.

## 60.2 Aktivitetet e Transmetimit të Programeve Televizive

### 60.20 Aktivitetet e transmetimit të programeve televizive

Kjo klasë përfshin, krijimin e programit komplet të kanalit televiziv nga komponentët e blera programore (p.sh. filmat, dokumentarët etj.), komponentët e programeve të vet prodhuar (p.sh. lajmet lokale, raportet live) ose kombinimet e tyre.

Ky program komplet televiziv, mundet të transmetohet nga ana e njësive prodhuese, apo të prodhuara për transmetim nga dsitributori i palës së tretë, siç janë kompanitë kabllovike apo ofruesit e shërbimeve televizive satelitore.

Programi mund të jetë i natyrës së përgjithshme, apo së specializuar (p.sh. formatet e kufizuara siç janë lajmet, programet sportive, edukative apo të rinisë). Kjo klasë përfshin programin që është i bërë lirshëm, i arritshëm për përdoruesit si dhe programi që është i arritshëm vetëm në bazë të abonimit. Këtu përfshihet edhe programi i video-kanaleve në bazë të kërkesës.

Kjo klasë gjithashtu përfshin transmetimin e të dhënave të integruara me transmetimin televiziv.

Kjo klasë përjashton:

- produksionin e programeve televizive (filmave, dokumentarëve, emisioneve të drejtpërdrejta, marketing etj.), jo të shoqëruara me transmetim, shih 59.11,
- montimi i një pakete të kanaleve dhe distribuimi i asaj pakete pa programim, shih ndarjen 61.

# 61 Telekomunikimi

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e sigurimit e telekomunikimit dhe të aktiviteteve tjera të shërbimit, d.m.th. të transmetimit të zërit, të të dhënave, të tekstit, të zërit dhe video. Objektet transmetuese që kryejnë këto aktivitete, mund të bazohen në një teknologji të vetme apo kombinim të teknologjive. E përbashkëta e aktiviteteve të klasifikuara në këtë ndarje, është transmetimi i përmbajtjes, duke mos qenë i përfshirë në krijimin e saj. Ndërprerja në këtë ndarje, bazohet në llojin e infrastrukturës së operuar.

Në rastin e transmetimit të sinjalit televiziv, kjo mund të përfshijë lidhjen e kanaleve komplete programore (të prodhuar në ndarjen 60) në paketat programore për distribuim.

# 61.1 Aktivitetet e Telekomunikimit Kabllor

## 61.10 Aktivitetet e telekomunikimit kabllor

Kjo klasë përfshin:

- operimin, mirëmbajtjen apo sigurimin e qasjes në objektet për transmetimin, e zërit, të të dhënave, të tekstit, zërit dhe videos, duke përdorur një infrastrukturë telekomunikuese me tel, përfshirë:
  - operimin dhe objektet e transmetimit për të siguruar komunikim nga pika në pikë, nëpërmjet linjave tokësore, mikorvalëve apo të kombinimit të linjave tokësore dhe lidhjeve satelitore,
  - operimin e sistemeve të distribuimit kabllovik (p.sh. për distribuimin e të dhënave dhe sinjaleve televizive), pajisjet telegrafike dhe komunikimet tjera jo vokale, duke përdorur objektet e veta,
  - Objektet e transmetimit që i kryejnë këto aktivitete, mund të bazohen në një teknologji të vetme apo kombinim të teknologjive.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- qasjen e blerjes dhe kapacitetin e rrjetës nga pronarët dhe operatorët e rrjetave dhe të dhënies së shërbimeve telekomunikuese, duke përdorur këtë kapacitet për bizneset dhe ekonomitë shtëpiake,
- sigurimin e qasjes së internetit nga operatori i infrastrukturës me tel.

Kjo klasë përjashton:

- rishitësit e telekomunikacionit, shih 61.90

# 61.2 Aktivitete të Telekomunikimit pa Tela (wireless)

## 61.20 Aktivitete të telekomunikimit pa tela (wireless)

Kjo klasë përfshin:

- operimin, mirëmbajtjen apo sigurimin e qasjes së objekteve për transmetimin e zërit, të të dhënave, të tekstit, tingullit, dhe video duke përdorur infrastrukturë të telekomunikacionit pa tela,
- mirëmbajtjen dhe operimin e pejxherit, celularit dhe rrjetave tjera të telekomunikacionit pa tela,
- objektet e transmetimit, sigurojnë transmetim të plot, të drejtë, nëpërmjet valëve ajrore dhe mund të bazohen në një teknologji të vetme, apo kombinim të teknologjive.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- qasjen e blerjes dhe të kapacitetit të rrjetit nga pronarët dhe operatorët e rrjetave dhe në sigurimin e shërbimeve telekomunikuese, pa tela (përveç satelitit), duke përdorur këto kapacitet për bizneset dhe ekonomitë shtëpiake,
- sigurimin e qasjes së internetit nga operatori i infrastrukturës pa tela, shih 61.90.

## 61.3 Aktivitetet e Telekomunikimit Satelitor

### 61.30 Aktivitetet e telekomunikimit satelitor

Kjo klasë përfshin:

- operimin, mirëmbajtjen apo sigurimin e qasjes në objektet për transmetimin e zërit, të të dhënave, tekstit, tingullit dhe video duke përdorur infrastrukturën e telekomunikimit satelitor ,
- shpërndarjen e programeve vizuale, dëgjimore apo tekstuale të marruara nga rrjetet kabllovike, stacionet televizive lokale apo rrjeteve radiofonike për konsumatorët, nëpërmjet sistemeve satelitore të drejtpërdrejtë në shtëpi. (Këto njësi të klasifikuara këtu në përgjithësi nuk japin materiale programore).

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- sigurimin e qasjes së internetit nga operatori i infrastrukturës satelitore.

Kjo klasë përjashton:

- rishitësit e telekomunikimit, shih 61.90.

## 61.9 Aktivitetet e Tjera të Telekomunikimit

### 61.90 Aktivitetet e tjera të telekomunikimit

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e instalimeve të specializuara të telekomunikimit, siç janë pista e satelitit, telemetri komunikues dhe operacionet e stacionit të radarit,
- operacioni i stacioneve të terminalit satelitore dhe të mjeteve përcjellëse, që janë në mënyrë operacionale të lidhura në një apo më tepër sisteme të komunikimit tokësor dhe të afta për transmetimin e telekomunikimeve, apo marrjen e telekomunikimeve nga sistemet satelitor,
- sigurimin e qasjes së internetit mes klientit dhe ISP-së, jo të poseduar nga ISP, siç është qasja e internetit me anë të thirrjes etj.,
- sigurimin e qasjes telefonike dhe të internetit në objekte të hapura për publikun,
- sigurimin e shërbimeve telekomunikuese nëpërmes lidhje ekzistuese të telekomit:
    - sigurimi i VOIP (Voice Over Internet Protocol);
- rishitësit e telekomunikacioneve (d.m.th. blerja dhe rishtija e kapacitetit të rrjetit, duke mos siguruar shërbime shtesë).

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e qasjes së internetit nga operatorët e infrastrukturës telekomunikuese, shih 61.10, 61.20, 61.30.

# 62 Programimi Kompjuterik, Konsultimi dhe Aktivitetet e Tjera rreth Tij

Kjo ndarje përfshin, aktivitetet vijuese të sigurimit të ekspertizës në fushën e teknologjive informative: të shkruarit, modifikimin, softueri i testimit dhe i mbështetjes, sistemet e planifikimit dhe dizajnimit kompjuterik, që integrojnë harduerët kompjuterik, softuerin dhe teknologjitë e komunikimit. Menaxhimi në terren dhe funksionimi i sistemeve të kompjuterëve të klientëve dhe/ose lehtësirat e procesimit të të dhënave, si dhe aktivitetet tjera profesionale dhe teknike lidhur me kompjuterin.

## 62.0 Programimi Kompjuterik, Konsultimi dhe Aktivitetet e Tjera rreth Tij

### 62.01 Aktivitetet e programimit kompjuterik

Kjo klasë përfshin të shkruarit, modifikimin, testimin dhe mbështetjen e softuerëve.

Kjo klasë përfshin:
- dizajnimin e strukturës dhe përmbajtjes dhe/ose të shkruarit e kodit kompjuterik, i nevojshëm për të krijuar dhe implementuar:
  - softuerin e sistemeve (përfshirë freskimet dhe korrigjimet),
  - aplikacionet e softuerëve (përfshirë freskimet dhe korrigjimet),
  - databazat,
  - ueb-faqet;
- ndryshimin e softuerit, d.m.th. modifikimin dhe konfigurimin e aplikacionit ekzistues, ashtu që të bëhet funksional brenda sistemit informative të klientëve.

Kjo klasë përjashton:
- botimin e softuerëve të paketuar, shih 58.29,
- përkthimin apo adaptimin e softuerit jo të ndryshuar për një treg të veçantë në llogari të vete, shih 58.29.
- planifikimin dhe dizajnimin e sistemeve kompjuterike që integrojnë harduerin, softuerin dhe teknologjitë komunikuese, edhe pse sigurimi i softuerit mund të jetë pjesë integrale, shih 62.02.

### 62.02 Aktivitetet e këshillimeve kompjuterike

Kjo klasë përfshin planifikimin dhe dizajnimin e sistemeve kompjuterike, të cilët integrojnë harduerin kompjuterik, softuerin dhe teknologjitë komunikuese. Shërbimet mund të përfshijnë trajtimin që ka të bëjë me përdoruesit.

Kjo klasë përjashton:
- shitjen e harduerëve apo softuerëve kompjuterik, shih 46.51, 47.41,
- instalimin e kompjuterëve qendror dhe kompjuterëve të ngjashëm, shih 33.20,

- instalimin kompjuterëve personal (zhvendosjen), shih 62.09,
- instalimin e softuerëve, për mbrojtjen e dëmtimit të kompjuterit, shih 62.09.

### 62.03 Aktivitete të menaxhimit të instalimeve kompjuterike

Kjo klasë përfshin sigurimin e menaxhimit në terren dhe funksionimin e sistemeve kompjuterike të klientëve dhe/ose mjetet e procesimit të të dhënave si dhe shërbimet tjera të mbështetjes.

### 62.09 Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike

Kjo klasë përfshin aktivitetet tjera të teknologjisë informative dhe aktivitetet tjera kompjuterike, jo të klasifikuar tjetër kund, siç janë:

- shërbimet rreth mbrojtjes së dëmtimit të kompjuterit,
- instalimin e kompjuterëve personal (zhvendosjen),
- shërbimet e instalimit të softuerit.

Kjo klasë përjashton:

- instalimin e kompjuterit qendror dhe kompjuterëve të ngjashëm, shih 33.20,
- programimi kompjuterik, shih 62.01,
- konsultimi kompjuterik, shih 62.02,
- menaxhimi i mjeteve kompjuterike, shih 62.03,
- procesimi dhe zotimi i të dhënave, shih 63.11.

# 63 Aktivitetet e Shërbimit të Informacionit

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e portaleve të kërkimit të ueb-portave, aktivitetet e procesimit dhe të zotimit të të dhënave, si dhe aktivitetet tjera që kryesisht furnizojnë informata.

## 63.1 Përpunimi i të Dhënave, Hostimi i Informacionit dhe Aktivitetet e Lidhura me To, Ueb-portalet

Ky grup përfshin sigurimin e infrastrukturës për zotimin, shërbimet e procesimit të të dhënave dhe sigurimin e mjeteve të kërkimit dhe hyrjeve tjera për internet.

### 63.11 Përpunimi i të dhënave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e infrastrukturës për zotimin, shërbimet e procesimit të të dhënave dhe aktivitetet lidhur me aktivitet e specializuara për zotim, siç janë:
    - zotimi i faqes,
    - shërbimet drejtuese,
    - aplikimi i zotimit;
- sigurimin e shërbimeve të aplikimit,
- sigurimin e ndarjes së kohës së përgjithshme të shërbimeve të kompjuterit qendror për klientët,

- aktivitetet e procesimit të të dhënave:
  - procesimin komplet të të dhënave të siguruara nga klientët,
  - gjenerimin e raporteve të specializuara nga të dhënat e siguruara nga klientët;
- sigurimin e shërbimeve për futjen e të dhënave.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet kur furnizuese përdor kompjuterët vetëm si mjetë dhe ato janë të klasifikuara sipas natyrës së shërbimeve të ofruara.

### 63.12 Ueb-portalet

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e ueb-portave që përdorin makinën e kërkimit për të prodhuar, dhe mirëmbajtur databazat ekstensive të adresave të internetit dhe të përmbajtjes në një format të kërkueshëm në mënyrë të lehtë,
- funksionimi i ueb-portave të tjera që veprojnë si hyrje për internet, siç janë media, qendrat që sigurojnë në mënyrë periodike përmbajtje të freskuara.

Kjo klasë përjashton:

- botimin e librave, gazetave, revistave etj., nëpërmes interneti, shih ndarjen 58,
- transmetimin nëpërmjet internetit, shih ndarjen 60.

## 63.9 Shërbimet e Tjera të Informacionit

Ky grup përfshin aktivitetet e agjencive të lajmeve dhe të gjitha aktivitetet tjera shërbyese të mbetura.

Ky grup përjashton:

- aktivitetet e bibliotekave dhe arkivave, shih 91.01.

### 63.91 Aktivitetet e agjencive të lajmeve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e agjencisë dhe sindikatave që sigurojnë lajme, fotografi dhe emisioni speciale.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e foto-reporterëve të pavarur, shih 74.20,
- aktivitetet e gazetarëve të pavarur, shih 90.03

### 63.99 Shërbimet e tjera të informacionit p.k.t

Kjo klasë përfshin aktivitetet e shërbimeve tjera të informatikës, jo të klasifikuar tjetër kund, siç janë:

- shërbimet e informacionit telefonik bazuar në kompjuter,
- shërbimet e kërkimit të informatave në bazë të kontratës apo pagesës,
- shërbimet rreth marrjeve të lajmeve të shkurtra, shërbimet rreth prerjeve të shkurtra të lajmeve të shtypit, etj.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e qendrave të thirrjes, shih 82.20.

# Sektori K – AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT

Ky sektor përfshin aktivitetet e shërbimeve financiare përfshirë aktivitetet e sigurimit, risigurimit dhe të fondit pensional si dhe të aktiviteteve në përkrahje të shërbimeve financiare.

Ky sektor gjithashtu përfshinë aktivitetet e aseteve holding, siç janë aktivitetet e kompanive holding si dhe aktivitetet e trusteve, fondeve dhe subjekteve të ngjashme financiare.

## 64 Aktivitetet e Shërbimeve Financiare, përveç Sigurimeve dhe Fondeve Pensionale

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e sigurimit dhe ridistribuimit të fondeve, ndryshe nga qëllimi për sigurim apo fondin pensional apo të sigurimit të detyrueshëm social.

Shënim: Marrëveshjet institucionale dhe nacionale, kanë gjasa të luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e klasifikimit brenda kësaj ndarje.

### 64.1 Ndërmjetësimi Monetar

Ky grup përfshin sigurimin e fondeve në formë të depozitave të transferueshme, d.m.th. fonde që janë të fiksuara në afate monetare të siguruara në bazë ditore, përveç Bankës Qendrorë, të siguruara nga burimet jo financiare.

#### 64.11 Aktiviteti i Bankës Qendrore

Kjo klasë përfshin:

- emetimin dhe menaxhimin e monedhës së një vendi,
- monitorimin dhe kontrollin e masës monetare,
- marrjen e depozitave që janë përdorur për vërtetimin e llogarive mes institucioneve financiare,
- mbikëqyrjen e operacioneve bankare,
- ruajtjen e rezervave ndërkombëtare të një vendi,
- veprimi si bankier ndaj qeverisë, (aktivitetet e bankave qendrore duhet të ndryshojnë arsyet institucionale).

#### 64.19 Ndërmjetësimet e tjera monetare

Kjo klasë përfshin marrjen e depozitave dhe/ose zëvendësit të afërt për depozita dhe vazhdimin e fondeve të kredive, apo hua dhënies. Dhënia e kredisë mund të përfshijë një llojllojshmëri të formave, siç janë, huatë, hipotekat, kartelat e kredit etj. Këto aktivitetet janë në përgjithësi kryhen nga institucionet monetare, ndryshe nga bankat qendrore siç janë:

- bankat,
- bankat e kursimit,
- unionet e kredive.

Kjo klasë përfshinë:

- aktivitetet e xhiro llogarive postare dhe të bankave kursimtare,
- dhënien e kredive për blerjen e shtëpive nga institucionet e specializuara për marrjen e depozitave,
- aktivitetet e fletporosive monetare.

Kjo klasë përfshin:

- dhënien e kredisë për blerjen e shtëpive nga institucionet e specializuara, jo depozituese, shih 64.92,
- aktivitetet e rregullimit dhe të procesimit të transaksionit me kredit-kartë, shih 66.19

## 64.2 Aktivitetet e Kompanive "Holding"

### 64.20 Aktivitetet e kompanive "holding"

Kjo klasë përfshin aktivitetet e kompanive holding, d.m.th njësitë që zotërojnë asete (që posedojnë – kontrollojnë nivele të aksioneve/kapitalit) të një grupi të korporatave ndihmëse dhe aktiviteti kryesor i të cilave është posedimin e grupit. Kompanitë holding në këtë klasë nuk japin ndonjë shërbim tjetër për bizneset, në të cilën ruhet kapitali, d.m.th. ato nuk i administrojnë apo menaxhojnë njësitë tjera.

Kjo klasë përjashton:

- menaxhmentin aktiv të kompanive dhe ndërmarrjeve, planifikimin strategjik dhe marrjen e vendimeve për kompanitë, shih 70.10.

## 64.3 Trustet, Fondet dhe Subjektet e Ngjashme Financiare

### 64.30 Trustet, fondet dhe subjektet e ngjashme financiare

Kjo klasë përfshin subjektet legale të organizuara për të shërbyer letra me vlerë, apo kapitale tjera financiare pa menaxhim, në emër të pjesëmarrësve të kapitalit apo përfituesve. Portofolet/letrat me vlerë, janë të kushtëzuara për të arrit karakteristikat specifike të investimit, siç është shumëllojshmëria, rreziku, shkalla e kthimit apo çmimi i luhatshmërisë. Këto subjekte fitojnë interes, dividenda dhe të ardhurat tjera pronësore, por kanë pak ose kurrfarë pronësimi dhe kurrfarë të ardhurash nga shitja e shërbimeve.

Kjo klasë përfshin:

- fondet e hapura të investimit,
- fondet e mbyllura të investimeve,
- fondet e njësisë të turstit të investimeve -trustet, agjencitë e patundshmërisë apo llogaritë e agjencionit, të administruara në emër të përfituesve, sipas kushteve të një marrëveshje të trustit, të testamentit apo të një marrëveshje të agjencionit.

Kjo klasë përfshin:

- fondet dhe trustet që fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave apo shërbimeve, shih klasën e NACE-s sipas aktivitetit të tyre kryesor,
- aktivitetet e kompanive holding, shih 64.20,
- fondin pensional, shih 65.30,
- menaxhimi i fondeve, shih 66.30,
- 64.9 Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional.

Ky grup përfshin aktivitetet e shërbimeve financiare ndryshe nga ato të udhëhequra apo të kryera nga institucionet monetare.

Ky grup përjashton:

- fondin e sigurimit dhe pensional, shih ndarjen 65.

### 64.91 Lizingu financiar

Kjo klasë përfshin:

- lizingun, ku kushti përafërsisht mbulon jetën e pritur të kapitalit dhe qiramarrësi fiton në mënyrë thelbësore të gjitha benefitet të përdorimit të tij dhe i merr të gjitha rreziqet të shoqëruara me pronësinë tij. Pronësia e kapitalit, mund apo nuk mund të transferohet përfundimisht. Huatë e tilla, mbulojnë të gjitha apo virtualisht të gjitha shpenzimet, përfshirë interesin.

Kjo klasë përjashton:

- lizingun operacional, shih ndarjen 77, sipas llojit të mallrave të dhënë me qira.

### 64.92 Aktivitetet e tjera të kredisë

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e shërbimeve financiare, kryesisht lidhur me lëshimin e huave nga institucionet jo të involvuara në ndërmjetësimin monetar, ku dhënia e kredisë mund të marrë një llojllojshmëri të formave siç janë huatë hipotekat, kartelat e kredive etj. duke siguruar llojet vijuese të shërbimeve:
  - dhënien e kredive të konsumatorëve,
  - financimin e tregtisë ndërkombëtare,
  - dhënien e kredive financiare afatgjate për industri nga bankat industriale,
  - dhënien e huave monetare jashtë sistemit bankar,
  - dhënien e kredive për blerjen e shtëpive nga institucionet e specializuara, jo depozituese,
  - pengëtorët dhe pengbrokerët,

Kjo klasë përjashton:

- dhënien e kredive për blerjen e shtëpive nga institucionet e specializuara, që gjithashtu marrin depozitë, shih 64.19,
- lizingu operacional, shih ndarjen 77, sipas llojit të mallrave të dhëna me qira,
- aktivitetet e dhënie së donacioneve nga organizatat anëtare, shih 94.99.

### 64.99 Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e shërbimeve tjera financiare, kryesisht të lidhura me distribuimin e fondeve, ndryshe nga dhënia huave:
  - aktivitetet e faktorit,
  - shkrimi i trambave/këmbimeve, opsioneve dhe marrëveshjeve tjera mbrojtëse,
  - aktivitetet e kompanive të vendosjes së shpenzimeve rrugore;

- aktivitete e investimeve për llogari të vete, siç janë të kompanive me kapital të investuar, klubet e investimeve etj.

Kjo klasë përjashton:

- lizingun financiar, shih 64.91,
- veprimtaria e sigurimit në emër të të tjerëve, shih 66.12,
- tregtimi, lizingu dhe marrja me qira e pronës së patundshme, shih ndarjen 68,
- argëtimi i faktuarve pa blerjen e borxhit, shih 82.91,
- aktivitetet e dhënies së donacioneve nga organizatat anëtare, shih 94.99.

# 65 Sigurimi, Risigurimi dhe Financimi i Fondeve të Pensioneve, përjashtuar Sigurimin Shoqëror të Detyrueshëm

Kjo ndarje përfshin pajtimin e anuiteteve dhe të poliseve të sigurimit dhe të premive investuese për të ndërtuar një portfolio apo kapital financiar, që të përdoret kundër kërkesave të ardhshme. Sigurimi i sigurimit të drejtpërdrejtë dhe risigurimi, janë përfshirë në këtë ndarje.

## 65.1 Sigurimi

Ky grup përfshin sigurimin jetësor me apo elemente thelbësore të sigurimit dhe të sigurimit jo-jetësor.

### 65.11 Sigurimi jetësor

Kjo klasë përfshin:

- përputhshmërinë e anuiteteve dhe të poliseve të sigurimit të jetës, polisat e sigurimit invalidor, dhe të vdekjes aksidentale dhe të poliseve të sigurimit të shqyerjes (me apo pa elementin e kursimeve thelbësore)

### 65.12 Sigurimi tjetër (jojetësor)

Kjo klasë përfshin:

- dhënien e shërbimeve të sigurimit, ndryshe nga sigurimi i jetës:
  - sigurimi nga aksidenti dhe zjarri,
  - sigurimi shëndetësor,
  - sigurimi i udhëtimit,
  - sigurimi i pronës,
  - sigurimi i makinës, detar, aviacionit dhe transportit,
  - sigurimi i humbjeve financiare dhe i përgjegjësisë.

## 65.2 Risigurimi

### 65.20 Risigurimi

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e marrjes përsipër të të gjithë apo një pjese të rrezikut të përcjellë me polisat e sigurimit ekzistues, që më parë janë kontraktuar me bartësit tjerë të sigurimit.

## 65.3 Fondet Pensionale

### 65.30 Fondet pensionale

Kjo klasë përfshin, subjektet legale (d.m.th. fondet, planet dhe/ose programet) të organizuar për të siguruar beneficionet e të ardhurave pensionale, ekskluzivisht për punonjësit apo punëdhënësit. Kjo përfshin planet e pensionale me beneficione të definuara, si dhe planet individuale, ku benificionet janë thjesht të definuara nëpërmes kontributit të anëtarit.

Kjo klasë përfshin:

- planet e beneficionit të punonjësit,
- fondet dhe planet e pensionit,
- planet e fondit pensional.

Kjo klasë përjashton:

- menaxhimin e fondeve pensionale, shih 66.30,
- skemat e sigurimit të detyruar social, shih 84.30.

# 66 Aktivitet Ndihmëse për Shërbimet Financiare dhe Aktivitetet e Sigurimit

Kjo ndarje përfshin, ofrimin e shërbimeve të sigurimeve të involvuara apo të lidhura ngushtë me aktivitetet e shërbimeve financiare, por ato vet nuk ofrojnë shërbime financiare. Ndarja kryesore mvaret nga lloji i transaksionit financiar, apo fondit përkatës.

## 66.1 Aktivitet Nihmëse për Shërbimet Financiare, përveç Financimit të Sigurimit dhe Fondeve Pensionale

Ky grup përfshin furnizimin e vend-tregjeve fizike apo elektronike, për qëllim të lehtësimit të blerjes apo shitjes të bursave, opsioneve të bursës, të obligacioneve apo të kontratave të mallit.

### 66.11 Administrimi i tregjeve financiare

Kjo klasë përfshin operacionin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare, ndryshe nga autoritetet publike, siç janë: këmbimet e kontratave të mallit, këmbimet e kontratave të mallit me afat, këmbimet e letrave me vlerë, bursat e aksioneve, këmbimet e opsioneve të bursës apo të mallit.

### 66.12 Shërbimet e ndërmjetësimit për letra me vlerë dhe kontrata të mallit

Kjo klasë përfshin:

- marrëveshja në tregjet financiare në emër të tjerëve (p.sh. ndërmjetësimin e bursës) dhe aktivitetet lidhur me te,
- ndërmjetësimi në letrat me vlerë,
- ndërmjetësimi në kontratat e mallit,
- aktivitetet e këmbimoreve, etj.

Kjo klasë përjashton:

- marrëveshja në tregje në llogari të vetë, shih 64.99,

- menaxhimi i portofolit, në bazë të pagesës apo kontratës, shih 66.30.

### 66.19 Aktivitet e tjera ndihmëse për shërbimet financiare, përveç financimit të sigurimit dhe fondeve pensionale

Kjo klasë përfshin, aktivitetet ndihmëse për aktivitetet e shërbimeve financiare jo të klasifikuar tjetër kund, siç janë:

- procesimi i transaksionit financiar dhe aktivitetet e marrëveshjes, përfshirë transaksionit e kartave të kreditit,
- shërbimet këshillëdhënëse për investim,
- aktivitetet e këshilltarëve dhe borkerëve të hipotekës.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përfaqësuesit e ligjit, shërbimet fiduciarisë dhe të kujdestarisë, në bazë të pagesës apo kontratës.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitete e agjentëve dhe të brokerëve të sigurimit, shih 66.22,
- menaxhimin e fondeve, shih 66.30.

## 66.2 Aktivitetet Ndihmëse të Sigurimeve dhe Fondeve Pensionale

Ky grup përfshin veprimin e agjentëve (d.m.th. brokerëve), në shitjen e anuiteteve dhe policet e sigurimit, apo sigurimin e beneficioneve tjera të punonjësve, të shërbimeve tjera të sigurimit dhe pensional, siç janë përshtatjet e kërkesave dhe administrimin e palës së tretë.

### 66.21 Vlerësimi i riskut dhe dëmit

Kjo klasë përfshin dhënien e shërbimeve administrative të sigurimit, siç janë vlerësimi dhe zgjidhja e kërkesave të sigurimit:

- vlerësimi i kërkesave të sigurimit:
  - rregullimi i kërkesave,
  - vlerësimi i rrezikut,
  - vlerësimi i rrezikut dhe i demit,
  - mesatarja dhe përshtatja e humbjes;
- vendosja ose zgjedhja e kërkesave të sigurimit.

Kjo klasë përjashton:

- përcaktimin e vlerës së patundshmërisë, shih 68.31,
- përcaktimin për qëllime tjera, shih 74.90,
- aktivitetet hetimore, shih 80.30.

### 66.22 Aktivitetet e agjentëve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit

Kjo klasë përfshin:

- aktivitete e agjentëve dhe brokerëve të sigurimit (ndërmjetësuesve të sigurimit) në shitjen, negocimin apo në kërkimin e anuiteteve dhe polisave të sigurimit dhe risigurimit

### 66.29 Aktivitetet e tjera ndihmëse të sigurimeve dhe fondeve pensionale

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e involvuara apo të ngushta, të lidhura me sigurimin dhe fondin pensional (përveç ndërmjetësimit financiar, rregullimit të kërkesave dhe të aktiviteteve të agjentëve të sigurimit):
  - administrimit i shpëtimit,
  - aktivitet vepruese.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitete e shpëtimit të marinës, shih 52.22.

## 66.3 Aktivitetet e Menaxhimit të Fondeve

### 66.30 Aktivitetet e menaxhimit të fondeve

Kjo klasë përfshin aktivitetet të portfolios dhe fondit në bazë të pagesës, apo kontratës për individ, biznese dhe të tjerë, siç janë:

- menaxhimin e fondeve dypalëshe,
- menaxhimin e fondeve tjera investuese,
- menaxhimin e fondeve pensionale.

# Sektori L – AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË

Kjo klasë përfshin, aktivitetin si qiradhënës, agjentë dhe/apo broker në njërën apo më shumë veprime vijuese: shitjen apo blerjen e patundshmërisë, dhënien me qira të patundshmërisë, dhënien e shërbimeve tjera të patundshmërisë siç është vlerësimi i patundshmërisë apo veprimi si agjent dorëzanë të patundshmërisë. Aktivitetet në këtë sektor mund të kryhen në pronën e vet, apo të dhënë me qira dhe mund të bëhen në bazë të pagesës apo kontratës. Në këtë sektor gjithashtu përfshin ndërtimin e ndërtesave, të kombinuar me mbajtjen e pronësisë apo dhënien me qira të ndërtesave të tilla.

Ky sektor përfshin menaxherët e pronës së patundshme.

## 68 Aktivitetet e Patundshmërisë

### 68.10 Blerja dhe shitja e patundshmërisë personale

Kjo klasë përfshin:
- blerjen dhe shitjen e pasurisë në pronë të vet:
- ndërtesat e apartamenteve dhe të banimit, ndërtesat jo banesore, përfshirë hallet e ekspozitave, objektet vet deponuese, shtëpitë e mallrave dhe qendrat tregtare,
- tokën.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- nën ndarjen e patundshmërisë në parcela, pa rregullimin e tokës.

Kjo klasë përjashton:
- zhvillimin e projekteve ndërtimore për shitje, shih 41.10,
- nën ndarjen dhe rritjen e vlerës së tokës, shih 42.99.

### 68.2 Qiradhënia dhe Menaxhimi i Patundshmërisë Personale ose të Marra me Qira

### 68.20 Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira

Kjo klasë përfshin:
- dhënien me qira dhe operimin e patundshmërisë në pronësi të vetë apo të dhënë me qira:
  - ndërtesat e apartamenteve dhe të banesave,
  - ndërtesat jo banesore, përfshirë sallat e ekspozitave, objektet e vetë definuar,
  - tokën;
- sigurimi i tokës për shtëpi dhe banesat, apartamentet e mobiluara apo të pa mobiluara, për shfrytëzim afatgjatë, në mënyrë tipike në bazë mujore apo vjetore.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- zhvillimin e projekteve ndërtimore për përdorim të vet,
- përdorimin e lokacioneve të shtëpive mobile banesore.

Kjo klasë përjashton:

- përdorimin e hoteleve, suite hoteleve, shtëpive pushimore, shtëpitë banesore, hapësirat e kampingut, parqet kampshtëpiza/rimorkio si dhe vendet tjera akomoduese jo banesore, apo për qëndrim të shkurtër, shih ndarjen 55.

## 68.3 Aktivitete të Pasurive të Patundshme në Bazë të Pagesës ose Kontratës

### 68.31 Agjencitë e patundshmërive

Kjo klasë përfshin sigurimin e aktivitetet nga agjencionet e patundshmërisë:

- ndërmjetësimin në blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të patundshmërisë në bazë të pagesës apo kontratës,
- aktivitetet këshilluese dhe shërbimet vlerësuese lidhur me blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të patundshmërisë në bazë të pagesës apo kontratës,
- aktivitetet e agjentëve dorëzan të patundshmërisë.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet legale, shih 69.10.

### 68.32 Manaxhimi i patundshmërisë në bazë të pagesës ose kontratës

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- agjencionet e grumbullimit të qerasë.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet legale, shih 69.10,
- shërbimet mbështetëse të objekteve (kombinimin e shërbimeve, siç janë pastrimin e brendshëm gjeneral, mirëmbajtjen dhe bërjen e riparimeve të vogla, heqjen e mbeturinave, gardën dhe sigurimin), shih 81.10,
- menaxhimin e objekteve, siç janë bazat ushtarake, objektet e burgjeve dhe të tjera (përveç menaxhimit të mjeteve kompjuterike), shih 81.10.

# Sektori M – AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE

Ky sektor përfshin aktivitetet e specializuara profesionale, shkencore dhe teknike. Këto aktivitete kërkojnë një shkallë të lartë të aftësimit, njohurive dhe iu ofrojnë përdoruesve aftësi dhe njohuri profesionale.

## 69 Aktivitete Juridike dhe të Kontabilitetit

Kjo ndarje përfshin përfaqësimin legal për interes të një pale kundër palës tjetër, qoftë para apo jo para gjykatave, apo para organeve tjera gjyqësore, apo nën mbikëqyrjen e personave, të cilët janë anëtarë të odës së avokatëve, siç është këshilla apo përfaqësimi në rastet civile, këshilla apo përfaqësimi në paditë kriminale, këshillim apo përfaqësim në lidhje me kontestet nga marrëdhënia e punës.

Kjo gjithashtu përfshin përgaditjen e dokumentave ligjore siç janë nenet e inkorpurimit, marrëveshjet e partneritetit apo dokumente të ngjajshme në lidhje me formimin e kompanisë, patentave dhe të drejtave të autorit, përgatitjen e akteve juridike, testamenteve, trusteve, etj. si dhe të aktiviteteve tjera të noterëve publik, të noterëve të drejtës civile, të ekzekutuesve gjyqësor, arbitrave, ekzaminuesve dhe gjyqtarëve. Kjo ndarje gjithashtu përfshin shërbimet e kontabilitetit dhe mbajtjes së librave, siç janë të auditimit, të të dhënave të kontabilitetit, përgatitjen e llogaritjeve financiare dhe të kontabilitetit.

### 69.1 Aktivitete Juridike

### 69.10 Aktivitete juridike

Kjo klasë përfshin:

- përfaqësimin legal të interesit të një pale kundër palës tjetër, para apo qoftë para gjykatave apo organeve tjera gjyqësore, me apo nën mbikëqyrjen e personave që janë anëtarë të avokatëve:
  - këshilla apo përfaqësimi në rastet civile,
  - këshilla apo përfaqësimi në rastet kriminale,
  - këshillim apo përfaqësim në lidhje me kontestet nga marrëdhënia e punës;
- konsultimin dhe këshillimin e përgjithshëm, përgatitjen e dokumenteve ligjore:
  - dispozitat e inkurpurimit, marrëveshjeve të partneritetit, apo dokumenteve të ngjashëm lidhur me formimin e kompanisë,
  - patentave dhe të drejtave të autorit,
  - përgatitjen e akteve juridike, testamenteve, trusteve etj.;
- aktivitetet tjera të notarive publike, notarive të drejtës civile, ekzekutuesve gjyqësore, arbitrave, ekzaminuesve dhe referuesve.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e gjykatave, shih 84.23.

### 69.2 Aktivitetet e Kontabilitetit, Libërmbajtjes dhe Auditimit; Këshillime Tatimore

#### 69.20 Aktivitetet e kontabilitetit, libërmbajtjes dhe auditimit; këshillime tatimore

Kjo klasë përfshin:

- regjistrimin e transaksioneve komerciale nga bizneset apo të tjerët,
- përgatitjen apo auditimin e llogarive financiare,
- kontrollimin e llogarive dhe vërtetimin e saktësisë së tyre,
- përgatitjen e tatimit për fitimin ardhurave dhe të ardhurave personale dhe biznesore,
- aktivitete këshilluese dhe përfaqësimin në emër të klientëve para autoriteteve tatimore.

Kjo klasë përjashton:

- procesimin e të dhënave dhe aktivitetet e tabelave, shih 63.11,
- konsutlimi i menaxhmentit mbi sistemet e kontabilitetit, procedurat e kontrollit buxhetor, shih 70.22,
- argëtimi i faturave, shih 82.91.

## 70 Aktivitetet e Udhëheqjes së Ndërmarrjeve dhe Aktivitetet e Konsultimit

Kjo ndarje përfshin dhënien e këshillës dhe asistencës për bizneset dhe organizatat tjera në çështjet e menaxhmentit, siç është planifikimi strategjik dhe organizativ, planifikimi financiar dhe buxhetor, objektivat dhe parimet dhe objektivat e marketingut, parimet, praktikat dhe planifikimin e burimeve njerëzore, planifikimin e prodhimit dhe planifikimin e kontrollit.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive tjera të së njëjtës kompani, apo ndërmarrje, d.m.th. aktivitetet zyrave kryesore.

### 70.1 Aktivitetet e Udhëheqjes së Ndërmarrjeve

#### 70.10 Aktivitetet e udhëheqjes së ndërmarrjeve

Kjo klasë gjithashtu përfshin mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive tjera të së njëjtës kompani, apo ndërmarrjes, sipërmarrja e planifikimit strategjik apo organizativ dhe rolit vendimmarrës të kompanisë apo ndërmarrjes, të ushtruarit e kontrollit operacional dhe menaxhimin e operacioneve të përditshme të njësive të tyre.

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- aktivitetet e zyrave kryesore,
- zyrave të qendrore administrative,
- zyrave të korporatave,
- zyrave të distrikteve dhe regjioneve,
- të zyrave të menaxhmentit të subvencionit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e kompanive holding, jo të angazhuara në menaxhim, shih 64.20.

## 70.2 Aktivitete të Këshillimeve Menaxheriale

### 70.21 Marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit

Kjo klasë përfshin dhënien e këshillës, udhëzimeve dhe asistencës operacionale, përfshirë aktivitetet e lobimit, për bizneset dhe organizatat tjera mbi relacionit publike dhe të komunikimit.

Kjo klasë përjashton:
- agjencionet e reklamimit dhe shërbimet e përfaqësimit medial, shih 73.1,
- hulumtimi i tregut dhe të opinionit publik, shih 73.20.

### 70.22 Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim

Kjo klasë përfshin dhënien e këshillës, udhëzimit dhe asistencës operacionale për bizneset dhe organizatat tjera mbi çështjet e menaxhmentit, siç është planifikimi strategjik dhe organizativ të korporatës, procesi i riinxhiniringut të biznesit, menaxhmenti i ndryshimit, zvogëlimi i kostos dhe çështjeve tjera financiare. Politikat dhe objektivat e marketingut, politikat, praktikat dhe planifikimi i burimeve njerëzore, strategjitë e kompensimit dhe pensionimit. Projektimi i prodhimit dhe planifikimi i kontrollit.

Kjo e dhënie e shërbimeve biznesore mund të përfshijë udhëzimin apo asistencën operacionale për bizneset dhe shërbimi publik përkatës:
- dizajnimin e metodave apo procedurave të kontabilitetit, programet e kostos së kontabilitetit, procedurat kontrolluese buxhetore,
- këshillimin dhe ndihmën për bizneset dhe shërbimet publike në planifikim, organizim efikasitet dhe kontroll, informatikën e menaxhmentit etj.

Kjo klasë përjashton:
- dizajnimin e softuerit të kompjuterit, sistemet e kontabilitetit, shih 62.01,
- këshillën ligjore dhe përfaqësimin, shih 69.10,
- aktivitetet e kontabilitetit, mbajtjes së librave dhe auditimin, si dhe konsultimin tatimor, shih 69.20,
- aktivitetet arkitekturale dhe të këshillimit inxhinierik, shih 71.11, 71.12,
- aktivitetet këshillimore rreth mjedisit, agronomisë, sigurisë dhe aktivitetet e ngjashme, shih 74.90,
- plasmanin ekzekutiv ose aktivitetet konsultative të kërkimit, shih 78.10,
- aktivitetet konsultative arsimore, shih 85.60.

# 71 Aktivitetet e Arkitekturës dhe Inxhinierisë; Analizat dhe Testimi Teknik

Kjo ndarje përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturale, inxhinierike, shërbimeve projektuese, shërbimeve të inspektimit të ndërtimit dhe shërbimet gjeodezike dhe topografike.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin kryerjen e shërbimeve të fizike, kimike dhe të testimeve tjera analitike.

## 71.1 Aktivitetet e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Këshillimeve të Tjera Teknike

Ky grup përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturale, inxhinierike, shërbimeve projektuese, shërbimeve të inspektimit të ndërtimit dhe shërbimet gjeodezike dhe topografike dhe të ngjashëm.

### 71.11 Aktivitetet e arkitekturës

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet konsultative arkitekturale:
  - dizajnimin dhe projektimin e ndërtimit,
  - planifikimin e qyteteve dhe qytezave si dhe arkitekturën e peizazhit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e konsulentëve të kompjuterit, shih 62.02, 62.09,
- dekorimin interior, shih 74.10.

### 71.12 Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik

Kjo klasë përfshin:

- dizajnimin inxhinerik (d.m.th. zbatimin e parimeve dhe ligjeve fizike të inxhinieringut në dizjanimin e makinave, materialeve, instrumenteve, godinave, proceseve dhe sistemeve) si dhe aktivitetet konsultative për:
  - makineri, proceset industriale dhe uzinat industriale,
  - projektet që përfshijnë inxhinieringun civil, inxhinieringun hidrualik dhe trafik, projektet menaxhuese të ujit,
  - realizimin dhe elaburimin e projekteve të përafërta me inxhinieringut elektrik dhe elektronik,
  - inxhnieringun e minierave, atë kimik, mekanik, inxhinieringun industrial dhe të sistemeve, inxhinieringun e sigurisë;
- elaburimin e projekteve që përdorin inxhinieringun e klimatizimit të ajrit, ftohjes, sanitarisë dhe të kontrollit të ndotjes, inxhinieringun akustik etj.,
- matjen fizike, gjeologjike dhe sizmike,
- aktivitetet e matjes gjeodezike:

  - aktivitetet e matjes së tokës dhe të kufijve të saj,
  - aktivitetet matëse hidrologjike,
  - aktivitetet e matjes nënujore,
  - aktivitetet informative hartografike dhe hapësinore.
- Kjo klasë përjashton:
- shpimin testues lidhur me operacionet e minierave, shih 09.10, 09.90,
- zhvillimin apo publikimin e softuerit përcjellës, shih 58.29, 62.01,
- aktivitetet e konsulentëve të kompjuterit, shih 62.02, 62.09,
- testimi teknik, shih 71.20,
- aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore lidhur me inxhinieringun, shih 72.19,
- dizajnin industrial, shih 74.10,
- fotografimi ajror, shih 74.20.

## 71.2 Testimi Teknik dhe Analizat

### 71.20 Testimi teknik dhe analizat

Kjo klasë përfshin kryerjen e testimit fizik, kimik dhe testimeve tjera analitike të të gjitha llojeve të materialeve dhe produkteve, siç janë:

  - testimin akustik dhe të vibracionit,
  - testimin e përbërjes dhe të pastërtisë së mineraleve etj.,
  - aktivitetet testuese në fushën e higjienës ushqimore, përfshirë testimin dhe kontrollin veterinar në lidhje me prodhimin e ushqimit,
  - testimin e veçorive fizike dhe të performancës së materialeve, siç është fortësia, trashësia, jetëgjatësia, radioaktiviteti etj.,
  - testimin e kualifikimit dhe të sigurimit,
  - testimin e performancës së makinerisë komplete: të motorëve, automobilave, pajisjeve elektronike etj.,
  - testimin e radiografik të saldimit dhe lidhjeve salduese,
  - analizën e dështimit,
  - testimin dhe matjen e indikatorëve të mjedisit: të ndotjes së ajrit dhe të ujit etj.,
- certifikimin e produkteve, përfshirë artikujt e konsumit, mjetet motorike, aeroplanët, të kontejnerëve me presion, uzinave nukleare etj..
- testimin periodik të sigurisë rrugore për mjetet motorike.
- testimin duke përdorur modelet apo simuluesit (p.sh. të aeroplanëve, anijeve, digave etj.),
- funksionimin e laboratorëve policor.

Kjo klasë përjashton:

- testimin e specieve të kafshëve, shih 75.00,
- pamjen diagnostike, testimin dhe analizën e mostrave medicinale dhe dentale, shih 86.

# 72 Hulumtimet Shkencore dhe Zhvillimi

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e tri llojeve të kërkimit dhe zhvillimit: 1) hulumtimin bazik: eksperimental, apo të punës teorike të ndërmarrë kryesisht për të fituar njohuri të reja, të themeleve kryesore të fenomeneve apo të fakteve të vëzhgueshme, pa ndonjë zbatim të veçantë apo përdorim në vështrim të; 2) hulumtimi i zbatuar: hulumtimin e ndërmarrë origjinal, për të fituar njohuri të reja të udhëhequra kryesisht në një qëllim apo objektiv specifik praktik; dhe 3) zhvillimi eksperimental: puna sistematike, vazhdimin mbi njohurinë ekzistuese, të fituar nga kërkimi dhe/ose përvoja praktike, e drejtuar për të prodhuar materiale të reja, produkte dhe mjete për instalimin e proceseve të reja, sistemeve dhe shërbimeve të reja dhe për përmirësimin thelbësor të atyre që veç janë prodhuar apo instaluar.

Aktivitetet e zhvillimit kërkimor dhe eksperimental në këtë ndarje, janë rindarë të dy kategori: shkencat natyrore dhe inxhinieringu, shkencat sociale dhe humanitare.

Kjo ndarje përjashton:

- hulumtimin e tregut, shih 73.20.

## 72.1 Kërkimi dhe Zhvillimi Eksperimental mbi Shkencat Natyrore dhe Inxhinieri

Ky grup përmban kërkimin bazik, kërkimin e aplikuar, zhvillimin eksperimental në shkencat natyrore dhe inxhinerike.

### 72.11 Kërkimi dhe zhvillimi eksperimental në bioteknologjinë

### 72.11 Kërkimi dhe zhvillimi eksperimental në bioteknologjinë

Kjo klasë përfshin zhvillimin kërkimore dhe eksperimental mbi bioteknologjinë:

- DNA/RNA: gjenomikët, farmakogjenomikët, shqyrtimi i gjenit, inxhineringu gjenetik, amplifikimi DNA/RNA pasues/sintezë, profilizimi i ekspresionit gjenetik dhe përdorimi i teknologjisë kundër ndjenjës,
- proteinat dhe molekulat tjera: inxhineringu artificial proteinave dhe peptideve (përfshirë hormonet e molekulave të mëdha), metodat e dërgimit të përmirësuar për ilaçet e molekulave të mëdha, proteomikët, izoluesin dhe pastruesin e proteinës, sinjalizimi, identifikimi i receptorëve të qelizës,
- kultivimi dhe inxhinieringu i qelizës dhe indit: kultivimi i qelizës/indit, inxhineringu i indit (përfshirë ngritjet e indit dhe inxhinieringut biomedicinal), fuzioni qelizor, simulantët e vaksinave/imunitetit, manipulimi i embrionit,
- teknikat e procesit bioteknologjik: fermentimin duke përdorur bioreaktorët, bioprocesimin, biokullimi, biopulpimi, biozbardhje, biodesulfurimi, biomjekimi, biofiltrimi dhe fitomjekimi,
- gjenet dhe vektorët RNA: terapia gjenetike, vektorët viral,

- bioinformatika: ndërtimi i databazave mbi gjenomet, sekuencat e proteinave, modelimin e proceseve komplekse biologjike, përfshirë sistemet biologjike,
- nanobioteknologjia: zbaton mjetet dhe proceset e nano /mikrofabrikimit për të ndërtuar aparate për studimin e biosistemeve dhe aplikimet në shpërndarjen e ilaçit, diagnostik etj.

### 72.19 Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri

Kjo klasë përfshin:
- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental mbi shkencat natyrore dhe inxhinieringun ndryshe nga kërkimi bioteknologjik dhe zhvillim eksperimental:
  - kërkimi dhe zhvillimi mbi shkencat natyrore,
  - kërkimi dhe zhvillimin në inxhiniering dhe teknologji,
  - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat medicinale,
  - kërkimi dhe zhvillimi në shkencat bujqësore,
  - kërkimin dhe zhvillimin interdisiplinar, duke mbisunduar në shkencat natyrore dhe inxhineringut.

## 72.2 Kërkimi dhe Zhvillimi Eksperimental në Shkencat Shoqërore dhe Humane

### 72.20 Kërkimi dhe zhvillimi eksperimental në shkencat shoqërore dhe humane

Kjo klasë përfshin:
- kërkimin dhe zhvillimin në shkencat sociale,
- kërkimin dhe zhvillimin në shkencat humane,
- kërkimin dhe zhvillimin interdisiplinor, duke mbizotëruar në shkencat sociale dhe humane.

Kjo klasë përjashton:
- hulumtimin e tregut, shih 73.20.

# 73 Publiciteti dhe Hulumtimi i Tregut

Kjo ndarje përfshin krijimin e kampanjave të reklamimit dhe plasmanin e reklamimit të tillë në shtypin periodikë, gazetat, radiot dhe televizionet, apo media tjera si dhe dizajnimin e strukturave dhe lokacioneve të ekspozimit.

## 73.1 Publiciteti

### 73.11 Agjencitë për publicitet

Kjo klasë përfshin dhënien e një shkalle të plotë të shërbimeve reklamuese (d.m.th. mundësive nëpër shtëpi apo nënkontraktim), përfshirë shërbimet këshillimore, creative, prodhimin e materialit reklamues dhe blerjen.

Kjo përfshin:
- krijimin dhe realizimin e kampanjave reklamuese:

  - krijimin dhe plasimin e reklamimit nëpër gazeta, periodik, radio, televizion, internet dhe media tjera,
  - krijimin dhe plasimin e reklamimit të jashtëm, p.sh. billboardat, panelet, buletinet dhe kornizat, veshjen e dritareve, dizajnimin e dhomave ekspozuese, reklamimin në vetura dhe autobusë etj.,
  - reklamimin në ajër,
  - distribuimin apo dorëzimin e materialit, apo mostrave të reklamimit,
  - krijimin e shtandeve dhe strukturave dhe lokacioneve tjera të ekspozimit;
- kryerjen e kampanjave të marketingut dhe të shërbimeve tjera reklamuese, të drejtuara në tërheqjen dhe ruajtjen e myshterinjve:
  - promovimin e produkteve,
  - pikën e marketingut të shitjes,
  - reklamimin direkt postar,
  - reklamimi i marketingut.

Kjo klasë përjashton:

- botimin e materialit reklamues, shih 58.19,
- prodhimin e televizioneve dhe të filmit të mesazheve komerciale, shih 59.11,
- prodhimin e mesazheve komerciale për radio, shih 59.20,
- hulumtimin e tregut, shih 73.20,
- fotografimin reklamues, shih 74.20,
- organizatorët e konventave dhe të ekspozitave tregtare, shih 82.30,
- aktivitetet postare, shih 82.19.

#### 73.12 Publiciteti përmes mediave

Kjo klasë përfshin:

- përfaqësimin medial, d.m.th. shitjen apo rishitjen e kohës dhe hapësirës për reklamime të ndryshme mediale.

Kjo klasë përjashton:

- shitjen e kohës apo hapësirës reklamuese drejtpërsëdrejti nga pronarët e kohës, apo hapësirës (publikuesit etj.), shih klasën e aktivitetit koreospondues - aktivitetet e relacionit me publikun, shih 70.21.

### 73.2 Hulumtimi i Tregut dhe Matja e Opinionit Publik (Sondazhet)

#### 73.20 Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet)

Kjo klasë përfshin:

- investigimin në potencialin e tregut, vetëdijesimin, pranimin dhe njohjen e mallrave si dhe blerjen e shprehive nga konsumatorët, për qëllim të promovimit të shitjes dhe të zhvillimit të artikujve dhe shërbimeve të reja, përfshirë analizat statistikore të rezultateve,
- investigimin e opinionit kolektiv të publikut mbi çështjet politike, ekonomike dhe sociale, si dhe të analizës statistikore.

# 74 Aktivitete të Tjera Profesionale, Shkencore dhe Teknike

Kjo ndarje përfshin, dhënien e shërbimeve profesionale shkencore dhe teknike (përveç aktiviteteve ligjore dhe të kontabilitetit, aktivitetet arkitekturale dhe inxhinierike, testimin dhe analizën teknike, menaxhimin dhe aktivitetet konsultative të menaxhimit, aktivitetet kërkimore zhvillimore dhe reklamuese).

## 74.1 Aktivitetet e Specializuara të Dizajnit

### 74.10 Aktivitetet e specializuara të dizajnit

Kjo klasë përfshin:

- dizajnimin e modelimit lidhur me tekstilet, rrobat e veshjes, këpucët, argjendarinë, mobilet dhe dekorimin tjetër të brendshëm dhe mallrat tjera, të mënyrës së veshjes si dhe artikujt tjerë personal apo shtëpiak,
- dizajnimin industrial, p.sh. krijimin dhe zhvillimin e dizajnëve dhe specifikave që mundësojnë përdorimin, vlerësimin dhe paraqitjen e produkteve, përfshirë përcaktimin e materialeve, mekanizmit, formës, ngjyrës dhe përfundimet sipërfaqësore të produktit, duke marrë parasysh karakteristikat dhe kërkesat e njeriut dhe të sigurisë, të apelit të tregut, të distribuimit, përdorim dhe mirëmbajtje,
- aktivitetet e dizajnerëve grafik,
- aktivitetet e dekoratorëve të interierit.

Kjo klasë përjashton:

- dizajnimin dhe programimin e ueb-portave, shih 62.01,
- dizajnimin arkitektural, shih 71.11,
- dizajnimin inxhinierik, d.m.th. zbatimin e ligjeve dhe principeve fizike të inxhinieringut në dizajnimin e makinave, materialeve, instrumenteve, strukturave, proceseve dhe sistemeve, shih 71.12.

## 74.2 Aktivitetet e Fotografimit

### 74.20 Aktivitetet e fotografimit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fotografisë komerciale dhe të konsumatorit:
  - fotografimin e portreteve për pasaporta, shkolla, dasma etj.,
  - fotografimin për qëllime të reklamave, për botuesit, revy modash, patundshmëri dhe turistike,
  - fotografimin ajror,
  - videoincizimin e ngjarjeve: dasmave, takimeve etj.
- procesimin filmor:
  - zhvillimin, printimin dhe rritjen nga negativat e klientëve apo të kino-filmave,
  - zhvillimin e filmit dhe laboratorët e fotoprintimit,
  - shitoret e fotografimit një orë (jo pjesë e shitoreve të kamerave),

  - montimin e sllajdeve,
  - kopjimin dhe rikthimin apo riprekjen e transparencës, lidhur me fotografitë;
- aktivitetet e fotoreporterëve.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- mikrofilmimin e dokumenteve.

Kjo klasë përjashton:
- procesimin e fotografisë filmike lidhur me industritë e filmit dhe të televizionit, shih 59.12,
- aktivitetet e informacioneve hartografike dhe hapësinore, shih 71.12,
- përdorimin e fotomakinave (vetshërbyese) të operuara me para të metalta, shih 96.09.

## 74.3 Aktivitetet e Përkthimit dhe Interpretimit

### 74.30 Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit

## 74.9 Aktivitetet e Tjera Profesionale, Shkencore dhe Teknike P.K.T.

### 74.90 Aktivitetet e tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t.

Kjo klasë përfshin një llojllojshmëri të madhe të aktiviteteve shërbyese në përgjithësi, dhënë klientëve komercial. Kjo klasë përfshin ato aktivitete për të cilat kërkohen nivele më të larta të avancuara, profesionale, shkencore dhe teknike, por nuk përfshin funksionet rutine të biznesit në vazhdim, që në përgjithësi janë të kohëzgjatjes së shkurtër.

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet e ndërmjetësimit biznesor, d.m.th. aranzhimin për blerjen dhe shitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, përfshirë praktikat profesionale, por duke mos përfshirë ndërmjetësimin në patundshmëri,
- aktivitetet e ndërmjetësimit të patentës (aranzhimin për blerjen dhe shitjen e patenteve),
- aktivitetet e vlerësimit ndryshe nga të patundshmërisë dhe të sigurimit (për gjësende antike, argjendari, etj.),
- auditimi i faturave dhe informatave të nivelit të transportit,
- aktivitetet e parashikimit të motit,
- konsultimin e sigurimit,
- konsultimin e agronomisë,
- konsultimin mjedisor,
- konsultimin tjetër teknik,
- aktivitetet e konsulentëve, ndryshe nga konsulentët arkitektural, inxhinieringut dhe të menaxhmentit,
- aktivitetet e anketuesve të sasisë.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- aktivitetet e kryera nga agjentët dhe agjencitë, në emër të individëve që zakonisht janë të përfshirë në marrjen e angazhimeve në prodhimin e filmit, shfaqjeve teatrore apo të atraksioneve tjera argëtuese, sportive dhe plasmanin e librave, dramave, veprave artistike, fotografive etj., me botuesit, producentët etj,.

Kjo klasë përjashton:

- shitje me shumicë të përdoruesve me ankand, shih 45.1,
- aktivitetet e ankandit online (shitje me pakicë), shih 47.91,
- aktivitetet e shtëpive të ankandeve (shitje me pakicë), shih 47.79,
- aktivitetet e brokerëve të patundshmërisë, shih 68.31,
- aktivitetet e mbajtjes së librave, shih 69.20,
- aktivitetet e konsulentëve të menaxhmentit, shih 70.22,
- aktivitetet e konsulentëve të arkitekturës dhe inxhineringut, shih 71.1,
- dizajni industrial dhe i makinerisë, shih 71.12, 74.10,
- kontrollin dhe testimin veterinar në lidhje me prodhimin e ushqimit, shih 71.20,
- ekspozimi i reklamave dhe dizjani i reklamimeve tjera, shih 73.11,
- krijimin e tezgave dhe të strukturave të lokacioneve dhe strukturave tjera të ekspozimit, shih 73.11,
- aktivitetet e organizatorëve të konventave dhe ekspozitave tregtare, shih 82.30,
- aktivitetet e udhëheqësve të pavarur të ankandit, shih 82.99,
- administrimin e programeve të lojalitetit, shih 82.99,
- këshillimi për kredi konsumuese dhe shlyerje të borxhit, shih 88.99.

# 75 Aktivitetet e Veterinarisë

Kjo ndarje përfshin, sigurimin e aktiviteteve të kujdesit dhe të kontrollit të shëndetit të kafshëve, për kafshët nëpër ferma ose për kafshët përkëdhelëse. Këto aktivitete kryhen nga veterinarët e kualifikuar në spitalet e veterinarisë, si dhe gjatë vizitimin të fermave, të kolibeve apo shtëpive në dhomat e veta, të konsultimit, të kirurgjisë, apo tjetër kund.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin, aktivitetet e ambulancës së kafshëve.

## 75.0 Aktivitetet e Veterinarisë

### 75.00 Aktivitetet e veterinarisë

Kjo klasë përfshin:

- kujdesin shëndetësore të kafshëve dhe aktivitetet e kontrollit për kafshët e fermave,
- kujdesin shëndetësor të kafshëve dhe aktivitetet e kontrollit për kafshët përkëdhelëse. Këto aktivitetet kryhen nga veterinarët e kualifikuar, deri sa punojnë në spitalet e veterinarisë si dhe gjatë vizitave të fermave, kolibeve apo shtëpive, në dhomat e veta të konsultimit, kirurgjisë apo tjetër kund.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e asistencave të veterinarisë, apo të personelit tjetër ndihmës të veterinarisë,
- aktivitetet kliniko-patologjike dhe aktivitetet tjera diagonstike për sa i përket kafshëve,
- aktivitetet e ambulancës së kafshëve.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e ruajtjes së kafshëve të fermës pa kujdes shëndetësor, shih 01.62,

- qethjen e dhënëve, shih 01.62,
- shërbimet testuese të kopesë, shërbimet e tufës, shërbimet e agjitacionit, tredhjen e shpezëve, shih 01.62,
- aktivitetet lidhur me insimimin (mbarësimin) artificial, shih 01.62,
- aktivitetet e ruajtjes së kafshëve përkëdhelëse, pa kujdesin shëndetësor, shih 96.09.

# Sektori N – SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Ky sektor përfshin një llojllojshmëri të aktiviteteve që mbështesin operacionet e përgjithshme biznesore. Këto aktivitete ndryshojnë nga ato në sektorin M, pasi që qëllimi primar i tyre nuk është transferi i diturisë së specializuar.

## 77 Aktivitetet e Qiradhënies dhe të Lizingut

Kjo ndarje përfshin dhënien me qira dhe lizingun e aseteve të luajtshme dhe të asteve të jo financiare të pa luajtshme, përfshirë një fushë të gjerë të mallrave të luajtshme, siç janë automobilat, kompjuterët, mallrat e konsumuesve, pajisjet dhe makinerinë industriale dhënë konsumatorëve në kthim prej një qiradhënie periodike apo pagese të qirasë. Kjo ndarje nën ndahet në: 1) dhënien me qira të mjeteve motorike; 2) dhënien me qira të pajisjeve rekreative dhe sportive, si dhe të personelit dhe pajisjes shtëpiake; 3) lizingun e makinerisë tjetër dhe të pajisjeve në llojin e shpeshtë të përdorur për operacione biznesore, përfshirë pajisjet tjera të transportit; dhe 4) lizingun e produkteve të pasurisë intelektuale dhe të produkteve të ngjashme.

Këtu përfshihet vetëm dhënia me qira operuese.

Kjo ndarje përjashton:

- lizingun financiar, shih 64.91,
- dhënien me qira të patundshmërisë, shih sektorin L,
- dhënien me qira të pajisjeve me operator, shih klasat korresponduese sipas aktiviteteve të kryera me këto pajisje, p.sh. ndërtimtari (sektori F), transporti (sektori H).

### 77.1 Marrja dhe Dhënia me Qira (Lizingu) i Automjeteve Motorike

#### 77.11 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i veturave dhe automjeteve të lehta motorike

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingu operacional i llojeve vijuese të mjeteve:
  - të automjeteve për pasagjer dhe të mjeteve tjera të lehta motorike (me peshë që nuk tejkalon 3,5 tonë) pa shofer.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira, apo lizingun e mjeteve të lehta motorike me shofer, shih 49.32, 49.39.

#### 77.12 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i kamionëve

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingun operacional të llojeve vijues të mjeteve:
  - të kamionëve, të rimorkiove të lehta të shërbimit publik dhe të mjeteve të rënda motorike (pasha e të cilëve tejkalon 3,5 tonë),
  - mjetet rekreative.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira apo lizingun e mjeteve të rënda për mallra të kamionëve me shofer, shih 49.41.

## 77.2 Marrja dhe Dhënia me Qira (Lizingu) i Artikujve Personalë dhe Shtëpiakë

Ky grup përfshin dhënien me qira të artikujve personal dhe shtëpiak, si dhe dhënien me qira të pajisjeve rekreative, sportive dhe të videokasetave. Këto aktivitete në përgjithësi përfshin qiradhënien afatshkurtër të mallrave edhe pse në disa raste mallrat mund të jepen me qira për periudha më të gjata kohore.

### 77.21 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i artikujve rekreativë dhe sportivë

Kjo klasë përfshin dhënien me qira të pajisjeve rekreative:

- të barkave për kënaqësi, kaikeve, lundrave,
- biçikletave,
- karrigeve dhe ombrellave të plazhit,
- pajisjeve tjera sportive,
- skijave.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të barkave të kënaqësisë dhe të barkave lundruese me ekip, shih 50.10, 50.30,
- dhënien me qira të videokasetave dhe disqeve, shih 77.22,
- dhënien me qira të artikujve tjerë personal dhe shtëpiak n.e.c., shih 77.29,
- dhënien me qira të pajisjeve për aktivitetet e lira dhe argëtim, si një pjesë integrale e mjeteve rekreative.

### 77.22 Marrja dhe dhënia me qira e video-kasetave dhe disqeve

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira të videokasetave, pllakave, CD, DVD, etj.

### 77.29 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e artikujve të tjerë personalë dhe shtëpiakë

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira të të gjitha llojeve të artikujve personal apo shtëpiak për ekonomitë shtëpiake apo industritë (përveç pajisjeve rekreative dhe sportive):
  - tekstilet, rrobat e veshjes dhe veshmbathjen,
  - mobilet, poçerinë dhe qelqin, artikujt e kuzhinës dhe të tavolinës, instalimet elektrike dhe artikujt shtëpiak,
  - argjendarinë, instrumentet muzikore, dekorimet dhe kostumet,
  - librat dhe revistat,
  - makinerinë dhe pajisjet e përdorura nga amatorët apo si hobi, p.sh. mjetet për riparime shtëpiake,
  - lulet dhe bimët,
  - pajisjet elektronike për shfrytëzim shtëpiak.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të veturave, kamionëve, rimorkiove dhe të mjeteve rekreative pa shofer, shih 77.1,
- dhënien me qira të mjeteve rekreative dhe sportive, shih 77.21,
- dhënien me qira të videokasetave dhe disqeve, shih 77.22,
- dhënien me qira të mobileve të zyrave, shih 77.33,
- dhënien me qira të motoçikletave dhe karvanëve pa shofer, shih 77.39,
- dhënien e teshave, uniformave punuese dhe të artikujve tjerë nga rrobalarëset publike, shih 96.01.

## 77.3 Marrja dhe Dhënia me Qira (Lizingu) e Makinerisë, Pajisjeve dhe e Mallrave të Tjerë të Luajtshëm

### 77.31 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve bujqësore

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingun operacional të makinerisë, pajisjes bujqësore dhe pyjore pa operator,
- dhënien me qira të produkteve të prodhuara nga klasa 28.30, siç janë traktorët bujqësor, etj.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të pajisjeve apo makinerisë pyjore me operator, shih 01.61, 02.40.

### 77.32 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve të ndërtimtarisë dhe inxhinierisë

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingun operacional të makinerisë, pajisjeve të ndërtimit dhe inxhineringut civil pa operator,
- kamionët e kraneve,
- skelet dhe platformat punuese, pa ngritje dhe çmontim.

Kjo klasë përjashton:

- dhënien me qira të makinerisë apo pajisjeve ndërtimore dhe inxhineringut civil me operator, shih ndarjen 43.

### 77.33 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve të zyrave (përfshirë kompjuterët)

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingun operacional të makinerisë dhe pajisjeve të zyrave pa operator:
  - kompjuterët dhe pajisjet periferike të kompjuterit,
  - makinat kopjuese, e shkrimit dhe makinat e përpunuese të fjalëve,
  - pajisjen dhe makinerinë e kontabilitetit: regjistrat e arkave, kalkulatorët elektronik, mobilet e zyrave.

### 77.34 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e pajisjeve të transportit ujor

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe lizingun operacional të pajisjeve të transportit ujor pa operator:
  - barkat dhe anijet komerciale.

Kjo klasë përjashton:

- dhënia me qira të mjeteve të transportit ujor me operator, shih ndarjen 50,
- dhënien me qira të barkave të argëtimit, shih 77.21.

### 77.35 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e pajisjeve të transportit ajror

Kjo klasë përfshin:
- dhënien me qira dhe lizingun operacional të mjeteve të transportit ajror me operator:
  - aeroplanët,
  - ballonët me ajër të nxehtë.

Kjo klasë përjashton:
- dhënien me qira të mjeteve të transportit ajror me operator, shih ndarjen 51.

### 77.39 Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të luajtshëm p.k.t.

Kjo klasë përfshin:
- dhënien me qira dhe lizingun operacional, pa operator, të pajisjeve dhe makinerisë tjetër që në përgjithësi përdoren si mallra kapitale nga industritë:
  - motorët dhe turbinat,
  - mjetet e makinerisë,
  - pajisjet e minierave dhe të fushave të naftës,
  - pajisjet e komunikimit profesional radio televiziv,
  - pajisjet e prodhimit të filmave,
  - pajisjet e matjes dhe të kontrollimit,
  - makineritë tjera shkencore, komerciale dhe industriale;
- dhënia me qira dhe lizingu operacional të mjeteve të transportit tokësor (ndryshe mjetet tjera motorike) pa shoferë:
  - motoçikletat, karvanët dhe kamp shtëpizat etj.,
  - mjetet hekurudhore.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- dhënien me qira të kontejnerëve të akomodimit apo të zyrave,
- dhënien me qira të kafshëve (p.sh. kopeve, kuajve të vrapimit),
- dhënien me qira të kontejnerëve,
- dhënien me qira të paletave.

Kjo klasë përjashton:
- dhënien me qira të biçikletave, shih 77.21,
- dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerisë bujqësore dhe pyjore, shih 77.31,
- dhënien me qira të pajisjes dhe makinerisë ndërtimore dhe të inxhinieringut civil, shih 77.32,
- dhënien me qira e pajisjeve dhe makinerisë të zyrave përfshirë kompjuterët, shih 77.33.

## 77.4 Dhënia me Qira (Lizingu) e Pronës Intelektuale dhe e Produkteve të Ngjashme, përveç Punimeve me të Drejtë të Autorit

### 77.40 Dhënia me qira (lizingu) e pronës intelektuale dhe e produkteve të ngjashme, përveç punimeve me të drejtë të autorit

Kjo klasë përfshin, aktivitetet e lejimit të personave tjerë për të përdorur produktet e pasurisë intelektuale dhe produkteve të ngjashme, për të cilët është paguar një pagesë mbi të drejtën e autorit apo të licensimit pronarit të produktit (d.m.th. mbajtësit të pronës). Lizingu i këtyre produkteve mund të ketë forma të llojllojshme, siç është lejimi për repredukim, përdorimi i proceseve apo produkteve vijuese, operimin e bizneseve sipas sistemit të françizës etj. Pronarët aktual, mund t'i kenë, apo mund të mos i kenë krijuar këto produkte.

Kjo klasë përfshin:

- lizingun e produkteve të pronës intelektuale (përveç veprave me të drejtë të autorit, siç janë librat apo softuerët),
- marrjen e tatimit mbi të drejtën e autorit apo pagesave të licencimit për përdorimin:
  - subjekteve të patentuara,
  - markave tregtare apo të shërbimeve,
  - emrat e markave,
  - eksplorimin dhe vlerësimin e mineraleve,
  - marrëveshjet françize.

Kjo klasë përjashton:

- fitimin e të drejtave dhe publikimin, shih ndarjen 58 dhe 59,
- prodhimin, riprodhimin dhe distribuimin e veprave me të drejtë të autorit (librave, softuerëve, filmave), shih ndarjet 58, 59,
- lizingun e patundshmërisë, shih 68.20,
- lizingun e produkteve (aseteve), shih grupet 77.1, 77.2, 77.3.

# 78 Aktivitetet e Punësimit

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e radhitjes së vendeve të zbrazëta të punësimit dhe të referimit, apo vendosjes të aplikantëve për punësim, kur individët referuar apo të vendosur nuk janë punonjës të agjencive të punësimit, furnizimin e punëtorëve për bizneset e klientëve për periudha kohore të kufizuara, për plotësimin e forcës punuese të klientit si dhe aktivitetet e sigurimit të burimeve tjera njerëzore.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e kërkimit dhe plasmanit ekzekutiv,
- aktivitetet e agjencive të shfaqjeve teatrore.

Kjo ndarje përjashton:

- aktivitetet e agjentëve për artistët individual, shih 74.90.

## 78.1 Aktivitet e Agjencive të Punësimit

### 78.10 Aktivitet e agjencive të punësimit

Kjo klasë përfshin, shpalljen e vendeve të lira të punës dhe i udhëzon apo punëson kandidatët, por këta nuk janë punonjës të agjencisë përkatëse.

Kjo klasë përfshin:

- kërkimin e personelit, aktivitetet e seleksionimit referues dhe të vendosjes, përfshirë vendosjen ekzekutive dhe aktivitetet e kërkimit,
- aktivitete e agjencive dhe të byrove të ndarjeve të roleve, siç janë agjencitë e ndarjeve të roleve teatrore,
- aktivitetet e agjencive të punësimit online.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e agjentëve ose agjencive të teatrove dhe artistëve, shih 74.90.

## 78.2 Aktivitetet e Agjencive të Punësimit të Përkohshëm

### 78.20 Aktivitetet e agjencive të punësimit të përkohshëm

Kjo klasë përfshin aktivitetet e furnizimit të bizneseve të klientëve me punëtorë, për periudha të kufizuara kohore, për zëvendësim të përkohshëm apo plotësimin e fuqisë punuese të klientit, ku individët e siguruar janë punonjës të një njësiti për dhënien e shërbimeve të ndihmës së përkohshme. Megjithatë, njësitë e klasifikuara këtu nuk sigurojnë mbikëqyrje direkt të punonjësve të tyre në vend punishtet e klientëve të tyre.

## 78.3 Sigurimi i Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimi i Funksioneve të Burimeve Njerëzore

### 78.30 Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore

Kjo klasë përfshinë, aktivitetet e sigurimit të burimeve humane për bizneset e klientëve të tyre. Njësitë e klasifikuara këtu, përfaqësojnë punonjësin e shënimeve për punonjësit mbi çështjet lidhur me listën e pagave, tatimeve, të çështjeve tjera të burimeve humane dhe fiskale, por ato nuk janë përgjegjëse për drejtimin dhe mbikëqyrjen e punonjësve. Sigurimi i resurseve humane, zakonisht bëhet në bazë të një afati të gjatë apo permanent dhe njësitë e klasifikuara, këtu në një fushë të gjerë të resurseve humane dhe të detyrave të menaxhmentit të personelit lidhur me këtë sigurim.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e funksioneve të resurseve humane bashkë me mbikëqyrjen apo drejtimin e biznesit, shih klasën e aktivitetet përkrahës ekonomike të atij biznesi,
- sigurimin e resurseve humane për zëvendësim të përkohshëm, apo plotësimin e fuqisë punëtore të klientit, shih 78.20.

# 79 Agjencitë e Udhëtimit, Operatorët Turistikë dhe Shërbimet e Rezervimeve të Tjera dhe Aktivitetet Lidhur me To

Kjo ndarje përfshin, aktivitetin e agjencive të angazhuara, kryesisht në shitjen e shërbimeve të udhëtimit turneve, transportit dhe akomodimit e publikut të përgjithshëm dhe të klientëve komercial, aktivitetin e aranzhimit dhe përgatitjen e turneve që shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit, apo direkt nga agjentët, siç janë operatorët e turneve dhe shërbimet tjera lidhur me udhëtimin, përfshirë

shërbimet e rezervimit. Aktivitetet e ciceronëve (guidave) turistike dhe të aktiviteteve të promovimit të turizmit, janë të përfshira gjithashtu.

## 79.1 Agjencitë e Udhëtimit dhe Aktivitetet e Operatorëve Turistikë

Ky grup përfshin, aktivitetin e agjencive të angazhuara kryesisht në shitjen e shërbimeve të udhëtimit, turneve, transportit, akomodimit e publikut të përgjithshëm dhe klientëve komercial, aktivitetin e aranzhimit dhe përgatitjen e turneve që shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit, apo direkt nga agjentët, siç janë operatorët e turneve.

### 79.11 Aktivitetet e agjencive të udhëtimit

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e agjencive të angazhuara kryesisht në shitjen e shërbimeve të udhëtimit, turneve, transportit dhe akomodimit në bazë të shitjes me shumicë apo pakicë të publikut dhe klientëve komercial.

### 79.12 Aktivitetet e operatorëve turistikë

Kjo klasë përfshin:

- aranzhimin dhe përgatitjen e turneve të shitura nëpërmes agjencive të udhëtimit, apo direkt nga operatorët e turneve. Turnet mund të përfshijnë njërin apo të gjitha nga vijuesit:
  - transportin,
  - akomodimin,
  - ushqimin,
  - vizitat e muzeve, lokacionet historike apo kulturore, ngjarjet teatrore, muzikore apo sportive.

## 79.9 Shërbimet e Tjera të Rezervimit dhe Aktivitetet e Lidhura me To

### 79.90 Shërbimet e tjera të rezervimit dhe aktivitetet e lidhura me to

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e rezervimit lidhur me udhëtimin:
  - rezervimet për transportin, hotelet, restorantet, marrje me qira të veturave, argëtimit dhe sportit etj.,
  - shërbimet për ndarjes së kohës,
  - aktivitetet e shitjeve të biletave për ngjarje teatrore, sportive dhe të ngjarjeve tjera argëtuese dhe zbavitëse;
- shërbimet e asistencës së vizitorit:
  - dhënien e informatave të udhëtimit për vizitorët,
  - aktivitetet e guidave turistike,
- aktivitetet promovuese të turizmit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe të operatorëve të turneve, shih 79.11, 79.12,
- organizimi dhe menaxhimi i ngjarjeve, siç janë takimet, konventat dhe konferencat, shih 82.30.

# 80 Aktivitetet e Sigurisë dhe të Hetimit

Kjo ndarje përfshin, shërbimet lidhur me sigurimin, siç janë shërbimet hetimore dhe të zbulimit, shërbimet e gardave dhe të patrullave, marrjen dhe dërgimin e parave të hyrjeve në arkë, apo të artikujve tjerë të vlefshëm me pajisje dhe personel për të mbrojtur pasuritë e tilla, deri sa janë në transit, përdorimin e sistemeve alarmuese të sigurisë elektrike, siç janë alarmet e vjedhjes dhe kundër zjarrit, ku aktiviteti përqendrohet në monitorimin nga distanca të këtyre sistemeve, por shpesh përfshijnë edhe shitjen, instalimin dhe shërbimet riparuese. Nëse komponentët e fundit sigurohen ndaras, ato përjashtohen nga kjo ndarje, klasifikohen në shitjen me pakicë, ndërtimtari etj.

## 80.1 Aktivitetet e Sigurisë Private

### 80.10 Aktivitetet e sigurisë private

Kjo klasë përfshin dhënien e njërit apo më shumë të shërbimeve vijues: të rojës dhe patrullimit, marrjes dhe dërgimit të parave, hyrjeve të arkave, apo artikujve tjerë të vlefshëm me pajisje dhe personel për të mbrojtur pasuritë e tilla gjatë transitit.

Kjo klasë përfshin:
- shërbimet e mjeteve të blinduara,
- shërbimet e rojeve,
- shërbimet poligrafike,
- shërbimet e shenjave të gishtërinjve,
- shërbimet e gardave të sigurisë,
- grimcimin e informatave të sigurisë mbi çdo media.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet e rendit dhe të sigurisë publike, shih 84.24.

## 80.2 Shërbimet e Sigurisë me Ndihmën e Sistemeve të Sigurisë

### 80.20 Shërbimet e sigurisë me ndihmën e sistemeve të sigurisë

Kjo klasë përfshin:

- monitorimin apo monitorimin nga distanca të sistemeve alarmuese të sigurimit elektronik, siç janë kundër vjedhjes dhe zjarrit, përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre,
- instalimin, riparimin, rindërtimin dhe rregullimin e mjeteve të kyçjes mekanike apo elektronike të arkave dhe të kasafortave të blinduara, lidhur me monitorimin e më vonshëm dhe monitorim në distancë. Njësitë që kryejnë këto aktivitete, mund të angazhohen në shitjen e sistemeve të tilla të sigurimit të aparateve të kyçjes mekanike apo elektronike të arkave dhe të kasafortave të blinduara.

Kjo klasë përjashton:
- instalimin e sistemeve të sigurimit, siç janë alarmet kundër vjedhjes dhe zjarrit pa monitorim të mëvonshëm, shih 43.21,

- shitjen me pakicë të sistemeve të alarmeve të sigurimit elektrik të pajisjeve të kyçjes mekanike apo elektronike, të arkave dhe kasafortave të blinduara në shitoret e specializuara pa monitorim, shërbimet e instalimit apo mirëmbajtës, shih 47.59,
- konsulentët e sigurimit, shih 74.90,
- aktivitetet e rendit dhe sigurisë publike, shih 84.24,
- sigurimin e shërbimeve kryesore të kuptimit, shih 95.29.

## 80.3 Aktivitetet e Hetimit

### 80.30 Aktivitetet e hetimit

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet e shërbimeve hetimore dhe të zbulimit,
- aktivitetet e të gjithë hetuesve privat, të pavarur nga lloji i klientit apo qëllimi i hetimit.

# 81 Shërbimet ndaj Ndërtesave dhe Shesheve

Kjo ndarje përfshin sigurimin e një numri të shërbimeve të përgjithshme përkrahëse, siç janë sigurimi e një kombinimi të shërbimeve përkrahëse në kuadër të objekteve të klientit, pastrimin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave të të gjitha llojeve, pastrimin e makinerisë industriale, pastrimin e trenave, autobusëve, aeroplanëve, etj., pastrimin e brendësisë së rrugëve dhe të tankerëve detar, aktivitetet dezinfektuese dhe të asgjësimit nëpër ndërtesa, anije trena etj., pastrimin e shisheve, fshirjen e rrugëve, largimin e borës dhe të akullit, sigurimin e shërbimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin e peizazhit dhe sigurimin e këtyre shërbimeve bashkë me dizajnimin e planeve të peizazhit dhe/ose të ndërtimit (d.m.th. instalimit) kalimet e këmbësorëve, muret mbrojtës, platformave, rrethojat, pellgjet dhe ndërtimet e ngjashme.

## 81.1 Aktivitetet Përkrahëse të Objekteve të Kombinuara

### 81.10 Aktivitetet përkrahëse të objekteve të kombinuara

Kjo klasë përfshin sigurimin e kombinimit të shërbimeve përkrahëse brenda objekteve të klientit. Këto aktivitete përfshin, pastrimin e brendshëm të përgjithshëm, mirëmbajtjen, heqjen e mbeturinave, gardën dhe sigurimin, dërgesat postare, recepcionin, larjen e rrobave dhe shërbimet tjera për të mbështetur operacionet brenda objekteve. Këto aktivitete përkrahëse kryhen nga një staf operacional, i cili nuk është i involvuar më, ose nuk është përgjegjës për biznesin thelbësor apo aktivitetet e klientit.

Kjo klasë përjashton:
- sigurimin e vetëm të njërit prej shërbimeve përkrahëse (p.sh. shërbimet e pastrimit të brendshëm, të përgjithshëm) apo adresimin e vetëm të një funksioni të vetëm (p.sh. ngrohjen), shih klasën e përshtatshme sipas shërbimit të siguruar,

- sigurimin e stafit menaxhues dhe operues për funksionimin komplet të ndërmarrjes së klientit, siç është hoteli, restoranti, xeherorja, apo spitali, shih klasën e njësisë së operuar,
- sigurimin në vendpunishte të funksionimit dhe menaxhimit të sistemeve kompjuterike të klientit dhe/ose të objekteve për procesimin e të dhënave, shih 62.03,
- funksionimin e objekteve korrektuese në bazë të kontratës apo pagesës, shih 84.23.

## 81.2 Aktivitetet e Pastrimit

Ky grup përfshin aktivitetet e pastrimit të brendshëm dhe të përgjithshëm të të gjitha llojeve të ndërtesave, pastrimin e jashtëm të ndërtesave aktivitetet e specializuara të pastrimit për ndërtesat apo aktivitetet tjera të specializuara të pastrimit, pastrimin e makinerisë industriale, pastrimin e brendësisë së rrugëve dhe të tankerëve të detit, aktivitetet dezinfektuese dhe të asgjësimit për hapësirat e ndërtesave dhe të makinerisë industriale, pastrimin e shisheve, fshirjen e rrugëve dhe largimin e borës dhe të akullit.

Ky grup përjashton:

- kontrollimin e insekteve bujqësore, shih 01.61,
- pastrimin e ndërtesave të reja menjëherë pas ndërtimit, shih 43.39,
- pastrimin me avull, ajrosje me rërë dhe aktivitetet e ngjashme për pjesët e jashtme të ndërtesave, shih 43.99,
- larjen e qilimave dhe të sixhadeve, pastrimin e draperëve dhe të perdeve, shih 96.01.

### 81.21 Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e përgjithshëm (jo të specializuara):
  - zyrave,
  - shtëpive dhe apartamenteve,
  - fabrikave, dyqaneve, institucioneve,
- pastrimin gjeneral (jo të specializuar) të lokaleve tjera biznesore, profesionale dhe të ndërtesave banesore me shumë apartamente.

Këto aktivitete kryesisht kanë të bëjnë me pastrimin e brendshëm edhe pse ato mund të përfshijnë pastrimin e zonave të jashtme përcjellëse, siç janë dritaret apo korridoret.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e specializuara të pastrimit, siç është pastrimi i dritareve, pastrimi i oxhaqeve, vatrave të zjarrit, kaminëve, stufave, furrave, furrat e djegies së mbeturinave, kaldajave, gypat e ventilimit, gypat e nxjerrjes së ajrit, shih 81.22.

### 81.22 Aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave, objeteve industriale

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e jashtëm të të gjitha llojeve të ndërtesave, përfshirë zyrat, fabrikat, dyqanet, institucionet si dhe lokalet tjera biznesore, profesionale dhe ato të ndërtesave banesore me shumë apartamente,

- aktivitetet e specializuara të pastrimit për ndërtesat, siç është pastrimi i dritareve, oxhaqeve, vatrave,
- kaminëve, stufave, furrave, furrat e djegies së mbeturinave, kaldajave, gypat e ventilimit, gypat e nxjerrjes së ajrit,
- pastrimin e makinerisë industriale,
- aktivitetet tjera të pastrimit të ndërtesave dhe industriale, p.k.t.

Kjo klasë përjashton:

- pastrimin me avull dhe ajrosjen me rërë dhe aktivitetet e ngjashme për pjesët e jashtme të ndërtesave, shih 43.99.

### 81.29 Aktivitetet e tjera të pastrimit

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e pastrimit dhe të mirëmbajtjes së pishinave,
- pastrimin e trenave, autobusëve, aeroplanëve, etj.,
- pastrimin e brendësisë së rrugëve dhe të tankerëve të detit,
- aktivitetet dezinfektuese dhe asgjësuese,
- pastrimin e shisheve,
- larjen e rrugëve dhe heqjen e borës e të akullit,
- aktivitetet tjera të pastrimit, p.k.t.

Kjo klasë përjashton:

- kontrollin e insekteve bujqësore, shih 01.61,
- pastrimi ne automobilave, larjen e veturave, shih 45.20.

## 81.3 Aktivitete Shërbimi të Mirëmbajtjes dhe të Kujdesit të Shesheve (Mjedisit)

### 81.30 Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit)

Kjo klasë përfshin:

- mbjelljen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e:
  - ▪ parqeve dhe kopshteve për:
  - banesat publike dhe private, ndërtesat publike dhe gjysmë publike (shkollat, spitalet, ndërtesat administrative, ndërtesat fetare etj.),
  - hapësirat komunale (parqet, zonat e gjelbra, varrezat etj.),
  - gjelbërimin përskaj autostradave (rrugëve, linjave të trenit dhe të tramvajit, kanaleve të lundrueshëm, porteve),
  - ndërtesat komerciale dhe industriale;
- gjelbërimin për:
- ▪ ndërtesat (kopshtet e çative, gjelbërimin e fasadave, kopshtet e brendshëm etj.),
- ▪ fushat sportive (të futbollit, të golfit etj.), fushat e lojërave, lëndinat për rrezitje dhe parqet tjera rekreative,
- ▪ ujërat e palëvizshme dhe të rrjedhshëm (pellgjet ujore, zonat e lagështa alternuese, liqet e vegjël, pishinat, kanalet, vijat e ujit, sistemet e bimëve të ujërave të zeza),
- bimët për mbrojtje nga zhurma, era, erozioni, pamja dhe verbërimi.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin dhe mbjelljen komerciale për prodhimin komercial të bimëve, drunjtëve, shih ndarjet 01, 02,
- fidanishtet e drurit dhe fidanishtet e drurit pyjor, shih 01.30, 02.10,
- mbajtjen e tokës në kushte të mira mjedisore për shfrytëzim bujqësor, shih 01.61,
- aktivitetet ndërtimore për qëllime të peizazhit, shih sektorin F,
- dizajnimi i peizazhit dhe aktivitetet arkitekturale, shih 71.11.

# 82 Administrimi i Zyrave, Mbështetja Administrative dhe Aktivitetet e Tjera Mbështetëse të Bizneseve

Kjo ndarje përfshin sigurimin e shërbimeve administrative të një shkalle ditore për zyrat, si dhe funksionet rutinë në vazhdim të përkrahjes biznesore për të tjerët, në bazë të kontratës apo të pagesës.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin, të gjitha aktivitetet shërbyeses të përkrahjes në mënyrë tipike të dhëna për bizneset jo të klasifikuara tjetërkund. Njësitë e klasifikuara në këtë ndarje, nuk sigurojnë staf operacional për të kryer operacionet komplete të një biznesi.

## 82.1 Zyrat Administrative dhe Aktivitetet Mbështetëse

Ky grup përfshin, sigurimin e shërbimeve administrative të zyrës në shkallë ditore, siç është planifikimi financiar, mbajtja e librave të faturave dhe të shënimeve, distribuimin e personelit fizik si dhe të logjistikës për të tjerët, në bazë të kontratës apo pagesës.

Ky grup gjithashtu përfshin, aktivitetet përkrahëse për të tjerët në bazë të kontratës apo pagesës, që janë funksione të vazhdueshme rutinore të përkrahjes biznesore, që bizneset dhe organizatat në mënyrë tradicionale i bëjnë për vete.

Njësitë e klasifikuara në këtë grup nuk sigurojnë staf operacional për të kryer operacionet komplete të një biznesi. Njësitë e angazhuara në një aspekt të veçantë të këtyre aktiviteteve janë klasifikuar sipas atij aktiviteti të posaçëm.

### 82.11 Aktivitetet e kombinuara shërbyese të administrimit të zyrave

Kjo klasë përfshin sigurimin e kombinimit të shërbimeve administrative ditore për zyrat, siç është recepcioni, planifikimi financiar, mbajtja e librave dhe të faktuarve të shënimeve, shërbimet e personelit dhe postare etj., për të tjerët në bazë të kontratës apo pagesës.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e vetëm një aspekti të veçantë të këtyre aktiviteteve, shih klasën sipas atij aktiviteti të veçantë,
- sigurimin e stafit operacional pa mbikëqyrje, shih 78.

### 82.19 Fotokopjimi, përgatitja e dokumenteve dhe aktivitetet e tjera të specializuara mbështetëse për zyrat

Kjo klasë përfshin një llojllojshmëri të aktiviteteve të specializuara të përkrahjes për zyra në kopjim dhe përgatitjen e dokumenteve. Aktivitetet e kopjimit/printimit të dokumentit, përfshin këtu vetëm aktivitetet e llojit të procesit të shkurtër të printimit.

Kjo klasë përfshin:

- përgatitjen e dokumentit,
- redaktimin e dokumentit apo lektorimin,
- daktilografimi dhe procesimi i fjalëve,
- shërbimet mbështetëse të sekretarisë,
- transkriptimin e dokumenteve dhe shërbimet tjera të sekretarisë,
- shkrimin e letrave apo të rezymeve,
- sigurimin me qira të kutive postare dhe të shërbimeve tjera të dërgesave postare, siç janë parasortimi, adresimi, etj.,
- fotokopjimi,
- shumëzimi,
- printimi i vizatimeve,
- shërbimet tjera të kopjimit të dokumenteve (pa sigurimin e shërbimeve të printimit, siç është printimi offset, printimi i shpejt, printimi digjital, shërbimet para shtypit).

Kjo klasë përjashton:

- printimin e dokumenteve (printimin offset, printimin e shpejtë etj.), shih 18.12.
- shërbimet para shtypit, shih 18.13.
- zhvillimin dhe organizimin e fushatave të reklamimit postar, shih 73.11.
- shërbimet e specializuara të stenotip, siç është raportimi gjyqësor, shih 82.99,
- shërbimet e stenografisë publike, shih 82.99.

## 82.2 Aktivitetet e Qendrave të Thirrjeve

### 82.20 Aktivitetet e qendrave të thirrjeve

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- aktivitetet e qendrave të thirrjes për brenda, thirrjet e përgjigjes nga klientët, duke përdorur operatorët njerëzor, distribuimin automatik të thirrjes, integrimin kompjuterik të telefonit, sistemet interaktive të përgjigjes së zërit apo të metodave të ngjashme për të marrë urdhra, sigurimin e informacionit të produktit, marrja me kërkesat e konsumatorit për asistencë apo adresimin e ankesave të konsumatorit,
- qendrat e thirrjes së jashtme duke përdorur metoda të ngjashme për të shitur apo tregtuar mallrat, apo shërbimet ndaj konsumatorëve potencial, për të ndërmarrë kërkimin e tregut apo sondazhin e opinionit publik dhe aktivitetet e ngjashme për klientët.

## 82.3 Organizimi të Konferencave dhe Panaireve Afariste

### 82.30 Organizimi të konferencave dhe panaireve afariste

Kjo klasë përfshin organizimin, promovimin ose menaxhimin e ngjarjeve, siç janë ekspozitat biznesore dhe tregtare, konventat, konferencat dhe takimet, qoftë përfshirë apo jo menaxhimi, sigurimi i stafit për të operuar me objektet, në të cilat këto ngjarje zhvillohen.

## 82.9 Aktivitetet Shërbyese Mbështetëse për Bizneset P.K.T.

Ky grup përfshin aktivitetet e agjencive të arkëtimit, byrotë kreditore dhe të gjitha aktivitetet përkrahëse që zakonisht i jepen bizneseve që nuk janë klasifikuar tjetërkund.

### 82.91 Aktivitetet e agjencive të arkëtimit të pagesave dhe zyrave të kreditit

Kjo klasë përfshin:

- grumbullimin ose arkëtimin, marrjen e pagesave dhe kërkesave dhe të urdhëresave të pagesave të arkëtuara tek klientët, siç janë faturat apo shërbimet e arkëtimit të borxheve,
- siç janë historitë e kreditimit dhe të punësimit për individët dhe historitë e kreditimit të bizneseve si dhe sigurimin e informatave për institucionet financiare, tregtarët dhe të tjerët, që kanë nevojë të vlerësojnë besueshmërinë për huamarrje.

### 82.92 Aktivitetet e paketimit (ambalazhimit)

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e ambalazhimit në bazë të pagesës apo të kontratës, qoftë apo jo të përfshirjes së tyre në procesin e automatizuar,
- futjen e likuideve nëpër shishe, përfshirë të pijeve dhe ushqimit,
- ambalazhimin e ngurtë (ambalazhimi me fluskim, mbulimet me folio etj.),
- ambalazhim sigurie i preparateve farmaceutike,
- vënien e tiketave, vënien e pullave dhe vulosjen,
- ambalazhimin e paketave dhe mbështjelljen e dhuratave.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e pijeve të lehta dhe prodhimin e ujit mineral, shih11.07,
- aktivitetet e ambalazhimit të herëpashershëm për transportin, shih 52.29.

### 82.99 Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e repartit tekstualisht dhe të incizimit stenotip të proceseve drejtë të përtretja ligjore si dhe kopjimin e materialeve pasuese të incizuara siç janë:
  - raportet gjyqësore apo shërbimet e incizimit stenotipe,
  - shërbimet e stenografisë publike;
- shërbimet rreth ngjarjeve të vërteta d.m.th. (të njëkohshme), vënia e nëntitujve televizive direkt nga takimet, konferencat, shërbimet e kodimit të adresave, shërbimin e barkodeve,
- shërbimet organizatave të mbledhjeve të parasë në bazë të kontratës, apo pagesës,
- shërbimet e riposedimit,
- shërbimet rreth arkëtimit të parave nga automatet e parkimit,
- aktivitetet e pjesëmarrëseve të pavarur të ankandit,

- administrimin e programeve të besueshmërisë,
- aktivitetet tjera të përkrahjes, dhënë  zakonisht bizneseve jo të klasifikuara tjetërkund.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e shërbimeve të kopjimit të dokumenteve, shih 82.19,
- sigurimin e shërbimeve filmike, të titrimit apo nëntitrimit të kasetave, shih 59.12.

# Sektori O – ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM

Ky sektor përfshin, aktivitetet e karakterit qeveritar, të kryera nga administrata publike. Kjo përfshin shpalljen dhe interpretimin gjyqësor dhe të rregulloreve të tyre përkatëse si dhe administrimin e programeve bazuar në to, aktivitetet legjislative, tatimore, mbrojtëse, nacionale, të rendit dhe të sigurisë publike, shërbimet e emigrimit, punët e jashtme dhe administrimin e programeve qeveritare. Statusi ligjor apo institucional nuk është, në vete faktori vendimtar për një aktivitetet që t'i takojë këtij sektori më para se sa të qenurit e një karakteri të saktësuar në paragrafin e mëparshëm. Kjo d.m.th. se aktivitetet e klasifikuara tjetërkund në NACE nuk bien nën këtë sektor, madje edhe sikur të kryhen nga entet publike. P.sh. administrimi i sistemit shkollor (d.m.th. rregulloret, shqyrtimet, plane programet mësimore) bie nën këtë sektor, por vet të mësuarit nuk bien (shih, sektorin P) dhe burgu, apo një spital ushtarak klasifikohet në shëndetësi (shih, sektorin Q). Në mënyrë të ngjashme, disa aktivitete të përshkruara në këtë sektor, mund të kryhen nga njësitë joqeveritare Ky sektor gjithashtu përfshin aktivitetet e sigurimit të detyruar social.

## 84 Administrata Publike dhe e Mbrojtjes; Sigurimi i Detyrueshëm Social

### 84.1 Administrimi i Politikave Shtetërore, Ekonomike dhe Sociale të Komunitetit

Ky grup përfshin administrimin e përgjithshëm (p.sh. administrimin ekzekutiv, legjislativ, financiar, etj., në të gjitha nivelet e qeverisjes) dhe mbikëqyrjen në terren të jetës shoqërore dhe ekonomike.

#### 84.11 Aktivitetet e përgjithshme të administratës publike

Kjo klasë përfshin:

- administratën ekzekutive dhe legjislative të organeve qendrore, regjionale dhe lokale,
- administrimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve fiskale,
  - funksionimin e skenave tatimore,
  - argëtimin e taksave doganore, tatimore mbi mallrat dhe hetimin e shkeljeve tatimore,
  - administratën doganore;
- implementimin e buxhetit dhe menaxhimin e fondeve dhe borxheve publike:
  - mbledhjen dhe pranimin e parave dhe kontrollimin e disbursimit të tyre;
- administrimin e politikës së përgjithshme, të kërkimit zhvillimit (civil) dhe të fondeve përcjellëse,
- administrimin dhe funksionimin e planifikimit të përgjithshëm ekonomik dhe social dhe të shërbimeve statistikore në nivele të ndryshëm të qeverisjes.

Kjo klasë përjashton:

- përdorimin e ndërtesave në pronë apo të zëna nga qeveria, shih 68.2, 68.3,
- administrimin e politikave kërkimore dhe zhvillimoreve, me qellim të rritjes së mirëqenies personale dhe të fondeve përcjellëse , shih 84.12,

- administrimin e politikave kërkimore dhe zhvillimore me qëllim të përmirësimit të performances dhe të konkurrencës ekonomike, shih 84.13,
- administrimin e politikave të mbrojtjes, administrimin e politikave kërkimore dhe zhvillimore lidhur me mbrojtjen dhe të fondeve përcjellëse, shih 84.22,
- funksionimi i arkivave qeveritare, shih 91.01.

## 84.12 Rregullimi i aktiviteteve të subjekteve, që ofrojnë shërbime shëndetësore, shërbime arsimore dhe kulturore, si dhe shërbime të tjera sociale, përjashtuar sigurimin social

Kjo klasë përfshin:

- administrimin publik të programeve të synuara për të rritur mirëqenien personale:
  - shëndetësore,
  - arsimore, kulturore,
  - sportive,
  - rekreative,
  - mjedisore,
  - banesore;
- shërbimeve sociale,
- administrimi publik i politikave kërkimore, zhvillimore dhe të fondeve përcjellëse për këto fusha.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- sponzorimin e aktiviteteve rekreative dhe kulturore,
- distribuimin e granteve publike për artistët,
- administrimin e programeve të furnizimit me ujë të pijshëm,
- administrimin e grumbullimit të mbeturinave dhe operacionet e largimit të mbeturinave,
- administrimin e programeve të mbrojtjes mjedisore,
- administrimin e programeve banesore.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet rreth kanalizimit, largimit të mbeturinave dhe të korrigjimit të tyre, shih ndarjet 37, 38, 39,
- aktivitetet e sigurimit të detyruar social, shih  84.30,
- aktivitetet arsimore, shih seksionin P,
- aktivitetet e kujdesit shëndetësor të njeriut, shih ndarjen 86,
- muzetë dhe institucionet tjera kulturore, shih ndarjen 91,
- aktivitetet e bibliotekave dhe të arkivave të drejtuara nga qeveria,
- aktivitetet sportive apo tjera rekreative, shih ndarjen 93.

## 84.13 Rregullimi dhe përmirësimi për një funksionim më efikas të bizneseve

Kjo klasë përfshin:

- administrimin dhe drejtimin publikë përfshirë alokimin e subvencioneve për sektorët e ndryshëm ekonomik:
  - bujqësinë,
  - shfrytëzim të tokës,
  - resurset energjetike dhe të minierave,

  - infrastrukturën,
  - transportin,
  - komunikimin,
  - hotelet dhe turizmin,
  - regëtinë me shumicë dhe pakicë;
- administrimin e politikave tatimore, zhvillimore dhe të fondeve përcjellëse për të përmirësuar performancën ekonomike,
- administrimin e çështjeve të përgjithshme të punës,
- implementimin e masave të politikës të zhvillimit rajonal, p.sh. zvogëlimin e papunësisë.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet kërkimore dhe të zhvillimit eksperimental, shih ndarjen 72.

## 84.2 Kryerja e Shërbimeve ndaj Komunitetit

Ky grup përfshin çështjet e politikës së jashtme, mbrojtjen dhe rendin e sigurinë publike.

### 84.21 Marrëdhëniet me jashtë

Ky grup përfshin:
- administrimin dhe funksionimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të misioneve diplomatike dhe konsullore të vendosura jashtë shtetit apo nëpër zyrat e organizatave ndërkombëtare,
- administrimin funksionimin dhe mbështetjen për informatat dhe shërbimet kulturore të synuara për distribuim përtej kufijve nacional,
- ndihma për vendet e huaja, qoftë apo jo nëpërmjet organizatave ndërkombëtare,
- dhënien e ndihmës ushtarake për vendet e huaja,
- menaxhimin e tregtisë së jashtme, çështjet financiare ndërkombëtare dhe teknike të jashtme.

Kjo klasë përjashton:
- fatkeqësitë ndërkombëtare apo shërbimet e refugjateve nga konfliktet, shih 88.99.

### 84.22 Aktivitetet e mbrojtjes

Kjo klasë përfshin:
- administrimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e çështjeve të mbrojtjes ushtarake, në tokë, det, ajër dhe të forcave të mbrojtjes hapësinorë siç janë;
  - forcat luftarake të armatës, forcave detare dhe ajrore,
  - inxhinieringun, transportin, komunikimin, inteligjencën, materialin, të forcave tjera personale dhe jo luftarake, komandat,
  - forcat rezervë dhe ndihmëse të mbrojtës,
  - logjistika ushtarake (sigurimin e pajisjeve, ndërtesave, furnizimeve etj.),
  - aktivitetet shëndetësore për personelin ushtarak në terren;
- administrimin, funksionimin dhe përkrahjen e forcave të mbrojtjes civile,
- përkrahjen për zgjidhjen e planeve të emergjencën dhe të kryerjes së ushtrimeve, në të cilat marrin pjesë institucionet civile dhe popullata,
- administrimin e politikave kërkimore dhe zhvillimore, lidhur me mbrojtjen dhe fondet tjera rreth kësaj.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet kërkimore dhe të zhvillimit eksperimental, shih ndarjen 72.72,

- sigurimin e ndihmës ushtarake vendeve të huaje, shih 84.21.
- aktivitetet e tribunaleve ushtarake.
- sigurimin e furnizimeve për përdorim të emergjencës vendore në rast të fatkeqësive në kohë paqeje, shih 84.23,
- aktivitetet arsimore të shkollave, kolegjeve dha akademive ushtarake,
- aktivitetet e spitaleve ushtarake, shih 86.10.

### 84.23 Aktivitetet e drejtësisë dhe gjyqësisë

Kjo klasë përfshin:
- administrimin dhe funksionimin e gjykatave të administratës civile dhe penale, tribunaleve ushtarake dhe te sistemit gjyqësore, përfshirë përfaqësimin dhe këshillën ligjore në emër të qeverisë, apo kur kjo sigurohet nga qeveria me anë të parave të gatshme, apo shërbimeve,
- sigurimin e aktgjykimeve të interpretimeve të ligjit,
- gjykimin e padive civile,
- administrimin e burgut dhe sigurimin e shërbimeve korrektuese, përfshirë shërbimet rehabilituese pa dallim nëse administrimi dhe funksionimin i tyre bëhet nga njësitë qeveritare apo nga njësitë private në bazë të kontratës apo pagesës.

Kjo klasë përjashton këshillimin dhe përfaqësimin në raste civile, penale dhe të tjera ,shih 69.10.
- aktivitetet e shkollave të burgut, shih ndarjen 55,
- aktivitetet e spitaleve të burgut, shih 86.10.

### 84.24 Aktivitetet e rendit dhe të sigurisë publike

Kjo klasë përfshin:
- administrimin dhe funksionimin e forcave të rregullta dhe ndihmëse policore të mbështetura nga autoritet publike dhe porteve, kufitare, bregdetare dhe të forcave tjera speciale policore, përfshirë rregullimin e trafikut, regjistrimin e të huajve, mirëmbajtjen e shënimeve të arrestit
- sigurimin e furnizimeve për nevoja vendore të emergjencës në rast të fatkeqësive në kohë paqeje.

Kjo klasë përjashton:
- funksionimin e laboratorëve policor, shih 71.20,
- administrimin dhe funksionimin e forcave të armatosura ushtarake, shih 84.22.

### 84.25 Aktivitetet e shërbimit të zjarrfikësve

Kjo klasë përfshin:
- luftimin e zjarrit dhe mbrojtjen nga zjarri:
  - administrimin dhe funksionimin e brigadave të rregullta dhe ndihmëse të zjarrfikëseve në mbrojtën, luftimin nga zjarri, shpëtimin e njerëzve dhe kafshëve, asistenca në fatkeqësitë civile, vërshime, aksidente rrugor etj.

Kjo klasë përjashton:
  - shërbimet e mbrojtjes dhe të luftimit të zjarrit të pylltarisë, shih 02.40,
  - luftimin e zjarrit në fushat e gazit dhe të naftës, shih 09.10,
  - shërbimet në luftimin dhe mbrojtjen nga zjarri në aeroporte të ofruara nga njësitë jo të specializuara, shih 52.23.

## 84.3 Aktivitetet e Sigurimit të Detyrueshëm Social

### 84.30 Aktivitetet e sigurimit të detyrueshëm social

Kjo klasë përfshinë:

- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimit social të siguruar nga qeveria:
    - sëmundjes, aksidentit në punë dhe të sigurimit të papunësisë,
    - sigurimet pensionale,
    - programet që mbulojnë humbjet e të ardhurave për shkak të maternitetit, paaftësisë së përkohshme, vejanisë (të atyre që kanë mbetur pa bashkëshort/e) etj.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin jo të detyruar social, shih 65.30.
- sigurimin e shërbimeve të mirëqenies dhe të punës sociale (pa akomodim), shih 88.10, 88.99.

# Sektori **P – ARSIMI**

Ky sektor përfshin arsimin në të gjitha nivelet, apo për çdo profesion. Mësimet mund të jenë orale apo me shkrim dhe mund të sigurohen me anë të radios, televizionit, internetit apo nëpërmes korrespondencës.

Ky sektor përfshin, arsimin nga institucionet e ndryshme në sistemin e rregullt shkollor dhe në nivelet e tij të ndryshëm si dhe arsimin e të rriturve, programet e shkrim, leximit etj. Këtu përfshihen gjithashtu shkollat dhe akademitë ushtarake, shkollat e burgjeve etj., në nivelet e tyre përkatëse. Ky sektor përfshin arsimin publik dhe privat.

Për çdo nivel të arsimit fillestar klasat përfshijnë arsimin special, për nxënësit me të meta fizike apo mendore.

Ndarja e kategorive në këtë sektor bazohet në nivelin e arsimit të ofruar, siç është definuar sipas niveleve ISCED. Aktivitetet e institucioneve arsimore që japin kurse në nivelin zero të ISCED-së, janë klasifikuar në 85.10, në ISCED nivelin 1 në 85.20, në ISCED nivelet 2-3 në grupin 85.3, në ISCED nivelin 4 në 85.41 dhe në ISCED nivelin 5-6 në 85.42.

Ky sektor gjithashtu përfshin udhëzimet që kryesisht kanë të bëjnë me aktivitetet sportive dhe rekreative, siç janë tenisi, golfi dhe aktivitetet e mbështetjes së arsimit.

## 85 Arsimi

### 85.1 Arsimi Parashkollor

#### 85.10 Arsimi parashkollor

Kjo klasë përfshin:
- arsimin parafillor (arsimi që vazhdohet me nivelin e pare),
- arsimi parafillor, definohet si fazë fillestare e udhëzimit të organizuar të dizajnuar kryesisht për njohjen e fëmijëve shumë të rinj me mjedisin e llojit shkollor, d.m.th. për të siguruar një urë mes atmosferës shtëpiake dhe shkollore.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijët, shih 88.91.

### 85.2 Arsimi Fillor (Cikli i Ulët i Arsimit 9 Vjeçar)

#### 85.20 Arsimi fillor

Kjo klasë përfshin arsim fillor: sigurimin e kurseve akademike dhe të punës rreth kurseve tjera përcjellëse, që i japin studenteve një arsim të sigurt themelor në lexim, shkrim dhe matematikë dhe në të kuptuarit elementar të lëndëve tjera, siç është historia, gjeografia, shkencat natyrore, shoqërore, artin dhe muzikën.

Një arsim i tillë në përgjithësi sigurohet për fëmijë, megjithatë sigurimi i programeve shkrim-lexim, brenda apo jashtë sistemit shkollorë, të cilat janë të ngjashme në përmbajtje me programet e arsimit

fillor, por janë të destinuara për ato që konsiderohen tepër të vjetër për të regjistruar në shkollat elementare, është future në këtë klasë po ashtu, (d.m.th. programet e shkrim-leximit për të rritur).

Kjo klasë përjashton:
- arsimin e të rriturve. siç definohet në 85.5.
- aktivitetet ditor për fëmijën, përfshirë kopshtet ditore për nxënës, shih 88.91.

## 85.3 Arsimi i Mesëm

Ky grup përfshin arsimin e përgjithshëm të mesëm, teknik dhe profesional.
Kjo klasë përfshin:
- arsimin e të rriturve, siç definohet në 85.5.

### 85.31 Arsimi i përgjithshëm i mesëm

Kjo klasë përfshin, sigurimin e arsimit të llojit që vendos bazamentin e të mësuarit jetësor dhe të zhvillimit njerëzorë, me anë të së cilit aftësohet për mundësitë e mëtutjeshme arsimore. Njësitë e tilla japin programe që zakonisht janë të orientuara në një model në më shumë lëndë, duke përdorur arsimtarë të specializuar dhe shumë shpesh angazhojnë dhe punësojnë arsimtarë që japin orë mësimi në fushat e tyre të specializimit.

Specializimi i lëndës në këtë nivel shpesh fillon të ketë ndikim, madje edhe mbi përvojën arsimore të atyre që ndjekin një program të përgjithshëm. Programet e tilla janë të përcaktuara për të kualifikuar studentet për arsimin teknik dhe profesional, apo për regjistrim në arsimin e lartë pa ndonjë parakusht special të lëndës.

Kjo klasë përfshin:
- arsimin e mesëm të përgjithshëm të ulët, që korrespondon më shumë apo më pak me periudhën e vijimit e shkollës së detyruar,
- arsimin e përgjithshëm të mesëm dhe të lartë që jep në parim, qasje për një arsim më të lartë.

### 85.32 Arsimi i mesëm teknik dhe profesional

Kjo klasë përfshin sigurimin e arsimit, që zakonisht ia vë theksin specializimit në çështje të lëndës dhe të mësuarit në të dyja aftësitë teorike dhe praktike në përgjithësi, të përcjella me punësim të tanishëm apo për të ardhmen. Qëllimi i programit mund të ndryshojë nga përgatitja për një fushë të përgjithshme të punësimit deri te një punë shumë specifike.

Kjo klasë përfshin arsimin teknik dhe profesional në nivelin e arsimit të lartë, siç definohet në 85.4.

Kjo klasë përfshin gjithashtu përfshin:
- mësimin e guidëve turistik
- mësimin për shefat e kuzhinave të hoteleve dhe të restoranteve,
- për kozmetologjinë dhe shkollat e berberëve,
- aftësimin e riparimit të kompjuterëve,
- shkollat e vozitjes për shoferet profesional, p.sh. të kamionëve, autobusëve, autobusëve ndërurban, të shkollave për pilot profesional.

Kjo klasë përjashton:
- arsimin e lartë teknik dhe profesional, shih 85.4,
- sigurimin e mësimeve të artit për qëllime të rekreacioneve dhe të vet-zhvillimit, shih 85.52,

- shkollat e vozitjes për vetura jo të destinuara për shoferë profesional, shih85.53,
- aftësim për punë, duke formuar pjesë të aktiviteteve të punës sociale pa akomodim, shih 88.10, 88.99.

## 85.4 Arsimi i Lartë

Ky grup përfshin sigurimin e kurseve pas shkollimit të mesëm, jo terciar dhe akademik dhe sigurimin e shalleve për nivelin e diplomës së fakultetit, diplomimit apo pas diplomimit sigurimin pas diplomimit. Kushti për pranim është diploma e së paku të nivelit të arsimit të lartë të mesëm.

Ky grup përjashton:

- arsimin e të rriturve, siç definohet në 85.5.

### 85.41 Arsimi pas të mesmes, por jo i lartë

Kjo klasë përfshin sigurimin e arsimit pas shkollimit të mesëm, i cili nuk mundë të konsiderohet si arsim terciar. P.sh sigurimi i arsimit plotësues, pas-shkollimit të mesëm për të përgatitur arsimin terciar apo profesionin, jo terciar pas shkollimit të mesëm.

### 85.42 Arsimi i lartë

Kjo klasë përfshin:

- arsimin terciar të fazës së parë, dytë dhe tretë.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- veprimtarinë e shkollave artistike, që japin arsim terciar.

## 85.5 Arsimi Tjetër

Ky grup përfshin arsimin e përgjithshëm në vazhdim dhe arsimin e profesional në vazhdim si dhe aftësimin për ndonjë profesion, hobi apo qëllime të vetëzhvillimit.

Ky grup përjashton, aktivitetet arsimore siç përshkruhen në grupet 85.1-85.4, i.e. d.m.th. arsimi parafillor, arsimi fillor, arsimi i mesëm, apo arsimi i lartë. Ky grup përfshin, kampet dhe shkollat që ofrojnë mësimet në aktivitetet e atletikës për grupe apo individë, mësime të gjuhëve të huaja, mësime për arte, në dramë apo muzikë, apo mësime tjera ose aftësim të specializuar jo i krahasueshëm me arsimin në grupet 85.1 - 85.4.

### 85.51 Arsimi për sporte dhe rekreacion

Kjo klasë përfshin sigurimin e mësimeve në aktivitetet e atletikës për grupe e individëve, siç janë ata nga kampingjet dhe shkollat në këtë klasë, gjithashtu përfshihen mësimet sportive të kampeve me qëndrim ditor dhe fjetje.

Kjo klasë nuk përfshin: shkollat akademike, kolegjet dhe universitetet. Mësimet mund të jepen në lokacione të ndryshme, siç janë objektet trajnuese të njësisë apo të klientit të mësimeve profesionale nga mjetet tjera. Mësimet e siguruara në këtë klasë organizohen në mënyrë formale.

Kjo klasë përfshin:

- mësimet sportive (bejsboll, basketboll, krikët, futboll, etj.),

- mësimet për kampingje dhe sportive,
- mësimet gjimnastikore,
- mësimet e ndarjes, akademitë,
- mësimet e notimit,
- instruktorët sportiv profesional, arsimtarët, trajnerët,
- mësimet e arteve luftarake,
- mësimet e lojërave me karta (siç është brixhi, pokeri ),
- mësimet e jogës.

Kjo klasë përjashton:

- arsimin kulturor, shihe 85.52.

### 85.52 Arsimi kulturor

Kjo klasë përfshin sigurimin e mësimeve në arte: dramë dhe muzikë. Kjo klasë përfshin, njësitë që japin këtë lloj të mësimeve, mund të quhen "studio", "klasë". Ato formalisht japin mësime të organizuara, kryesisht për hobi, qëllime rekreative apo të vet-zhvillimit, por mësimet e tilla nuk çojnë deri te marrja e diplomës profesionale të shkallës së baçeller apo të diplomimit etj.

Kjo klasë përfshin:

- arsimtarët e pianos dhe të mësimeve tjera muzikore,
- mësimet e arteve,
- mësimet e vallëzimit dhe studiot e vallëzimit,
- shkollat e dramave (përveç akademive),
- shkollat e arteve të bukura (përveç akademive),
- shkollat e veprimtarive artistike (përveç akademive),
- shkollat e fotografisë (përveç atyre komerciale).

Kjo klasë përjashton:

- mësimet e gjuhëve të huaja, shih 85.59.

### 85.53 Aktvitetet e autoshkollave

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shkollat e fluturimit, lundrimit dhe të drejtimit të anijeve që nuk japin certifikata dhe leje komerciale.

Kjo klasë përjashton:

- shkollat e vozitjes për shoferë profesional, shih 85.32.

### 85.59 Arsimi tjetër p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- arsimin që nuk është i definueshëm sipas nivelit,
- mësimin akademik,
- qendrave të mësimit që ofrojnë kurse plotësuese,
- kurse të shqyrtimit të ekzaminimit profesional,
- mësime të gjuhës dhe mësime të aftësive bashkëbiseduese,
- aftësimin kompjuterik,
- aftësimin religjioz .

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- trajnimin për shpëtim jete,

- aftësimin për mbijetesë,
- aftësimin e të folurit publik,
- mësimin e leximit të shpejtë.

Kjo klasë përjashton:

- programet e shkrim-leximit për të rritur, shih 85.20,
- arsimin e përgjithshëm të mesëm, shih 85.31,
- arsimin e mesëm teknik dhe profesional 85.32,
- edukimi i lartë, shih 85.4.

## 85.6 Aktivitetet Mbështetëse Arsimore

### 85.60 Aktivitetet mbështetëse arsimore

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e aktiviteteve jo udhëzuese, që mbështesin proceset apo sistemet arsimore:
  - konsultimin arsimor,
  - aktivitetet këshilluese të udhëheqjes arsimore,
  - aktivitetet e vlerësimit të testimit arsimorë,
  - aktivitetet e testimit arsimorë,
  - organizimin e programeve të këmbimit studentor.

Kjo klasë përjashton:

- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental mbi shkencat shoqërore dhe humane, shih 72.20.

# Sektori Q – AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE

Ky sektor përfshin sigurimin e aktiviteteve shëndetësore dhe të punës artificiale. Aktivitetet përfshin një fushë të gjerë të aktiviteteve, duke filluar nga kujdesi shëndetësor i ofruar nga profesionistët e aftësuar medicinal në spitale dhe objektet tjera, duke përfshirë aktivitetet e kujdesit banesor që akoma përfshin një shkallë të aktiviteteve të kujdesit shëndetësor për aktivitetet e punës sociale, pa ndonjë involvim të profesionistëve të kujdesit shëndetësor.

## 86 Aktivitetet e Shëndetit të Njeriut

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e spitaleve afatshkurtër apo afatgjatë të spitaleve të përgjithshme, apo të specializuar mjekësor, kirurgjik, psikiatrik dhe të spitaleve të abuzimit të substancave, sanatoriumin, preventinvat, shtëpitë e kujdesit mjekësor, strehimoret, institucionet e spitaleve mentale, qendrat rehabilituese, leprosaria dhe institucionet tjera të shëndetit njerëzor, të cilët i kanë objektet e tyre të akomodimit dhe të cilët angazhohen në sigurimin e trajtimit diagonstik dhe medicinal për pacientët, me cilëndo prej kushteve mjekësore të llojllojshmërisë së gjerë. Kjo ndarje, gjithashtu përfshin konsultimin dhe trajtimin mjekësor në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe të specializuar nga ana e mjekëve të praktikës së përgjithshme dhe të specialistëve dhe kirurgëve medicinal. Ndarja përfshin edhe aktivitetet e praktikës dentale të natyrës së përgjithshme, apo të specializuar dhe të aktiviteteve ortodontike. Përveç kësaj, kjo ndarje përfshin aktivitetet e shëndetit njerëzor, jo të kryera nga mjeket e spitalit apo të praktikës mjekësore, por nga mjeket e praktikës së përgjithshme paramedicinale, të njohur legalisht për të trajtuar pacientët.

### 86.1 Aktivitetet e Spitaleve

#### 86.10 Aktivitetet e spitaleve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet spitalore afatshkurtër apo afatgjatë, d.m.th. aktivitetet e trajtimit medicinal dhe diagnostik, të spitaleve të përgjithshme (p.sh. spitalet e komunitetit dhe rajonal, spitalet e organizatave jo përfituese, spitalet universitare, spitalet e bazave ushtarake dhe të burgjeve) dhe spitalet e specializuara (p.sh. spitalet e shëndetit mendor dhe të abuzimit të substancave, spitalet për sëmundjet infektive, spitalet e maternitetit, sanatoriumet e specializuara).
- Këto aktivitete kryesisht i drejtohen të sëmurëve, kryhen sipas mbikëqyrjes direket të mjekëve meidicinal dhe përfshin:
    - shërbimet e stafit medicinal dhe paramedicinal,
    - shërbimet e laboratorit dhe të pajisjeve teknike, përfshirë shërbimin radiologjik dhe anasteziologjik,

- shërbimet e dhomës emergjente,
- sigurimin e shërbimeve të sallës së operacionit, shërbimet farmaceutike, të ushqimeve dhe të shërbimeve tjera spitalore,
- shërbimet e qendrave të planifikimit familjar, duke dhënë trajtime medicinale, siç është sterilizimi dhe ndërprerjen e shtatzënisë me akomodim.

Kjo klasë përjashton:

- testimin laboratorik dhe inspektimin e të gjitha llojeve të materialeve dhe produkteve, përveç atyre medicinale, shih 71.20,
- aktivitetet e veterinarisë, shih 75.00,
- aktivitetet shëndetësore për personelin ushtarak në terren, shih 84.22,
- aktivitetet e praktikës dentale të natyrës së përgjithshme apo të specializuar, p.sh. dentisti, endodontik dhe dentistin pediatrik, patologjia orale, aktivitetet ortodontike, shih 86.23,
- shërbimet e konsulentëve privat për të sëmurit, shih 86.2,
- testimin laboratorik medicinal, shih 86.90,
- aktivitetet e transportit me autoambulancë, shih 86.90.

## 86.2 Aktivitetet e Praktikës së Mjekëve dhe Dentistëve

Ky grup përfshin konsultimin dhe trajtimin medicinal të kryer nga mjekët e praktikës së përgjithshme dhe specialistët tjerë, përfshirë kirurgët dentistët, etj. Këto aktivitete mund të kryhen në praktikën private, praktikat grupore dhe në klinikat spitalore me pacientë nga jashtë dhe në klinikat, siç janë ato pranë firmave, shkollave, shtëpive të pleqve, organizatave të punës dhe organizatave vëllazërore, si dhe shtëpitë e pacientëve.

Ky grup gjithashtu përfshin:

- shërbimet e konsulentëve privat për të sëmurët.

### 86.21 Aktivitetet e mjekësisë së praktikës së përgjithshme

Kjo klasë përfshin:

- konsultimin dhe trajtimin medicinal në fushën e mjekësisë së përgjithshme të kryer nga mjekët e praktikës së përgjithshme.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet spitalore për të sëmurit, shih 86.10,
- aktivitetet paramedicinale, siç janë ato të mamive, infermierëve dhe të fizioterapeutëve, shih 86.90.

### 86.22 Aktivitetet e mjekësisë së specializuar

Kjo klasë përfshin:

- konsultimin dhe trajtimin medicinal në fushën e mjekësisë së specializuar nga ana e specialistëve dhe kirurgëve medicinal.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- qendrat e planifikimit familjar, duke siguruar trajtim medicinal, siç është sterelizimi dhe ndërprerjen e shtatzënisë pa akomodim.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet spitalore për të sëmurit, shih 86.10,
- aktivitetet e mamive, fizioterapeutëve dhe të mjekëve tjerë paramedicinal, shih 86.90.

### 86.23 Aktivitetet e dentistëve

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet e praktikës dentalë, të natyrës së përgjithshme ose të specializuar, p.sh. stomatologji, endodontikë dhe stomatologji pediatrike, patologji orale,
- aktivitet ortodontike.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- aktivitetet dentale në sallat e opereimit.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e dhëmbëve artificial, të pajisjeve dentale dhe prostetike nga laboratorët dental, shih 32.50,
- aktivitetet spitalore për të sëmurët, shih 86.10,
- aktivitetet e personelit ndihmës dental, siç janë higjienistët dental, shih 86.90.

## 86.9 Aktivitetet e Tjera të Shëndetit të Njeriut

### 86.90 Aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet për shëndetin njerëzor, jo të kryera nga spitalet, mjekët apo dentistët:
  - aktivitetet e infermierëve, mamive, fizioteraputëve apo të mjekëve tjerë paramedicinal në fushën e optometrisë, hidroterapisë, masazh medicinale, terapisë profesionale, terapisë të së folurit, kiropodisë, homeopatisë, kiropraktikës, akupunkturë etj.

Këto aktivitete mund të kryhen në klinikat e shëndetit, siç janë ato të vendosura nëpër firma, shkolla, shtëpi të pleqve, oraganizatave të punës dhe të organizatave të vëllazërisë, si dhe në objektet shëndetësore banesore, ndryshe nga spitalet si dhe në dhomat e veta të konsultimit, në shtëpitë e pacientëve apo tjetërkund.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:
- aktivitetet e personelit paramjekësor dental, siç janë terapeutët dental, infermierët dentale të shkollave dhe higjienistët dental, të cilët mund të punojnë nga distanca por që periodikisht mbikëqyren nga dentisti,
- aktivitetet e laboratorëve medicinal siç janë:
  - laboratorët e rëntgenit dhe të qendrave të pamjeve diagnostike,
  - laboratorët e analizave të gjakut;
- aktivitetet e bankave të gjakut, bankave të spermës, bankave të transplantimit të organeve etj.,
- transportin e pacientëve me autoambulanca, nga cila do mënyrë e transportit përfshirë aeroplanët.

Këto shërbime shpesh jepen gjatë emergjencave medicinale.

Kjo klasë përjashton:
- prodhimin e dhëmbëve artificial, të pajisjeve dentale dhe prostetike, nga ana e laboratorëve dental, shih 32.50,
- transferin e pacientëve, pa pajisje për shpëtim jete e as personel mjekësor, shih ndarjet 49, 50, 51,

- testimin laboratorik jo medicinal, shih 71.20,
- aktivitetet e testimit në fushën e higjienës së ushqimit, shih 71.20,
- aktivitetet spitalore, shih 86.10,
- aktivitetet e praktikës medicinale dhe dentale, shih 86.2,
- pajisjet e kujdesit të infermierisë banesore, shih 87.10.

# 87 Aktivitetet e Përkujdesjes në Shtëpi

Kjo ndarje përfshin sigurimin e kujdesit banesor të kombinuar me infermierë, mbikëqyrje apo të llojeve tjera të kujdesit, siç kërkohet nga banorët. Pajisjet janë një pjesë e rëndësishme e procesit të prodhimit dhe kujdesi i ofruar është një përzierje e shërbimeve shëndetësore dhe sociale me shërbimet shëndetësore, duke qenë në pjesë të madhe të një niveli të shërbimeve të infermierisë.

## 87.1 Aktivitetet e Përkujdesjes Infermerike në Shtëpi

### 87.10 Aktivitetet e përkujdesjes infermerike në shtëpi

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e:
  - shtëpive të pleqve me kujdesin e infermierëve,
  - të shtëpive të shërimit,
  - të shtëpive të pushimit me kujdesin e infermierisë,
  - objektet e kujdesit të infermierisë,
  - shtëpitë e infermierisë.

Kjo klasë përjashton:

- shërbimet brenda shtëpisë të dhënë nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, shih ndarjen 86,
- aktivitetet e shtëpive të pleqve pa apo me kujdes minimal të infermierisë, shih 87.30,
- aktivitetet e punës sociale me akomodim, siç janë jetimoret, pensionet dhe konviktitet e fëmijëve, strehimoret e përkohshme për të pastrehë, shih 87.90.

## 87.2 Aktivitetet e Përkujdesjes në Shtëpi për të Sëmurët Mendorë, të Shëndetit Mendor dhe Abuzimit të Substancave

### 87.20 Aktivitetet e përkujdesjes në shtëpi për të sëmurët mendorë, të shëndetit mendor dhe abuzimit të substancave

Kjo klasë përfshin, sigurimin e kujdesit banesor (por jo të kujdesit të spitalit të licencuar) për njerëzit e sëmurë penalisht, sëmurjeve mentale, apo të problemeve të abuzimit të substancave. Objektet sigurojnë dhomën, pensionin, mbikëqyrjen mbrojtëse dhe konsultimin dhe një kujdes shëndetësor.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e:
  - objekteve për trajtimin e alkoolizmit dhe të narkomanisë,
  - të shtëpive të rehabilitim psikiatrik,
  - të shtëpive të banimit grupor për personat emocionalisht të çrregulluar,
  - objektet e të sëmurëve mental,
  - shtëpitë e largëta të kujdesit mendor.

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e kujdesit banesore për pacientët të shëndetit mental dhe të sëmurëve të abuzimit të substancave.

Kjo klasë përjashton:

- spitalet mentale, shih 86.10,

- aktivitetet e punës sociale me akomodim, siç janë strehimoret e përkohshme për të pastrehë, shih 87.90.

## 87.3 Aktivitetet në Shtëpitë e Kujdesit për të Moshuarit dhe Personat me Nevoja të Veçanta

### 87.30 Aktivitetet në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta

Kjo klasë përfshin, sigurimin e shërbimeve të kujdesit banesor dhe personal për të moshuarit dhe të paaftit, të cilët nuk janë të aftë që të kujdesen plotësisht për vetveten, ose ata të cilët nuk dëshirojnë të jetojnë në mënyrë të pavarur. Kujdesi rëndom përfshin dhomën, ushqimin, mbikëqyrjen dhe asistencën gjatë banimit ditor, siç janë shërbimet e mirëmbajtjes së shtëpisë. Në disa raste këto njësi ofrojnë kujdes të infermierisë së kualifikuar për banorët në objektet e ndara në kuadër të pensionit.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e:
  - objektet e ndihmuara për të jetuar,
  - kujdesin e vazhduar për komunitetet e të pensionuarve,
  - shtëpitë për të moshuarit, me një kujdes minimal të infermierisë,
  - shtëpitë e pushimit pa ndonjë kujdes të infermierisë.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e shtëpive të pleqve, me kujdes të infermierisë, shih 87.10,
- aktivitetet e punës sociale me akomodim, ku trajtimi mjekësor apo arsimi nuk janë elemente të rëndësishme, shih 87.90.

## 87.9 Aktivitetet në Shtëpitë e Tjera të Kujdesit P.K.T.

### 87.90 Aktivitetet në shtëpitë e tjera të kujdesit p.k.t.

Kjo klasë përfshin, sigurimin e shërbimeve të kujdesit banesor dhe personal për personat, përveç të moshuarve dhe të paaftëve, të cilët nuk janë në gjendje që plotësisht të kujdesen për vetveten, apo ata të cilët nuk dëshirojnë të jetojnë në mënyrë të pavarur.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e ofruara në bazë të orës të drejtuara për të ofruar asistencë sociale për fëmijët dhe kategoritë speciale të personave me disa limite në aftësi për vet-kujdes, por trajtimi mjekësor apo arsimi nuk janë elemente të rëndësishme:
  - jetimoret,
  - shtëpitë ushqyese të fëmijëve dhe konviktet,
  - strehimoret e përkohshme për të pastrehë,
  - institucionet që kujdesen për nënat e pamartuara dhe fëmijët e tyre.

Aktivitetet mund të kryhen nga dikasteret qeveritar, apo organizatat private.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e:
  - shtëpitë e grupeve gjysmake, për personat me probleme sociale apo personale,
  - shtëpitë gjysmake për delikuentet dhe kriminelët/kundërvajtësit,

- shtëpitë korrektuese për të miturit.

Kjo klasë përjashton:

- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimit të detyruar social, shih 84.30,
- aktivitetet e objekteve të kujdesit me infermier, shih 87.10,
- aktivitetet e kujdesit banesor për të moshuarit apo të paaftit, shih 87.30,
- aktivitetet e birësimit, shih 88.99,
- aktivitetet e strehimit afat-shkurtër për viktimat e fatkeqësive, shih 88.99.

# 88 Aktivitetet e Punës Sociale pa Akomodim

Kjo ndarje përfshin ofrimin e një game të aktiviteteve sociale të drejtpërsëdrejti për klientët. Aktivitetet në këtë ndarje, nuk përfshin shërbimet e akomodimit, përveç në bazë të përkohshme.

## 88.1 Aktivitetet e Kujdesit Social pa Akomodim për të Moshuarit dhe Personat me Nevoja të Veçanta

### 88.10 Aktivitetet e kujdesit social pa akomodim për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet sociale, këshilluese, mirëqenies, referuese dhe të ngjashme, të cilët i drejtohen të moshuarve dhe të paaftëve në shtëpitë e tyre apo tjetërkund dhe kryhen nga dikasteret qeveritar apo organizatat, organizatat nacionale apo lokale vet-asistuese dhe nga specialistët që ofrojnë shërbime këshillimore:
  - të vizituarit e të moshuarve dhe të paaftit,
  - aktivitetet e kujdesit ditor për të moshuarit apo për të paaftit e rritur,
  - aktivitetet e rehabilitimit profesional dhe të riedukimit për personat e paaftë me kusht që kjo formë e edukimit është e kufizuar.

Kjo klasë përjashton:

- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimit të detyruar social, shih 84.30,
- aktivitetet të ngjashme me ato të përshkruara në këtë klasë, por që përfshin akomodimin, shih 87.30,
- aktivitetet e kujdesit ditor për fëmijë e paaftë, shih 88.91.

## 88.9 Aktivitetet e Tjera të Kujdesit Social pa Akomodim

### 88.91 Aktivitetet e kujdesit ditor të fëmijëve

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e infermierisë ditore për nxënësit, përfshirë aktivitetet e kujdesit ditor për fëmijët e paaftë.

## 88.99 Aktivitetet e tjera të kujdesit social pa akomodim p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet sociale, këshillimore, të mirëqenies, të refugjatëve, referuese dhe të ngjashëm, të cilët u ofrohen individëve dhe familjeve në shtëpitë e tyre apo tjetërkund dhe kryhen nga dikasteret qeveritar apo organizatat private, organizatat e ndihmës në rast fatkeqësie dhe të organizatave nacionale apo lokale të pavarura dhe nga specialistët që ofrojnë shërbime këshillimore:
  - aktivitetet e mirëqenies dhe të udhëheqjes për fëmijë dhe të rriturit,
  - aktivitetet e birësimit, aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të tjerëve nga keqtrajtimi familjar,
  - këshillim të buxhetit shtëpiak, udhëheqje të martesës dhe familjes, shërbime këshillimore të kreditim dhe të larjes së borxheve,
  - aktivitetet e komunitetit dhe të fqinjësisë,
  - aktivitetet e viktimave të fatkeqësive, refugjatëve, imigrantëve etj.,
  - përfshirë strehimin e përkohshëm apo të vazhduar për ta,
  - aktivitete e rehabilitimin profesional dhe të riedukimit për personat e papunësuar, me kusht që komponentët e arsimit të jenë të limituara në përcaktimin e të drejtës, lidhur me ndihmën sociale,
  - shtesat për qira, apo kullat e ushqimit,
  - furnizimet ditore për të pastrehë dhe grupet tjerë të dobëta në aspektin social, aktivitetet të bamirësisë, siç janë mbledhja e parave dhe aktivitetet tjera përkrahëse të synuara për punë sociale.

Kjo klasë përjashton:

- financimin dhe administrimin e programeve të sigurimit të detyruara social, shih 84.30,
- aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në këtë klasë, por duke përfshirë akomodimin, shih 87.90.

# Sektori R – ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI

Ky sektor përfshin një fushë të gjerë të aktiviteteve për të plotësuar interesat e ndryshme kulturore, argëtuese dhe rekreative të publikut të gjerë, përfshirë paraqitjet direkt (live), funksionimin e lokacioneve të muzeve, bixhozit, aktivitetet sportive dhe rekreative.

## 90 Aktivitetet Krijuese, Artistike dhe Argëtuese

Kjo ndarje përfshin, operimin e enteve dhe sigurimin e shërbimeve për të përmbushur interesimet kulturore dhe argëtuese të klientëve të tyre. Kjo përfshin produksionin, promovimin dhe pjesëmarrjen në paraqitje direkt, ngjarja apo ekspozita të destinuara për shikimi të publikut; ofrimin e aftësive artistike, kreative apo teknike për produksionin e produkteve artistike dhe të paraqitjeve direkt.

Kjo ndarje përjashton:
- funksionimin e muzeve të të gjitha llojeve, kopshteve botanik dhe zoologjik, konservimin e lokacioneve historike dhe aktivitetet e pasurive natyrore, shih ndarjen 91,
- aktivitetet e bixhozit dhe të bastit, shih ndarjen 92,
- aktivitetet sportive, zbavitëse dhe rekreative, shih ndarjen 93.

Disa njësi që ofrojnë lehtësira dhe shërbime kulturore, zbavitëse apo rekreative, janë klasifikuar në ndarjet tjera, siç është filmi dhe distribuimi i videove, shih 59.11, 59.12, 59.13,
- projeksionin e filmit, shih 59.14,
- transmetimin radio-televizive, shih 60.1, 60.2,

## 90.0 Aktivitetet Krijuese, Artistike dhe Argëtuese

Ky grup përfshin aktivitetet në përformimin e arteve kreative.

### 90.01 Shfaqjet artistike

Kjo klasë përfshin:
- produksionin e prezantimeve teatrore live, të koncerteve dhe operave apo të produksioneve të vallëzimit dhe të produksioneve tjera skenike:
  - aktivitetet e grupeve të amfiteatrave natyror apo kompanive, orkestrave apo bendeve,
  - aktivitetet e artistëve individual, siç janë aktorët, valltarët, muzicientët, lektorët apo spikerët.

Kjo klasë përjashton:
- aktivitetet e agjencive personale, teatrore apo artistike, shih 74.90,
- aktivitetet e ndarjeve të roleve, shih 78.10.

### 90.02 Aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet mbështetëse për shfaqjen artistike për prodhimin e prezantimeve live teatrore, koncerteve dhe operave apo produksioneve të vallëzimit dhe produksioneve tjera skenike:
  - aktivitetet e regjisorëve, producentëve, ndërtuesve dhe dizajnerëve të skenave, mekanikët e skenës, inxhinierët e ndriçimit etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e producentëve apo ndërmarrësve të ngjarjeve live të arteve, me apo pa pajisje.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet personale të agjentëve apo agjencive teatrore apo artistike, shih 74.90,
- aktivitetet e ndarjes së roleve, shih 78.10.

### 90.03 Krijimtaria artistike

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e artistëve individualë, siç janë skulptorët, piktorët, karikaturistët, gravursitët, gdhendësit etj.
- aktivitetet e shkrimtarëve individual, për të gjitha subjektet, përfshirë të shkruarit e letërsisë artistike, teknik etj.
- aktivitetet e gazetarëve të pavarur,
- restaurimin e veprave artistike, siç janë pikturat etj.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e shtatorëve, ndryshe nga veprat artistike origjinale, shih 23.70,
- restaurimin e organove dhe instrumenteve tjera muzikore historike, shih 33.19,
- produksionin e filmave dhe të videove, shih 59.11, 59.12,
- restaurimin e mobileve (përveç restaurimit të llojit muzeor), shih 95.24.

### 90.04 Funksionimi i objekteve të artit

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e sallave teatrore dhe koncertale dhe të objekteve artistike.

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e kinemave, shih 59.14,
- aktivitetet e agjencive të biletave, shih 79.90,
- funksionimin e muzeve të të gjitha llojeve, shih 91.02.

## 91 Bibliotekat, Arkivat, Muzetë dhe Aktivitetet e Tjera Kulturore

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e bibliotekave dhe të arkivave, funksionimin e muzeve të të gjitha llojeve, kopshteve botanik dhe zoologjik, funksionimin e lokacioneve historike dhe aktivitetet mbi pasuritë natyrore.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin, konservimin dhe ekspozimin e objekteve, lokacioneve dhe të pasurive natyrore me interes historik, kulturor apo edukativ (p.sh. lokacionet trashëgimisë botërore, etj.).

Kjo ndarje përjashton:

- aktivitetet sportive, argëtuese dhe rekreative, siç janë plazhet e larjes dhe parqet e rekreacionit, shih ndarjen 93.

# 91.0 Aktivitetet e Bibliotekave, Arkivave, Muzeve dhe Aktivitetet e Tjera Kulturore

## 91.01 Aktivitetet e bibliotekave dhe të arkivave

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e dokumenteve dhe informatave të bibliotekave të të gjitha llojeve, leximi, dëgjimi dhe sallat e shikimit, arkivat publike që i ofrojnë shërbim masës së gjerë apo një klientele speciale, siç janë studentët, shkencëtarët, personeli, anëtarët si dhe funksionimin e arkivave qeveritare:
    - organizimin e koleksionit, qoftë i specializuar apo jo, katologimin e koleksioneve, huazimin dhe ruajtjen e librave, hartave, periodikëve, filmave, pllakave, kasetave, veprave të artit etj.,
    - aktivitetet korrigjuese për të përputhur me kërkesat informative etj.,
    - depot e fotografive, bibliotekat e filmit dhe shërbimet.

## 91.02 Aktivitetet e muzeve

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e muzeve të të gjitha llojeve:
    - muzeve të artit, muzeve të argjendarisë, të mobileve, kostumeve, qeramikës, artikujve të argjendit,
    - muzetë e historisë natyrore, të shkencës dhe teknologjisë, përfshirë muzetë ushtarak,
    - muzetë tjera të specializuar,
    - muzetë e hapur në natyrë.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e galerive komerciale të artit, shih 47.78,
- restaurimin e veprave të artit dhe grumbullimin e objekteve të muzeut, shih 90.03,
- aktivitetet e bibliotekave dhe arkivave, shih 91.01.

## 91.03 Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike, si dhe i atraksioneve të ngjashme për vizitorë

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin dhe konservimin e lokacioneve dhe ndërtesave historike.

Kjo klasë përjashton:

- renovimin dhe restaurimin e lokacioneve dhe ndërtesave historike, shih sektorin F.

## 91.04 Kopshtet botanike dhe zoologjike, si dhe aktivitetet e pasurive natyrore

Kjo klasë përfshin:

- funksionimin e kopshteve botanik dhe zoologjik, përfshirë kopshtet zoologjik të fëmijëve,
- funksionimin e bukurive natyrore, përfshirë ruajtjen e kafshëve të egra etj.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e peizazhit dhe të kopshtarisë, shih 81.30,
- funksionimi i peshkimit sportiv dhe të rezervateve të gjuetisë, shih 93.19.

# 92 Aktivitetet e Lojërave të Fatit dhe Basteve

Kjo ndarje përfshin, objektet e bixhozit, siç janë kazinotë, sallat e bingos dhe terminaleve, të video lojërave dhe sigurimin e shërbimeve të bixhozit, siç janë lotaritë dhe të tërheqjes së basteve.

## 92.0 Aktivitetet e Lojërave të Fatit dhe Basteve

### 92.00 Aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve

Kjo klasë përfshin aktivitetet e bixhozit dhe të bastit siç janë:

- shitja e biletave të lotarisë,
- funksionimin (eksploatimin) e automateve të bixhozit,
- funksionimin e ueb-faqeve të bixhozit virtual,
- regjistrimi i basteve dhe të funksioneve tjera të basteve – tërheqja e basteve,
- funksionimi i kazinove, përfshirë "kazinotë lundruese".

# 93 Aktivitetet Sportive, Argëtuese dhe Aktivitetet e Rekreacionit

Kjo ndarje përfshin, ofrimin e aktiviteteve rekreative, argëtuese dhe sportive (përveç aktiviteteve të muzeve, konservimin e lokacioneve historike, aktivitetet e kopshteve botanike, zoologjike dhe të bukurive natyrore, aktivitetet e bixhozit dhe të basteve).

Nga kjo ndarje, janë të përjashtuar artet dramatike, muzika dhe artet dhe zbavitjet tjera, siç janë produksioni i prezantimeve live teatrore, koncerteve, operave apo produksioneve të vallëzimit dhe produksioneve tjera skenike, shih ndarjen 90.

## 93.1 Aktivitetet Sportive

Ky grup përfshin, funksionimin e objekteve sportive, aktivitetet e ekipeve sportive apo të klubeve që kryesisht marrin pjesë në ndeshje sportive live, para audiencës që paguan. Atletët e pavarur të angazhuar në pjesëmarrje nëpër ngjarje sportive, apo gara para audiencës që paguan. Pronarët e pjesëmarrësve të vrapimit siç janë veturat, qentë, kuajt, etj., kryesisht të angazhuar në futjen e tyre në ngjarjen e vrapimit apo në ngjarjet tjera sportive për shikuesit. Trajnerët sportive, që ofrojnë shërbime të specializuara për përkrahjen e pjesëmarrësve në ngjarjet sportive apo në gara. Operatorët e arenave dhe stadiumeve. Aktivitetet tjera të organizimit, promovimit apo menaxhimin të ngjarjeve sportive, p.k.t.

### 93.11 Funksionimi i objekteve sportive

Kjo klasë përfshin:

- përdorimin e objekteve për ngjarje sportive të brendshme, apo të jashtme (të hapura, mbyllura apo të mbuluara me apo pa ulëse të shikuesve):
    - stadiumet e futbollit, hokejit, kriketit dhe ragbit,
    - hipodromet për vetura, qentë dhe vrapim kuajsh,
    - pishinat dhe stadiumet,

  - stadiumet e atletikës,
  - arenat dhe stadiumet e sporteve dimëror,
  - arenat e hokejt,
  - arenat e boksit,
  - fushat e golfit,
  - shtigjet e bollingut;
- organizimin dhe funksionimin e ngjarjeve sportive të jashtme apo të brendshme për profesionalët apo amatorët, nga organizatat me anë të objekteve vetanake.

Kjo klasë përfshin, menaxhimin dhe ofrimin e stafit për të operuar me këto objekte.

Kjo klasë përjashton:

- operimin e ski-lifteve, shih 49.39,
- huadhënien e pajisjeve rekreative dhe sportive, shih 77.21,
- aktivitetet e objekteve të fitnesit, shih 93.13,
- aktivitetet e parqeve dhe plazheve, shih 93.29,

## 93.12 Aktivitetet e klubeve sportive

Kjo klasë përfshin, aktivitetet e klubeve sportive, të cilët, qofshin klubet profesionale, semiprofesionale, apo amator, u japin anëtarëve të tyre shansin për t'u angazhuar në aktivitetet sportive.

Kjo klasë përfshin:

- punën e klubeve sportive:
  - klubeve të futbollit,
  - klubeve të bollingut,
  - klubeve të notit,
  - klubeve të golfit,
  - klubeve të boksit,
  - klubeve të sporteve dimërore,
  - klubeve të shahut,
  - klubeve të atletikës,
  - klubeve të qitjes, etj.

Kjo klasë përjashton:

- mësimet sportive nga arsimtarët individual, trajnerët, shih 85.51,
- funksionimin e objekteve sportive, shih 93.11,
- organizimin dhe punën e ngjarjeve sportive të jashtme apo të brendshme për profesionistët apo amatorët, nga klubet sportive me objektet e tyre vetanake, shih 93.11.

## 93.13 Palestra e fitnesit

Kjo klasë përfshin:

- pajisjet dhe klubet e fitnesit dhe të zhvillimit të trupit.

Kjo klasë përjashton:

- mësimet sportive nga arsimtarët individual, trajnerët, shih 85.51.

### 93.19 Aktivitetet e tjera sportive

Kjo klasë përfshin:
- aktivitetet e producentëve apo promotorëve të ngjarjeve sportive, me apo pa objekte,
- aktivitetet e sportistëve dhe atletëve individual për llogari të veten, referëve, gjyqtarëve, kohëmatësit etj.
- aktivitetet e ligave sportive dhe organet e rregullatorit,
- aktivitetet lidhur me promovimin e ngjarjeve e sportive,
- aktivitetet rreth stallave, kolibeve dhe garazheve të vrapimit,
- funksionimin e peshkimit sportiv dhe rezervatet e gjuetisë,
- aktivitetet mbi guidat e alpinizmit,
- aktivitetet mbështetëse për sport, apo gjueti dhe peshkim rekreativ.

Kjo klasë përjashton:
- sigurimin me qira të pajisjeve sportive, shih 77.21,
- aktivitetet e shkollave të sportit dhe të lojërave, shih 85.51,
- aktivitetet e instruktorëve të sportit, arsimtarëve, trajnerëve, shih 85.51,
- organizimin dhe funksionimin e ngjarjeve sportive të jashtme apo të brendshme për profesionistët apo amatorët,
- nga klubet sportive me apo pa objektet e veta, shih 93.11, 93.12,
- aktivitetet e parqeve dhe plazheve, shih 93.29.

## 93.2 Aktivitetet Argëtuese dhe të Rekreacionit

Ky grup përfshin një fushë të gjerë të njësive që operojnë me objektet apo ofrojnë shërbime për të plotësuar interesat e ndryshme rekreative të patronëve të tyre. Ky grup përfshin punën e atraksioneve të llojllojshme, siç janë vozitjet mekanike, ngasjet në ujë, lojërat, shfaqjet, ekspozitat tematike apo fushat e piknikit.

Ky grup përjashton aktivitetet sportive dhe artet dramatike, muzikën dhe artet dhe zbavitjet tjera.

### 93.21 Aktivitetet e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar

Kjo klasë përfshin aktivitetet e parqeve të argëtimit apo parqet e zbavitjes sipas dëshirës. Këtu përfshin punën e atraksioneve të llojllojshme, siç janë vozitjet mekanike, ngjarjet në ujë, lojërat, shfaqjet, ekspozitat tematike apo fushat e piknikut.

### 93.29 Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit

Kjo klasë përfshin aktivitetet lidhur me argëtimin dhe rekreacionin (përveç parqeve të zbavitjes dhe të atyre sipas motivit/dëshirës), jo të klasifikuara tjetërkund:
- punën (eksploatimin) e automateve të lojërave,
- aktivitetet e parqeve të rekreacionit (pa akomodim),
- punën e pajisjeve transportuese të rekreacionit, p.sh. porteve për jahte,
- operacioni i pistave të skijimit,
- sigurimin me qira të pajisjeve të hobit dhe të kënaqësisë, si pjesë integrale e pajisjeve rekreative,
- panairet dhe ekspozitat e karakterit rekreativ,

- aktivitetet e plazheve, përfshirë sigurimin me qira të pajisjeve, siç janë kabinat e plazhit, dollapët me çelës, karriget etj.,
- punën e podiumeve të vallëzimit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin aktivitetet e producentëve apo sipërmarrësve të ngjarjeve live, ndryshe nga ato të artit apo ngjarjet sportive, me apo pa pajisje.

Kjo klasë përjashton:

- funksionimin e teleferikëve, të atyre me kabllo, të lifteve të skijave dhe kabllove, shih 49.39,
- lundrimin për peshkim, shih 50.10, 50.30,
- sigurimin e hapësirës dhe të objekteve për qëndrim të shkurtër nga vizitorët në parqet e rekreacionit në pyje dhe në terrenet e kampingut, shih 55.30,
- parqet e rimorkiove, kampingjet e rekreacionit, kampingjet e gjuetisë dhe të peshkimit, lokacionet dhe fushat e kampingjeve, shih 55.30,
- diskotekat, shih 56.30,
- grupet teatrore dhe të cirkut, shih 90.01,

# Sektori S – AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE

Ky sektor (si një kategori e mbetur), përfshirë aktivitetet e organizatave të anëtarësimit, riparimin e kompjuterëve dhe të artikujve personal dhe shtëpiak, dhe një llojllojshmëri të aktivitetet shërbyese personale, që nuk janë të përfshira tjetërkund në klasifikim.

## 94 Aktivitetet e Shoqatave dhe Organizatave

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e organizatave që përfaqësojnë interesat e grupeve speciale, apo promovimin e ideve për publikun e gjerë. Këto organizata zakonisht zonën e tyre elektorale të anëtarëve, por aktivitetet e tyre mund të përfshijnë dhe të kenë përfitime edhe jo anëtarët. Thyerja kryesore e kësaj ndarje përcaktohet sipas qëllimit të shërbimit të organizatave, interesat e punëdhënësve, individëve të vetëpunësuar dhe të komunitetit shkencor (grupi 94.1), interesat e punonjësve (grupi 94.2) apo promovimin e ideve dhe të aktiviteteve religjioze, politike, kulturore, edukative apo rekreative (grupi 94.9).

### 94.1 Aktivitetet e Shoqatave dhe Organizatave Ekonomike, Punëdhënësve dhe Shoqatave Profesionale

Ky grup përfshin, aktivitetet e njësive që promovojnë interesat e anëtarëve të organizatave të biznesit dhe punëdhënësve. Në rastin e organizatave të anëtarësimit profesional, ky grup përfshin aktivitetet e promovimit të interesave profesionale të anëtarëve të profesionit.

#### 94.11 Aktivitetet e shoqatave dhe organizatave ekonomike, punëdhënësve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave, interesat e anëtarëve të cilëve fokusohen në zhvillimin dhe prosperitetin e ndërmarrjeve në një linjë të posaçme të biznesit apo tregtisë, përfshirë bujqësinë, apo mbi rritjen dhe klimën ekonomike të një zone të veçantë gjeografike apo nën ndarje politike, pa dallim të linjës së biznesit,
- aktivitetet e federatave të shoqatave të tilla,
- aktivitetet e odave ekonomike, shoqërive dhe organizatave të ngjashme.
- shpërndarjen e informatave, përfaqësimin para agjencive qeveritare, marrëdhëniet publike dhe negociatat e punës të organizatave të biznesit dhe të punëdhënësve.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e sindikatave, shih 94.20.

#### 94.12 Aktivitetet e shoqatave profesionale

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave, interesat e anëtarëve të të cilave përqendrohen kryesisht në një disiplinë të veçantë shkollore, apo praktikës profesionale apo fushës teknike, siç janë shoqatat medicinale, legale, të kontabilitetit, të inxhineringut, arkitektëve etj.,

- aktivitetet e asociacioneve të specialistëve të angazhuar në veprimtari shkencore, akademike apo kulturore, siç janë asociacionet e shkrimtarëve, piktorëve, interpretuesve të llojeve të ndryshëm, gazetarëve, etj.
- shpërndarjen e informatave, themelimin dhe mbikëqyrjen e standardeve të praktikës, përfaqësimin para agjencive qeveritare dhe marrëdhëniet publike të organizatave profesionale.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e shoqatave të diturisë.

Kjo klasë përjashton:

- arsimin e siguruar nga këto organizata, shih ndarjen 85.

## 94.2 Aktivitetet e Sindikatave të të Punësuarve

### 94.20 Aktivitetet e sindikatave të të punësuarve

Kjo klasë përfshin:

- promovimin e interesave të organizatave sindikale të punëtorëve.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e asociacioneve, anëtarët e të cilëve janë punonjësit e interesuar kryesisht në përfaqësimin e pikëpamjeve të tyre, lidhur me rrogën dhe gjendjen e punës dhe në veprimin e përbashkët përmes organizatave,
- aktivitetet e sindikatave të një uzine të vetme, të sindikatave të përbëra nga degët e ndara dhe të organizatave të përbëra nga sindikatat e ndara në bazë të profesionit, rajonit, strukturës organizative apo kritereve tjerë.

Kjo klasë përjashton:

- edukimin e ofruara nga këto organizata, shih ndarjen 85.

## 94.9 Aktivitetet e Organizatave të Tjera

Ky grup përfshin aktivitetet e njësive (përveç organizatave të biznesit dhe të punëdhënësve, organizatave profesionale, sindikatave) që promovojnë interesat e anëtarëve të tyre.

### 94.91 Aktivitetet e organizatave fetare

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave apo individëve fetar që ofrojnë shërbime drejtpërsëdrejti për besimtarët në: xhami, kisha, tempuj, sinagoga apo vendet tjera,
- aktivitetet e manastireve dhe të konakut,
- aktivitetet e vendstrehimeve  religjioze.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shërbimet fetare të funeralit.

Kjo klasë përjashton:

- edukimin e ofruar nga organizatat e tilla, shih ndarjen 85,
- aktivitetet shëndetësore nga organizatat e tilla, shih ndarjen 86,
- aktivitetet e punës sociale nga organizatat e tilla, shih ndarjet 87, 88.

### 94.92 Aktivitetet e organizatave politike

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave politike dhe të organizatave ndihmëse, siç janë ato të rinisë të lidhura me një parti politike. Këto organizata kryesisht angazhohen në influencimin e marrjes së vendimeve në organet publike të qeverisjes, duke i vënë anëtarët e partisë apo simpatizantët e partisë në shërbim të politikës dhe përfshihen në shpërndarjen e informatave, marrëdhënieve publike, grumbullimin e mjeteve etj.

### 94.99 Aktivitetet e organizatave tjera p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave që nuk i përkasin ndonjë partie politike, duke ndjekur një çështje apo kauzë publike me anë të edukimit të opinionit publik, influencës politike, grumbullimin e mjeteve etj.:
    - iniciativat e qytetarëve apo lëvizjet e protestave,
    - lëvizjet mjedisore dhe ekologjike,
    - organizatat e përkrahjes së komunitetit dhe të objekteve të shkollimit p.k.t.
    - organizatat për mbrojtjen dhe përmirësimin e kushteve të grupeve të veçanta, p.sh. grupeve etnike dhe të minoriteteve,
    - asociacionet për qëllime patriotike, përfshirë asociacionet e veteranëve të luftës;
- asociacionet e konsumatorëve,
- asociacionet e automobilistëve
- asociacionet për qëllime të njohjes sociale, siç janë klubet e rotarisë, lozhave etj.,
- shoqatat e të rinjëve, të studentëve, klubeve të vëllazërimit etj.,
- asociacionet për ndjekjen e një aktiviteti kulturor, rekreativ apo hobi (ndryshe nga sportet apo lojërat), p.sh., klubet e poezisë, letërsisë dhe librave, klubet e historisë, kopshtarisë, filmit dhe fotografisë, muzikës dhe artit, klubet e zanatit dhe të kolektorëve, klubeve sociale, klubeve të karnavaleve etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e dhënies së granteve nga organizatat e anëtarësimit.

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet bamirëse, siç janë mbledhja e fondeve të destinuara për kujdesin social shih 88.99,
- aktivitetet e grupeve apo organizatave profesionale artistike, shih 90.0,
- aktivitetet e klubeve sportive, shih 93.12,
- aktivitetet e asociacioneve profesionale, shih 94.12,

# 95 Riparimi i Kompjuterëve dhe Artikujve të Tjerë Personal dhe Shtëpiakë

Kjo ndarje përfshin, riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve periferike të kompjuterëve, siç janë desktopët, laptopët, terminalët kompjuterik, pajisjet e ruajtjes dhe printerët.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin riparimin e pajisjeve të komunikimit, siç janë fakset, radiot dy-lidhjeje dhe elektronikën e konsumatorit, siç janë radiot dhe televizorët, pajisjet shtëpiake dhe të kopshtit, siç janë kositëset e barit, ventilatorët, veshmbathjet dhe artikujt e lëkurës mobilet dhe pajisjet shtëpiake,

veshmbathjen dhe artikujt e saj, artikujt sportiv, instrumentet muzikore, artikujt e hobit dhe artikujt e tjerë personal dhe shtëpiak.

Nga kjo ndarje përjashton riparimi i pajisjeve mjekësore dhe të fotografimit diagnostik, instrumentet e matjes dhe të kontrollimit, instrumentet e laboratorit, pajisjet e radarit dhe të sonarit, shih 33.13.

## 95.1 Riparimi i Kompjuterëve dhe Pajisjeve të Komunikimit

Ky grup përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe pajisjeve tjera të komunikimit.

### 95.11 Riparimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike

Kjo klasë përfshin, riparimin e pajisjeve elektronike, siç janë kompjuterët, makineria kompjuterike dhe pajisjet periferike.
Kjo klasë përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e:

- kompjuterëve desktop,
- kompjuterëve laptop,
- periferikët e disketës magnetike, periferikët flesh dhe mjetet tjera të ruajtjes,
- periferikët e disketës optike (CD-RW, CD-ROM, DVD-ROM, DVD-RW),
- printerëve,
- monitorëve,
- tastaturave,
- minokëve, gjoistikëve dhe aksesorëve trakballit,
- modemëve internal dhe eksternal të kompjuterit,
- terminalëve të dedikuara të kompjuterit,
- serverëve të kompjuterit,
- skanerëve, përfshirë skanerët e bar-kodeve,
- lexuesve të smart-kartave,
- helmetetve të realitetitt virtual,
- projektorëve kompjuterik.

Kjo klasë gjithashtu përfshin riparimin dhe mirëmbajtjen e:

- kompjuterëve terminal, siç janë bankomatet (ATM), terminalet e pikave shitëse (POS), jo të operuara mekanikisht,
- kompjuterëve të dorës (PDA).

Kjo klasë përjashton:

- riparimin dhe mirëmbajtjen e modemeve të pajisjes bartëse, shih 95.12.

### 95.12 Riparimi i pajisjeve të komunikimit

Kjo klasë përfshin, riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimit siç janë:

- telefonat ajror,
- telefonat celular,
- modemet e pajisjes së transportit,
- pajisjet e telefaksit,
- pajisjet e transmisionit të komunikimeve (p.sh. ruterët, brigjet, modemët),
- radio marrëse dhe dhënëse,
- kamerat profesionale televizive dhe video kamerat.

# 95.2 Riparimi i Artikujve Personal dhe Shtëpiakë

Ky grup përfshin, riparimin dhe servisimin e artikujve personal dhe shtëpiak.

## 95.21 Riparimi i pajisjeve elektronike të konsumit të gjerë

Kjo klasë përfshin, riparimin dhe mirëmbajtjen e elektronikës së konsumatorit:

- riparimin e elektronikës së konsumit të gjërë si që janë :
  - televizorin, radio marrësit,
  - video kasetë rekorderët (VCR),videopaisjet
  - CD plejerat,
  - video-kamerat (vëzhguese)

## 95.22 Riparimi i pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve për shtëpi dhe të kopshtarisë

Kjo klasë përfshin, riparimin dhe servisimin e aparateve shtëpiake dhe të pajisjeve shtëpiake dhe të kopshtit:

- riparimi dhe servisimi i aparateve shtëpiake,
  - frigoriferëve, stufave, makinave larëse, tharësve të rrobave, klimatizuesit e dhomave, etj.;
- riparimin dhe servisimin e pajisjeve të shtëpisë dhe të kopshtit:
- kositëset e barit, mprehëset, pastruesit e borës dhe të gjetheve, makinat prerëse, etj.

Kjo klasë përjashton:

- riparimin e mjeteve të fuqisë me dorë, shih 33.12,
- riparimin e sistemit qendror të klimatizimit, shih 43.22.

## 95.23 Riparimi i këpucëve dhe artikujve prej lëkurës

Kjo klasë përfshin, riparimin dhe mirëmbajtjen e këpucëve dhe artikujve prej lëkure:

- riparimin e çizmeve, këpucëve, valixheve dhe të ngjashme,
- vënia e takave të këpucëve.

## 95.24 Riparimi i mobilieve dhe orendive shtëpiake

Kjo klasë përfshin:

- rimveshjen, riparimin dhe përmirësimin e mobileve dhe artikujve shtëpiak të mobilierisë, përfshirë mobilet e zyrave

## 95.25 Riparimi i orëve të dorës, të murit dhe argjentarisë

Kjo klasë përfshin:

- riparimin e orëve të dorës, murit dhe pjesëve të tyre, siç janë kutitë dhe shtëpizat e orëve të të gjitha materialeve, mekanizmat, kronometrat, etj.,
- riparimin e artikujve të argjendarisë dhe stolive.

Kjo klasë përjashton:

- gravurimin industrial të metaleve, shih 25.61.

- riparimin e orëve për matjen e kohës, vulave të kohës/datës, bravat me treguesin e kohës dhe aparate të ngjashme të incizimit të kohës, shih 33.13.

### 95.29 Riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiakë p.k.t.

Kjo klasë përfshin riparimin e artikujve personal dhe shtëpiak:

- riparimin e biçikletave,
- qepjen dhe riparimin e rrobave,
- riparimin e artikujve sportive (përveç pushkëve sportive) dhe pajisjeve të kampingut,
- riparimin e librave,
- riparimin e instrumenteve muzikore (përveç organove dhe instrumenteve historik muzikor),
- riparimin e lodrave dhe artikujve të ngjashëm,
- riparimin e artikujve të tjerë personal dhe shtëpiak,
- akordimi i pianos.

Kjo klasë përjashton:

- riparimin e pushkëve sportive dhe rekreative, shih 33.11,
- riparimin e mjeteve të dorës, shih 33.12.

# 96 Aktivitetet e Tjera Shërbyese

Kjo ndarje përfshin të gjitha aktivitetet shërbyese, jo të përmendur tjetërkund në klasifikim. Kjo veçanërisht përfshin llojet e shërbimeve, siç janë larjen dhe pastrimin kimik të produkteve të tekstilit dhe të gëzofit, parukerisë dhe trajtimit tjetër të bukurisë, aktivitetet e funeralit dhe të tjera.

## 96.0 Aktivitetet e Tjera Shërbyese

### 96.01 Larja (pastrimi kimik) dhe tharja e tekstileve dhe produkteve të gëzofit

Kjo klasë përfshin:

- larjen dhe pastrimin kimik, presingun etj., të të gjitha llojeve të rrobave të veshjes (përfshirë gëzofin) dhe tekstilit, e cila bëhet në mënyrë mekanike, me dorë ose të makinave rrobalarëse të vet shërbimit automatik, qoftë për publikun e gjerë, për klientët industrial apo komercial,
- mbledhjen dhe shpërndarjen e rrobave,
- larjen me shampon të qilimave dhe sixhadeve, artikujve të draperisë dhe të perdeve, qoftë në objektin e klientëve apo jo,
- ofrimin e çarshafëve, uniformave të punës dhe të artikujve tjerë nga vendet për rrobalarje
- shërbimet e larjes së pelenave.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin me qira të rrobave ndryshe nga uniformat e punës, madje edhe nëse pastrimi i këtyre artikujve është pjesë integrale e aktivitetit, shih 77.29,
- qepjen dhe riparimin e rrobave, shih 95.29.

### 96.02 Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë

Kjo klasë përfshin:

- larjen e flokëve, nënqethjen dhe prerjen, rregullimin, ngjyrosjen, dallgëzimin e flokëve dhe drejtësimin e flokëve të burrave dhe grave,
- rrojën dhe nënqethjen e mjekrës,
- masazhin e fytyrës, manikyrin dhe pedikyrin, grimin etj.

Kjo klasë përjashton:

- prodhimin e parukave, shih 32.99.

### 96.03 Shërbimet funerale dhe aktivitetet e lidhura me to

**Kjo klasë përfshin:**

- varrimin dhe djegien e kufomave të njerëzve dhe aktivitete të ngjashme:
    - përgatitjen e të vdekurit për varrim apo kremacion dhe shërbimet e balsamimit
    - të sipërmarrësve të varrimit,
    - ofrimin e shërbimeve të varrimit apo kremacionit,
    - sigurimi me qira i hapësirës së pajisur për funeral;
- sigurimin me qira apo shitjen e varreve,
- mirëmbajtjen e varrezave dhe të mauzoleve
- varrimin dhe djegien e kafshëve të ngordhura

Kjo klasë përjashton:

- rregullimin e varrezave, shih 81.30,

- aktivitetet shërbyese religjioze të funeralit, shih 94.91.

## 96.04 Aktivitetet e mirëmbajtjes trupore

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e banjove turke, saunave dhe banjove me avull, solariumet, sallonet e dobësimit, sallonet e masazheve etj.

Kjo klasë përjashton:

- masazhet dhe terapinë medicinale, shih 86.90,
- aktivitetet e klubeve të fitnesit dhe zhvillimit të trupit, shih 93.13.

## 96.09 Aktivitetet e tjera p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e astrologëve dhe të spiritualistëve,
- aktivitetet sociale siç janë shërbimet e përcjelljes, shërbimet e takim/njoftimit, shërbimet e byrove për martesë,
- shërbimet e kujdesit për kafshët përkëdhelëse siç është të ushqyerit, kujdesi dhe aftësimi i kafshëve përkëdhelëse,
- organizatat gjenealogjike,
- aktivitetet e tatuve dhe studiot për shpimin e veshëve
- lustraxhitë e këpucëve, derëtarët (hamallët), shërbëtori i parkingut të veturave etj.,
- aktivitetet në bazë koncesioni me aparate automatike të shërbimit personal (kabinat e fotografimit, peshoret e trupit, për kontrollimin e shtypjes së gjakut, dollapët me çelësa etj.).

Kjo klasë përjashton:

- aktivitetet e veterinarisë, shih 75.00,
- aktivitetet me rrobalarëse automatike, shih 96.01,
- aktivitetet me aparate automatike të bixhozit lojrave të fatit, shih 92.00.
- aktivitetet me aparate automatike për lojë

# Sektori T – AKTIVITETET E EKONOMIVE FAMILJARE SI PUNËDHËNËS; MALLRAT DHE SHËRBIMET E PADIFERENCUARA, AKTIVITETET E EKONOMIVE FAMILJARE PËR PËRDORIM VETANAK

## 97 Aktivitetet e Ekonomive Familjare si Punëdhënës të Personelit Vendor

### 97.0 Aktivitetet e Ekonomive Familjare si Punëdhënës të Personelit Vendor

#### 97.00 Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës të personelit vendor

Kjo klasë përfshin aktivitetet e shtëpiakëve, si punëdhënës të personelit vendas, siç janë shërbyesit, kuzhinierët, kamerierët, shërbëtorët e dhomave, kryeshërbëtorët, rrobalarësit, kopshtarët, dertarët, shtallarët, shoferët, kujdestarët, kujdestare fëmijësh, mësuesit, sekretarët etj.

Kjo klasë lejon personelin e punësuar vendas të shprehin (deklarojnë) aktivitetin e punëdhënësit të tyre në regjistrime, apo studime, madje edhe nëse punëdhënësi është një individ. Produkti i nxjerr nga ky aktivitet, konsumohet nga shtëpiaku që punëson.

Kjo klasë përjashton:

- sigurimin e shërbimeve, siç janë përgatitjen e gjellëve, kopshtarinë etj., nga siguruesit e shërbimeve të pavarura (kompanitë apo individët), shiko sipas llojit të shërbimeve.

## 98 Aktivitete të Prodhimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Ndryshme të Familjeve për Përdorim Vetanak

Kjo ndarje përfshin, mallrat e rëndësishëm të padiferencuara, që prodhojnë shërbime dhe aktivitete të shtëpiakëve.

Shtëpiakët duhet të klasifikohen këtu vetëm nëse është e mundshme të identifikojnë një aktivitetet primar, për aktivitetet e ekzistencës të shtëpiakut. Nëse shtëpiaku angazhohet në aktivitetet e tregut, ai duhet të klasifikohet sipas aktivitetit të kryer primar të tregut. Mallrat e padiferencuara që prodhojnë aktivitetet e shtëpiakëve privat për shfrytëzimin vetanak.

### 98.1 Aktivitetet e Prodhimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Ndryshme të Familjeve për Përdorim Vetanak

#### 98.10 Aktivitetet e prodhimit të mallrave të ndryshme të familjeve për përdorim vetanak

Kjo klasë përfshin, artikujt ekzistencial të padifirencuar që prodhojnë aktivitete të shtëpiakëve, d.m.th., aktivitet të shtëpiakëve që angazhohen në aktivitete të ndryshme që prodhojnë mallra për

ekzistencën e vet të tyre. Këto aktivitete përfshin, gjuetinë dhe grumbullimin, blegtorinë, prodhimin e strehimoreve dhe të veshjes si dhe të artikujve tjerë të prodhuara nga shtëpiaku për ekzistencën e tij.

Nëse shtëpiakët janë po ashtu të angazhuar në prodhimin e artikujve të tregtuar, ata klasifikohen në industrinë e duhur të NACE-s për prodhimin e artikujve. Nëse ata parimisht angazhohen në një aktivitetet specifik të ekzistencës për prodhimin e artikujve, ata klasifikohen në industrinë e duhur të NACE-s për prodhimin e artikujve.

## 98.2 Aktivitetet e Prodhimit të Shërbimeve të Ndryshme të Familjeve për Përdorim Vetanak

### 98.20 Aktivitetet e prodhimit të shërbimeve të ndryshme të familjeve për përdorim vetanak

Kjo klasë përfshin aktivitetet e prodhimit të shërbimeve ekzistenciale të padiferencuara të shtëpiakëve. Këto aktivitete përfshin zierjen e gjellëve, të mësuarit, kujdesin për anëtarët e shtëpisë dhe shërbimet tjera të prodhuara nga shtëpiaku për ekzistencën e vet.

Nëse shtëpiakët angazhohen po ashtu në prodhimin e artikujve të shumëfishtë për qëllime të ekzistencës, ata klasifikohen në aktivitetet e padiferencuara të prodhimit të artikujve ekzistencial të shtëpiakëve.

# Sektori U – AKTIVITETET E TRUPAVE DHE ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

## 99 Aktivitetet e Trupave dhe Organizatave Ndërkombëtare

### 99.0 Aktivitetet e Trupave dhe Organizatave Ndërkombëtare

### 99.00 Aktivitetet e trupave dhe organizatave ndërkombëtare

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, siç janë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të sistemit të Kombeve të Bashkuara, organizmat rajonal etj., Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Organizata Botërore e Doganave, Organizata për Zhvillim dhe Kooperim Ekonomik, Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës, Komunitetet Evropiane, Asociacioni Evropian i Tregtisë së Lirë etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e misioneve diplomatike dhe konsullore, kur ato caktohen nga vendi i tyre që ata përfaqësojnë.

Linku për Rregulloren për Implementimin e Standartit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NACE Rev. 2.:

http://ask.rks-gov.net/images/files/RREGULLORE_Nr11_2013_PER_IMPLEMENTIMIN_E_STANDARTIT_PER_KLASIFIKIMIN_E_VEPRIMTARIVE_EKONOMIKE_NE_VERSIONIN_NACE_Rev.pdf

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

330:311

Klasifikimi i veprimtarive ekonomike : (NACE Rev.2) / [kryeshefi ekzekutiv Isa Krasniqi].– Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014.- 406 f. : ilustr. me ngjyra ; 30 cm.

1. Krasniqi, Isa

**ISBN 978-9951-22-136-8**